FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 66

Tiranë – E mërkurë, 19 prill 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 208, datë 13.4.2023	Për emërim në detyrë.....	7661
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 13.4.2023	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit".....	7661
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 13.4.2023	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Habitatet".....	7700
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 13.4.2023	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Infrastruktura industriale".....	7739
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 13.4.2023	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria *"Suntech Power"* sh.p.k.....	7790
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 13.4.2023	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria *"A Great Company"* sh.p.k.....	7792
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 13.4.2023	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria "*Nikolica Ski Resort*" sh.p.k.....	7794
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.4.2023	Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim	7796

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 13.4.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1039, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave për emetimin, prodhimin, përdorimin dhe tregtimin e pullës postare shqiptare".....	7799
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 13.4.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim i qendrës shëndetësore në lagjen 'Gafurr Muço', Bashkia Lushnjë".....	7800
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 13.4.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i sheshit përpara degës së thesarit Tiranë, rruga 'Mustafa Lleshi'".....	7802
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 221, datë 13.4.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni", të ndryshuar.....	7805
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 13.4.2023	Për një shtesë në numrin e punonjësve organikë në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2023, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, miratuar për vitin 2023	7805
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 13.4.2023	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për një hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e projektit të rehabilitimit të rrugës së lumit të Vlorës, ratifikuar me ligjin nr. 47/2020.....	7806
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 13.4.2023	Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023.....	7810
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 13.4.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 110, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre".....	7837
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 13.4.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".....	7839
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 45, datë 12.4.2023	Për përcaktimin e tarifave të shërbimit për aplikim për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit, kulturës, arsimit, shkencës dhe sportit.....	7849
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Brendshëm nr. 46, datë 13.4.2023	Për përcaktimin e procedurës për asgjësimin e sendeve të sekuestruara, afatit, si dhe organit kompetent për asgjësimin e tyre...	7849
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 80, datë 9.2.2023	Për miratimin e formularit të veçantë për aplikimin e autonomisë spitalore dhe përcaktimin e sistemit të pikëzimit.....	7851

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 201, datë 6.4.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë..	7855
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 204, datë 6.4.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Maqedonia e Veriut.....	7855
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 213, datë 7.4.2023	Për ndalimin e peshkimit në liqenet e Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit.....	7858
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 225, datë 12.4.2023	Për delegim kompetencash.....	7859
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 10.3.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 253 regjistri, datë 11.11.2020; nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	7859
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 15.3.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-883, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	7871
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 128/7, datë 13.4.2023	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Rehabilitimi i rrugës së ish-Repartit Ushtarak për në aeroportin e Rinasit'".....	7881
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Eda Hasani.....	7881

VENDIM
Nr. 208, datë 13.4.2023

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Enkelejdi Joti emërohet zëvendësministër i Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 210, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI - TEMA: "INFRASTRUKTURA PËR MONITORIMIN E MJEDISIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja "o", e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Infrastruktura për monitorimin e mjedisit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI
TEMA: "INFRASTRUKTURA PËR MONITORIMIN E MJEDISIT"

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE
2. HYRJE
2.1 Qëllimi
2.2 Si lexohet dokumenti
2.3 Detyrimet ligjore
2.4 Fusha e veprimit
3. TEMA
3.1 Infrastruktura për monitorimin e mjedisit
3.1.1 Parathënie
3.1.2 Skemat e aplikimit dhe diagrami UML për temën *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*
3.1.3 Katalogu i tipologjive
3.1.3.1 Aktiviteti i monitorimit të mjedisit
3.1.3.2 Hierarkia
3.1.3.3 Lidhjet me domein
3.1.3.. Kapaciteti i monitorimit
3.1.3.5 Objekti i monitorimit
3.1.3.6 Periudha e aktivitetit operacional
3.1.3.7 Programi i monitorimit të mjedisit
3.1.3.8 Rrjeti i monitorimit të mjedisit
3.1.3.9 Raportimi në aktin ligjor
3.1.3.10 Infrastruktura për monitorimin e mjedisit
3.1.3.11 Rrjeti i infrastrukturës
3.1.3.12 Tipologjia e monitorimit
3.1.3.13 Vlerat e elementeve të monitorimit
3.1.3.14 Vlerat e qëllimit të grumbullimit
3.1.3.15 Vlerat e llojit të procesit
3.1.3.16 Vlerat e rezultatit në burim
3.1.3.17 Vlerat e natyrës së rezultatit
3.1.3.18 Vlerat e specializuara të llojit të infrastrukturës për monitorimin e mjedisit
3.1.3.19 Vlerat e matjes së regjimit
3.2 Metadata
3.3 Kodi EPSG për KRGJSH-në

3.4 Cilësia e të dhënave
3.4.1 Përputhja ligjore - Përputhja konceptuale *(Logical consistency – Conceptual consistency)*
3.4.2 Përputhja ligjore - Përputhja me domeinin *(Logical consistency – Domain consistency)*
4. ANEKSE
4.1 Aneksi A - Katalogu i tipologjive
4.2 ANEKSI C - Kodlistat
4.2.1. Skema e aplikimit për temën *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*
4.2.1.1 Vlerat e matjes së regjimit
4.2.1.2 Vlerat e elementit të monitorimit
4.2.1.3 Vlerat e llojit të procesit
4.2.1.4 Vlerat e rezultatit në burim
4.2.1.5 Vlerat e natyrës së rezultatit

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI-së. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), e cila është autoritet publik përgjegjës, për temën *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit.*

Data e publikimit të versionit nr. 1 është 20 dhjetor 2019. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2019_ IMM_v.1, ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2019 – Viti i krijimit

IMM – Tema për të cilën është krijuar standardi: *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*, e cila i referohet temës "*Environmental Facilities*" të direktivës INSPIRE

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, për të dhënat gjeohapësinore të temës; *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/o, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI[1] në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmëri midis tyre.

2.2 SI LEXOHET DOKUMENTI

2.2.1 STRUKTURA E DOKUMENTIT

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. Hyrje – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

3. Tema – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit.*

4. Anekse – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

- Përmbajtja e kapitullit të 3-të është strukturuar në 4 pjesë kryesore:

3.1 Përshkrimi i temës – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës, si dhe detajohen: Diagramet UML dhe katalogu i tipologjive.

3.2 Metadata – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.3 Sistemi Koordinativ Referencë – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë (KRGJSH)

3.4 Cilësia e të dhënave – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 DIAGRAMET UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në "Katalogun e tipologjive" *(Feature Catalogue).* Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave,

[1] NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.

duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i tipologjive, mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e kodlistave.

Tabela 1

EMRI - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	**Tipi i elementit** që mund të jetë i këtyre llojeve: «**FeatureType**», një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte «**DataType**», një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë atributesh, për t'u lidhur me një element tjetër. «**Enumeration**» "codeList", listë e parapërgatitur vlerash, ku elementi duhet të marrë vlerë. *Enumeration* nënkupton "renditje vlerash", ndërsa *codeList* nënkupton listë vlerash ose ndryshe "kodlistë". Në dokument gjenden të shqipëruara, si "Numërtimet dhe kodlistat". «**Union**», një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet, të cilat bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dy grupeve të të dhënave hyrëse. «**Imported**», të dhëna të specifikuara në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden të shqipëruara, si "Të dhënat e importuara".
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: **pikë, linjë, poligon.** **"Abstrakt**", kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë; 1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera; 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme; 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë.
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet. Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet.
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve "Rol-shoqërime" tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit **-- Përkufizimi --** Përkufizimi i elementeve **-- Përshkrimi --** Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh.: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh.: ***Ligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi i elementeve
Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh.: ***Joligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi i elementeve

2.2.3 KARAKTERISTIKAT <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<*voidable*>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në realitet. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat, e përcaktuara për objektet gjeohapësinore, duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera "*void*". Një vlerë "*void*" nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës "*void*" duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArsyesSëPavlefshmërisë (VoidReasonValue),* e cila përmban:

- ***E panjohur*** *(Unknown)*

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrimi --

Shembull. Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit" e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë "E panjohur".

- ***E papopulluar*** *(Unpopulated)*

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull. Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit" nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë "E papopulluar"

- ***Konfidenciale*** *(Withheld).*

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull. Të dhënat personale të popullsisë, të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi <<voidable>> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në realitet. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh., nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh., nëse një njësi administrative

ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4 MBULIMET – *COVERAGES*

Funksionet e mbulimit *"Coverages"* përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh., vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh., izolinjat), rrjetet (p.sh., ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është realizim i një prej llojeve të specifikuara në SSH EN ISO 19123.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh., ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik, për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptual të Përgjithshëm *"Generic Conceptual Model"*.

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *RrjetiIMbulimitIKorrigjuar (rektifikuar)*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 1, majtas).

- *RrjetiIMbulimitReferencë*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.



Figura 1: Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5 NUMËRTIMET DHE KODLISTAT *(ENUMERATION AND CODE LIST)*

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistën, "vlera të tjera" përcaktohet lloji i përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht, si më poshtë:

- ***"jo"*** përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë dokument;

- ***"të kufizuara"*** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;

- ***"të hapura"*** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

- ***"po"*** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese, të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera **"*jo*"**, pra të specifikuara në dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin "*FillimiICiklitJetësor*" dhe "*PërfundimiICiklitJetësor*" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi "*FillimiICiklitJetësor*" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi "*PërfundimiICiklitJetësor*" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në realitet.

Ndryshimet që bëhen në atributin "*PërfundimiICiklitJetësor*" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "*FillimiICiklitJetësor*".

- Shënim i rëndësishëm

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType, Void, Coverages etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike, sipas termave të direktivës INSPIRE.

2.3 DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*", ASIG është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, për secilën nga temat e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI-së në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit – IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- Metadata – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (sikurse është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë (VKM nr. 1077, datë 23.12.2015).

- Specifikimi i të dhënave – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë atribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:



Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi (Përpunimi) – Është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen, arkivohen, duke u bazuar në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi të vendit ku implementohet standardi. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të paaksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen, për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde kombëtare ose legjislacionin në fuqi.

3. TEMA

3.1 Infrastruktura për monitorimin e mjedisit

3.1.1 Parathënie

Tema *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* përfshin vendndodhjen, funksionimin, vëzhgimin dhe matjet e shkarkimeve në stacionin e monitorimit, si dhe gjendjen e parametrave mjedisorë dhe të ekosistemeve (biodiversiteti, kushtet ekologjike të bimësisë etj.), realizuar nga, apo në emër të autoriteteve publike.

Kjo temë përfshin dy aspekte kryesore, që janë: stacionet e monitorimit të mjedisit, si objekte gjeohapësinore, si dhe të dhënat e marra përmes vëzhgimeve dhe matjeve të kryera në këto objekte.

Tema *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* është ndërvepruese në fushat tematike mjedisore, kështu që modeli i përgjithshëm lejon lirinë për të sjellë nevoja specifike dhe tematike, duke mbajtur një strukturë të përbashkët të të dhënave.

Nënfusha tematike mjedisore e përcaktuar nga tema e të dhënave gjeohapësinore *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* është ndërlidhëse, për çdo zonë tematike që merret me mjedisin, dhe se qëllimet mund të arrihen nga sondazhet dhe marrjet e mostrave me metoda të ndryshme, deri nga satelitët. Fokusi është në objektet e monitorimit mjedisor, si dhe në elementet lidhëse midis temave të tjera të të dhënave gjeohapësinore, si vëzhgimet dhe matjet në aspektet specifike të mjedisit (p.sh. cilësia e ajrit, kushtet atmosferike, cilësia e ujit etj.).

Specifikimi i të dhënave në këtë temë përpiqet të adresojë dy dimensione. Nga njëra anë, objektet e monitorimit mjedisor janë të lidhura me informacionin që përshkruan grupin e stacioneve të monitorimit për nënfushën e caktuar. Nga ana tjetër, objektet e monitorimit mjedisor lidhen me vëzhgimet dhe matjet e kryera. Kjo pjesë e specifikimit të të dhënave do të mbulohet duke përdorur në standard vëzhgime dhe matje të përshtatura për një strukturë të përbashkët të përdorur në specifikimin e të dhënave INSPIRE, në të gjitha fushat tematike.

Specifikimi i të dhënave krijon mundësinë për të zbatuar modelin konceptual, sipas nevojave funksionale të shteteve. Mënyra të ndryshme të lidhjes së objekteve të monitorimit mjedisor, që shprehen sipas niveleve hierarkike, marrëdhëniet gjenealogjike në ndonjë lidhje tematike, të cilat japin mundësinë për të ofruar informacione në nivelin e duhur të detajeve/grumbullimit dhe një

organizim të mirë për nevojat tematike. Dokumentimi i legjislacionit në të gjitha nivelet, nga ai lokal në atë evropian apo global, është një informacion thelbësor për monitorimin e aktiviteteve. Lidhjet nga objektet e monitorimit mjedisor me raportimin mjedisor janë të përfshira në modelin konceptual të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*.

Modeli konceptual i të dhënave, në këtë version të specifikimit të të dhënave, është zhvilluar përmes disa hapave drejt një qasjeje të përgjithshme, por të shkallëzueshme. Modeli i ofruar është një kornizë e përbashkët brenda së cilës duhet të përshkruhet tema *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit,* në një mënyrë të përbashkët në zonat e territoreve, ndërsa harmonizimi për aspektet e hollësishme mbetet me aspektet e fushës.

Synimi i përgjithshëm për specifikimin e të dhënave për temën *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* është të ofrojë një model të përgjithshëm i cili mund të përdoret në fusha të ndryshme dhe ofrimi i lirisë së nevojshme për fushat tematike, për të sjellë nevoja specifike, duke mbajtur një strukturë të përbashkët. Pra, specifikimi i të dhënave siguron një strukturë të përbashkët por jo një harmonizim tematik në të gjitha fushat.

Struktura mund të duket komplekse, por mundëson që komunitetet të specifikojnë lehtësirat e monitorimit mjedisor me vëzhgime dhe matje të lidhura me nivelin e duhur të detajeve që është e rëndësishme për shkëmbimin e të dhënave. Ky dokument specifik përpiqet të ruajë ekuilibrin midis të qenët (i përshtatshëm dhe i zotërueshëm) dhe jo të qenët abstrakt dhe i lexueshëm nga ekspertët. *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* përcakton gjuhën e vetme, e cila duhet të përdoret për fushat ndërlidhëse dhe kjo ofron një mundësi për të hyrë në informacione me këndvështrim ndërdisiplinor.

Specifikimi i të dhënave të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*

Përshkrimi i *Infrastrukturës për monitorimin* e *mjedisit* është një element themelor për të lidhur vëzhgimet dhe matjet me një veçori gjeohapësinore. Objektet e monitorimit mund të grupohen në rrjetet e monitorimit, pasi një numër objektesh u përkasin programeve monitoruese me perspektivë afatgjatë (kryesisht të nxitura nga legjislacioni) ose mund të përfshihen në aktivitete specifike monitorimi.

Legjislacioni është një element themelor për krijimin e lehtësirave për monitorimin e mjedisit i cili siguron informacion të rëndësishëm për autoritetet publike që merren me mjedisin. Meqë vëzhgimet dhe matjet janë të lidhura me strukturën e monitorimit mjedisor, kontribuojnë në çdo lloj raportimi (të detyrueshëm apo vullnetar), kjo lidhje përfshihet në specifikimin e të dhënave për të krijuar një marrëdhënie midis objekteve të monitorimit mjedisor dhe raporteve që duhen dorëzuar ose dhënë. Kjo ka për qëllim të mbështesë opsionalisht raportimin elektronik në të ardhmen.

Specifikimet e të dhënave mbulojnë të gjitha llojet e monitorimit mjedisor, duke përdorur stacione fikse, pajisje lëvizëse ose sensorë të largët, të cilët mund të zbatohen për nevojat tematike të fushave të ndryshme.

Të drejtat e aksesit dhe mbrojtja e të dhënave në pikat e nivelit të vëzhgimit të stacionit është një aspekt mjaft i rëndësishëm për monitorimin specifik, si mbrojtja e natyrës dhe monitorimi i biodiversitetit. Publikimi i stacionit të objektit të monitorimit mund të ndryshojë pikën e vëzhguar dhe për këtë arsye e kryen vetë monitorimin.

Aspektet që lidhen me nivelin e përshtatshëm të detajeve dhe shkëmbimin e të dhënave të informacionit janë pjesë e organizimit të *Infrastrukturës për monitorimin e mjedisit*. Aspektet e tjera që lidhen me të drejtat e aksesit dhe mbrojtjen e të dhënave janë jashtë mjeteve mbrojtëse.

Nuk mbulohen nga specifikimet e të dhënave të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*:

- Kuptimi i strukturës specifike dhe përshtatja e elementeve të tyre.

- Udhëzues për nivelin e duhur të detajeve, pasi ky është specifik i fushës së studimit.

- Shembuj që mbulojnë fushat tematike, të adresuara nga temat e tjera të INSPIRE, si ekspertizë domeini nuk është në dispozicion të infrastrukturës për monitorimin e mjedisit.

- Menaxhimi i saktë i të drejtave të aksesit dhe mbrojtja e të dhënave nuk është objekt i këtij specifikimi të dhënash.

3.1.2 SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAME UML PËR TEMËN *INFRA-STRUKTURA PËR MONITORIMIN E MJEDISIT*

Skema e aplikimit të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* përfshin dy aspekte, që janë: përshkrimi i një objekti, si dhe monitorimi dhe lidhja për vëzhgime dhe matje. Skema ndjek një trajtë të përgjithshme, e cila duhet t'u mundësojë komuniteteve tematike të përdorin këtë strukturë në fushat përkatëse. Specifikimet dhe përkufizimet ofrojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për fushat tematike për të sjellë të dhënat e tyre. Për të mos krijuar një bashkësi tematike, elementet e zakonshme janë të përcaktuar në specifikimin e të dhënave, janë mbajtur në minimum dhe janë zvogëluar në elemente të cilat shihen si thelbësore për të hyrë në objektet e monitorimit mjedisor, në një mënyrë të përbashkët dhe për të mbajtur një emërues të përbashkët nëpër domeine. Kërkesat tematike të domeineve janë shumë të ndryshme dhe harmonizimi nëpër tema është kompleks. Dimensioni i harmonizimit specifik të temës/domeinit nuk është nënvlerësuar dhe mbetet me përparësi të lartë, në lidhje me shkëmbimin e të dhënave të rëndësishme, por nuk mund të mbulohet nga skema e aplikimit të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*. Kjo do të përfshijë përdorimin e domeinit të kodeve dhe kërkesave të përbashkëta për të ofruar informacione për objektet e monitorimit mjedisor. Nga ky këndvështrim, specifikimi i të dhënave të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* duhet të mbulojë kërkesat nga fusha specifike e domeinit, por, gjithashtu, të sigurojë një mundësi për zhvillimet e ardhshme.

Tema *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* përfshin aspektin e përshkrimit të shërbimit të monitorimit mjedisor. Linku për vrojtimin dhe matjet përfshihet në modelin e ofruar, por duke u adresuar nga një udhëzim që përfshin referenca të sakta.

Skema e aplikimit të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* përmban 4 lloje objektesh gjeohapësinore:

- Programi i monitorimit të mjedisit;
- Aktiviteti i monitorimit të mjedisit;
- Rrjeti i monitorimit të mjedisit;
- Infrastruktura për monitorimin e mjedisit;

Infrastruktura për monitorimin e mjedisit është lloji qendror i objektit gjeohapësinor për të dyja aspektet e temës. Përshkrimi përqendrohet në shpjegimin e llojeve të objekteve gjeohapësinore, siç u përmendën më sipër, për të shpjeguar marrëdhëniet e tyre, si dhe për lidhjen me vrojtimet dhe matjet. Për arsye modelimi, dy kategoritë abstrakte janë futur në grupin e atributeve, të përbashkëta të ndara, midis llojeve të objekteve gjeohapësinore.

Ideja e përgjithshme e modelit të dhënë është që secili domein mund të vendosë bazuar në kërkesat specifike, se cili nivel i detajeve është më i përshtatshëm. Modeli nuk nënkupton një nivel të detyrueshëm të detajeve, por jep mundësinë për ta kryer aty ku është më e përshtatshme.



Figura 3: Ndërlidhja e diagrameve me skemën e aplikimit të temës "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit"



Figura 4: Diagrami UML: Përshkrimi i skemës së aplikimit të temës "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit"

Infrastruktura për monitorimin e mjedisit

Ekzistenca gjeohapësinore e temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* është rezultat i informacionit të modeluar në këtë temë, por edhe në dy kategori abstrakte të përmendura më lart. Përshkrimi i infrastrukturës për monitorimin e mjedisit ndan elementet me llojet e tjera të objektit gjeohapësinor të këtij modeli dhe këto atribute janë modeluar në kategori abstrakte, si të gjitha llojet e tjera të objekteve gjeohapësinore. *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* ka një atribut gjeometrik si pikë përfaqësuese për të lehtësuar nevojën për të pasur një paraqitje të pikës në kontekstin tematik. Një strukturë e monitorimit të mjedisit mund të jetë fikse, e lëvizshme ose e bashkëngjitur me një tjetër. Meqenëse infrastruktura për monitorimin mjedisor mund të përshkruhet në nivele të ndryshme detajesh, modeli ofron një lidhje hierarkike. Kjo pasqyron faktin se një stacion mund të ketë pjesë të ndryshme ose një platformë në të cilën mund të jenë një numër sensorësh ose pajisjesh matëse, duke u modeluar si një lidhje atributesh "hierarkike".



Figura 5: Skema e aplikimit të hierarkisë së temës "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit"

Për rastet kur *infrastruktura e monitorimit të mjedisit* është duke përfunduar funksionimin e saj dhe mbivendoset nga një tjetër, modeli i lidhjes gjenealogjike është modeluar. Kjo lidhje reflekton që infrastruktura për monitorimin e mjedisit zëvendësohet nga një tjetër. Arsyeja kryesore për ta integruar këtë në modelin tonë është të sigurojmë një mekanizëm i cili siguron që vëzhgimet në lidhje me mjedisin mund të interpretohen si seri dhe vazhdimësi nga një këndvështrim tematik.



Figura 6: Skema e aplikimit të lidhjes gjenealogjike brenda një hierarkie të temës "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit"

Lidhja tematike është modeluar për të pasqyruar çështjen që në grupe të ndryshme tematike është e nevojshme të kryhen lidhje midis *infrastrukturës për monitorimin e mjedisit,* për të krijuar një lidhje të pavarur nga lidhjet hierarkike ose gjenealogjike. Për shembull, kur një strukturë për monitorimin e sasisë së ujit ka të bëjë me një stacion monitorimi në rrjedhën e sipërme, të cilësisë së ujit. Lidhja e modeluar ofron një mundësi për bashkësitë tematike, që lidhin *infrastrukturën për monitorimin e mjedisit,* në përputhje me nevojat e tyre specifike të brendshme.

Përpunimi i avancuar i grumbullimit të automatizuar, duke filluar nga niveli më i lartë i detajeve dhe i kufizimeve, se si të zhvillohet grumbullimi, i cili është në përgjegjësinë e plotë të ekspertëve tematikë dhe, për këtë arsye, nuk mund të jetë pjesë e modelit të temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit,* i cili duhet të qëndrojë në aspekt të përgjithshëm.



Figura 7: Diagrami UML i nxjerrë nga skema e aplikimit të temës "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit"

***Rrjeti i monitorimit të mjedisit*:**

RrjetiIMonitorimitTëMjedisit është një lloj objekti gjeohapësinor në modelin përkatës, me një numër në *infrastrukturën e monitorimit mjedisor*. Është e mundur të sigurohen informacione për nivelin e grumbulluar të një rrjeti të monitorimit mjedisor, duke përfshirë mundësinë për të pasur kaskada të rrjeteve dhe nënrrjeteve. Një strukturë e *infrastrukturës së monitorimit mjedisor* mund t'u përkasë rrjeteve të ndryshme të monitorimit, p.sh., duke qenë pjesë e një rrjeti rajonal dhe kombëtar.



Figura 8: Diagrami UML i nxjerrë nga skema e aplikimit "Rrjetet e monitorimit të mjedisit"

Programi i monitorimit të mjedisit

Programi i monitorimit të mjedisit është një përshkrim i rëndësishëm për politikën që përcakton objektivin për grumbullimin e vrojtimeve/vendosjen e *infrastrukturës për monitorimin e mjedisit* në këtë fushë. Programi i monitorimit të mjedisit ka një perspektivë afatgjatë për të paktën disa vjet. Program i monitorimit të mjedisit mbulon një zonë interesi (p.sh., një rajon) dhe bazohet në legjislacionin mjedisor. Përshkrimi i këtij lloji të objektit gjeohapësinor ofron një pasqyrë të qartë dhe mund të përdoret për vlerësimin e politikave.

Informacioni i lidhur me programin e monitorimit të mjedisit është i rëndësishëm edhe nëse lokacioni i objekteve është i fshehur. Ai siguron një pikë hyrjeje të përgjithshme për informacionin e monitorimit të mjedisit me një pamje të përgjithshme ku mund të zbatohet nga domeine të kryqëzuara. Niveli i detajeve të vëna në dispozicion është në domeinin tematik, por jo i shkaktuar nga skema e aplikacionit. Klasa *ObjektiIMonitorimit* modelon të gjitha elementet e përbashkëta midis *Infrastrukturës për monitorimin e mjedisit, Rrjetit të monitorimit të mjedisit* dhe *Programit të monitorimit të mjedisit*. Këto atribute ofrojnë një emërues të përbashkët midis llojeve thelbësore të objekteve gjeohapësinore dhe lejojnë një grupim ose qasje duke përdorur të njëjtat atribute.



Figura 9: Diagrami UML i nxjerrë nga skema e aplikimit "Programi i monitorimit të mjedisit"

Aktiviteti i monitorimit të mjedisit:

Skema e aplikimit të *Aktiviteti i monitorimit të mjedisit* shpreh nevojën për të përshkruar fushat e monitorimit mjedisor që kryhen me pajisje specifike për një periudhë të caktuar kohore.

Shembull mund të jetë një lundrim kërkimor i një anijeje me pajisje monitorimi në oqean ose fluturime nga një aeroplan që ka sensorë të ndryshëm për vëzhgimet në ajër. Këta shembuj tregojnë rëndësinë e lartë për objektet e lëvizshme të monitorimit të mjedisit, në lidhje me një perspektivë afatgjatë të programeve të monitorimit mjedisor. *Aktiviteti i monitorimit të mjedisit* modelohet si një lidhje ndërmjet *Infrastrukturës për monitorimin e mjedisit* dhe *Rrjetit për monitorimin e mjedisit* për një kohë specifike, në *Programin e monitorimit të mjedisit,* duke përdorur kategorinë abstrakte të *TipologjiaEMonitorimit* si elementi i tyre i përbashkët.



Figura 10: Diagrami UML i nxjerrë nga skema e aplikimit "Aktiviteti i monitorimit të mjedisit"

Një pjesë thelbësore e temës *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* lidhet me vrojtimet dhe matjet e marra në një strukturë të shërbimit mjedisor. Lidhja me kategorinë *Vrojtimi* pasqyron lidhje të drejtpërdrejtë, e cila është e mundur nga çdo infrastrukturë për monitorimin e mjedisit ose rrjet i monitorimit të mjedisit. Kategoria *KapacitetiIMonitorimit* është modeluar për të treguar nevojën që një regjim matjeje të përshkruhet pa siguruar vetë vlerën e vëzhguar ose të matur. Kategoria përmban atribute për të përshkruar kohën operacionale për një regjim matjeje, një vlerë të llojit të procesit për të bërë dallimin midis *Procesit* dhe *Sensorit* si tregues i asaj që pritet të ketë lidhje me procesin, *VleraENatyrësSëRezultatit,* të cilat janë të dhëna parësore, të dhëna të përpunuara ose që vijnë nga

modele të ngjashme dhe në rast se është në dispozicion informacioni që regjimi i matjes është krijuar për të shërbyer në mënyrë specifike nga një raportim detyruar.

Së bashku me lidhjen *Vrojtimi* kategoria *KapacitetiIMonitorimit* krijon një lidhje të qëndrueshme nga tema *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit* për vëzhgimet dhe matjet. Përputhjet duhet të sigurohen midis lidhjeve nga kategoritë e *KapacitetiIMonitorimit* dhe *Vrojtimit*. Pra, nëse një vrojtim është i lidhur me një i*nfrastrukturë për monitorimin e mjedisit*, edhe ky objekt duhet të ketë një përshkrim të aftësisë monitoruese. *KapacitetiIMonitorimit* duhet t'i referohet *Fenomenit* dhe *Procesit* identik si *Vrojtimi*. Domeini duhet të jetë identik ose në disa raste, domeini i vrojtimit është një tipologji e domeinit të *KapacitetiIMonitorimit*.



Figura 11: Diagrami UML i nxjerrë nga skema e aplikimit "Kapaciteti i monitorimit dhe vëzhgimi"

Këtu paraqiten ato pjesë të adresuara të skemës së aplikimit të temë *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit,* që kanë të bëjnë me vrojtimet dhe matjet e kryera te shërbimi.

Roli i *Vrojtimit* duhet të zbatohet, si më poshtë:

- të mos përdoret asnjë vlerë nëse nuk ka vrojtim në stacion (d.m.th. ai nuk është akoma funksional).
- përdorimi "të pavlefshme" dhe "jo populluar" nëse ka vëzhgime, por shërbimi i monitorimit/ofruesi i të dhënave të rrjetit nuk ka qasje në to.
- përdorimi "fshehur" nëse ka vrojtime, por këto nuk janë në dispozicion në përputhje me këtë specifikim.

***Referencat e monitorimit të mjedisit*:**



Figura 12: Skema e aplikimit "Referencat e monitorimit të mjedisit"

Kodlistat dhe numërtimet për temën "Infrastruktura për monitorimin e mjedisit"



Figura 13: Kodlistat

3.1.3 KATALOGU I TIPOLOGJIVE

3.1.3.1 AKTIVITETI I MONITORIMIT TË MJEDISIT

-- Emri --

Aktiviteti i monitorimit të mjedisit

-- Përkufizim --

Grupi specifik i *TipologjiaEMonitorimit,* i përdorur për një domein të caktuar, në një kornizë kohore koherente, për një zonë ose destinacion. Zakonisht informacionet e mbledhura trajtohen si një e dhënë kohore në një program monitorimi afatgjatë. Është një realizim konkret i caktuar në *PrograminEMonitorimitTëMjedisit*.

-- Përshkrim --

Për shembull, një anije mund të pajiset me një koleksion të *InfrastrukturësPërMonitoriminEMjedisit* për një fushë të dhënë *(AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit),* që përmbush kërkesën për *PrograminEMonitorimitTëMjedisit*. Pas një periudhe të caktuar, kjo anije mund të jetë e pajisur me një grup tjetër për *InfrastrukturënEMonitorimitTëMjedisit* për një fushë që përmbush kërkesat e *ProgramitTëMonitorimitTëMjedisit*.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

ATRIBUTET
BurimetOnline: URL Shumëllojshmëria: [0..*] **-- Emri --** Burimet *online* **-- Përkufizimi --** Lidhja me dokumentet e jashtëm që ofron informacione të mëtejshme mbi *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit*. [I detyrueshëm: PO]
InspireId: Identifikues Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** InspireId **-- Përkufizimi --** Identifikuesi i objektit të jashtëm. [I detyrueshëm: PO]
PeriudhaEMonitorimit: Objekt Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Periudha e monitorimit **-- Përkufizimi --** Jetëgjatësia e *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit.* [I detyrueshëm: PO]
KornizaKufizuese: Kufiri Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Korniza kufizuese

ATRIBUTET

-- Përkufizimi --
Korniza kufizuese në të cilën zhvillohet *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit*

-- Përshkrimi --
Shembull. Nëse një anije kërkimore ka disa aktivitete monitorimi (*AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit*) është e rëndësishme të dimë për secilën nga anijet se kur do dalë në det (*AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit).*

[I detyrueshëm: PO]

KushtetEAktivitetit: Tekst
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Kushtet e aktivitetit

-- Përkufizimi --
Përshkrimi i *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit.*

[I detyrueshëm: PO]

PalëtPërgjegjëse: Palët përgjegjëse
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Palët përgjegjëse

-- Përkufizimi --
Palët përgjegjëse për *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit.*

[I detyrueshëm: PO]

LIDHJE

Lidhja (Drejtimi: Dy-Drejtime)

Burimi: Publike "voidable" shkakton (Class) *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit* "featureType"
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Përkufizimi --
AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit shkaktuar nga *ProgramiIMonitorimitTëMjedisit*

Objektivi: Publike «voidable» VendosurPër (Class) *ProgramiIMonitorimitTëMjedisit* "featureType"
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Përkufizimi --
ProgramiIMonitorimitTëMjedisit për të cilën *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit* është vendosur.

Lidhja (Drejtimi: Dy-Drejtime)

Burimi: Publike "voidable» përdorime (Class) *TipologjiaEMonitorimit* "featureType"
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Përkufizimi --
Struktura specifike e *TipologjiaEMonitorimit* e përfshirë në një *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit.*

Target: Publike «voidable» IPërfshirë (Class) *AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit* «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Përkufizimi --
AktivitetiIMonitorimitTëMjedisit në të cilën është përfshirë *TipologjiaEMonitorimit.*

3.1.3.2. HIERARKIA
-- Emri --
Hierarkia
-- Përkufizim --
Lidhja hierarkike midis *ObjektiIMonitorimit.*

-- Tipi i elementit --
DataType (AssociationClass)

ATRIBUTET
PeriudhaELidhjes: Objekt Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Periudha e lidhjes **-- Përkufizimi --** Periudha kohore e lidhjes hierarkike. [I detyrueshëm: PO]

3.1.3.3. LIDHJET ME DOMEIN
-- Emri --
Lidhjet me domein
-- Përkufizimi --
Lidhjet e përshtatshme të *InfrastrukturaPërMonitoriminEMjedisit,* e cila nuk është hierarkike ose e lidhur nga pikëpamja gjenealogjike.
-- Tipi i elementit --
DataType (AssociationClass)

ATRIBUTET
Atributi "*FillimiICiklitJetësor*" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi "*PërfundimiICiklitJetësor*" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin "*PërfundimiICiklitJetësor*" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "*FillimiICiklitJetësor*".

- Shënim i rëndësishëm:

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType, Void, Coverages etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.3 DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*", ASIG është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, për secilën nga temat e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, në përputhje me standardet evropiane (Direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në Direktivën INSPIRE si dhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- Metadata – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (sikurse është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilat do ta implementojnë atë.(VKM nr. 1077, datë 23.12.2015)

- Specifikimi i të dhënave – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë atribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:



Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi– Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi (Përpunimi) – Është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen, arkivohen duke u bazuar në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi të vendit ku implementohet standardi. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen, për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde kombëtare ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1 HABITATET

3.1.1 PARATHËNIE

"Habitatet" është një temë mbi biodiversitetin që trajton habitatet dhe biotopet, si zona gjeografike të karakterizuara nga kushte specifike ekologjike, procese, struktura dhe funksione që mbështesin fizikisht organizmat që jetojnë atje. Në to përfshihet toka, uji i freskët dhe zonat detare, që dallohen nga veçoritë gjeografike, abiotike dhe biotike, qofshin ato natyrale ose gjysmë natyrale.

Kjo temë përfshin të dhënat gjeohapësinore të organizmave biologjikë dhe komuniteteve biologjike pra biodiversitetin. Habitatet dhe biotopet trajtohen në mënyrë të ngjashme dhe përfshihen si zona, bashkë me kufijtë e tyre të dallueshëm. Këto të dhëna gjeohapësinore që përfshihen në këtë kategori përbëjnë një karakterizim të shpërndarjes së zonave gjeografike, që janë zona funksionale për organizmat e gjallë. Biotopet janë mjedisi hapësinor i një komuniteti biotik (biocenoza). Habitatet janë mjedisi hapësinor i specieve specifike.

Edhe pse emërtimi i temës është "*Habitatet"",* në shumicën e rasteve, duhet të kemi parasysh që përfshihen edhe Biotopet.

Tema "*Habitatet"* nga ana konceptuale lidhet me disa nga temat e tjera, si:

- *Zonat e mbrojtura*
- *Mbulesa e tokës*
- *Infrastruktura për monitorimin e mjedisit*
- *Shpërndarja e specieve*
- *Zonat ekologjike*

Vende ose komunitete të ndryshme kanë sisteme të ndryshme të klasifikimit të habitatit. Mund të hasen vështirësi gjatë hartëzimit me saktësi të klasave të caktuara të habitatit, midis nomenklaturave kombëtare apo midis nomenklaturave kombëtare dhe evropiane. Harmonizimi i të dhënave duhet të bazohet tek sistemi i klasifikimit të habitatit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Sistemi i klasifikimit të habitatit EUNIS, shërben si sistem mbi të cilin hartohen të gjithë sistemet e tjerë të klasifikimit. Klasifikimi i habitatit lokal ose kombëtar mund të përdoret, për aq kohë sa sigurohet një lidhje për këto referenca. Si rezultat, të gjitha tiparet e habitatit do të kenë një ose më shumë kodime të tipit të habitatit, të detyrueshëm nga kodlista *KlasifikimiIHabitatit EUNIS* dhe opsionale nga një kodlistë e regjistruar

që lidhet me një sistem klasifikimi ndërkombëtar, kombëtar ose lokal të habitatit.

Të dhënat janë të nevojshme për vendndodhjen gjeografike dhe shtrirjen (sipërfaqen, gjatësinë dhe/ose vëllimin) e habitateve, si dhe shpërndarjen gjeografike të tyre. Duke qënë se kufijtë e shpërndarjes së *Habitateve* dhe *Biotopeve* nuk bazohen tek vetë habitati dhe biotopi, por në kufijtë e veçorive të tjera gjeografike, paraqiten dy skema aplikimi të ndryshme: një paraqet *Habitatet* dhe tjetra paraqet *Shpërndarjen e Habitateve dhe Biotopeve*.

Tipologjia për temën *"Habitatet"* përshkruan shumë informacione, ku disa prej tyre janë: tiparet strukturore, lista e specieve, propozime të menaxhimit. Tema "*Habitatet"* paraqet vetëm informacionet e nevojshme, për këtë arsye specifikimi i të dhënave kufizon atributet themelore që lidhen me *feature*-at biotike, siç janë llojet e bimësisë dhe speciet. Atributet që lidhen me feature-at abiotik (p.sh. kimia e ujit, për ujërat e ëmbla ose habitatet detare) nuk përfshihen, por mund të shtohen më vonë në një skemë aplikimi të zgjeruar.

Skema e aplikimit të temës "*Habitatet"* përfshin, habitatet dhe biotopet që janë zona gjeografike me kufijtë e tyre të veçantë, të cilat klasifikohen dhe hartëzohen duke u bazuar në karakteristikat e tyre specifike p.sh. përbërjen e specieve dhe strukturën e bimësisë. Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimet e ndikimit në mjedis p.sh. efektet e ndryshimeve të përdorimit të tokës dhe ndryshimet e klimës.

Skema e aplikimit të shpërndarjes së habitateve dhe biotopeve, ka të bëjë me shpërndarjen gjeografike të habitateve dhe biotopeve dhe përshkruhet duke u bazuar në një bazë referimi të dhënash p.sh. të dhënat në formë rrjeti.

Habitatet dhe biotopet kanë kufij natyrorë dhe klasifikohen sipas kushteve të tyre ekologjike ose gjeofizike. Ato hartëzohen duke u bazuar në punën në terren dhe/ose duke interpretuar fotografimet ajrore. Në disa raste, të dhënat e referencës (p.sh. një sistem gjeografik i rrjetit) përdoren për të mbledhur, ruajtur dhe paraqitur informacione mbi habitatet.

Qëllimi për mbledhjen e të dhënave për habitatet është ruajtja e natyrës. Instrumente të ndryshme politikash janë duke u përdorur për ruajtjen e natyrës, përkatësisht instrumente juridike (p.sh. direktivat e BE-së dhe konventat ndërkombëtare), instrumentet financiarë, planifikimi gjeohapësinor dhe arsimimi. Bazuar në legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtar (përfshirë aktet e planifikimit gjeohapësinor) vendet e mbrojtura caktohen dhe menaxhohen për të ruajtur speciet dhe habitatet e rrezikuara. Ata zakonisht kanë lidhje me koleksionin e të dhënave të habitatit ose specieve.

Në INSPIRE përdoruesit përcaktohen kryesisht si ofrues dhe përdorues të të dhënave gjeohapësinore nga autoritetet publike nëpër nivele të ndryshme, vende të ndryshme dhe sektorë të ndryshëm. Thelbi i "autoritetit publik" në INSPIRE përfshin jo vetëm administratën publike në vetvete, por edhe të gjithë personat ose organizatat që ofrojnë shërbime publike, të lidhura me mjedisin. Si përfundim, ekziston një gamë e gjerë e palëve të interesuara, të cilët prodhojnë, mbajnë dhe përdorin të dhëna gjeohapësinore, të rëndësishme për ruajtjen e natyrës dhe/ose biodiversitetin. Këta njerëz dhe organizata punojnë në fusha të ndryshme të mbrojtjes së natyrës dhe veprojnë në shkallë të ndryshme - nga niveli lokal deri në nivelin e BE-së. Fokusi këtu është tek autoritetet publike, ndërkohë që dhe palët e tjera të interesuara nuk janë të përjashtuara.

Të dhënat janë të nevojshme për shpërndarje, shtrirje dhe për "cilësi" të habitateve në nivele të ndryshme (shkallë evropiane dhe lokale). "Cilësia" e habitatit në varësi të llojit të tij mund të shprehet në aspektin e llojeve tipike të florës, faunës, strukturës dhe përbërjes së florës së tyre. Këto të dhëna kërkohen për shumë qëllime të ndryshme duke përfshirë caktimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, zbatimin e ligjit (vlerësimin e ndikimit në mjedis-VNM), çështjet e ndikimeve klimatike, ndryshimin e klimës dhe raportimin e shteteve anëtare të BE-së në Këshillin Evropian për "statusin e ruajtjes" së habitateve.

3.1.2. TERMA DHE PËRKUFIZIME

1. **Biocenozë** – një bashkësi ose një bashkim natyral i organizmave, shpesh përdoret si një alternativë për ekosistemin por saktësisht është bashkësia e faunës/florës duke përjashtuar aspektet fizike të mjedisit.

Shënim: Në kontekstin e këtij specifikimi ai është një grup speciesh që përdorin të njëjtin habitat (biotop). Shembull – Një biocenozë mund

të nën klasifikohet në fitocenozë (bashkësia e bimëve) ose zeocenozë (bashkësia e kafshëve).

2. **Biotop** – një rajon i kushteve mjedisore relativisht të njëtrajtshme, të zënë nga një komunitet i caktuar bimësh dhe nga një komunitet shoqëror i kafshëve.

Shënim: Në varësi të nivelit të detajeve, një biotop mund të përbëhet nga shumë lloje të habitatit (kompleksi i habitatit) ose mund të ketë vetëm një lloj habitati dhe kështu shpesh do të jetë më i vogël në shtrirje sesa komplekset e habitatit.

3. **Status i konservimit -** Sipas Direktivës së Habitateve ky term është: Statusi i ruajtjes së një lloji të caktuar të habitatit në një rajon të caktuar bio-gjeografik. Sipas Direktivës së Habitateve, statusi i ruajtjes së një habitati natyror përcaktohet si shuma e ndikimeve që veprojnë në një habitat natyror dhe speciet e tij tipike që mund të ndikojnë në shpërndarjen, strukturën dhe funksionet e tij natyrore afatgjata, si dhe mbijetesën afatgjatë të specieve të tij.

Shënim: Statusi i ruajtjes së një habitati natyror do të merret si i favorshëm kur:

- sfera e tij natyrore dhe zonat që mbulon brenda këtij diapazoni janë të qëndrueshme ose në rritje,
- struktura specifike dhe funksionet të cilat janë të domosdoshme për mirëmbajtjen e saj afatgjatë ekzistojnë dhe ka të ngjarë të vazhdojnë të ekzistojnë për të ardhmen e parashikueshme.
- statusi i ruajtjes së specieve të tij tipike është i favorshëm.

Statusi i ruajtjes së një lloji të habitatit mund të konsiderohet si "i favorshëm", "i pafavorshëm", "i papërshtatshëm" ose "i panjohur".

4. **Habitat –** lokaliteti në të cilin një bimë ose një kafshë rritet ose jeton natyrshëm. Mund të jetë ose zona gjeografike mbi të cilën shtrihet, ose stacioni i veçantë në të cilin gjendet një ekzemplar. Një habitat karakterizohet nga një uniformitet relativ i mjedisit fizik dhe ndërveprim mjaft i ngushtë i të gjithë specieve biologjike të përfshira.

Shënim: Për sa i përket rajonit, një habitat mund të përbëjë një shkretëtirë, një pyll tropikal, tundra ose oqeani Arktik.

5. **Habitatet dhe biotopet** – Tema "*Habitatet"* përfshin: zonat gjeografike të karakterizuara nga kushte specifike ekologjike, procese, struktura dhe (funksione të mbështetjes së jetës) që mbështesin fizikisht organizmat që jetojnë atje. Kjo temë përfshinë zona tokësore dhe ujore që dallohen nga veçoritë gjeografike, abiotike dhe biotike, qoftë krejtësisht natyrale apo gjysmë natyrale.

6. **Sistemet e klasifikimit të habitateve** - Habitatet dhe biotopet në parim janë pjesë unike e realitetit. Sidoqoftë, ato mund të jenë të zakonshme në disa karakteristika në një nivel të caktuar detajesh dhe kështu mund të klasifikohen si lloje abstrakte: p.sh. si pyje, kullota duke iu referuar strukturës së tyre të bimësisë, ose si ujëra të rrjedhshëm, shkëmbinj gëlqerorë ose duna rëre, duke iu referuar tipareve abiotike, por edhe zonave dimërore, zona foleje apo korridore të papërcaktuara etj., si dhe ndarje përkatëse, cikli i një specie apo reparti të caktuar. Këto klasa zakonisht organizohen në sisteme klasifikimi, me më shumë ose më pak kodlista të plota. Klasifikimi i habitatit EUNIS aktualisht është sistemi më i përpunuar në Evropë.

7. **Kompleksiteti i habitateve** - Një veçori e habitatit që përbëhet nga më shumë se një lloj habitati (një kompleks gjeohapësinor i llojeve të ndryshme të habitateve).

8. **Hartat e habitateve** - Habitatet dhe Biotopet janë të hartëzuara (të përshkruara në një hartë dhe atribuohen me shumë informacione specifike) bazuar në punën në terren, interpretimin e imazhit ajror me sensorë, dhe ndonjëherë edhe me anë të modelimit. Si rezultat, marrim një vendndodhje dhe madhësi të saktë (sipërfaqe dhe/ose vëllim) të një tipologjie të habitatit. Përshkrimet e tipologjive të habitatit zakonisht mbajnë shumë informacione: një listë e llojeve të habitatit që gjenden, tiparet strukturore, listat e specieve, llojet e bimësisë, propozimet e menaxhimit.

9. **Llojet e habitateve (llojet e biotopeve)** - Një lloj abstrakt i klasifikuar për të përshkruar habitatet ose biotopet që janë të zakonshëm në disa karakteristika në një nivel të caktuar detajesh. Kriteret e klasifikimit të përdorura zakonisht mund të referohen në strukturën e bimësisë (si pyje, kullota) ose karakteristika abiotike siç janë ujërat e rrjedhshëm, shkëmbinjtë gëlqerorë ose dunat e rërës, por edhe fazat përkatëse të ciklit jetësor të një specie të caktuar ose repart ekologjik, si zonat e dimrit, zonat fole ose korridoret e papërcaktuar etj.

10. **Shpërndarjet (llojet e habitateve)** - Një koleksion i objekteve gjeohapësinore ku ndodh lloji i habitatit, duke dhënë informacione mbi shfaqjen e

një lloji specifik të habitatit në kohë ose hapësirë nëpër njësi analitike. Zakonisht përshkruhet ose modelohet bazuar në objektet e tjera gjeohapësinore të përdorura si njësi analitike, për shembull nëpër qelizat e rrjetit (shumë shpesh), rajonet bio-gjeografike, vendet e ruajtjes së natyrës ose njësitë administrative.

Shënim: Në kontekstin e temës "*Habitatet"*, shpërndarja e llojeve të habitatit jep informacion mbi shfaqjen e një lloji specifik të habitatit në kohë dhe/ose hapësirë nëpërmjet një lloji njësish analitike.

11. **Tipologjitë e habitateve** - Kjo do të thotë një vendbanim në drejtim të vendndodhjes së tij të saktë, madhësia (zona ose volumi) dhe informacioni i tij biologjik (p.sh. ndodhin llojet e habitateve, tipare strukturore, listat e specieve, llojet e bimësisë).

12. **Speciet** - Një kategori taksonomike që renditet menjëherë nën një gjini dhe duke përfshirë individë të lidhur ngushtë dhe morfologjikisht të ngjashëm. Në kontekstin e temës "*Habitatet" specie*, nënkupton të gjitha speciet shtazore, speciet bimore ose kërpudhat specifike të rëndësishme që përshkruajnë një habitat.

13. **Bimësi** - Bimët e një zone që konsiderohen në përgjithësi ose si komunitete, por jo si taksonomi. Bimësia mund të përcaktohet gjithashtu si mbulesa totale e bimëve në një zonë të caktuar ose në tokë.

Shënim: Shumë shpesh termi "bimësi" përdoret për shumën e të gjitha llojeve të bimësisë që gjenden në një zonë.

14. **Llojet e bimësisë** - Një bimë (ose masa totale e jetës së bimëve) të një zone të caktuar të konsideruar në përgjithësi ose si komunitet bimorë, por jo si taksonomi.

Shënim: Mbulesa e bimëve mund të jetë e zakonshme me disa karakteristika në një nivel të caktuar detajesh dhe kështu mund të klasifikohet nga shkenca e bimësisë si lloj abstrakt.

Shembull: Bimësia mund të klasifikohet si tundra ose pyje mesdhetare duke iu referuar strukturës së tyre dhe formacioneve bio-gjeografike si dhe përbërjes së tyre floristike, ose si kamaofite ose hemi-kriptofite, dhe tipareve strukturore etj. Shumë sisteme të klasifikimit të llojit të bimësisë ekzistojnë në të gjithë Evropën. Disa nga këto sisteme kanë një strukturë të thellë hierarkike.

3.2 PËRSHKRIMI I NËNTEMËS "HABITATET"

3.2.1 PARATHËNIE

Nëntema "*Habitatet",* përfshin Habitatet dhe Biotopet që janë zona gjeografike me kufijtë e tyre specifik, si dhe hartat përkatëse. Habitatet dhe biotopet klasifikohen dhe hartëzohen duke u bazuar në karakteristikat e tyre specifike p.sh. përbërjen e specieve dhe strukturën e bimësisë. Gjithashtu këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimet e ndikimit në mjedis p.sh. efektet e ndryshimeve të përdorimit të tokës dhe ndryshimit të klimës.

3.2.2 SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMA UML PËR NËNTEMËN "HABITATET"

Skema e aplikimit merr në konsideratë vetëm karakteristikat themelore. Vlerësimet p.sh. statusi i ruajtjes së habitateve trajtohet në kuadrin e direktivave të tjera të BE-së, kështu që ky lloj informacioni (statusi i ruajtjes) nuk përfshihet në skemën e aplikimit. Diagrama tregon marrëdhëniet midis skemës së aplikimit të *HabitateveDheBiotopeve* dhe paketës *LlojiBazë* i përcaktuar në modelin konceptual të përgjithshëm nga INSPIRE. Gjithashtu varet nga paketa e shpërndarjes së specieve (duke përdorur kodlistat e specifikave referuese), *ShpërndarjaEHabitateve* (për klasifikim) dhe paketa e *SistemiIAdresave.*



Figura 3- Diagrama UML: Përshkrimi i skemës së aplikimit HabitatetDheBiotopet

Skema e plotë e aplikimit për *HabitatetDheBiotopet* tregohet në Figurën 4 dhe përshkruhet në detaje më poshtë:



Figura 4- Diagrama UML: Përshkrimi i skemës së aplikimit HabitatetDheBiotopet (pa kodlista)

Disa kodlista janë referuar në skemën e aplikimit *HabitatetDheBiotopet*. Një përmbledhje e tyre shihet në figurën 5.



Figura 5 – Kodlistat e skemës së aplikimit HabitatetDheBiotopet

Feature-i kryesor është *Habitati,* i cili klasifikohet sipas llojeve përkatëse. Do të ofrohet një lidhje me një sistem të klasifikimit të habitatit të referencës (*LlojetEMbulimesësSëLlojitTëHabitatit*). Tipologjitë e habitatit lokal ose kombëtar përfshihen me anë të atributit EmriLokalIHabitatit (*LlojetEMbulimesësSëLlojitTëHabitatit*). Kjo bën të mundur që përdoruesit dhe ofruesit të përdorin skemën e tyre të klasifikimit të habitatit, përveç skemave të referencës (EUNIS, HD dhe MSFD). Me anë të një kualifikuesi (*LlojiIEmritLokal*, atributi *EmriLokalKualifikues* nga habitati referencë vendor në atë ndërkombëtar, sistemi i klasifikimit mund të tregohet (*VleratEEmritLokalKualifikues*).

Habitati si objekt gjeohapësinor (p.sh. i treguar në hartë) mund të përbëhet nga lloje të ndryshme habitatesh dhe më pas do të quhet habitat kompleks . Prandaj është e mundur të përfshihen më shumë se një lloj habitati brenda një veçorie (*LlojetEMbulimesësSëLlojitTëHabitatit*). Në rastin e habitatit, mund të shtohen informacione komplekse, përkatësisht për zonën (*ZonaEMbuluar*), gjatësinë (*GjatësiaEMbuluar*) ose vëllimin (*MbulimiVëllimit*) që mbulohet nga llojet e ndryshme të habitatit.



Figura 6 – Harta e habitatit me një tipar (kompleksi i habitatit), kjo veçori e habitatit përmban 5 lloje të habitatit nga referenca SkemaEKlasifikimitTëDirektivësSëHabitateve, një listë e këtyre llojeve të habitateve në metadatat e veçorive përkatëse do të kenë informacion të mëtejshëm për sipërfaqen totale, gjatësinë, vëllimin ose përqindjen e mbuluar nga secili lloj i vetëm i habitatit

Sidoqoftë, në shumë raste, hartat e habitatit do të paraqesin feature-a që i referohen vetëm një lloji të habitatit siç tregohet në figurën e mëposhtme:

Figura 7 – Harta e habitatit me feature-in habitat, secila veçori ka vetëm një lloj habitati nga referenca SkemaEKlasifikimitTëDirektivësSëHabitateve

Meqenëse habitatet karakterizohen shpesh nga feature-a biotik siç janë speciet (*SpecietEHabitateve*) dhe llojet e bimësisë (*BimësiaEHabitatit*) këto atribute shtohen në skemën e aplikimit, por të pavlefshme. Feature-at abiotike, megjithëse kanë rëndësi vetëm për habitatet detare, nuk janë përfshirë si atribute në skemën e aplikimit.

Duhet të vihet në dispozicion të paktën një lloj habitati sipas një reference (panevropiane) *SkemaELlojitTëHabitatit* të listuar në kodlistën *VleratESkemësSëLlojitTëHabitatitReferencë*. Si klasifikim referencë të habitateve do merret klasifikimi EUNIS. Në këtë klasifikim përveç ID (*KodiIEmritLokal*), të jepet edhe emri i plotë i llojit të bimësisë. Çdo skemë lokale e klasifikimit për llojet e habitatit duhet të regjistrohet në nivelin kombëtar.

3.2.3 KATALOGU I TIPOLOGJIVE

3.2.3.1 HABITATET

-- Emri --

Habitatet

-- Përkufizimi --

Zonat gjeografike të karakterizuara nga kushte specifike ekologjike, procese, struktura dhe funksione që mbështesin fizikisht organizmat që jetojnë atje.

-- Përshkrimi --

Përfshinë zona tokësore dhe ujore që dallohen nga veçoritë gjeografike, abiotike dhe biotike, qofshin ato natyrale ose gjysmë natyrale.

Një zonë, vijë ose pikë e habitatit mund të përbëjë një ose më shumë tema të habitatit sipas një ose më shumë skemave të klasifikimit të habitatit, shpesh në varësi të procesit të kapjes së të dhënave ose që lidhet me shkallën e një harte. Pra, një veçori e habitatit mund të përfaqësojë një kompleks të llojeve të ndryshme të habitatit.

Shënim: Ndonëse habitatet në parim janë zona gjeografike, ato gjithashtu mund të përshkruhen si linja ose pika.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

ATRIBUTET

BimësiaEHabitatit : LlojiIBimësisëSëHabitatit
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --
Bimësia e habitatit

-- Përkufizimi --
Lista e llojeve të bimësisë që përbëjnë një habitat të caktuar.

-- Përshkrimi --
Mbulesa e bimëve mund të jetë e zakonshme në disa karakteristika në një nivel të caktuar detajesh dhe kështu mund të klasifikohet nga shkenca e bimësisë si lloj abstrakt.
P.sh. bimësia mund të klasifikohet si tundër ose pyje mesdhetare duke iu referuar strukturës së tyre dhe formacioneve bio-gjeografike.
Shumë sisteme të klasifikimit të llojit të bimësisë ekzistojnë në të gjithë Evropën. Disa nga këto sisteme kanë një strukturë të thellë hierarkike. Prandaj rekomandohet të regjistrohen skema e llojit të bimësisë që është përdorur.

[I detyrueshëm:PO]

Gjeometria : Objekt
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Gjeometria

-- Përkufizimi --
Shkalla e habitatit bazuar në kufijtë natyrorë.

-- Përshkrimi --
Shënim 1: Mund të jetë poligon, vijë ose pikë.
Shënim 2: Mund të jetë edhe feature 3-dimensional

[I detyrueshëm: PO]

Habitatet : LlojetEMbulesësSëLlojitTëHabitatit
Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --
Lloji i habitateve

-- Përkufizimi --
Identifikuesi për një klasë të habitatit, i përcaktuar dhe përshkruar në një skemë ndërkombëtare të klasifikimit të habitatit ndërkombëtar, kombëtar ose lokal.

-- Përshkrimi --
Habitatet dhe biotopet mund të jenë të zakonshme në disa karakteristika në një nivel të caktuar detajesh dhe kështu mund të klasifikohen si lloje abstrakte: p.sh. si pyje, kullota, duke iu referuar strukturës së tyre të bimësisë ose ujërave të rrjedhshëm, shkëmbinj gëlqerorë ose duna rëre. Referuar tipareve abiotike që përbëhet nga zona dimërore, zona foleje apo korridore të papërcaktuara etj., si dhe fazave përkatëse për ciklin jetësor të një specie të caktuar ose zone ekologjike. Këto klasa tipologjike zakonisht janë të organizuara në sistemet e klasifikimit (p.sh. klasifikimi i habitatit EUNIS).

[I detyrueshëm:PO]

InspireId : Identifikues
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Inspire Id

-- Përkufizimi --
Identifikimi i objektit të jashtëm të objektit gjeohapësinor.

ATRIBUTET

-- Përshkrimi --
Një identifikues i objektit të jashtëm, është një identifikues unik i objektit i publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikimet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit të realitetit.

[I detyrueshëm:PO]

SpecietEHabitateve : LlojetESpecieveTëHabitateve
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --
Speciet e habitateve

-- Përkufizimi --
Lista e specieve që ndodhen ose përbëjnë një habitat të caktuar në kohën që krijohet harta.

[I detyrueshëm:PO]

3.2.3.2 LLOJET E SPECIEVE TË HABITATEVE

-- Emri --
Llojet e specieve të habitateve.

-- Përkufizimi --
Llojet që gjenden në një habitat të caktuar në kohën e krijimit të hartës.

-- Tipi i elementit --
DataType

ATRIBUTET

EmriLokalISpecieve : LlojiIEmritLokal
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Emri lokal i specieve.

-- Përkufizimi --
Emri shkencor dhe autori që përdoren në nomenklaturën kombëtare taksonomike.

-- Përshkrimi --
EmriLokalISpecieve siguron informacionin e nomenklaturës në lidhje me emrin e specieve të përdorura në vend dhe konceptet taksonomike të nënkuptuara nga përdorimi i këtij emri sipas një referencë të dhënë. Nëse lihet emri dhe koncepti i dhënë nga *IdESpecieveReferencë* do të zhvillohet sipas skemës së specifikave të referencës që është përdorur në vend.

[I detyrueshëm:PO]

IdESpecieveReferencë : VleratEKoditTëSpecieveReferencë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Id e specieve referencë

-- Përkufizimi --
Identifikuesi i njërit prej listave të referencës të dhëna nga *SkemaESpecieveReferencë.*

[I detyrueshëm:PO]

SkemaESpecieveReferencë : VleratESkemësSëSpecieveReferencë
Shumëllojshmëria: [1]

ATRIBUTET
-- Emri -- Skema e specieve referencë **-- Përkufizimi --** Lista e referencave që përcakton një standard nomenklature dhe taksonomike, në të cilin do të hartohen të gjithë emrat lokalë të specieve lokale dhe konceptet taksonomike. **-- Përshkrimi --** Kodlista e mbyllur e referencave taksonomike panevropiane të pranuara që përcaktojnë nomenklaturën dhe konceptin taksonomik të një emri specie të caktuar. Shërbejnë edhe si përkufizim i një koncepti taksonomik, i përshkruar nga marrëdhëniet sistematike dhe sinonime, ku mund të regjistrohen emra të tjerë dhe koncepte taksonomike. Kodlista përfshin Eu-Nomen, EUNIS dhe Natura2000. [I detyrueshëm: PO]

3.2.3.3 LLOJET E BIMËSISË SË HABITATIT

-- Emri --

Lloji i bimësisë së habitatit

-- Përkufizimi --

Lloji i bimësisë që gjendet në një habitat të caktuar.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET
EmriLokalIBimësisë : LlojiIEmritLokal Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Emri i bimësisë lokale **-- Përkufizimi --** Emri gjuhësor natyror i një klase të bimësisë (lloji i bimësisë) sipas një skeme lokale të klasifikimit të bimësisë. **-- Përshkrimi --** Rekomandohet të jepet emri i plotë i llojit të bimësisë sesa shkurtimi ose kodi i përdorur në skemën lokale. Shembull: "Stellario alsines – Montietum rivularis (Franzi 1984)". [I detyrueshëm:PO]

3.2.3.4 LLOJET E EMRIT LOKAL

-- Emri --

Lloji i emrit, lokal

-- Përkufizimi --

Emri sipas një skeme vendore të klasifikimit.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET
EmriLokal : Tekst Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Emri lokal

ATRIBUTET

-- Përkufizimi --
Emri sipas një skeme vendore të klasifikimit.

-- Përshkrimi --
Emri sipas skemës vendore të klasifikimit. Rekomandohet të merren të gjithë emrat lokalë nga një skemë e regjistruar e klasifikimit.

[I detyrueshëm:PO]

EmriLokalKualifikues : VleratEEmritLokalKualifikues
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Emri lokal kualifikues

-- Përkufizimi --
Lidhja midis emrit lokal dhe emrit përkatës në skemën panevropiane.

-- Përshkrimi --
Shembull: Lloji i habitatit lokal mund të jetë konceptualisht i njëjtë me llojin e lidhur të habitatit panevropian, marrëdhënia quhet "kongruente" ose lloji i habitatit lokal mund të jetë një nënlloj i llojit të habitatit panevropian, prandaj marrëdhënia duhet të përfshihet "*PërfshihetNë*", etj.

[I detyrueshëm: PO]

KodiIEmritLokal : VleratEKoditTëEmritLokal
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Kodi i emrit lokal

-- Përkufizimi --
Emri i gjuhësor natyror sipas një skeme vendore të klasifikimit.

[I detyrueshëm: PO]

SkemaLokale : Tekst
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Skema lokale

-- Përkufizimi --
Identifikimi i burimeve unike të një skeme lokale të klasifikimit.

-- Përshkrimi --
Skema e klasifikimit, e cila përdoret në vend dhe përmban të gjitha llojet e klasifikimit, kodet e tyre dhe/ose shumë shpesh emrat gjuhësorë natyrorë.
Shembull:http://www.rac-spa.org/sites/default/files/doc_fsd/lchm_en.pdf për Klasifikimin e Llojeve të habitatit detar benthic për Rajonin Mesdhe ose http://www.lifenatura2000.ro/doc/Habitatele_din_Romania.pdf për klasifikimin e habitateve Rumune.

[I detyrueshëm:PO]

3.2.3.5 LLOJET E MBULESËS SË LLOJIT TË HABITATIT

-- Emri --
Llojet e mbulesës së llojit të habitatit

-- Përkufizimi --
Lloji i habitatit sipas një skeme të klasifikimit të habitatit ndërkombëtar, kombëtar ose lokal.

-- Përshkrimi --
Përfshinë informacione shtesë për sipërfaqen, gjatësinë ose vëllimin e mbuluar.

-- Tipi i elementit --
DataType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
Gjeneralizuar from «dataType» *LlojetEHabitetitNatyra2000* tek «dataType» *LlojetEMbulesësSëLlojitTëHabitatit*

ATRIBUTET

EmriIHabitatitLokal : LlojiIEmritLokal
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Emri lokal i habitatit

-- Përkufizimi --
Lloji i habitatit sipas një skeme lokale të klasifikimit.

-- Përshkrimi --
Llojet e habitatit që përdoren në një zonë të caktuar (p.sh. Deti Mesdhe), ose në një vend të caktuar, në një rajon të caktuar, qark ose në ndonjë nivel tjetër lokal.
Rekomandohet të regjistrohet skema lokale e klasifikimit nga e cila merren emrat vendorë të habitatit.
Shembull: Klasifikimi i llojeve të habitatit detare benthic për rajonin mesdhetar, Habitatet e Rumanisë, llojet e bimësisë Nordike, Klasifikimi Kombëtar i Vegjetacionit Kombëtar në Mbretërinë e Bashkuar, etj.

[I detyrueshëm: PO]

LlojiIEmritTëHabitatitReferencë : Tekst
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Lloji i emrit të habitatit referencë

-- Përkufizimi --
Emri i një lloji të habitatit sipas një skeme klasifikimi panevropian.

-- Përshkrimi --
Në sistemet e dhëna të klasifikimit të habitatit panevropian, llojet e habitatit mund të identifikohen nga: një "identifikues" i shkurtër (kodi) dhe një emër në gjuhën natyrore, i cili nënkuptohet në këtë atribut.
Shembull: Direktiva e habitatit të llojit të tij 3260 (kodi) "Bimësia lundruese e Ranunculus" ose "Chenopodietum rubri e lumenjve nën tokë" (emri).

[I detyrueshëm:PO]

IdELlojitTëHabitatitReferencë : VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Id e llojit të habitatit referencë

-- Përkufizimi --
Identifikuesi (kodi) unik i llojit të habitatit sipas një skeme klasifikimi panevropian.

-- Përshkrimi --
Shembull: "1110", "40C0", "95A0" etj, nëse *SkemaEHabitateveReferencë* është "*DirektivaEHabitateve*", ose "A1.111", "A1.1121", "G1.1111", "X34" etj, nëse *SkemaEHabitateveReferencë* është "EUNIS".

[I detyrueshëm:PO]

ATRIBUTET

GjatësiaEMbuluar : Gjatësia
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Gjatësia e mbuluar

-- Përkufizimi --
Gjatësia e mbuluar nga një lloj i caktuar i habitatit brenda gjeometrisë së dhënë të objektit gjeohapësinor të habitatit.

-- Përshkrimi --
Gjatësia duhet të shprehet në metra.
Shembull: Brenda një gjeometrie të caktuar të habitatit prej 300 metrash katrorë ekzistojnë disa lloje të habitatit. Dy lloje të habitatit natyror me interes të komunitetit, "91F0" dhe "9160" mbulojnë këtë zonë të përgjithshme. Është renditur një lloj i tretë i habitatit natyror me interes të komunitetit "3260", i cili është një tipar linear dhe kështu shprehet në metra të gjatësisë së tij (p.sh. 120 m).

[I detyrueshëm: PO]

VëllimiIMbuluar : Volum
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Vëllimi i mbuluar

-- Përkufizimi --
Vëllimi i mbuluar nga një lloj i caktuar i habitatit brenda gjeometrisë së dhënë të objektit gjeohapësinor të habitatit.

-- Përshkrimi --
Vëllimi duhet të shprehet në metra kub.

[I detyrueshëm: PO]

SkemaELlojitTëHabitatitReferencë : VleratESkemësSëLlojitTëHabitatitReferencë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Skema e llojit të habitatit referencë

-- Përkufizimi --
Një nga skemat e klasifikimit panevropian, që përdoren gjerësisht në Evropë.

-- Përshkrimi --
Lista përfshin të paktën klasifikimin e llojeve të habitatit natyror të interesit të komunitetit, të listuar në anekset e Direktivës së Habitateve, si dhe klasifikimin hierarkik të llojeve të habitatit të interesit për biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës, të listuara në bazën e të dhënave EUNIS, e cila mirëmbahet nga EEA.

[I detyrueshëm:PO]

ZonaEMbuluar: Zona
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Zona e mbuluar

-- Përkufizimi --
Zona e mbuluar nga një lloj i caktuar i habitatit brenda gjeometrisë së dhënë të objektit gjeohapësinor të habitatit.

-- Përshkrimi --
Sipërfaqja duhet të shprehet në metra katrorë.
Mund të përdoret vetëm në rastin kur gjeometria e dhënë në tipologjinë *Habitat* paraqet një zonë në të cilën ekzistojnë më shumë se një lloj habitati me fjalë të tjera një kompleks i llojeve të ndryshme të habitatit. Në këtë rast, për secilin tip të habitatit sipërfaqja e zonës së mbuluar mund të sigurohet brenda këtij atributi.

ATRIBUTET
Meqenëse gjeometria e parashikuar në tipologjinë *Habitat* mund të jetë më e madhe se sipërfaqja totale e llojeve të habitatit të listuar brenda asaj gjeometrie, sipërfaqja totale e llojeve të habitatit mund të jetë më e vogël se sipërfaqja e gjeometrisë së dhënë. Shembull: Brenda një gjeometrie të caktuar të habitatit prej 30.2 hektarësh ekzistojnë disa lloje të habitatit, nga të cilët dy janë lloje të habitatit natyror me interes të komunitetit, "91D0" që mbulon 22.5 hektarë dhe "7110" që mbulon 5.3 hektarë, pra në total janë më të vogla se sipërfaqja totale . [I detyrueshëm: PO]

3.2.3.6 VLERAT E EMRAVE LOKAL KUALIFIKUES

-- Emri --

Vlerat e emrave lokal kualifikues

-- Përkufizimi --

Lista e vlerave që specifikojnë lidhjen midis një emri të përdorur në vend dhe një emër të përdorur në nivelin panevropian.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

3.2.3.7 VLERAT E KODIT TË DIREKTIVËS SË HABITATEVE

-- Emri --

Vlerat e kodit të Direktivës së Habitateve.

-- Përkufizimi --

DirektivaEHabitateve sipas Aneksi 1.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇐ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEKoditTëDirektivësSëHabitateve* tek «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë*

3.2.3.8 VLERAT E KODIT TË DIREKTIVËS SË KORNIZËS STRATEGJIKE DETARE

-- Emri --

Vlerat e kodit të Direktivës së Kornizës Strategjike Detare.

-- Përkufizimi --

Direktiva e Kornizës Strategjike Detare.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇐ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEKoditTëDirektivësSëKornizësStrategjikeDetare* tek «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë*

3.2.3.9 VLERAT E KODIT TË EMRIT LOKAL
-- Emri --
Vlerat e kodit të emrit lokal.

-- Përkufizimi --
Identifikuesi i marrë nga çdo skemë e klasifikimit vendor.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

3.2.3.10 VLERAT E KODIT TË LLOJIT TË HABITATIT EUNIS
-- Emri --
Vlerat e kodit të llojit të habitatit EUNIS.

-- Përkufizimi --
Lloji i klasifikimit të habitatit EUNIS.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇐ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitEUNIS* tek «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë*

3.2.3.11 VLERAT E KODIT TË LLOJIT TË HABITATIT REFERENCË
-- Emri --
Vlerat e kodit të llojit të habitatit referencë

-- Përkufizimi --
Vlerat e përdorura në skemat e klasifikimit të habitatit panevropian.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURORE TË BRENDSHME
⇒ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitEUNIS* tek «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë*
⇒ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEKoditTëDirektivësSëHabitateve* tek «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë*
⇒ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEKoditTëDirektivësSëKornizësStrategjikeDetare* tek «codeList» *VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë*

3.2.3.12 VLERAT E SKEMËS SË LLOJIT TË HABITATIT REFERENCË
-- Emri --
Vlerat e skemës së llojit të habitatit referencë
-- Përkufizimi --
Kjo vlerë përcakton se cila skemë panevropiane e klasifikimit të habitatit është përdorur.

-- Përshkrimi --
Shembull: EUNIS

-- Tipi i elementit --
Kodlist

3.3 PËRSHKRIMI I NËNTEMËS "SHPËRNDARJA E HABITATEVE DHE BIOTOPEVE"

3.3.1 PARATHËNIE

*Nëntema "*Shpërndarja e habitateve dhe biotopeve*" ka të bëjë me shpërndarjen gjeografike të habitateve dhe biotopeve, të ngjashme me shpërndarjen gjeografike të specieve. Ndryshimi nga nëntema "Habitatet" është sepse nuk përmban kufijtë gjeografikë të habitateve dhe biotopeve.*

3.3.2 SKEMA E APLIKIMIT DHE DIAGRAMA UML PËR NËNTEMËN "SHPËRNDARJA E HABITATEVE DHE BIOTOPEVE"

Skema e aplikimit *ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve* dhe paketave të referuara është përshkruar në *figurën 8*. Diagrama tregon marrëdhëniet midis skemës së aplikimit *HabitatetDheBiotopet* dhe paketat e tipit bazë të përcaktuara në modelin konceptual të përgjithshëm INSPIRE. Kjo gjithashtu varet nga *ShpërndarjaESpecieve* (duke përdorur kodlistat e specifikave referuese), *ShpërndarjaDheHabitatet* (për klasifikimin) dhe diagrama e *SistemitTëAdresave* (për adresën e të dhënave, për adresën e kërkimit).

Shpërndarja e habitateve dhe biotopeve përshkruhet bazuar në një bazë të dhënash referimi p.sh. të dhëna rrjet ose njësi të tjera analitike.



Figura 8: Përshkrimi i skemës së aplikimit ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve

Objekti kryesor gjeohapësinor për skemën e aplikimit për *ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve* është *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve*. Informacioni mbi llojet e habitatit është grumbulluar brenda këtij lloji të objektit gjeohapësinor. Objekti gjeohapësinor i *GrupiITëDhënavePërShpërndarjenEHabitateve* specifikon një bazë të dhënash, që përmban disa raste të *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve*.

GrupiITëDhënavePërShpërndarjenEHabitateve është një grup i paravendosur i të dhënave i cili përmban metadata specifike për shtrirjen (informacion më të detajuar në shkallë sesa elementet e metadatave të

nivelit të zbulimit në masë), emrin dhe detajet e dokumentacionit p.sh. për cilin qëllim ligjor është krijuar grupi i të dhënave.

Të dhënat për shpërndarjen e habitatit shpesh përdoren për raportim sipas detyrimeve ligjore, përmes lidhjes sigurohet mundësia për të përfshirë një lidhje me dokumentet ligjore ose dokumente të tjera *DokumentBazë* nga *GrupiITëDhënavePërShpërndarjenEHabitateve,* të objektit gjeohapësinor *CitimiIDokumentave* e përcaktuar në skemën e aplikimit "*Lloji Bazë*" (model i përgjithshëm konceptual). Ky lloj objekti gjeohapësinor mund të sigurojë informacione për detajet e dokumentit.



Figura 9: Diagrama UML: Skema e aplikimit të diagramës ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve

Kodlistat janë referuar skemës së aplikimit të *ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve*, siç shihet edhe më poshtë:





Figura 10: Kodlistat në skemën e aplikimit ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve

Gjeometria e objektit gjeohapësinor *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve* mund të korrespondojë me një veçori tjetër gjeografike (*TipologjiaAbstrakte*) për shembull një rrjet, njësi administrative ose zonat e Natura2000, të cilat mund të specifikohen/zgjidhen nga ofruesi. Shpërndarja e një habitati në të vërtetë ekziston për një koleksion të njësive të shpërndarjes së habitatit.



Figura 11: Shpërndarja e llojeve të habitateve 3130, SkemaEKlasifikimitTëDirektivësSëHabitateve duke iu referuar njësive analitike të një rrjeti Gaus-Kruger në North Rhine-Westphalia, Gjermani



Figura 12: Shpërndarja e llojeve të habitateve 3130, SkemaEKlasifikimitTëDirektivësSëHabitateve duke iu referuar njësive administrative në North Rhine-Westphalia, Gjermani



Figura 13: Shpërndarja e llojeve të habitateve 3130, SkemaEKlasifikimitTëDirektivësSëHabitateve duke iu referuar zonave të Natyra2000 në North Rhine-Westphalia, Gjermani

Meqenëse kufijtë e *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve* nuk korrespondojnë domosdoshmërisht me kufijtë e një tipologjie të habitatit, atributet *SipërfaqiaEPërgjithshme*, *GjatësiaEPërgjithshme* dhe *VëllimiIPërgjithshëm* janë shtuar që të jetë e mundur të specifikohet sipërfaqja, gjatësia ose vëllimi total që mbulohet nga habitati brenda *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve*.

Rrjeti_ETRS89-LAEA është hierarkik, me rezolucione prej 1m, 10m, 100m, 1000m, 10000m dhe 100000m. Orientimi i rrjetit është jug-veri, perëndim-lindje.

NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve është i lidhur me llojin e objektit gjeohapësinor të *InformacioniIBurimit* me qëllim përshkrimin e informacionit të metadatave, për instanca specifike të njësive të shpërndarjes. Këto metadata mund të ndahen midis disa njësive të shpërndarjes së habitatit.

InformacioniIBurimit përmban atributin e mëposhtëm:

Burimi: Është dataType *LlojiIBurimit* i cili siguron informacione mbi burimet dhe origjinën e tyre:

- *EmriIInstitucionit* është një characterString që përfaqëson emrin e institucionit që jep të dhënat burimore.

- *AdresaEInstitucionit* përfaqëson adresën duke përdorur dataType *PërfaqësimiIAdresës* nga skema e aplikimit *SistemiIAdresave.*

- *DatabazaEBurimit* është një characterString duke treguar emrin e databazës ku janë marrë të dhënat e shpërndarjes së habitateve.

- *MetodaEBurimit* ka dataType-in *LlojiIMetodësSëBurimit* dhe siguron metodat e përdorura gjatë mbledhjes së të dhënave burimore (metodës së vlerës) nga tekste analoge të shkruara dhe/ose harta, ose metoda të tjera. Vlerat përcaktohen në kodlistat *VleratEMetodësSëBurimit.* Kjo kodlistë mund të zgjatet nëse kërkohet. Për më tepër, *ReferencaEMetodës* ofron një referencë për një përshkrim të metodës me të cilën mblidhen të dhënat për shpërndarjen e habitatit.

3.3.3 KATALOGU I TIPOLOGJIVE

3.3.3.1 GRUPI I TË DHËNAVE PËR SHPËRNDARJEN E HABITATEVE

-- Emri --

Grupi i të dhënave për shpërndarjen e habitateve

-- Përkufizimi --

Ky grup i të dhënave është një mbledhje e objekteve (njësive) individuale gjeohapësinore në një shpërndarje të habitateve.

-- Përshkrimi --

Shpërndarja gjeografike e një habitati brenda një vendi të caktuar, rajoni bio-gjeografik ose një zonë tjetër gjeografike, përshkruhet duke u bazuar në tipare(feature) të tjera gjeografike p.sh. rrjetet.

Shënim: Shpërndarja e habitatit është një nga aspektet për të vlerësuar statusin e ruajtjes së llojeve të habitatit të Direktivës së Habitatit. Shtetet anëtare janë të detyruara t'i sigurojnë KE-së hartat e shpërndarjes, (rrjetet prej 10 * 10 km) informacion në lidhje me dukuritë aktuale të llojeve të habitatit, brenda rajoneve bio-gjeografike të shtetit anëtar, bazuar në rezultatet e një hartografie kombëtare gjithëpërfshirëse ose inventarizimit të habitateve kudo që të jetë e mundur.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË BRENDSHME
Agreguar nga «featureType» *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve* tek «featureType» *GrupiITëDhënavePërShpërndarjenEHabitateve*

ATRIBUTET
Emri : CharacterString Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Emri **-- Përkufizimi --** Emri i grupit të të dhënave për shpërndarjen e habitateve. **-- Përshkrimi --** Një emër identifikimi i shkurtër, përshkrues për një bazë të dhënash specifike të siguruar nga një institucion. [I detyrueshëm:PO]
FillimiICiklitJetësor : Datë

ATRIBUTET

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

-- Përshkrimi --
Shënim: Kjo datë është regjistruar për të mundësuar vetëm gjenerimin e skedarëve të azhornimit të ndryshimit.

[I detyrueshëm: PO]

InspireId : Identifier
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Inspire Id

-- Përkufizimi --
Identifikimi i objektit të jashtëm të objektit gjeohapësinor.

-- Përshkrimi --
Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues unik i objektit i publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikimet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi, është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit në realitet.

[I detyrueshëm:PO]

PërfundimiICiklitJetësor : Datë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar ose tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore.

-- Përshkrimi --
Shënim: Kjo datë është regjistruar kryesisht për ato sisteme që "mbyllin" një hyrje në të dhënat gjeohapësinore të vendosura në rast të ndryshimit të atributit.

[I detyrueshëm:PO]

ShtrirjaEDomein : Sipërfaqe
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Shtrirja e domeinit

-- Përkufizimi --
Shtrirja gjeografike e mbulimit të të dhënave të shpërndarjes së habitatit.

[I detyrueshëm: PO]

LIDHJE

Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Destinacioni)

Burimi: Publike (Class) *GrupiITëDhënavePërShpërndarjenEHabitateve* «featureType*»*

Objektivi: Publike «voidable» *DokumentiBazë* (Class) *CitimiIDokumentit*

LIDHJE	
	Shumëllojshmëria: [0..*] **-- Emri --** Dokumenti bazë **-- Përkufizimi --** Referenca ose citimi i një dokumenti që përshkruan një fushatë ose një akt juridik, nga i cili është krijuar baza e të dhënave.

3.3.3.2 INFORMACIONI I BURIMIT

-- Emri --

Informacioni i burimit

-- Përkufizimi --

Përmban metadata për raste specifike të shpërndarjes së habitatit.

-- Përshkrimi --

Mund të ndahet midis disa njësive të shpërndarjes së habitatit.

-- Tipi i elementit –

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇐ Agreguar nga «featureType» *InformacioniIBurimit* tek «featureType» *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve*

ATRIBUTET
Burimi : LlojiIBurimit Shumëllojshmëria: [1..*] **-- Emri --** Burimi **-- Përkufizimi --** Informacion në lidhje me institucionin, që përpunon të dhënat nga baza e të dhënave burimore në një të dhënë të plotë. [I detyrueshëm: PO]
InspireId : Identifikues Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Inspire Id **-- Përkufizimi --** Identifikimi i objektit të jashtëm, të objektit gjeohapësinor. **-- Përshkrimi --** Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues unik i objektit i publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikimet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit të realitetit. [I detyrueshëm: PO]

3.3.3.3 LLOJET E BURIMIT
-- Emri --
Llojet e burimit

-- Përkufizimi --
Identifikimi i burimit të të dhënave për shpërndarjen e habitatit.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET
AdresaEInstitucionit : AdresaPërfaqësuese Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Adresa e institucionit **-- Përkufizimi --** Adresa e pronarit ose operatorit të bazës së të dhënave burimore. [I detyrueshëm:PO]
DatabazaEBurimit : CharacterString Shumëllojshmëria: [0..*] **-- Emri --** Databaza e burimit **-- Përkufizimi --** Emri i bazës së të dhënave nga ku merren të dhënat e shpërndarjes së habitatit. [I detyrueshëm:PO]
EmriIInstitucionit : CharacterString Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Emri i institucionit **-- Përkufizimi --** Emri i pronarit ose operatorit të bazës së të dhënave burimore. [I detyrueshëm:PO]
MetodaEBurimit : LlojiIMetodësSëBurimit Shumëllojshmëria: [1..*] **-- Emri --** Metoda e burimit **-- Përkufizimi --** Metoda me të cilën mblidhen të dhënat për shpërndarjen e habitatit. **-- Përshkrimi --** U referohet metodave se si janë bërë ose regjistruar vëzhgimet dhe janë grumbulluar duke përdorur M*etodaEAgregimit* e caktuar, në njësinë e shpërndarjes së habitatit. [I detyrueshëm:PO]

3.3.3.4 LLOJET E HABITATIT

-- Emri --

Lloji i habitatit

-- Përkufizimi --

Lloji i habitatit sipas një skeme të klasifikimit të habitatit ndërkombëtar, kombëtar ose lokal.

-- Përshkrimi --

Skema të ndryshme të klasifikimit të habitatit ekzistojnë në të gjithë Evropën. Në shumë raste, një skemë e klasifikimit vendor ose kombëtar do të jetë në përdorim të përditshëm, megjithatë, referencat në skemat ndërkombëtare të klasifikimit (evropian) tashmë do të futen shpesh (p.sh. Llojet e habitatit të interesit të komunitetit, Direktiva e Habitatit). Është e detyrueshme të kodifikohen llojet e habitatit sipas një reference (panevropiane).

SkemaELlojitTëHabitatit të listuar në kodlistën e *VleratESkemësSëLlojitTëHabitatitReferencë*. Ky kodim ka për qëllim të lejojë pyetjet në llojet e habitatit në një nivel të harmonizuar panevropian.

Rekomandohet të referohen vlerat e kodlistës së klasifikimit të habitatit EUNIS. Llojet e habitatit të listuara në Aneksin I të Direktivës së Habitateve ose llojet e habitatit të Direktivës së Kornizës së Strategjisë Detare, p.sh. për shkak të detyrimeve për raportimin e shteteve anëtare. Përkthimet ekzistojnë midis këtyre skemave të klasifikimit të habitatit dhe klasifikimit të habitatit EUNIS.

Kodlista *VleratESkemësSëLlojitTëHabitatitReferencë* mund të zgjatet me kalimin e kohës, duke përfshirë më shumë skema të klasifikimit të habitatit panevropian që lejojnë këtë qëllim harmonizimi.

Është e mundur të kodifikohen llojet e habitatit me një *EmriLokalIHabitateve* që rrjedh nga një skemë e klasifikimit kombëtar, rajonal ose lokal. Çdo skemë e klasifikimit lokal rekomandohet të regjistrohet në nivelin kombëtar.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET
EmriLokalIHabitatit : LlojiIEmritLokal Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Emri lokal i habitatit **-- Përkufizimi --** Lloji i habitatit sipas një skeme lokale të klasifikimit. **-- Përshkrimi --** Llojet e habitatit që përdoren në një zonë të caktuar (d.m.th.: deti Mesdhe), ose në një vend të caktuar, ose edhe më të kufizuar në një rajon, qark ose ndonjë nivel tjetër lokal. Shembull: Klasifikimi i llojeve të habitatit detar benthic për rajonin mesdhetar, habitatet e Rumanisë, llojet e bimësisë Nordike, Klasifikimi Kombëtar i Vegjetacionit në Mbretërinë e Bashkuar, etj. [I detyrueshëm: PO]
EmriILlojitTëHabitatitReferencë : CharacterString Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Emri i llojit të habitatit referencë **-- Përkufizimi --** Emri i një lloji të habitatit sipas një skeme klasifikimi panevropian.

ATRIBUTET

-- Përshkrimi --
Në sistemet e dhëna të klasifikimit të habitatit panevropian, llojet e habitatit mund të identifikohen nga: një "identifikues" i shkurtër (kodi) dhe një emër në gjuhën natyrore.
Shembull: Direktiva e habitatit të llojit 3260 (kodi) "Bimësia lundruese e Ranunculus" ose "Chenopodietum rubri e lumenjve nëntokësorë" (emri).

[I detyrueshëm:PO]

IdELlojitTëHabitatitReferencë : VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitReferencë
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --
Id e llojit të habitatit referencë

-- Përkufizimi --
Identifikuesi (kodi) unik i llojit të habitatit sipas një skeme klasifikimi panevropian.

-- Përshkrimi --
Shembull: "1110", "40C0", "95A0" etj., në qoftë se *SkemaEHabitatitReferencë* është "*DirektivaEHabitatit*", ose "A1.111", "A1.1121", "G1.1111", "X34" etj, në qoftë se *SkemaEHabitatitReferencë* është "EUNIS".

[I detyrueshëm: PO]

SkemaELlojitTëHabitatitReferencë : VleratESkemësSëLlojitTëHabitatitReferencë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Skema e llojit të habitatit referencë

-- Përkufizimi --
Një nga skemat e klasifikimit panevropian, që përdoren gjerësisht në Evropë.

-- Përshkrimi --
Lista përfshin të paktën klasifikimin e llojeve të habitatit natyror të interesit të komunitetit të listuara në Aneksin I të Direktivës së Habitateve, si dhe klasifikimin hierarkik të llojeve të habitatit të interesit për biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës të listuara në bazën e të dhënave EUNIS, e cila mirëmbahet nga EEA.

[I detyrueshëm:PO]

3.3.3.5 LLOJET E METODËS SË BURIMIT

-- Emri --
Lloji i metodës së burimit

-- Përkufizimi --
Përmban metadata për raste specifike të shpërndarjes së habitatit.

-- Përshkrimi --
Mund të ndahet midis disa njësive të shpërndarjes së habitatit.

-- Tipi i elementit --
DataType

ATRIBUTET

ReferencaEMetodës : URI
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Referenca e metodës

-- Përkufizimi --
Një referencë për një përshkrim të metodës me të cilën mblidhen të dhënat për shpërndarjen e habitatit.
[I detyrueshëm:PO]

VleraEMetodës : VleratEMetodësSëBurimit
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Vlera e metodës

-- Përkufizimi --
Metoda me të cilën mblidhen të dhënat për shpërndarjen e habitatit.
[I detyrueshëm:PO]

3.3.3.6 NJËSIA E SHPËRNDARJES SË HABITATEVE

-- Emri --

Njësia e shpërndarjes së habitateve

-- Përkufizimi --

Përfaqëson veçoritë individuale (njësi) në shpërndarjen e habitateve.

-- Përshkrimi --

Njësia e shpërndarjes së habitatit është pjesë e shpërndarjes gjeografike të një habitati të caktuar (lloji i habitatit). Tregon shfaqjen (praninë ose mungesën) e një habitati.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

Agreguar nga «featureType» *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve* tek «featureType» *GrupiITëDhënavePërShpërndarjenEHabitateve*

LIDHJE STRUKTURORE TË BRENDSHME

Agregation nga «featureType» *InformacioniIBurimit* tek «featureType» *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve*

ATRIBUTET

FillimiICiklitJetësor : Datë
Shumellojshmeria: [0..1]

-- Emri --
Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar ose tërhequr nga grupi i të dhënave

ATRIBUTET
gjeohapësinore. **-- Përshkrimi --** Shënim: Kjo datë është regjistruar kryesisht për ato sisteme që "mbyllin" një hyrje në të dhënat gjeohapësinore të vendosur në rast të ndryshimit të atributit [I detyrueshëm: PO]
GjatësiaEPërgjithshme : Integer Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Gjatësia e përgjithshme **-- Përkufizimi --** Gjatësia e një habitati (e shprehur në metra) brenda objektit gjeohapësinor që është përdorur për të përshkruar shpërndarjen e habitatit (llojit) brenda një vendi të caktuar, rajonit bio-gjeografik ose zonës tjetër gjeografike. **-- Përshkrimi --** Shënim: Kjo është e rëndësishme vetëm nëse habitati është një tipar linear që mund të shprehet me gjatësi (p.sh. brenda një rrjeti) dhe jo nëse habitati mbulon një zonë të caktuar. [I detyrueshëm: PO]
Gjeometria : Objekt Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Gjeometria **-- Përkufizimi --** Gjeometria e secilës njësi në një koleksion. [I detyrueshëm: PO]
Habitatet : LlojiIHabitatit Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Habitatet **-- Përkufizimi --** Identifikuesi për një klasë të habitateve, i përcaktuar dhe përshkruar në një skemë ndërkombëtare të klasifikimit të habitatit ndërkombëtar, kombëtar ose lokal. **-- Përshkrimi** -- Habitatet dhe biotopet mund të jenë të zakonshme në disa karakteristika në një nivel të caktuar detajesh dhe kështu mund të klasifikohen si lloje abstrakte: p.sh. si pyje, kullota duke iu referuar strukturës së tyre të bimësisë ose si ujëra të rrjedhshëm, shkëmbinj gëlqeror ose duna rëre, si dhe duke iu referuar tipareve abiotike por edhe zona dimërore, zona foleje apo korridore të papërcaktuara etj. Këto klasa tipologjike zakonisht janë të organizuara në sistemet e klasifikimit (p.sh. klasifikimi i habitatit EUNIS). [I detyrueshëm:PO]
MbledhurDeri : Datë Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Mbledhur deri **-- Përkufizimi --** Data kur mbledhja e të dhënave të dukurisë së habitatit fillestar është ndalur. [I detyrueshëm:PO]

ATRIBUTET

MbledhurNga : Datë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Mbledhur nga

-- Përkufizimi --
Data kur filloi mbledhja e të dhënave origjinale të ndodhjes së habitatit.

[I detyrueshëm: PO]

PërfundimiICiklitJetësor : DatëKohë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data dhe ora në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

-- Përshkrimi --
Shënim: Kjo datë është regjistruar për të mundësuar vetëm gjenerimin e skedarëve të azhornuar.

[I detyrueshëm: PO]

SipërfaqjaEPërgjithshme : Integer
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Sipërfaqja e përgjithshme

-- Përkufizimi --
Zona e një habitati (e shprehur në metra katrorë) ,brenda objektit gjeohapësinor që është përdorur për të përshkruar shpërndarjen e habitatit (llojit) brenda një vendi të caktuar, rajoneve bio-gjeografike ose zonave të tjera gjeografike.

-- Përshkrimi --
Shënim: Kjo është e rëndësishme vetëm nëse habitati mbulon një zonë të caktuar (p.sh. brenda një rrjeti) dhe jo në rastin e një tipari linear.
Shembull: Sipërfaqja e qelizës së rrjetit.

[I detyrueshëm:PO]

VëllimiIPërgjithshëm : Integer
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Vëllimi i përgjithshëm

-- Përkufizimi --
Vëllimi (shprehur në metra kub), i një lloji të caktuar të habitatit, brenda gjeometrisë së dhënë të një njësie specifike të shpërndarjes së habitatit.

[I detyrueshëm: PO]

LIDHJA

Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Destinacioni)

Burimi: Publike (Class) *NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve* «featureType» Objektivi: Publike «voidable» *ObjektiGjeohapësinor* (Class) *TpologjiAbstrakte* «FeatureType»

LIDHJA	
	Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Objekti gjeohapësinor **-- Përkufizimi --** Një referencë për një objekt tjetër gjeohapësinor që përcakton shtrirjen gjeohapësinore të një njësie shpërndarjeje. **-- Përshkrimi --** Shembull: Një zonë administrative specifike

3.3.3.7 VLERAT E METODËS SË BURIMIT

-- Emri --

Vlerat e metodës së burimit

-- Përkufizimi --

Metodat që janë përdorur në burime për përpunimin e informacionit në lidhje me dukuritë e habitateve brenda një njësie grumbullimi.

-- Përshkrimi --

Nënklasat për fushat specifike mund të shtohen nga secili shtet.

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURORE TË BRENDSHME
⇨ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEMetodësSëBurimitNeni17* tek «codeList» *VleratEMetodësSëBurimit*

3.3.3.8 VLERAT E METODËS SË BURIMIT, NENI 17

-- Emri --

Vlerat e metodës së burimit, neni 17

-- Përkufizimi --

Metodat që janë përdorur në burime për përpilimin e informacionit në lidhje me dukuritë e habitateve brenda një njësie grumbullimi për qëllime të nenit 17.

-- Përshkrimi --

Përshkruan se si është përpiluar informacioni në lidhje me dukuritë e habitateve brenda një njësie.

Shënim: vlerat e listës gjenden në:

http://circa.europa.eu/Public/irc/env/monnat/library?l=/habitats_reporting/reporting_2007-2012/reporting_guidelines/reporting-formats_1/_EN_1.0_&a=d

-- Tipi i elementit --

Kodlistë

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇦ Gjeneralizuar nga «codeList» *VleratEMetodësSëBurimitNeni17* tek «codeList» *VleratEMetodësSëBurimit*

ATRIBUTET
TëDhënatQëMungojnë : Publike **-- Emri --** Të dhënat që mungojnë **-- Përkufizimi --** Të dhënat që mungojnë
VëzhgimiIPlotë : Publike **-- Emri --** Vëzhgimi i plotë **-- Përkufizimi --** Vëzhgimi i plotë
EkspertiVlerësues : Publike **-- Emri --** Eksperti vlersues **-- Përkufizimi --** Vlerësimi i bazuar në mendimin e ekspertit pa marrjen e mostrave minimale ose maksimale.
VlerësimiIPjesshëm : Publike **-- Emri --** Vlerësimi i pjesshëm **-- Përkufizimi --** Vlerësimi i bazuar në të dhëna të pjesshme me disa ekstrapolime dhe/ose modelime.

3.4 METADATA

Përshtatja e elementeve të metadatës përcaktohet në rregulloren e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015 "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë".

3.5 KODI EPSG PËR KRGJSH-në

Referenca gjeodezike e të dhënave gjeohapësinore mbështetet në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.669, datë. 07.08.2013, *"Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë"* ndryshuar me Vendimin nr.322, datë. 27.04.2016 dhe Vendimin nr.359, datë. 29.05.2019.

Kodi EPSG** për Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH) është: **EPSG – 6870.

3.6 CILËSIA E TË DHËNAVE

Ky kapitull përfshin një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe nën elementeve si dhe cilësinë e matjes së të dhënave, që duhen përdorur, për të vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë për grupet e të dhënave gjeohapësinore të temës "*Habitatet*".

Cilësia e të dhënave të elementeve, nën elementeve dhe matjeve duhet të përdoret për të:

- Vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e të dhënave dhe kufizimet e objekteve gjeohapësinore, ku pronat ose kufizimet e tilla përcaktohen si pjesë e skemës së aplikimit.
- Vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e të dhënave të elementeve të metadatave të grupeve të të dhënave gjeohapësinore.
- Për të specifikuar kërkesat ose rekomandimet në lidhje me rezultatet e cilësisë së të dhënave të zbatueshme për grupet e të dhënave gjeohapësinore që lidhen me temën "*Habitatet*".

Tabela e mëposhtme, paraqet të gjitha elementet dhe nën elementet e cilësisë së të dhënave që përdoren në këtë specifikim. Informacioni i cilësisë së të dhënave mund të vlerësohet në nivelin e objektit gjeohapësinor, llojit të objektit gjeohapësinor, datasetit ose grupit të të dhënave. Niveli në të cilin bëhet vlerësimi është dhënë në kolonën "Sfera e vlerësimit".

Masat që do të përdoren për secilin nga nën elementet e listuara të cilësisë së të dhënave janë përcaktuar në nën seksionet e mëposhtme.

Tabela - Elementet e cilësisë së të dhënave të përdorura në temën "Habitatet"

Pjesa	Elementi i cilësisë së të	Nën elementi i cilësisë së të	Përkufizimi	Sfera e vlerësimit
3.6.1	Përputhja ligjore	Përputhja konceptuale	Zbatimi i rregullave në skemën konceptuale.	Grup të dhënash; Llojet e objektit gjeohapësinor; Objekti Gjeohapësinor
3.6.2	Përputhja Ligjore	Përputhja në domein	Zbatimi i vlerave në vlerat e domeinit.	Grup të dhënash; Llojet e objektit gjeohapësinor; Objekti Gjeohapësinor

3.6.1 PËRPUTHJA LIGJORE – PËRPUTHJA KONCEPTUALE *(LOGICAL CONSISTENCY – CONCEPTUAL CONSISTENCY)*

Rekomandim

Për testet në përputhjen konceptuale, është e rekomanduar të përdoret Përputhja ligjore – Përputhja konceptuale e nënelementeve të cilësisë së të dhënave dhe masa e numrit të artikujve që nuk janë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale sikurse është specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Emri	
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Përputhja ligjore
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Përputhja konceptuale
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizimi	Numërimi i të gjithë elementeve në grupin e të dhënave që nuk janë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale.
Përshkrimi	Nëse skema konceptuale përshkruan shprehimisht ose në mënyrë absolute rregullat, këto rregulla duhet të ndiqen. Shkeljet ndaj rregullave të tilla mund të jenë, për shembull, vendosjen e pavlefshme të karakteristikave brenda një tolerance të definuar, dyfishimin e karakteristikave dhe mbivendosjen e pavlefshme të karakteristikave.
Fusha e vlerësimit	Objektet gjeohapësinore/Llojet e objekteve gjeohapësinore
Fusha e raportimit	Grupi i të dhënave
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	-
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Integer
Burimi referencë	ISO/DIS 19157 Informacioni gjeografik – Cilësia e të dhënave
Shembulli	**-**
Masa identifikuese	10

3.6.2 PËRPUTHJA LIGJORE – PËRPUTHJA ME DOMEININ *(LOGICAL CONSISTENCY – DOMAIN CONSISTENCY)*

Rekomandim

Për testet në përputhje me domeinin, është e rekomanduar të përdoret Përputhja ligjore – Përputhja në domein e nën elementeve të cilësisë së të dhënave dhe masa e numrit të artikujve që nuk janë në përputhje me vlerën e domeinit sikurse është specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Emri	**Numri i artikujve që nuk janë në përputhje me vlertat e domeinit të tyre**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Saktësia tematike
Cilësia e të dhënave të nën elementëve	Përputhje me domeinin
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizimi	Numërimi i të gjithë elementeve në grupin e të dhënave që nuk janë në përputhje vlerat e domeinit të tyre
Përshkrimi	-
Fusha e vlerësimit	Objektet gjeohapësinore/Llojet e objekteve gjeohapësinore
Fusha e raportimit	Grupi i të dhënave
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer

4. ANEKSE

4.1 ANEKSI A – KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Nr.	*Emri i elementit anglisht*	*Emri i elementit shqip*	*Nëntema*	*Tipi*
Habitatet				
3.2.3.1	*Habitat*	*Habitatet*	*Habitatet*	*FeatureType*
3.2.3.2	*HabitatSpeciesType*	*LlojetESpecieveTëHabitatit*	*Habitatet*	*DataType*
3.2.3.3	*HabitatVegetationType*	*LlojetEBimësisëSëHabitatit*	*Habitatet*	*DataType*
3.2.3.4	*LocalNameType*	*LlojetEEmritLokal*	*Habitatet*	*DataType*
3.2.3.5	*HabitatTypeCoverType*	*LlojetEMbulesësSëLlojitTëHabitati t*	*Habitatet*	*DataType*
3.2.3.6	*QualifierLocalNameValue*	*VleraEEmritLokalKualifikues*	*Habitatet*	*CodeList*
3.2.3.7	*HabitatDirectiveCodeValue*	*VleratEKoditTëDirektivësSëHabit ateve*	*Habitatet*	*CodeList*
3.2.3.8	*MarineStrategyFrameworkDi rectiveCodeValue*	*VleratEKoditTëDirektivësSëKorniz ësStrategjikeDetare*	*Habitatet*	*CodeList*
3.2.3.9	*LocalNameCodeValue*	*VleratEKoditTëEmritLokal*	*Habitatet*	*CodeList*
3.2.3.10	*EUNISHabitatTypeCodeVa lue*	*VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitE UNIS*	*Habitatet*	*CodeList*
3.2.3.11	*ReferenceHabitatTypeCodeVa lue*	*VleratEKoditTëLlojitTëHabitatitR eferencë*	*Habitatet*	*CodeList*
3.2.3.12	*ReferenceHabitatTypeScheme Value*	*VleratESkemësSëLlojitTëHabitatit Referencë*	*Habitatet*	*CodeList*
3.3.3.1	*HabitatDistributionDataSet*	*GrupiTëDhënavePërShpërndarjenE Habitateve*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBioto peve*	*FeatureType*
3.3.3.2	*SourceInformation*	*InformacioniIBurimit*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBioto peve*	*FeatureType*
3.3.3.3	*SourceType*	*LlojetEBurimit*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBioto peve*	*DataType*
3.3.3.4	*HabitatType*	*LlojetEHabitatit*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBioto peve*	*DataType*

3.3.3.5	*SourceMethodType*	*LlojetEMetodësSëBurimit*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve*	*DataType*
3.3.3.6	*HabitatDistributionUnit*	*NjësiaEShpërndarjesSëHabitateve*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve*	*FeatureType*
3.3.3.7	*SourceMethodValue*	*VleratEMetodësSëBurimit*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve*	*CodeList*
3.3.3.8	*Srticle17SourceMethodValue*	*VleratEMetodësSëBurimitNeni17*	*ShpërndarjaEHabitateveDheBiotopeve*	*CodeList*

4.2 ANEKSI C - KODLISTAT

4.2.1 SKEMA E APLIKIMIT PËR TEMËN "HABITATET"

KODLISTAT
VleratEEmritLokalKualifikues
VleratESkemësSëLlojitTëHabitatitReferencë

4.2.1.1 VLERAT E EMRIT LOKAL KUALIFIKUES

-- **Emri** --

Vlerat e emrit lokal kualifikues

-- **Përkufizimi** --

Lista e vlerave që specifikojnë lidhjen midis një emri të përdorur në vend dhe një emri të përdorur në nivelin panevropian.

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/QualifierLocalNameValue

-- **Vlerat** –

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përmbajnë çdo vlerë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

KODLISTË
-- Emri -- Në përputhshmëri **-- Përkufizimi –** Lloji lokal është konceptualisht i njëjtë me llojin e tij panevropian.
-- Emri -- Përjashtime **-- Përkufizimi --** Lloji i habitatit panevropian nuk është konceptualisht një nëntip i llojit të tij lokal.
-- Emri -- Përfshirë në **-- Përkufizimi--** Lloji lokal është konceptualisht një nëntip i llojit të tij panevropian.
-- Emri -- Përfshin **-- Përkufizimi --** Lloji i habitatit panevropian është konceptualisht një nëntip i llojit të tij lokal.
-- Emri -- Mbivendosjet **-- Përkufizimi --** Ekziston një mbivendosje e caktuar midis llojit lokal dhe llojit të tij panevropian që lidhet me përkufizimet e tyre përkatëse, por asnjë nga marrëdhëniet e tjera specifike (në përputhshmëri, përjashtime, përfshirë në, përfshin) nuk mban.

4.2.1.2 VLERAT E SKEMËS SË LLOJIT TË HABITATIT REFERENCË
-- **Emri** --
Vlerat e skemës së llojit të habitatit referencë

-- **Përkufizimi** --
Kjo vlerë përcakton se cila skemë panevropiane e klasifikimit të habitatit është përdorur.

-- **Përshkrimi**--
Shembull: EUNIS

-- **Identifikuesi** --
http://inspire.ec.europa.eu/codeList/ReferenceHabitatTypeSchemeValue

-- **Vlerat** –
Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përmbajnë çdo vlerë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

KODLISTË
-- Emri -- EUNIS **-- Përkufizimi –** Klasifikimi i habitateve EUNIS
-- Emri -- Direktiva e habitateve **-- Përkufizimi --** Klasifikimi i habitateve sipas direktivës 92/43/EEC.
-- Emri -- Direktiva e kornizës së strategjisë detare **-- Përkufizimi--** Klasifikimi i habitateve sipas tabelës 1 të aneksi III të direktivës 2008/56/EC.

VENDIM
Nr. 212, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI - TEMA: INFRASTRUKTURA INDUSTRIALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja "p", e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Infrastruktura industriale", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI.
TEMA: "INFRASTRUKTURA INDUSTRIALE"

Përmbajtja
1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE
2 HYRJE
2.1 Qëllimi
2.2. Si lexohet dokumenti
2.3 Detyrimet ligjore

2.4 Fusha e veprimit
3. TEMA
3.1 Infrastruktura industriale
3.1.1 Parathënie
3.1.2 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për temën: "Infrastruktura industriale"
3.1.3 Katalogu i tipologjive
3.1.3.1 Strukturë prodhimi
3.1.3.2 Impiantet e prodhimit
3.1.3.3 Lloji i statusit
3.1.3.4 Ndërtesa prodhimi
3.1.3.5 Ngastër prodhimi
3.1.3.6 Zonë prodhimi
3.1.3.7 Njësia teknike
3.1.3.8 Pjesë e impiantit të prodhimit
3.1.3.9 Vlerat e llojeve të impianteve
3.1.3.10 Vlerat e llojeve të ndërtesave të prodhimit
3.1.3.11 Vlerat e llojeve të pjesëve të impianteve
3.1.3.12 Vlerat e teknikës së reduktimit të ndotjes
3.1.3.13 Vlerat e zonave të baseneve të lumenjve
3.2 Infrastruktura industriale modeli i zgjeruar
3.2.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për temën: "Infrastruktura industriale"
3.2.2 Katalogu i tipologjive
3.2.2.1 Aktiviteti
3.2.2.2 Shkarkime
3.2.2.3 Hyrjet e procesit
3.2.2.4 Njësia teknike
3.2.2.5 Procesi i prodhimit
3.2.2.6 Daljet e procesit
3.2.2.7 Matja
3.2.2.8 Vlerat e shkarkimit
3.2.2.9 Vlerat e llojit të regjistrimit
3.2.2.10 Vlerat e dukshme të rrjedhjes
3.2.2.11 Vlerat finalizuese
3.2.2.12 Vlerat e elementeve të procesit
3.2.2.13 Vlerat e klasifikimit të energjisë
3.2.2.14 Vlerat e kodeve të aktivitetit
3.2.2.15 Vlerat e kodit CPA
3.2.2.16 Vlerat e kodit CPL
3.2.2.17 Vlerat e kodit E-PRTR
3.2.2.18 Vlerat e kodit EWC
3.2.2.19 Vlerat e kodit IPP
3.2.2.20 Vlerat e kodit NACE
3.3 Metadata
3.4 Kodi EPSG për KRGJSH
3.5 Cilësia e të dhënave
3.5.1 Kompletimi – përjashtimi (*Completeness – Omission*)
3.5.2 Përputhja ligjore – Përputhja konceptuale (*Logical consistency – Conceptual consistency*)
3.5.3 Përputhja ligjore – Përputhja me domeinin (*Logical consistency – Domain consistency*)
3.5.4 Saktësia e pozicionimit – Saktësia absolute apo e jashtme (*Positional accuracy - Absolute or external accuracy*)
3.5.5 Saktësia tematike – Korrektësia e klasifikimit (*Thematic accuracy – Classification correctness*)
3.5.6 Cilësia kohore– Vlefshmëria kohore (*Temporal quality – Temporal validity*)
4. ANEKSE
4.1 Aneksi A – Katalogu i tipologjive
4.2 Aneksi C – Kodlistat
4.2.1 Skema e aplikimit e temës "Infrastruktura industriale"
4.2.2 Vlerat teknike të reduktimit të ndotjes
4.2.3 Skema e aplikimit "Infrastruktura industriale modeli i zgjeruar"
4.2.4 Vlerat e kodeve të aktivitetit
4.2.5 Vlerat e kodit CPL
4.2.6 Vlerat e kodit CPA
4.2.7 Vlerat e kodit E-PRTR
4.2.8 Vlerat e kodit EWC
4.2.9 Vlerat e klasifikimit të energjisë
4.2.10 Vlerat e kodit IPPC
4.2.11 Vlerat e elementeve të procesit

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike, të të dhënave gjeohapësinore, për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në Direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), të cilat janë autoritete publike përgjegjëse, për temën "Infrastruktura industriale".

Data e publikimit të versionit nr. 1 është Qershor 2019. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2019_ II_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2019 – Viti i krijimit

II. Tema për të cilën është krijuar standardi: "Infrastruktura industriale", e cila i referohet temës "Production and Industrial Facilities" të Direktivës INSPIRE

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1 QËLLIMI

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, të harmonizuara konform Direktivës INSPIRE, për të dhënat gjeohapësinore të temës "Infrastruktura industriale", temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/p, të ligjit nr. 72/2012, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

Ky dokument publikohet si standard, që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI[3] në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë e tyre.

2.2 SI LEXOHET DOKUMENTI

2.2.1 STRUKTURA E DOKUMENTIT

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1- **Përshkrimi i standardeve**: – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2- **Hyrje**: – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

3- **Tema**:- Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën "Infrastruktura industriale".

4- **Anekse**: – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

- *Përmbajtja e Kapitullit të 3-të është strukturuar në 4 pjesë kryesore:*

3.1 Përshkrimi i temës – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës si dhe detajohen **Diagramet UML** dhe **Katalogu i tipologjive**.

3.2 Metadata – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.3 Sistemi Koordinativ Referencë – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë që është miratuar me vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me vendimin nr. 322, datë 27.4.2016 dhe vendimin nr. 359 datë 29.5.2019.

3.4 Cilësia e të dhënave – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 DIAGRAMET UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore, të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në 'Katalogu i tipologjive' (*Feature Catalogue*). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i tipologjive, mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kodlistës.

[3] NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor

Tabela 5

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas Direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	**Tipi i elementit** që mund të jetë i këtyre llojeve: **«featureType»** - një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte. **«dataType»** - një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë atributesh, për t'u lidhur me një element tjetër. **«enumeration»** "KodList» - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. *Enumeration* nënkupton "renditje vlerash", ndërsa *codeList* nënkupton listë vlerash ose ndryshe "kodlistë". Në dokument gjenden të shqipëruara si "Numërtimet dhe kodlistat". **«union»** - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet që bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dy grupeve të të dhënave hyrëse. **«Imported»** - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të Direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden "Të dhënat e importuara"
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: **pikë, linjë, poligon.** **Abstrakt** – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve "Rol shoqërimet" tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 6

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas Direktivës INSPIRE i elementeve **-- Përshkrimi --** Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 7

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: ***Ligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas Direktivës INSPIRE i elementeve
Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh.: ***Joligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas Direktivës INSPIRE i elementeve

2.2.3 KARAKTERISTIKAT E <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<*voidable*>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera '*void*'. Një vlerë *void* nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës *void* duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArsyesSëPavlefshmërisë* (VoidReasonValue), e cila përmban:

- ***E panjohur*** (Unknown)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull: Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit" e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë "E panjohur".

- ***E papopulluar*** (Unpopulated)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit" nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë "E pa populluar"

- ***Konfidenciale***

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull: Të dhënat personale të popullsisë të cilat ekzistojnë por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi <<voidable>> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4 MBULIMET - COVERAGES

Funksionet e mbulimit *"Coverages"* përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe /ose hapësirë. Shembuj tipik të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si vetitë e llojeve të objekteve gjeohapësinore ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është një realizim i një prej llojeve të specifikuara në SSH EN ISO 19123.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh. ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndër tematik për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptues të Përgjithshëm " Generic Conceptual Model".

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *RjetiIMbulimitIKorrigjuar (rektifikuar)*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe

koordinatave të sistemit koordinativ referencë. (shih figurën 1, majtas).

- *RrjetiIMbulimitReferencë:* Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje të mbulimit (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.



Figura 1 – Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5 NUMËRTIMET DHE KODLISTAT (ENUMERATION AND CODE LIST)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistë, 'vlera të tjera' përcaktojnë llojin e përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

- ***'jo'*** përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë dokument.
- ***'të* kufizuara'** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.
- ***'të hapura'*** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.
- ***'po'*** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera ***"jo"****, pra* të specifikuara në dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin "FillimiICiklitJetësor" dhe "PërfundimiICiklitJetësor" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi "FillimiICiklitJetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi "PërfundimiICiklitJetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin "PërfundimiICiklitJetësor" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "FillimiICiklitJetësor".

❖- *Shënim i rëndësishëm:*

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType, Void, Coverages etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.3 DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të ligjit nr. 72/2012, neni 16, "*Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*", ASIG është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në Direktivën INSPIRE si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- Metadata – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë. (VKM nr. 1077, datë 23.12.2015).

- Specifikimi i të dhënave – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë atribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4. Fusha e veprimit

Të gjitha autoritetet publike, kompanitë private apo individët që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:



Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi– Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi (përpunimi) – Është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen duke u bazuar në standarde kombëtare dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde kombëtare ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1 INFRASTRUKTURA INDUSTRIALE

3.1.1 PARATHËNIE

Tema "Infrastruktura industriale" përfshin të dhënat gjeohapësinore, të cilat japin informacion në lidhje me aktivitetet që zhvillohen gjatë proceseve industriale, objektet industriale dhe çështjet kryesore mjedisore që lidhen me to (parandalimi i ndotjes, menaxhimi i mbetjeve, risku).

Tema "Infrastruktura industriale" lidhet ngushtë me tema të tjera të dhënash gjeohapësinore si;

- *Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura*
- *Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare*
- *Ndërtesat*
- *Sistemi i adresave*
- *Kufijtë e njësive administrative*
- *Parcelat kadastrale*

Për të kryer një proces të plotë të harmonizimit për temën "Infrastruktura industriale"*,* mund të përfshihen specifikimi i të dhënave të temave "*Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura"* dhe *"Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare".*

Përkufizimi:

Kjo temë përfshin të dhëna gjeohapësinore që lidhen dhe përshkruajnë karakteristika industriale si dhe subjektet që lidhen me to. Ajo realizon një paraqitje të plotë informacionit gjeohapësinor, për karakteristikat industriale, dhe çështjet kryesore mjedisore që lidhen me to (parandalimi i ndotjes, menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i riskut).

Aktivitetet që lidhen me objektet e *Infrastrukturës industriale* përfshijnë nxjerrjen e burimeve, transformimin e tyre në produkte ose nënprodukte, dhe ruajtjen e tyre.

- Procesi i nxjerrjes së burimeve përfshin: industrinë nxjerrëse jo energjetike (minierat e materialeve ndërtimore, minerale industriale dhe minerale metalike), industrinë nxjerrëse të energjisë dhe industrinë e energjisë ujore.

- Transformimi i burimeve duhet parë si transformim i një burimi apo produkti tjetër, ose si transformim në energji, duke përfshirë impiantet e prodhimit të energjisë brenda fushëveprimit të kësaj teme.

- Procesi i depozitimit (ruajtjes) përfshin strukturat për depozitim të sigurt ose ruajtjen e substancës së përfshirë në procesin industrial.

- Mbetjet gjithashtu, do të konsiderohen si komponent kryesor në procesin e ndërtimit të një

landfilli ose strukturave të tjera që mund të shërbejnë për ruajtjen e përhershme të tyre.

Proceset më lart ndërveprojnë me njëri - tjetrin me anë të instalimeve të posaçme për komunikim (stacionet e komunikimit) të cilat përfshihen në këtë temë.

Aktivitetet e *infrastrukturës industriale* janë të përcaktuara nga klasifikimi ndërkombëtar NACE, i cili i ndan në disa nivele dhe kategori aktivitetet (2 kategori B, C, D, E, F dhe H). Ato radhiten si më poshtë:

- Minierat dhe karrierat
- Industria përpunuese
- Energjia elektrike
- Gazi
- Energjia e ajrit dhe avullimit
- Energjia ujore
- Industria ndërtimore
- Transportimi dhe magazinimi

Një përshkrim gjithëpërfshirës do të paraqitet edhe për objektin *ShkarkimIndustrial*, ku listohen llojet e proceseve industriale të konsideruara në fushën e tij dhe mund të përdoret si referencë për të identifikuar aktivitetet industriale.

Infrastruktura industriale funksionin sipas ligjeve të përcaktuara në nivel kombëtar, zakonisht është një strukturë e ndryshueshme që përmban ndërtesa, ngastra toke dhe njësi teknike të tjera, që lidhen ndërmjet tyre me makineri, tubacione, mole, linja hekurudhore (p.sh linja hekurudhore të vogla komunikuese nëpër miniera), bankina etj. Këto njësi grupohen nëpër ndërtime të ndryshme, të ndara secila sipas funksionit që kanë, në proceset industriale.

Tipologjitë kryesore që zotërojnë të dhëna gjeohapësinore për këtë temë janë: *ZonaProdhimi, StrukturëProdhimi, ImpiantetEProdhimit* dhe *PjesëEImpianteveTëProdhimit.* Këto objekte gjeohapësinore krijojnë një strukturë të *infrastrukturës industriale*, e cila ka fokus proceset që lidhen me aktivitetet që ndodh brenda vetë objektit.

Informacioni gjeohapësinor paraqitet nëpërmjet dy tipologjive kryesore që janë: *NgastërProdhimi* dhe *NdërtesaIndustrialeDheProdhimi* (Production and Industrial Building)

- *NgastërProdhimi* paraqet një pjesë toke, e cila ka funksion të caktuar.

- *NdërtesaIndustrialeDheProdhimi* paraqet një ndërtim artificial, pjesë e objekteve industriale, të cilat janë të nevojshme, për të siguruar vendndodhjen, për zhvillimin e aktivitetit.

Niveli mininal i detajeve, për informacionin gjeohapësinor, realizon kërkesën e paraqitjes së objekteve të infrastrukturës si pika, ndërkohë që objektet të tjera si *Impiantet* dhe *PjesëImpianti* japin një përshkrim më të saktë. Gjithsesi një objekt i infrastrukturës mund të paraqesë një nivel detajesh më të lartë në hartë nëse sipërfaqja është e përcaktuar. Proces i njëjtë ndodh dhe për instalimet, parcelat dhe ndërtesat.

Objekti industrial është një aktivitet i cili zgjat, pra nuk është i përkohshëm. Ky lloj objekti paraqet karakteristika industriale, mjedisore (p.sh. zonat e kontaminuara). Por nuk përjashtohen rastet kur këto karakteristika lidhen me pikëpamje të tjera si monumente historike, kulturore e natyrore. Në këtë rast objektet, duke ruajtur planin dhe karakteristikat e ndërtimit të një zone industriale, do të humbasin statusin e tyre industrial dhe duhet të riklasifikohen në mënyrë tipike si *Ndërtesa*, *Shërbime qeveritare.*

Modeli i të dhënave llogarit mundësinë e kalimit të statusit të objektit dhe objekteve të tjera gjeohapësinore në lidhje me kohën kur përdoren, duke treguar kohën që është aktivizuar statusi i objektit gjeohapësinor, që lidhet me kodlistat e përshkruara përgjatë standardit.

3.1.2 SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMET UML PËR TEMËN: "INFRA-STRUKTURA INDUSTRIALE"

Skema e aplikimit për temën "Infrastruktura industriale" bazohet në tiparet kryesore të funksioneve, të proceseve industriale. Tema paraqitet përmes tre skemave: *KornizaIndustriale*, *NjësiaIndustriale* dhe *LidhjaMeTematETjera.*

Korniza industriale, bazohet në objektet kryesore gjeohapësinore si: *StrukturaEProdhimiT, ImpiantetEProdhimit*, *PjesëEImpianteveTëProdhimit* dhe *ZonëIndustriale.*

Objekti gjeohapësinor *StrukturëProdhimi* përmban informacione kyçe dhe është i vetmi objekt gjeohapësinor ku ***gjeometria është e përcaktuar si pikë vendndodhje***. Tipari gjeometrik plotësues është sipërfaqja, duke shënuar vendndodhjen e zgjerimit të objektit. Një objekt përfaqëson diçka të projektuar, të ndërtuar dhe të vendosur, për t'i shërbyer një funksioni të veçantë, duke kuptuar pajisjet për një proces të plotë. Një strukturë grupon së bashku një ose më shumë instalime, që operohen në të njëjtin vend nga i njëjti

person fizik/juridik, dhe ku është e pranishme, toka, ndërtesat dhe pajisjet e përdorura, për kryerjen e një shërbimi/industrie/biznesi.

ImpiantetEProdhimit përfaqësojnë: makineri, aparate, pajisje. *ImpiantetEProdhimit* paraqiten si një stacion teknik, pjesë njësie të një strukture ku kryhet një ose më shumë aktivitete, të cilat kanë një lidhje teknike me aktivitetet e kryera në atë vend dhe të cilat mund të ndikojnë në mjedis, duke e ndotur përmes shkarkimeve të ndryshme.

Impianti është një njësi teknike brenda ndërmarrjes, ku prodhohen, përdoren, trajtohen, magazinohen substanca të rrezikshme.

ZonaEProdhimit përfshihet në impiantet e prodhimit dhe gjeometria e saj është e shprehur si pikë vendndodhje. Tipari gjeometrik dytësor është poligoni (sipërfaqe), që përcakton vendndodhjen e zgjerimit për zonën e instalimit. *ZonaEProdhimit* paraqet një pjesë specifike teknike të instalimit, duke zhvilluar një funksion përfaqësues që duhet të regjistrohet sipas legjislacionit.

Shembull: *Oxhakët janë pjesë e zonës së instalimit dhe për ndërtimin/vendosjen e tyre duhet të kryhet pajisja me leje.*

Kodlista *VleratEKlasifikimitTëEnergjisë* përmban vlerat referuese për elementin "energjia" referuar atributit *HyrjetEProcesit* ose *DaljetEProcesit*. Energji nënkupton fuqinë e prodhuar nga burime fizike ose kimike, të afta për të furnizuar me ndriçim dhe nxehtësi makinat e punës.

-- **Tipi i elementit**--

Kodlistë

3.2.2.14. Vlerat e kodeve të aktivitetit

--Emri--

Vlerat e kodeve të aktiviteteve

--Përkufizimi--

Kodlista e *VleratEKodeveTëAktivitetit* përmban të gjitha vlerat potenciale referuese për atributin *KodiIAktivitetit*, në klasën *Aktiviteti.*

-- **Tipi i elementit**--

Kodlistë

3.2.2.15 VLERAT E KODIT CPA

--Emri--

Vlerat e kodit CPA

--Përkufizimi--

Kodlista e vlerave të kodit CPA, ka vlera referencë për atributin *KodiIAktivitetit* në klasën *Aktiviteti*. Kjo listë siguron edhe klasifikim për aktivitetet në bazë të regjistrit E-PRTR (European Pollutant Release and Transfer Register – Regjistri Evropian i Shkarkimit dhe i Transferimit të Ndotësve).

-- **Tipi i elementit--**

Kodlistë

3.2.2.16 VLERAT E KODIT CPL

--Emri--

Vlerat e kodit CPL

--Përkufizimi--

Kodlista e CLP përmban vlerat referencë për elementin "substancë" referuar atributit *ElementetEProceseve,* në klasën *HyrjetEProcesit* ose *DaljetEProcesit* dhe atributit *SubsatancaNdotëse.* Substancë nënkupton çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim të disa substancave specifike.

-- **Tipi i elementit--**

Kodlistë

3.2.2.17 VLERAT E KODIT E-PRTR

--Emri--

Vlerat e kodit E-PRTR

--Përkufizimi--

Kodlista e vlerave të kodit E-PRTR, ka vlera referencë për atributin *KodiIAktivitetit,* në klasën *Aktiviteti.* Kjo listë mbart edhe klasifikimin për aktivitetet në bazë të rregullores së E-PRTR.

--Përshkrimi--

Klasifikimi i E-PRTR ka një strukturë hierarkike, të ngritur në nivele të ndryshme të trupëzuar, në kodin e aktivitetit.

-- **Tipi i elementit--**

Kodlistë

3.2.2.18 VLERAT E KODIT EWC

--Emri--

Vlerat e kodit EWC

--Përkufizimi--

Kodlista *VleratEKoditEWC*, përmban vlerat referencë për elementin "mbetje" referuar atributit *ElementetEProceseve* te klasa *DaljetEProcesit.* Me mbetje kuptojmë çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

-- **Tipi i elementit--**

Kodlistë

3.2.2.19 VLERAT E KODIT IPP

--Emri--

Vlerat e kodit IPPC

--Përkufizimi--

Kodlista e vlerave të kodit IPPC ka një grup vlerash referencë për atributin *KodiIAktivitetit,* në klasën *Aktiviteti.* Kjo listë përmban klasifikimin për aktivitetet në përputhje me Rregulloren e Këshillit 96/61/EC, të cilat janë përafruar në legjislacionin shqiptar.

--Përshkrimi--

Klasifikimi i IPPC ka një strukturë hierarkike, të ngritur në nivele të ndryshme, të trupëzuar në kodin e aktivitetit. Kodi i aktivitetit është i shoqëruar me emërtimin e aktivitetit.

-- **Tipi i elementit--**

Kodlistë

3.2.2.20 VLERAT E KODIT NACE

--Emri--

Vlerat e kodit NACE

--Përkufizimi--

Vlerat e kodit NACE, kanë një grup vlerash referencë për atributin *KodiAktiviteti,* në klasën *Aktiviteti*. Kjo listë përmban klasifikime të aktiviteteve në përputhje me Rregulloren e Këshillit 3037/90/EEC[4]

--Përshkrimi--

Klasifikimi i NACE ka një strukturë hierarkike, kodi i aktivitetit shoqërohet me emërtimin e veprimtarisë.

-- **Tipi i elementit--**

Kodlistë

3.3 METADATA

Përshtatja e elementeve të metadatës përcaktohet në rregulloren e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015 "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë".

3.4 KODI EPSG PËR KRGJSH

Referenca gjeodezike e të dhënave gjeohapësinore mbështetet në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare bazuar në vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 669, datë. 7.8.2013, *"Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë",* ndryshuar me vendimin nr. 322, datë. 27.4.2016 dhe vendimin nr. 359, datë 29.5.2019.

Kodi EPSG *për Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH) është:* ***EPSG – 6870****.*

3.5 Cilësia e të dhënave

Ky kapitull përfshin një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe nën elementeve si dhe cilësinë e matjes së të dhënave, që duhen përdorur për të vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e tyre, për grupet e të dhënave që lidhen me të dhënat gjeohapësinore të temës "Infrastruktura industriale".

Cilësia e të dhënave të elementeve, nën elementeve dhe matjeve duhet të përdoret për të:

- Vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e të dhënave dhe kufizimet e objekteve gjeohapësinore, ku pronat ose kufizimet e tilla përcaktohen si pjesë e skemës së aplikimit.

- Vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e të dhënave të elementeve të metadatave të grupeve të të dhënave gjeohapësinore.

- Për të specifikuar kërkesat ose rekomandimet në lidhje me rezultatet e cilësisë së të dhënave të zbatueshme për grupet e të dhënave gjeohapësinore që lidhen me temën "Burimet minerale".

Tabela e mëposhtme, paraqet të gjitha elementet dhe nën elementet e cilësisë së të dhënave që përdoren në këtë specifikim. Informacioni i cilësisë së të dhënave mund të vlerësohet në nivelin e objektit gjeohapësinor, llojit të objektit gjeohapësinor, datasetit ose grupit të të dhënave. Niveli në të cilin bëhet vlerësimi është dhënë në kolonën "Sfera e vlerësimit".

Masat që do të përdoren për secilin nga nën elementet e listuar, të cilësisë së të dhënave, janë përcaktuar në nën seksionet e më poshtme.

[4] Shiko Nomenklaturën REV të INSTAT-it.

Tabela - Elementet e cilësisë së të dhënave të përdorura në temën "Infrastruktura industriale" të të dhënave gjeohapësinore

Pjesa	Elementi i cilësisë së të dhënave	Nën elementi i cilësisë së të dhënave	Përkufizimi	Sfera e vlerësimit
3.4.1	Kompletimi	Përjashtimi	Të dhënat që mungojnë nga grupi i të dhënave, sikurse përshkruhet nga fushëveprimi.	Grupet e të dhënave
3.4.2	Përputhja ligjore	Përputhja konceptuale	Zbatimi i rregullave të skemës konceptuale.	Grupet e të dhënave
3.4.3	Përputhja ligjore	Përputhja në domein	Zbatimi i vlerave, në vlerat e domeinit.	Grupet e të dhënave
3.4.4	Saktësia pozicionale	Saktësia absolute ose e jashtme.	Aferësia e vlerave të koordinatës së raportuar, për vlerat e vërteta ose vlerat e pranuara si të tilla.	Objekti gjeohapësinor
3.4.5	Saktësia tematike	Korrektësia e klasifikimit	Karakteristikat e krahasimit të klasave të caktuara ose atributet e tyre në një univers ligjërimi.	Grup të dhënash, Grupet e të dhënave, Llojet e objektit gjeohapësinor, Objekti gjeohapësinor
3.4.6	Cilësia e kohës	Vlefshmëria e dimensionit kohor	Vlefshmëria e të dhënave të përcaktuara nga fushëveprimi në lidhje me kohën	Grup të dhënash; Llojet e objektit gjeohapësinor; Objekti gjeohapësinor

3.5.1 KOMPLETIMI – PËRJASHTIMI (COMPLETENESS – OMISSION)

Rekomandim

Përjashtimi mund të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur normën e artikujve të munguar sikurse specifikohet në tabelën e mëposhtme.

Emri	Normat e artikujve të tepërt
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Kompletimi
Cilësia e të dhënave të nën elementeve	Përjashtimi
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Matja e gabimit
Përkufizimi	Numri i artikujve që mungojnë në grupin e të dhënave bazuar në numrin e artikujve që duhet të ishin të pranishëm.
Përshkrimi	Informacioni që zotërojnë grupet e dhënave mund të tregojnë vetëm një grup të elementeve të kufizuar për shkak të shkaqeve të ndryshme si problemet në gjeoreferencim, kufizimet teknike të fushës, cilësia apo saktësia e të dhënave.
Fusha e vlerësimit	Grupi i të dhënave
Fusha e raportimit	Grupi i të dhënave
Parametri	Metoda e llogaritjes: reale, e përllogaritur.
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Lloji i vlerës që shërben për raportuar një rezultat të cilësisë së të dhënave. Lloji i vlerës së cilësisë së të dhënave duhet të ketë një rezultat të cilësisë së të dhënave. *Shembujt përfshijnë : Boolean, Real, Integer, Ratio (numëruesi i llojit të plotë: emërues i tipit të plotë), Përqindja, Masa (et) (vlera (t) +njësi (të)), Ratio.*
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	SSH EN ISO 19157 Informacion Gjeografik – Cilësia e të dhënave
Shembulli	Me anë të ligjit vendosen limite (p.sh. DjegjaEKapacitetit) për entitete do të regjistrohen në datat tematike të të dhënave. Kufijtë dhe kushtet për saktësinë e kërkuar nga legjislacioni (p.sh. rregullorja (KE) nr. 1166/2008)
Masa identifikuese	7

3.5.2 PËRPUTHJA LIGJORE – PËRPUTHJA KONCEPTUALE. (LOGICAL CONSISTENCY – CONCEPTUAL CONSISTENCY)

Rekomandim

Për testet në përputhje konceptuale, është e rekomanduar të përdoret Përputhja ligjore – Përputhja konceptuale e nën elementeve të cilësisë së të dhënave dhe masa e numrit të artikujve që nuk janë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale sikurse është specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Emri	
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja ligjore
Cilësia e të dhënave të nën elementeve	Përputhja konceptuale
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numërimi i gabimit
Përkufizimi	Numërimin i të gjithë artikujve në grupin e të dhënave që nuk janë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale.
Përshkrimi	Rregullat që përshkruhen në mënyrë të qartë dhe absolute duhet të ndiqen detyrimisht. Shkelja e rregullave, shoqërohet me gabime si vendosja e pavlefshme e karakteristikave në një interval tolerance, dyfishimin e karakteristikave dhe mbivendosjen e pavlefshme të karakteristikave.
Fusha e vlerësimit	Objekt gjeohapësinor: Llojet e objekteve gjeohapësinore
Fusha e raportimit	Grupi i të dhënave
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	-
Burimi reference	SSH EN ISO 19157 Informacion Gjeografik – Cilësia e të dhënave
Shembulli	
Masa identifikuese	10

3.5.3 PËRPUTHJA LIGJORE – PËRPUTHJA ME DOMEININ. (LOGICAL CONSISTENCY – DOMAIN CONSISTENCY)

Rekomandim

Për testet në përputhjet me domeinin, rekomandohet të përdoren nën elementet e cilësisë së të dhënave të Përputhjes ligjore – Përputhjes me domein dhe masa e numrit të artikujve që nuk janë në përputhje me vlerën e domeinit të tyre, të përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Emri	**Vlera e mos konformitetit të domeinit**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja ligjore
Cilësia e të dhënave të nën elementeve	Përputhja me *domeinin*
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numërimi i gabimit
Përkufizimi	Numërimi i të gjithë artikujve në grupin e të dhënave që nuk janë në përputhje me vlerën e domeinit të tyre.
Përshkrimi	-
Fusha e vlerësimit	Objekt gjeohapësinor: Llojet e objekteve gjeohapësinore
Fusha e raportimit	Grupi i të dhënave
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer

3.5.4 SAKTËSIA E POZICIONIMIT – SAKTËSIA ABSOLUTE APO E JASHTME. (POSITIONAL ACCURACY - ABSOLUTE OR EXTERNAL ACCURACY)

Rekomandim

Saktësia absolute ose e jashtme duhet të vlerësohen dhe dokumentohen duke përdorur vlerën mesatare të paqartësive pozicionale siç specifikohet në tabelat e mëposhtme

Emri	**Saktësia pozicionale**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Saktësia pozicionale

Cilësia e të dhënave të nën elementeve	Saktësi absolute ose e jashtme
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Nuk aplikohet
Përkufizimi	Vlera mesatare e pasigurive pozicionale për një grup pozicionesh, ku pasiguritë pozicionale përcaktohen si distanca ndërmjet një pozicioni të matur dhe atij që konsiderohet si pozicioni i vërtetë.
Fusha e vlerësimit	Grupi i të dhënave
Fusha e raportimit	Grupi i të dhënave
Përshkrimi	**Gabimi Mesatar Kuadratik (GMK = RMSE në anglisht)** - Është rrënja katrore e mesatares së ndryshimeve në katror ndërmjet vlerave të koordinatave të një grupi të dhënash të matura dhe vlerave të koordinatave nga një burim i pavarur i saktësisë më të lartë për pikat identike. GMK dallon dy raste :

Rasti 1 - Kur llogariten gabimet e mundshme v_i

$$m = \pm\sqrt{\frac{\sum v^2}{n-1}} : v_i = \bar{X} - x_i : \bar{X} = {\sum xi}/{n}$$

Ku:

v_i - gabimi i mundshëm që llogaritet si diferencë e vlerës përfaqësuese me vlerën e matur.

$\bar{X}$ - Vlera përfaqësuese që merret si vlera mesatare e vlerave të matura x_i

n - Numri i matjeve

Saktësia pozicionale[5] e përcaktuar nga të dhënat e kontrolluara:

➢ **Saktësia Horizontale**

$$GMK_X = \sqrt[2]{\sum (x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2/n}$$

$$GMK_Y = \sqrt[2]{\sum (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2/n}$$

ku:

$x_{Edhënë,i}$, $y_{Edhënë,i}$ –janë koordinat horizontale e pikave të kontrolluara në grupin e të dhënave.

$x_{Ekontrolluar,i}$, $y_{Ekontrolluar,i}$ – janë koordinatat e pikave të kontrolluara nga burime të pavarura të një saktësie më të lartë

n – është numri i pikave të testuara

i - është numri përkatës i pikës.

Gabimi horizontal i pikës përcaktohet nga:

$$GMK_r = \sqrt[2]{\sum ((x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2 + (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2)/n}$$

$$GMK_r = \sqrt{{GMK_x}^2 + {GMK_y}^2}$$

Nëse nga llogaritjet kemi $GMK_X = GMK_Y$,

$$GMK_r = \sqrt{2 * {GMK_x}^2} = \sqrt{2 * {GMK_y}^2}$$

$$GMK_r = 1{,}4142 * GMK_x \quad = 1{,}4142 * GMK_y$$

[5] Referuar Standardit Kombëtar për Raportimin e Saktësisë së të dhënave gjeohapësinore

	Supozohet sikur gabimet sistematike janë eliminuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse gabimet janë të shpërndara në mënyrë normale dhe të pavarura në secilin komponent (x, z) një koeficient (faktor) 2.4477 përdoret për të llogaritur saktësinë horizontale me nivel besimi 95% (Greenwalt and Schultz 1968). Kur zbatohen kushtet e mësipërme, $GMK_X = GMK_Y$, vlera e saktësisë horizontale referuar NSSDA duhet të llogaritet nga formula: $$Saktësia_r = 2{,}4477 * GMK_X = 2{,}4477 * GMK_Y$$ $$Saktësia_r = 2{,}4477 * GMK_r/1{,}4142$$ $$Saktësia_r = 1{,}7308 * GMK_r$$ ➢**Saktësia Vertikale** $$GMK_z = \sqrt[2]{\sum (z_{Edhënë,i} - z_{Ekontrolluar,i})^2/n}$$ *ku:* $z_{Edhënë,i}$, $y_{Edhënë,i}$ *–janë koordina vertikale e pikave të kontrolluara në grupin e të dhënave.* $z_{Ekontrolluar,i}$, $y_{Ekontrolluar,i}$ – *janë koordinata vertikale të pikave të kontrolluara nga burime të pa varuara të një saktësie më të lartë* n *– është numri i pikave të testuara* i *- është numri përkatës i pikës.* Supozohet sikur gabimet sistematike janë eliminuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse gabimet janë të shpërndara në mënyrë normale, një koeficient (faktor) 1.9600 përdoret për të llogaritur saktësinë vertikale me nivel besimi 95% (Greenwalt and Schultz 1968). Nga kjo, saktësia vertikale, e raportuar sipas NSSDA duhet të llogaritet nga formula: $$Saktësia_z = 1{,}9600 * GMK_z$$
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Matjet
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	-
Burimi referencë	-
Shembulli	-
Masa identifikuese	28

Emri	
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Saktësia e pozicionimit
Cilësia e të dhënave të nën-elementeve	Saktësia absolute dhe e jashtme
Cilësia e të dhënave matjeve themelore	-
Përkufizimi	Vlera mesatare e gabimeve pozicionale për një grup pozicionesh ku gabimet pozitive përcaktohen si distanca ndërmjet një pozicioni të matur dhe asaj që konsiderohet si pozicioni përkatës i vërtetë.
Përshkrimi	Për një numër pikash (N), për të cilat pozicionet e matura jepen si koordinata x_{mi}, y_{mi} dhe z_{mi} në varësi të dimensionit në të cilin matet pozicioni i pikës. Një grup përkatës i koordinatave, x_{ti}, y_{ti} dhe z_{ti}, konsiderohen të përfaqësojnë pozicionet e vërteta. Gabimet llogariten si: 1D: $e_i = \lvert x_{mi} - x_{ti} \rvert$ 2D: $e_i = \sqrt{(x_{mi} - x_{ti})^2 + (y_{mi} - y_{ti})^2}$ 3D: $e_i = \sqrt{(x_{mi} - x_{ti})^2 + (y_{mi} - y_{ti})^2 + (z_{mi} - z_{ti})^2}$ Vlera mesatare e gabimeve pozicionale horizontale absolute ose të jashtme, do llogaritet si më poshtë: $\bar{e} = \frac{1}{N}\sum_{i=1}^{N} e_i$ Rëndësi të veçantë ka dhe kriteri për vendosjen e korrespondencës (p.sh. duke lejuar korrespondencën në pozicionin më të afërt, korrespondencën në vertexe ose përgjatë vijave). Kriteri / kriteret për gjetjen e pikave përkatëse do të raportohen me rezultatin e vlerësimit të cilësisë së të dhënave. Kjo masë e cilësisë së të dhënave është e ndryshme nga devijimi standard.
Fusha vlerësimit	Të dhënat gjeohapësinore: KompleksitetiIAktivitetit/InfrastrukturaIndrustriale
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Matje ose reale
Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	-
Burimi referencë	SSH EN ISO 19157 Informacioni Gjeografik – Cilësia e të dhënave
Shembulli	**E-PRTR Manuali i përdoruesit:** http://www.eionet.europa.eu/schemas/eprtr/EPRTRUserManual.pdf 3.1.4 Raportimi i elementeve të objekteve KoordinatatGjeografike: Koordinatat e vendndodhjes së objektit duhet të shprehen në koordinatat gjatësi dhe gjerësi duke dhënë një saktësi të rendit prej të paktën 500 metra dhe duke iu referuar qendrës gjeografike të vendit të objektit. *Kriter i domosdoshëm!
Masa identifikuese	28 (SSH EN ISO 19157)

3.5.5 SAKTËSIA TEMATIKE – KORREKTËSIA E KLASIFIKIMIT (THEMATIC ACCURACY – CLASSIFICATION CORRECTNESS)

Rekomandim

Korrektësia e atributeve jo-sasior duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur shkallën e vlerave të atributeve të pasakta siç specifikohet në tabelën e më poshtme:

Emri	**Shkalla e vlerave të atributeve të pasakta**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Saktësia tematike
Cilësia e të dhënave të nën elementeve	Korrektësia e atributeve jo sasiore
Matjet themelore të cilësisë së të dhënave	Shkalla e gabimit
Përkufizimi	Numri i vlerave të atributeve, ku vlerat e pasakta janë përcaktuar në lidhje me numrin e përgjithshëm të vlerave atribut.
Përshkrimi	-
Fusha e vlerësimit	Grupe të dhënash
Fusha e raportimit	Grupe të dhënash
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindje
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	ISO/DIS 19157 Informacion Gjeografik – Cilësia e të dhënave
Shembulli	Ngjashmëria e temave në terminologji, mund të ndikoj në cilësinë e të dhënave (janë lehtësisht të ngatërrueshëm).
Masa identifikuese	61 (SSH EN ISO 19157)

3.5.6 CILËSIA KOHORE– VLEFSHMËRIA KOHORE (TEMPORAL QUALITY – TEMPORAL VALIDITY)

Rekomandim

Vlefshmëria e kohës duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur shkallën e përputhshmërisë së vlerës së domeinit siç specifikohet në tabelën e më poshtme:

Emri	**Shkalla e përputhshmërisë së vlerës së domeinit**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Cilësia kohore
Cilësia e të dhënave të nën elementeve	Vlefshmëria kohore
Matje themelore të cilësisë së të dhënave	Shkalla e gabimit
Përkufizimi	Numri i artikujve në grupin e të dhënave që janë në përputhje me domenin e vlerës së tyre, në raport me numrin e përgjithshëm të artikujve në grupin e të dhënave.
Përshkrimi	-
Fusha e vlerësimit	Lloji i objektit gjeohapësinor: KompleksitetiIAktivitetit
Fusha e raportimit	Grupe të dhënash
Parametri	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	-
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	-
Shembulli	Çdo ndryshim ligji, kërkon kohë për tu përshtatur te të dhënat. Prandaj ka raste ku grupet e të dhënave duhet të përditësohen pasi mund të jenë dhe të dyfishta. Vlefshmëria kohore dhe rifreskimi i të dhënave është një çështje e rëndësishme.
Masa identifikuese	28

4. ANEKSE

4.1 ANEKSI A – KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Nr	Emri i elementit Anglisht	Emri i elementit Shqip	Nëntema	Tipi
INFRASTRUKTURA INDUSTRIALE				
3.1.3.1	ProductionFacility	StrukturëProdhimi	InfrastrukturaIndustriale	FeatureType
3.1.3.2	ProductionInstallation	ImpiantetEProdhimit	InfrastrukturaIndustriale	FeatureType
3.1.3.3	StatusType	LlojiIStatusit	InfrastrukturaIndustriale	DataType
3.1.3.4	ProductionBuilding	NdërtesaProdhimi	InfrastrukturaIndustriale	FeatureType
3.1.3.5	ProductionPlot	NgastërProdhimi	InfrastrukturaIndustriale	FeatureType
3.1.3.6	ProductionSite	ZonëProdhimi	InfrastrukturaIndustriale	FeatureType
3.1.3.7	TechnicalUnit	NjësiaTeknike	InfrastrukturaIndustriale	FeatureType
3.1.3.8	ProductionInstallationPart	PjesëEImpianteveTëProdhimit	InfrastrukturaIndustriale	FeatureType
3.1.3.9	InstallationTypeValue	VleratELlojeveTëImpianteve	InfrastrukturaIndustriale	KodListë
3.1.3.10	TypeOfProductionBuildingValue	VleratELlojeveTëNdërtesaveTëProdhimit	InfrastrukturaIndustriale	KodListë
3.1.3.11	InstallationPartTypeValue	VleratELlojeveTëPjesëveTëImpianteve	InfrastrukturaIndustriale	KodListë
3.1.3.12	PollutionAbatementTechniqueValue	VleratETeknikësSëReduktimitTëNdotjes	InfrastrukturaIndustriale	KodListë
3.1.3.13	RiverBasinDistrictValue	VleratEZonaveTëBaseneveTëLumenjve	InfrastrukturaIndustriale	KodListë
3.2.2.1	Activity	Aktiviteti	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	FeatureType
3.2.2.2	Emission	Shkarkimi	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	FeatureType
3.2.2.3	ProcessInput	HyrjetEProcesit	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	FeatureType
3.2.2.4	TechnicalUnit	NjësiaTeknike	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	FeatureType
3.2.2.5	ProductionProcess	ProcesiIProdhimit	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	FeatureType
3.2.2.6	ProcessOutput	DaljetEProcesit	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	FeatureType
3.2.2.7	Measure	Matjet	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	DataType
3.2.2.8	EmissionValue	VleratEShkarkimit	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	
3.2.2.9	RegistrationNatureValue	VleratELlojitTëRegjistrimit	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	Numërtime
3.2.2.10	FlowApperenceValue	VleratEDukshmeTëRrjedhës	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	Numërtime
3.2.2.11	DestinationValue	VleratFinalizuese	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	Numërtime
3.2.2.12	ProcessItemValue	VleratEElementeveTëProcesit	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	Numërtime
3.2.2.13	EnergyClassificationValue	VleratEKlasifikimitTëEnergjisë	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë
3.2.2.14	ActivityCodeValue	VleratEKodeveTëAktivitetit	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë
3.2.2.15	CPACodeValue	VleratEKoditCPA	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë
3.2.2.16	CPLCodeValue	VleratEKoditCPL	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë
3.2.2.17	E-PRTRCodeValue	VleratEKoditE-PRTR	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë
3.2.2.18	EWCCodeValue	VleratEKoditEWC	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë
3.2.2.19	IPPCCodeValue	VleratEKoditIPPC	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë
3.2.2.20	NACECodeValue	VleratEKoditNACE	InfrastrukturaIndustrialeModeliIZgjeruar	KodListë

4.2 ANEKSI C – KODLISTAT

4.2.1 SKEMA E APLIKIMIT E TEMËS "INFRASTRUKTURA INDUSTRIALE"

KODLISTË
VleratTeknikeTëReduktimitTëNdotjes

4.2.2 VLERAT TEKNIKE TË REDUKTIMIT TË NDOTJES

-- **Emri** --

Vlera teknike të reduktimit të ndotjes

-- **Përkufizimi** --

Kodlista e vlerave teknike të reduktimit të ndotjes mbart vlerat referencë, për atributet teknike në klasën *PjesëEImpianteveTëProdhimit.*

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/PollutionAbatementTechniqueValue

-- **Vlerat** --

Vlerat e lejuara për këtë listë kodesh përfshijnë vlerat e specifikuara në tabelën më poshtë dhe vlerat shtesë në çdo nivel të përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.

KODLISTË
-- Emri -- Graviteti **-- Përkufizimi --** Reduktimi i ndotjes me gravitacion.
-- Emri -- Pastrues pluhuri- dust scrubbers **-- Përkufizimi --** Reduktimi i ndotjes nëpërmjet pastruesve të pluhurave.
-- Emri -- Filtrim **-- Përkufizimi --** Reduktimi i ndotjes me filtrim.
-- Emri -- Kondensim **-- Përkufizimi --** Reduktimi i ndotjes me kondensim.
-- Emri -- Absorbimi **-- Përkufizimi--** Reduktimi i ndotej me absorbim.

4.2.3 SKEMA E APLIKIMIT "INFRASTRUKTURA INDUSTRIALE MODELI I ZGJERUAR"

KODLISTË
VleratEKodeveTëAktivitetit
VleratEKoditCPL
VleratEKoditCPA
VleratEKoditE-PRTR
VleratEKoditEWC
VleratEKlasifikimitTëEnergjisë
VleratEKoditIPP
VleratEElemneteveTëProcesit

4.2.4 VLERAT E KODEVE TË AKTIVITETIT

-- **Emri** --

Vlerat e kodeve të aktivitetit

-- **Përkufizimi** --

VleratEKodeveTëAktivitetit mbart vlerat e të gjitha vlerave referencë potenciale për atributin *KodiIAktivitetit* në klasën *Aktiviteti.*

-- **Vlerat** --

Vlerat e kësaj kodliste përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse lokale.

4.2.5 VLERAT E KODIT CPL

-- **Emri** --

Vlerat e kodit CPL

-- **Përkufizimi** --

Kodlista e CPL ka vlera referencë, për atributin *ElementeveProceseve,* në klasën *HyrjetEProcesit* ose *DaljetEProcesit* dhe atributit *SubsatancaNdotëse,* në klasën *Shkarkime.* Substancë nën kupton çdo element kimik dhe komponimet e tij, me përjashtim të disa substancave specifike.

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/CLPCodeValue

-- **Vlerat** --

Vlerat e kësaj kodliste përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse lokale.

4.2.6 VLERAT E KODIT CPA

-- **Emri** --

Vlerat e kodit CPA

-- **Përkufizimi** --

Kodlista e vlerave të kodit CPA, përmban një grup vlerash reference për atributin *KodiIAktivitetit*, në klasën *Aktiviteti.* Lista përmban klasifikimin për aktivitetet në përputhje me regjistrin E-PRTR.

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/CPACodeValue

-- **Vlerat** --

Vlerat e kësaj kodliste përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse lokale.

4.2.7 VLERAT E KODIT E-PRTR

-- **Emri** --

Vlerat e kodit E-PRTR

-- **Përkufizimi** –

Kodlista e vlerave të kodit E-PRTR, ka vlera referencë për atributin *KodiIAktivitetit*, në klasën *Aktiviteti.* Kjo listë përmban një klasifikim për aktivitetet në përputhje me regjistrin E-PRTR.

--Përshkrimi--

Klasifikimi i E-PRTR ka një strukturë hierarkike, të ngritur në nivele të ndryshme, të trupëzuar në kodin e aktivitetit. Kodi i aktivitetit shoqërohet me emërtimin e aktivitetit.

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/E-PRTRCodeValue

-- **Vlerat** --

Vlerat e kësaj kodliste përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse lokale.

4.2.8 VLERAT E KODIT EWC

-- **Emri** --

Vlerat e kodit EWC

-- **Përkufizimi** --

Kodlista e vlerave të kodit EWC, përmban një grup vlerash referencë për atributin për elementin "mbetje" si mbetja, referuar atributeve *ElementetEProceseve,* në klasat *HyrjetEProcesit* ose *DaljetEProcesit.*

Mbetje është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

--Përshkrimi--

Klasifikimi EWC (Katalogu Evropian i Mbetjeve implementuar në Shqipëri me VKM-në nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", e ndryshuar) ka një strukturë hierarkike të bazuar në nivele të ndryshme të përfshira në kodin e mbetjeve. Kodi i mbetjes shoqërohet me emërtimin e mbetjes.

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/EWCCodeValue

-- **Vlerat** –

Vlerat e kësaj kodliste përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse lokale.

4.2.9 VLERAT E KLASIFIKIMIT TË ENERGJISË

-- **Emri** --

Vlerat e klasifikimit të energjisë

-- **Përkufizimi** –

Kodlista *VleratEKlasifikimitTëEnergjisë*, përfshijnë një grup vlerash referencë për elementin "energjia", referuar atributeve *ElementetEProceseve,* në klasat *HyrjetEProcesit* ose *DaljetEProcesit.* Energjia

nënkupton energjinë që prodhohet nga burime fizike ose kimike, të aftë për të furnizuar ndriçim ose nxehtësi, për makinat e punës.

--Përshkrimi--

Klasifikimi që përdoret bazohet në një sërë burimesh, përfshirë EUROSTAT, DG ECFIN dhe EEA.

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/EnergyClassificationValue

-- **Vlerat** --

Tabela më poshtë përfshin vlerat e rekomanduara, që mund të përdoren nga ofruesit e të dhënave. Para krijimit të vlerave të reja, duhet të kontrollohet nëse njëri prej tyre mund të përdoret.

KODLISTË
-- Emri -- Lëndë djegëse të ngurta **-- Përkufizimi --** Energjia që përftohet nga lëndët djegëse të ngurta.
-- Emri -- Produktet e naftës **-- Përkufizimi --** Energjia që përftohet nga burimet e naftës.
-- Emri -- Gazet – Gases **-- Përkufizimi --** Energjia që përftohet nga burimet e gazit.
-- Emri -- Elektriciteti **-- Përkufizimi --** Energjia që përftohet nga burimi i energjisë elektrike.
-- Emri -- Energji bërthamore **-- Përkufizimi --** Energjia që përftohet nga energjia bërthamore
-- Emri -- Energji e rinovueshme **-- Përkufizimi --** Energjia që përftohet nga burimet e rinovueshme.

4.2.10. VLERAT E KODIT IPPC

-- **Emri** --

Vlerat e kodit IPP

-- **Përkufizimi** --

Kodlista e vlerave të kodit IPPC, përmban një grup vlerash reference, për atributin *KodiAktivitetit,* në klasën *Aktiviteti*. Kjo kodlistë përmban klasifikimin për aktivitetet në përputhje me Rregulloren e Këshillit të BE (e cituar më lart).

--Përshkrimi--

Klasifikimi IPPC (Integrated Pollution Prevention and Control- Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes) ka një strukturë hierarkike e cila përmban nivele të ndryshme, për kodet e aktiviteteve. Kodet e aktiviteve shoqërohen me emërtimin e aktivitetit.

-- **Identifikuesi** --

http://inspire.ec.europa.eu/codeList/IPPCCodeValue

-- **Vlerat** --

Vlerat e kësaj kodliste përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse lokale.

4.2.11. VLERAT E ELEMENTEVE TË PROCESIT

-- **Emri** --

Vlerat e elementeve të procesit

-- **Përkufizimi** --

Kodlista e elementeve të procesit ka gjithë vlerat potenciale referuese për atributin *ElemetetEProcesit,* në klasat HyrjetEProcesit ose *DaljetEProcesit.*

-- **Vlerat** --

Vlerat e kësaj kodliste përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse lokale.

VENDIM
Nr. 213, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË TRAGJAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM, QARKU VLORË, NGA SHOQËRIA *"SUNTECH POWER"* SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria "*SUNTECH POWER*" sh.p.k., me elementet si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria "*SUNTECH POWER*" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L81906019T;

c) Tipi i centralit: Eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për marrjen e lejes së ndërtimit, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqërisë "*SUNTECH POWER*" sh.p.k. i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik;

gj) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 3 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë, për qëllime të veçanta, mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

h) Shoqëria "*SUNTECH POWER*" sh.p.k. ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuara informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë "*SUNTECH POWER*" sh.p.k. ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast

mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "*SUNTECH POWER*", sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 214, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË TRAGJAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM, QARKU VLORË, NGA SHOQËRIA *"A GREAT COMPANY"* SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria "*A GREAT COMPANY*" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria "*A GREAT COMPANY*" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L44404004S;

c) Tipi i centralit: Eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për marrjen e lejes së ndërtimit, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqërisë "*A GREAT COMPANY*" sh.p.k. i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik;

gj) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 3 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë, për qëllime të veçanta, mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

h) Shoqëria "*A GREAT COMPANY*" sh.p.k. ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "*A GREAT COMPANY*" sh.p.k. ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "*A GREAT COMPANY*" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 215, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË TRAGJAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM, QARKU VLORË, NGA SHOQËRIA "*NIKOLICA SKI RESORT*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria *"NIKOLICA SKI RESORT*" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria "*NIKOLICA SKI RESORT*" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L74829001T;

c) Tipi i centralit: Eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për marrjen e lejes së ndërtimit, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqërisë "*NIKOLICA SKI RESORT*" sh.p.k. i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik;

gj) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 3 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë, për qëllime të veçanta, mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

h) Shoqëria "*NIKOLICA SKI RESORT*" sh.p.k. ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "*NIKOLICA SKI RESORT*" sh.p.k. ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "*NIKOLICA SKI RESORT"* sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 216, datë 13.4.2023

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, si dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Krijimin e sistemit të integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim (në vijim "sistemi i integruar"), i cili unifikon metodologjinë e llogaritjes e të formatit të paraqitjes së preventivave dhe situacioneve, si dhe të analizave teknike të çmimeve për të lehtësuar veprimtarinë e subjekteve publike apo private, si dhe për lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar në fushën e ndërtimit.

2. Institucioni përgjegjës për gjenerimin dhe përditësimin e të dhënave në sistemin integruar është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 2

1. Të dhënat parësore që përmban sistemi i integruar janë:

a) të dhënat për çmimet mesatare të 4 (katër) elementeve të strukturës së kostos;

b) analizat teknike të çmimeve mesatare për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologjitë e reja, të përdorura nga subjektet publike dhe/ose private, që kryejnë veprimtari në fushën e ndërtimit, të prodhimit të materialeve të ndërtimit, si dhe të tregtimit të tyre sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

c) preventivat/situacionet për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve.

2. Të dhënat dytësore që përmban sistemi i integruar janë të dhënat e identifikimit të subjekteve të interesuara, si: emri, mbiemri, numri personal i identifikimit, NIPT-i ose numri i licencës.

Neni 3

1. Sistemi i integruar ndërvepron me baza të tjera të dhënash, si:

a) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

b) Regjistri Tregtar i Qendrës Kombëtare të Biznesit;

c) Regjistri i Licencave;

ç) Portali unik qeveritar *e-Albania.*

2. Dhënës të informacionit në sistemin e integruar janë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

b) Personat fizikë apo juridikë privatë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e ndërtimit;

c) institucionet e administratës publike që planifikojnë investimet për ndërtimin e veprave publike.

Neni 4

1. Subjekte të interesuara janë të gjithë personat fizikë apo juridikë, publikë ose privatë, të cilët kërkojnë të përdorin sistemin e integruar për hartimin e preventivit ose situacionit në rastin e një investimi apo punimi në fushën e ndërtimit, si dhe për çdo arsye tjetër.

2. Niveli i aksesimit në sistemin e integruar është, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka të drejta regjistrimi, përpunimi, raportimi, leximi, shkrimi dhe përditësimi për të dhënat e regjistruara në sistemin e integruar:

b) Subjektet e interesuara sipas pikës 1, të këtij neni, kanë akses në leximin për sa u përket të dhënave për çmimet mesatare të 4 (katër) elementeve të strukturës së kostos, si dhe analizat teknike të çmimeve mesatare, krijimin e dokumenteve përkatëse, si preventiv apo situacione, si dhe dhënien e informacionit,

analizave apo të dhënave për çmimin e elementeve të kostos.

KREU II
MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË INTEGRUAR

Neni 5

Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit.

Neni 6

Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.

Neni 7

Preventivat për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në faqen e preventivave të unifikuar në portalin unik qeveritar *e-Albania*, sipas metodologjisë së llogaritjes së kostos, janë pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo të ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

1. Vlerat e zërave të punës së preventivave të objekteve ndërtimore, të projektuara nga subjekte, publike apo private, përcaktohen nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit, me çmimet për njësi në sistemin e integruar të manualit të çmimeve.

2. Vlera e zërave të punës, të situacioneve e të ndërtimit përcaktohen nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike.

Neni 9

1. Sistemi i integruar i manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim përmban çmimet e punimeve të ndërtimit të mesatarizuara dhe analizat teknike të punimeve të ndërtimit, të specifikuara sipas numrit të analizave.

2. Manuali i çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim pasqyron situatën aktuale të çmimeve të mesatarizuara të materialeve të ndërtimit dhe produkteve për ndërtim, të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit në çdo moment të kohës.

Neni 10

Materialet e ndërtimi janë të gjitha materialet, që përdoren në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përfshirë lëndën e parë dhe materialet ndihmëse, në përputhje me standardet e miratuara dhe me rregulloren evropiane për produktet e ndërtimit. Në rastet kur është e aplikueshme, produktet duhet të jenë të shoqëruara me deklaratën e konformitetit (CE).

Neni 11

Sistemi i integruar i manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet informacionit të ardhur nga subjektet publike dhe/ose private, që kryejnë veprimtari në fushën e ndërtimit, të prodhimit të materialeve të ndërtimit, si dhe të tregtimit të tyre, nëpërmjet këtij sistemi, sipas strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit, të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi.

Neni 12

Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit nëpërmjet shërbimit të dedikuar elektronik në portalin unik qeveritar *e-Albania*, paraqesin analizat teknike dhe çmimet për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologjitë e reja, të përdorura prej tyre, për të cilat

nuk ekziston një analizë teknike e çmimit në manualin elektronik. Analizat teknike paraqiten në përputhje me metodologjinë e parashikuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

Neni 13

1. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike nga buxheti i shtetit apo nga donatorë të huaj, në kontrollin e çmimeve për zërat e punës së ofertave të paraqitura në tender, u referohen çmimeve të zërave të punimeve të dhëna në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve.

2. Në rastin kur zëri i punës nuk është në manualin e çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim, institucioni shtetëror, që kryen prokurime, u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në formatin e dhënë në sistemin e integruar, si dhe në metodologjinë e strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit, të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi.

3. Fond i veçantë i parashikuar për çdo objekt, i cili shërben për zbatimin e masave për sigurinë në kantier, në zbatim të aneksit VI, të vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", parashikohet në dokumentacionin që do të shoqërojë miratimin e projektit. Vlera e këtij fondi do të dalë në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet, por, në çdo rast, jo më pak se 3% e vlerës së tij.

4. Institucioni prokurues nëpërmjet sistemit të integruar i dërgon analizat për zërin e punës, të paraqitura nga subjekti ofertues i shpallur fitues, si kërkesë për t'u përfshirë në manualin e çmimeve.

Neni 14

Subjektet, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e ndërtimit, bëjnë kërkesë nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania* për përfshirjen e produkteve dhe analizave të reja teknike, të shoqëruara me informacionin:

a) Për prodhuesit e materialeve të ndërtimit, në përputhje me licencën që zotërojnë:

i. analizën tekniko-financiare të prodhimit;

ii. skedën teknike të çdo materiali (analizat laboratorike);

iii. emrin dhe kodin e saktë të çdo materiali, sipas standardit të referimit;

iv. çmimin përkatës të çdo materiali.

b) Për importuesit e materialeve të ndërtimit:

i. skedën teknike të çdo materiali të importuar, sipas standardit të vendit të origjinës;

ii. emrin dhe kodin e saktë të çdo materiali, sipas standardit të referimit;

iii. çmimin përkatës të çdo materiali.

c) Për ndërtuesit, që përdorin materialet e ndërtimit, sipas përdorimeve përkatëse:

i. analizën tekniko-financiare të zërit të punës;

ii. specifikimet teknike të materialeve dhe të teknologjisë së përdorur.

Neni 15

Ministria, që ka në përgjegjësinë e saj fushën e ndërtimit, përpunon informacionin e ardhur nga subjektet kërkuese, duke e zbërthyer në katër elementet e strukturës së kostos:

a) shpenzimet për pagat bazë dhe shtesën mbi pagën;

b) shpenzimet për materialet;

c) shpenzimet për transportin;

ç) shpenzimet për makineritë,

dhe nëpërmjet sistemit të integruar i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve çmimet e mesatarizuara në shkallë vendi.

Neni 16

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me marrjen e kërkesës për dhënien e çmimeve të mesatarizuara në shkallë vendi, është përgjegjëse për vënien në dispozicion brenda 15 ditëve të çmimeve të mesatarizuara pas kontrollit nëpërmjet platformës qendrore të menaxhimit të faturave ose hulumtimeve në terren, ministrisë që ka në përgjegjësinë e saj fushën e ndërtimit.

Neni 17

1. Ministria, që ka në përgjegjësinë e saj fushën e ndërtimit, është përgjegjëse për unifikimin dhe përpunimin e analizave të reja me çmimet e mesatarizuara të ardhura nga Drejtoria e

Përgjithshme e Tatimeve, si dhe reflektimin e ndryshimit të çmimeve të mesatarizuara në analizat ekzistuese.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon në çdo kohë, nëpërmjet sistemit, përditësimin e çmimeve mesatare ekzistuese, si dhe kryen propozime për produkte të reja nga kontrolli nëpërmjet platformës qendrore të menaxhimit të faturave ose hulumtimeve në terren.

Neni 18

Të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit dhe detyrimet e tjera, të lidhura me veprimtarinë ndërtuese në fushën e ndërtimit, përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, llogariten sipas vlerave faktike të punimeve, bazuar në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin e çmimeve të ndërtimit, të zbërthyera sipas strukturës së kostos, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

KREU III
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 19

1. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15. 7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre", të ndryshuar, dhe nr. 514, datë 15.8.2007, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, shfuqizohen.

2. Rregullat e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre", të ndryshuar, dhe nr. 514, datë 15.8.2007, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, do të zbatohen deri në 3 (tre) muaj nga publikimi i sistemit të integruar në portalin unik qeveritar *e-Albania*.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe çdo institucion shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 217, datë 13.4.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1039, DATË 16.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR EMETIMIN, PRODHIMIN, PËRDORIMIN DHE TREGTIMIN E PULLËS POSTARE SHQIPTARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 46/2015, "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 1039, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"24. Pullat postare shqiptare shtypen në ente të specializuara, të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm për shtypjen e letrave me vlerë, certifikatë cilësie dhe sigurie të shtypit.".

b) Në nenin 25, fjala "... shtypja ..." hiqet.

2. Ngarkohet Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 218, datë 13.4.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM I QENDRËS SHËNDETËSORE NË LAGJEN 'GAFURR MUÇO', BASHKIA LUSHNJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim i qendrës shëndetësore në lagjen 'Gafurr Muço', Bashkia Lushnjë".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme shpronësimi, prej 2 254 070 (dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 254 070 (dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Bashkia Lushnjë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Lushnjë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIM I QENDRËS SHËNDETËSORE NË LAGJEN 'GAFURR MUÇO', BASHKIA LUSHNJË"

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE									"TRUALL"			"NDËRTESË"			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Arë" (m2)	"Truall" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	O	P	Q	R	S	T	Y	Z
1	AGIM	QAZIM	STAFA	LUSHNJE	8572	12/182	NDËRTESË	25	0	0	25	18	7	0.0	0	0	25.0	0	348966	348,966	Konfirmuar nga ASHK
2	ALFONS	DUDE	BEQARI	LUSHNJE	8572	12/74	TRUALL	81	0	81	76			81.0	8,954	725274	76	0	1179830	1,905,104	Konfirmuar nga ASHK
	SHUMA															725274			1528796	2,254,070	

VENDIM
Nr. 219, datë 13.4.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHESHIT PËRPARA DEGËS SË THESARIT TIRANË, RRUGA 'MUSTAFA LLESHI'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i sheshit përpara Degës së Thesarit Tiranë, rruga 'Mustafa Lleshi"'.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 54 608 531.59 (pesëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një pikë pesëdhjetë e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 54 608 531.59 (pesëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një pikë pesëdhjetë e nëntë) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHESHIT PËRPARA DEGËS SË THESARIT TIRANË, RRUGA 'MUSTAFA LLESHI"'

NR.	PRONËSIA			TË DHËNA KADASTRALE									TË DHËNAT E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN										SHËNIME	
													TRUALL			NDËRTESË BANIMI			NDËRTESË SOCIAL EKONOMIKE			VLERA E SHPRONËSIMIT		
	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	QYTETI	ZK	NR. I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE (m²)	TRUALL (m²)	NDËRTESË (m²)	VOL	FAQE	SIPËRFAQJA (m²)	ÇMIMI (lek/m²)	VLERA (lekë)	SIPËRFAQJA (m²)	ÇMIMI (lek/m²)	VLERA (lekë)	SIPËRFAQJA (m²)	ÇMIMI (lek/m²)	VLERA (lek)	VLERA TOTALE (LEKE)	(Kufizime hipotekare barre mbi pasurinë etj.)	Shënime të tjera
1	Haxhi	Rushit	Muçaj	Tiranë	8160	3/76	Truall	92.5	92.5	37.30	17	154	92.5	66,969	6,194,632.50	37.30	96,485.19	3,598,897.59	37.30	20,091.14	749,399.48	**10,542,929.57**	Konfirmuar nga ASHK-ja D - Pasuria bllokohet në favor të "Banka e Parë e Investimeve Albania" sh.a. për shumën 2.725.000 lekë	Shënim S.Sh.: Në përgjigje të aplikimit nr. 85995, datë 9.12.2022, objekti i pozicionuar mbi pasurinë nr. 3/76, Zk 8160 është konfirmuar si godinë e kombinuar 1 kat + 1 kat nën tokë, ku kati përdhes është me funksion banim, ndërsa kati nëntokë është me funksion social-ekonomik.
2	Shaban		Gega	Tiranë	8160	3/460	Truall	19.00	19.00	0.00	12	175	19.00	66,969	1,272,411.00			-	0.00		-	**1,272,411.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
3	Zoica	Jorgji	Frasheri	Tiranë	8160	3/73	Truall	172.00	172.00	0.00	15	104	158.00	66,969	10,581,102.00			-	0.00		-	**10,581,102.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
4	Arjan	Zef	Dodaj	Tiranë	8160	3/653	Truall	15.00	15.00	0.00	18	112	15.00	66,969	1,004,535.00			-	0.00		-	**1,004,535.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
5	Arjan	Zef	Dodaj	Tiranë	8160	3/654	Truall	18.00	18.00	10.00	18	192	18.00	66,969	1,205,442.00			-	0.00		-	**1,205,442.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	Shënim. S.Sh.: Nga verifikimi në terren dhe referuar ASIG-ut, nuk ka ndërtesë ekzistuese, për këtë arsye nuk ndërtesa nuk është pjesë e llogaritjeve.
6	Vjollca Ylli		Peci Peci	Tiranë	8160	3/48	Truall	30.00	30.00	0.00	12	99	25.00	66,969	1,674,225.00			-	0.00		-	**1,674,225.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
7	Lirie	Ismail	Bejtja	Tiranë	8160	3/12	Truall	146.00	146.00	0.00	13	41	26.00	66,969	1,741,194.00			-	0.00		-	**1,741,194.00**	Konfirmuar	

																							nga ASHK-ja	
8	Ferik	Zenel	Gremshi	Tiranë	8160	3/517	Truall	17.00	17.00	0.00	13	157	4.00	66,969	267,876.00			-	0.00		-	**267,876.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
9	Dashnor Albana	Malush Xhavit	Malushi, Rruçi	Tiranë	8160	3/516	Truall	78.00	78.00	57.30	13	156	18.00	66,969	1,205,442.00			-	0.00		-	**1,205,442.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni E: Vendim leg. shtesë anësore 1-katëshe. Sip. e katit përdhes = 57.3 m²/soc.-ekonomike.	
10	Fatbardha	Sefer	Goni	Tiranë	8160	3/506	Truall	140.00	140.00	0.00	13	98	140.00	66,969	9,375,660.00			-	0.00		-	**9,375,660.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
11	Artan Miranda Farije Qerim		Mata Shima Mata Mata	Tiranë	8160	3/507	Truall	30.00	30.00	0.00	13	97	30.00	66,969	2,009,070.00			-	0.00		-	**2,009,070.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja E - pasuria pa datë lëshimi. certifikate e vlefshme për informacion.	
12	Hasan Gezim Bujar Ganimet Myzejen Shpresa Mustafa Suzana Kujtim Bukurije Deshirë Fatos Ilir	. . . . . . Shaban Shaban Shaban Shaban Shaban	Sokoli Sokoli Sokoli Sokoli Kashari Kodra Sokoli Sauku Hyka Kita Mihalçka Hyka Hyka	Tiranë	8160	3/31	Truall	1869.00	1869.00	0.00	24	191	9.00	66,969	602,721.00			-	0.00		-	**602,721.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
13	Antoneta Marjana Loreta Jorgjeta Liljana		Ballamaci Ballamaci Ballamaci Ballamaci Ballamaci, etj	Tiranë	8160	3/402	Truall	18.00	18.00	0.00	13	154	11.00	66,969	736,659.00			-	0.00		-	**736,659.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja	
14	Besnik	Faik	Meça	Tiranë	8160	3/394	Truall	204.00	204.00	204.00	18	211	185.00	66,969	12,389,265.00			-	0.00		-	**12,389,265.00**	Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni C - Kontratë dhurimi	Shënim. S. Sh.: Referuar planit të prishjeve dhe të verifikimit nga ASIG-u, nuk ekziston ndërtesë mbi këtë pasuri.
	VLERA E SHPRONËSIMIT												**750.50**	**66,969**	**50,260,234.50**	**37.30**	**96,485.19**	**3,598,897.59**	**37.30**	**20,091.14**	**749,399.48**	**54,608,531.59**		

VENDIM
Nr. 221, datë 13.4.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 475, DATË 8.6.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË NATO-s NË LETONI", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 5, të vendimit nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data "31 dhjetor 2023" zëvendësohet me "31 dhjetor 2026".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 223, datë 13.4.2023

PËR NJË SHTESË NË NUMRIN E PUNONJËSVE ORGANIKË NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2023, DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR, MIRATUAR PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 12 e 14, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, për vitin 2023, shtohet me 27 (njëzet e shtatë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 73 (shtatëdhjetë e tre) punonjës.

2. Numri rezervë i punonjësve, për vitin 2023, zvogëlohet me 27 (njëzet e shtatë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 73 (shtatëdhjetë e tre) punonjës.

3. Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në grupin buxhetor nr. 87, "Institucione të tjera qeveritare", në programin "e-Qeverisja", i shtohet fondi prej 40 (dyzet) milionë lekësh, përkatësisht, 25 (njëzet e pesë) milionë lekë për shpenzime korrente dhe 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë për shpenzime kapitale.

4. Fondi prej 40 (dyzet) milionë lekësh përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 225, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES PËR NJË HUA SHTESË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 47/2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për një hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e projektit të rehabilitimi të rrugës së lumit të Vlorës, ratifikuar me ligjin nr. 47/2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

14 mars 2022 7:35 Marrë me 10/02/2021 23:54

Nr. 6434 Fq. 1/3

(stema) **FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB**

(stema)

Ref: KF/ 11/1027/3 - 53		Faqet në total: 3
Data: 14.3.2022		CF: AB/79/Py
Faks: (965) 22999190 (965) 22999091	Telefon (965) 22999000 E-mail: operations@kuwait-fund.org	Faqja e internetit: http://www.kuwait-fund.org

Drejtuar: **Nr. i faksit/Email**

Shkëlqesisë së Tij Ministrit të Financave
Ministria e Financave
Tiranë-Republika e Shqipërisë
+355 4 2228 494
info@financa.gov.al

Kopja i dërgohet:
1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit
Tiranë-Republika e Shqipërisë
+355 4 2234 885
adf@albaniandf.org

2. Shkëlqesisë së Tij Ambasadorit të shtetit të Kuvajtit
422 36501
Ambasada e Shtetit të Kuvajtit
Tiranë-Republika e Shqipërisë
00355
kuwaitembassy.tirana@gmail.com
kuwaitembassy.tirana@mail.mofa.gov.kw

3. Shkëlqesisë së Tij Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë,
25240628
Ambasada e Republikës së Shqipërisë
Kuvajt
embassy.kuwait@mfa.gov.al

Lënda: Programi i Rishikuar i Amortizimit të Marrëveshjes Shtesë të Huasë-
Projekti i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës- K.F .Huaja Nr. 943/1027

Shkëlqësia Juaj,

Në referencë të shkresës sonë Nr. KF/11/1027/3-45, datë 22/02/2022, në të cilën kemi korrigjuar gabimin tipografik në datat gjashtëmujore të versionit në anglisht të Marrëveshjes së Huasë për objektin.

Dëshirojmë të sjellim në vëmendje të Shkëlqesisë Suaj faktin se jemi në pritje të një kopjeje të Formularit të Konfirmimit që i përket ndryshimit të lartpërmendur që duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar dhe që duhet të na dërgohet neve (kopja bashkëlidhur).

Gjithashtu, ju lutem gjeni bashkëlidhur këtij dokumenti Programin e Rishikuar të Amortizimit, pas ndryshimeve në datat e Versionit në anglisht të Marrëveshjes së Huasë për Objektin.

Duke i konfirmuar Shkëlqesisë Suaj bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm, ju lutem pranoni vlerësimin dhe konsideratën time më të lartë.

(Nënshkrimi)
Drejtor i Përgjithshëm
Marwan A. Th. AlGhanem

13030 2921 Faks: (965) 22999090/22999091 Tel: (965) 22990000
Kutia Postare: 2921 Salat, 12030 Kuvait – E-mail: info@kuwait-fund.org

14 mars 2022 7:35 Marrë me 10/02/2021 23:54

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

PROGRAMI I NDRYSHUAR I AMORTIZIMIT PËR HUATË E FONDIT TË KUVAJTIT NR. 943/1027 PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS - REPUBLIKA E SHQIPËRISË. **1027/943**

Kësti për tu paguar në K.D.	Data e Përfundimit	Kësti Nr.
495,000/-	01/11/2023	1
495,000/-	01/05/2024	2
496,000/“	01/11/2024	3
495,000/-	01/05/2025	4
495,000/-	01/11/2025	5
495,000/-	01/05/2026	6
495,000/-	01/11/2026	7
495,000/-	01/05/2027	8
495,000/-	01/11/2027	9
495,000/-	01/05/2028	10
495,000/-	01/11/2028	11
495,000/-	01/05/2029	12
495,000/-	01/11/2029	13
495,000/-	01/05/2030	14
495,000/-	01/11/2030	15
495,000/-	01/06/2031	16
495,000/-	01/11/2031	17
495,000/-	01/06/2032	18
495,000/-	01/11/2032	19
495,000/-	01/05/2033	20
495,000/-	01/11/2033	21
495,000/-	01/05/2034	22
495,000/-	01/11/2034	23
495,000/-	01/05/2035	24
495,000/-	01/11/2035	25
495,000/-	01/05/2036	26
495,000/-	01/11/2036	27
495,000/-	01/05/2037	28
495,000/-	01/11/2037	29
495,000/-	01/05/2038	30
495,000/-	01/11/2038	31
496,000/-	01/05/2039	32
495,000/-	01/11/2039	33
495,000/-	01/05/2040	34
495,000/-	01/11/2040	35
495,000/-	01/05/2041	36
495,000/-	01/11/2041	37
485,000/-	01/05/2042	38
Totali: 18,800,000/-		

(Vetëm tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind dinarë të Kuvajtit)

14 mars 2022 7:35 Marrë me 10/02/2021 23:54
Nr. 6434 Fq. 3/3

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

FORMULARI I KONFIRMIMIT

Me anë të kësaj konfirmojmë pranimin e gabimit me shkrim, të përcaktuar në këtë shkresë në lidhje me datën
e shlyerjes, d.m.th datën 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti të përcaktuar në Seksionin 2.08 të Marrëveshjes Shtesë të Huasë për Projektin e Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës, të ndryshuar më 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti.

Data:

Nga: Delina Ibrahimaj
(Përfaqësuesi i autorizuar)

22 shkurt 2022 8:54 Marrë më 22/01/2021 01:13
Nr. 6389 Fq. 1/2

الصندوق الكويتي للتنمية الاقتصادية العربية

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

Ref: KF/ 11/1027/3 - 45		Numri total i faqeve: 2
Data: 22/2/2022	**Administrimi dhe Operacionet**	CF: AB/29/Py
Faks: (965) 22999190 (965) 22999090	Numri i telefonit (965) 22999000 **Email: operations@kuwait-fund.org**	Faqja e internetit: http://www.kuwait-fund/org

Drejtuar:
Shkëlqesisë së Tij, Ministrit të Financave
Ministria e Financave
Tiranë – Republika e Shqipërisë

Nr. i faksit/Email-i:
+355 4 2228 494
info@financa.gov.al

Për dijeni të:

1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit
   Tiranë – Republika e Shqipërisë
   +355 4 2234 885
   adf@albaniandf.org
2. Shkëlqesisë së Tij, Ambasadorit të Shtetit të Kuvajtit
   Ambasada e Shtetit të Kuvajtit
   Tiranë – Republika e Shqipërisë
   00355 422 36501
   kuwaitembassy.tirana@gmail.com
   kuwaitembassy.tirana@mail.mofa.gov.kw
3. Shkëlqesisë së Tij, Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë,
   Ambasada e Republikës së Shqipërisë
   Kuvajt
   25240628
   embassy.kuwait@mfa.gov.al

Lënda: **Korrigjim tipografik: Në lidhje me Seksionin 2.08 të Marrëveshjes së Huasë Shtesë – Projekti i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës**

Shkëlqesia Juaj,

Duke iu referuar Marrëveshjes së Huasë Shtesë në lidhje me Projektin e Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës, të nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab në datën 02.03.2020, dëshirojmë të informojmë Shkëlqesinë Tuaj se për shkak të një gabimi tipografik, datat janë parashikuar në Seksionin 2.08 të versionit të Marrëveshjes së Huasë në gjuhën angleze si çdo gjashtëmujor më datë 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti në vend të datës 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti. Ne e kemi korrigjuar gabimin në versionin tonë të Marrëveshjes së Huasë në gjuhën angleze; për rrjedhojë, do ta vlerësonim nëse do të kryenit të njëjtin korrigjim në versionin tuaj, në mënyrë që datat të jenë data 1 maj dhe 1 nëntor e çdo viti, ndërsa këto data mbeten të pandryshuara në versionin e Marrëveshjes së Huasë në gjuhën arabe.

Ju lutem gjeni bashkëlidhur Formularin e Konfirmimit në lidhje me ndryshimin e sipërpërmendur. Ju lutem merrni masat e nevojshme që ky dokument të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të na dërgohet sërish neve.

Duke siguruar Shkëlqesinë Tuaj për bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm, ju lutem pranoni vlerësimin dhe konsideratën time më të lartë.

(Nënshkruar)
Marwan A. Th. AlGhanem
Drejtor i Përgjithshëm

22 shkurt 2022 8:54 Marrë më 22/01/2021 01:13
Nr. 6389 Fq. 2/2

FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

FORMULARI I KONFIRMIMIT

Nëpërmjet këtij dokumenti konfirmojmë pranimin e korrigjimit tipografik të parashikuar në këtë shkresë në lidhje me datën e shlyerjes së pagesës të parashikuar në Seksionin 2.08 të Marrëveshjes së Huasë Shtesë - Projekti i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës.

Data: Nga: Delina Ibrahimaj
(Përfaqësuesi i Autorizuar)

VENDIM
Nr. 226, datë 13.4.2023

PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t'ia përcjellë menjëherë rekomandimet prioritare të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe t'ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

REKOMANDIME PRIORITARE
NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2023
Tiranë, mars 2023

Ministria e Drejtësisë bazuar në detyrimet e ligjit nr. 97, datë 6.10.2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka përgatitur rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023.

Këto rekomandime vijnë në vazhdën e një tradite të konsoliduar të bashkërendimit të përpjekjeve të institucioneve të të gjitha niveleve për të përforcuar luftën pa kompromis kundër fenomeneve negative të shoqërisë shqiptare, për të përmirësuar legjislacionin parandalues, ndëshkues, korrigjues, rehabilitues, si dhe për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe infrastrukturore, në drejtim të: i) *rritjes së pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit*; ii) *minimizimit deri në eliminimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar*; iii) *respektimit të të drejtave të njeriut*; dhe iv) *konsolidimit të bashkëpunimit ndërinstitucional*.

Tashmë, ndjekja, gjykimi dhe ndëshkimi i kriminalitetit kanë marrë dimensione të reja, pasi të gjitha institucionet ligjzbatuese, përfshirë Byronë Kombëtare të Hetimit, SPAK, gjykatat e posaçme, gjykatat e të gjitha niveleve të riorganizuara dhe që funksionojnë me magjistratë, ku pjesa më e konsiderueshme e të cilëve e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar (*vetting*), kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin efektin e pritshëm në

drejtësibërje dhe në rritjen e besimit të publikut te drejtësia dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Rekomandimet kundër kriminalitetit edhe këtë vit mbështeten në dokumentet strategjike, të cilat pasqyrojnë vizionin, politikën, qasjen dhe qëllimin kryesor të Qeverisë Shqiptare që lidhet me integrimin e shpejtë në Bashkimin Evropian nëpërmjet dëshmisë së përpjekjeve dhe rezultateve konkrete në forcimin e ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve dhe konkretisht: Programit Qeverisës 2021-2025[1]; Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe të planit të saj të veprimit[2]; Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024[3]; Rekomandimet e Progres Raportit për Shqipërinë të Komisionit Evropian për vitin 2021; Planit të Veprimit 2015-2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit[4]; Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025[5]; Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të Veprimit 2022–2026[6], Raporteve të organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare joqeveritare[7] lidhur me monitorime për çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike, si dhe dokumente të tjera me rëndësi strategjike, si dhe në analizën e të dhënave statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë, përgjatë vitit 2022[8]. Gjithashtu, pjesë e përmbajtjes së rekomandimeve janë edhe masat e propozuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të cilat kanë në përbërje të tyre personel me funksionet e policisë gjyqësore. Po kështu, vijimësisht është ndjekur nga Ministria e Drejtësisë implementimi i rekomandimeve të dhëna për vitin 2022, duke analizuar dhe vlerësuar përmbushjen e tyre, ndërsa problematikat e evidentuara kanë shërbyer si bazë për të adresuar rekomandime konkrete për vitin 2023.[9]

Në adresim të sa më sipër, rekomandimet prioritare që Këshilli i Ministrave i drejton organit të prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, janë:

1. Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit

Rekomandimet për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit mbështetet në

[1]Publikuar në faqen zyrtare: https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverisës_2021-2025.pdf

[2] Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 24.12.2021, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 205, datë 30.12.2021.

[3] Plani Kombëtar për Integrimin Evropian miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 9.2.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 18.2.2022.

[4] Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 1.7.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 7.7.2020.

[5] Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 12.1.2021.

[6] Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 892, datë 27.12.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 13, datë 24.1.2023.

[7] Progres Raporti për Shqipërinë i Komisionit Evropiani vitit 2022, publikuar në "*Report, Acompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2022 Communication on EU Enlargement Policy*" https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en;Indeksi vjetor i korrupsionit i Transparency International, Corruption perception Index 2022, publikuar në faqen zyrtare:https://www.transparency.org/en/cpi/2022

World Justice Project "Indeksi i sundimit të ligjit 2022, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendës dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen web: https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2022/Albania/. Raporti për të Drejtat e Njeriut i Departamentit Amerikan të Shtetit ALBANIA 2022 HUMAN RIGHTS REPORT (state.gov).

[8] Ministria e Drejtësisë me shkresat e saj nr. 2361/5 prot., datë 24.10.2022 dhe nr. 2361/6 prot., datë 14.12.2022 i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të Rekomandimeve për vitin 2022. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 1108/34, datë 28.12.2022 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 2361/7 prot., datë 29.12.2022 dhe shkresën nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 532/2 prot., datë 13.3.2022. Prokuroria e Posaçme ka përcjellë informacion me shkresën nr. *nr.* 3864/1 prot., datë 15.3.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/3 prot., datë 15.3.2023.

[9] Ministria e Drejtësisë ka kërkuar me shkresën nr. 277 prot., datë 16.1.223 kontribut nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes si dhe Ministria e Mjedisit dhe Turizmit. Ministria e Brendshme ka përcjellë kontribut me shkresën e tyre nr. 562/3 prot., datë 6.2.2023, protokolluar pranë nesh me nr. 277/1 prot., datë 9.2.2023; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përcjellë kontribut me shkresën nr. 392/2 prot., datë 9.2.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 277/2 prot., datë 10.2.2023; Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë kontribut me shkresat nr. 2126/1 prot., datë 20.2.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe nr. 181/1 prot., datë 10.2.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 277/7 prot., datë 10.3.2023; Agjencia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ka përcjellë kontribut nëpërmjet e-mailit datë 20.3.2023; shkresën me nr. 1937/1 prot., datë 21.2.2023, protokolluar me nr. 277/4 prot., datë 21.2.2023 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ministria e Mbrojtjes me shkresën e tyre nr. 814/1 prot., datë 9.2.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 277/3 prot., datë 10.2.2023. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2361/6 prot., datë 14.12.2022, ka kërkuar statistikat për vitin 2022 nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme (SPAK).

analizën e ecurisë së deritanishme të mënyrës së funksionimit të këtij organi, problematikave, arritjeve dhe kërkesave për forcimin e integritetit, përmirësimin e profesionalizimit dhe rritjes së përgjegjshmërisë. Riorganizimi gjyqësor me impakt të drejtpërdrejtë edhe në funksionimin e prokurorisë, pavarësisht vështirësive të para në implementim dhe përshtatjen e strukturave, pritet të japë rezultatet e duhura në plotësimin e kapaciteteve dhe eficiencën në hetimin dhe ndjekjen penale.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka ardhur drejt konsolidimit, sidoqoftë plotësimi me prokurorë dhe staf mbetet ende në proces. Për vitin 2022 numri i prokurorëve të posaçëm nuk ka ndryshuar pasi Prokuroria e Posaçme vijon të ketë në përbërje të saj 17 prokurorë nga 20 prokurorë të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ndërkohë në vitin 2022 është plotësuar organika prej 60 hetuesish të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe ka filluar faza e përcaktimit të rregullave të cilat do të normojnë procesin e përzgjedhjes së 50 oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e konsideron thelbësore bashkëpunimin me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit. Rezulton intensifikim i bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore të huaja, si dhe ato brenda vendit e konkretisht me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimin Informativ Shtetëror, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Në lidhje me rekomandimin për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit, nga të dhënat e përcjella nga organi i prokurorisë[10], lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2022 në zbatim të Rezolutës së Kuvendit datë 14.7.2022, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë një sërë udhëzimesh për zbatim nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Konkretisht janë miratuar: Udhëzimi nr. 2, datë 29.7.2022 *"Për Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm",* urdhri nr. 57, datë 29.7.2022, *"Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022".*

Këto akte nënligjore, u janë dërguar për njohje dhe zbatim prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Drejtuesit e prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Gjykatave të Apelit, për të lehtësuar zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 2/2022 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme dhe/ose urdhra për miratimin e planit të veprimit, për të siguruar efikasitetin në koordinimin, mbikëqyrjen /monitorimin e punës në çdo prokurori, duke garantuar paanshmërinë e prokurorit dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit, në pavarësinë dhe/ose paanshmërinë në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies në sistemin e prokurorisë, dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në zbatim të kompetencave kushtetuese e ligjore, ka vijuar bashkëpunimin dhe në rastet e konstatimit të shkeljeve të kryera nga prokurorë / gjyqtarë, i ka dërguar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë materialet me qëllim hetimin/ inspektimin e rasteve.

Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të rritjes së rolit aktiv të prokurorit, ka normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake dhe kryerjen e hetimeve proaktive nëpërmjet udhëzimit nr. 2, datë 29.7.2022 të lartpërmendur, ku si rezultat në vitin 2022 është rritur numri i hetimeve proaktive dhe me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në kuadrin e 573[11] procedimeve penale, e cila rezulton me një ulje prej 12,5% të numrit të procedimeve proaktive, proces i finalizuar me arrestimin në flagrancë/ ndalimin e 585[12] personave të dyshuar për kryerjen e veprave

[10]Me shkresat e tyre nr. 1108/34 prot., datë 28.1212.2022 dhe nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1207/1 prot., datë 3.3.2022 dhe nr. 523/2 prot., datë 13.3.2023.

[11] Për vitin 2021 rezulton që numri i hetimeve proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit ka qenë 655 procedime penale.

[12] Për vitin 2021 kanë qenë arrestuar në flagrancë 640 persona.

penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Referuar të dhënave statistikore evidentohet se për vitin 2022 janë filluar/regjistruar kryesisht 124 procedime penale ose me numër të njëjtë të procedimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2021[13].

Në hetimet dhe ndjekja penale për vepra penale në kompetencë lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, prokurorët me rol aktiv kanë vlerësuar të dhënat e përftuara nga përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit edhe për kryerjen e veprave penale në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Në zbatim dhe të Aktit të Koordinimit Institucional datë 15.12.2020, për vitin 2022 prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 80[14] procedime / referime, që përbëjnë 76.26% të referimeve/ procedimeve të transferuara ose me rritje 2.16% të raportit në përqindje të referimeve të pranuara krahasuar me vitin 2021 për kategoritë e veprave penale që i përkasin krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe krimeve në detyrë në kompetencë lëndore të asaj prokurorie.

Me synim vijimin e nxitjes së prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të policisë gjyqësore, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 4/2022, datë 18.10.2022 "Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10/2021, datë 30.12.2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë në bashkëpunim me institucionet kushtetuese dhe ligjore", për vënien në funksionim të sistemit (SVHOPGJ) për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori.

Në vitin 2022 ka vijuar zbatimi i urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 61, datë 2.6.2021, nga grupi i punës për inspektimin e veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokuroritë e një rrethi gjyqësor sipas objektit të kontrollit të përcaktuar lidhur me veprimtarinë administrative dhe procedurale të tyre. Për shkelje disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, sipas ligjit dhe në kuadrin e bashkërendimit institucional me Komisionin e Policisë Gjyqësore, Prokurori i Përgjithshëm i është drejtuar këtij të fundit në rastet e konstatimit të shkeljeve ligjore nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe ka kërkuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore për 8 oficerë të policisë gjyqësore pranë një prokurorie të rrethit gjyqësor.

Prokuroria e Përgjithshme nisur nga numri në rritje i vakancave në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim shmangien e mangësive lidhur me funksionimin e seksioneve në disa prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, deri në hyrjen në fuqi të hartës së re gjyqësore të miratuar me datë 10.6.2022 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadrin e unifikimit të veprimtarisë administrative të prokurorive dhe ruajtjen e nivelit të eficiencës, garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence/ndikimi ndaj prokurorit, në zbatim të urdhrit të përgjithshëm nr. 40, datë 20.6.2022, "Për miratimin e një shtese në Rregulloren Standard "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm" miratuar me urdhrin nr. 164, datë 18.12.2020, drejtuesit e prokurorive kanë miratuar shtesën në rregulloren standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorive që drejtojnë me synim për të siguruar eficiencën dhe efikasitetin në funksionimin e veprimtarisë që kryen secila strukturë në prokurori nëpërmjet zbatimit të rregullave standard.

Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të rekomandimit për marrjen e masave për rritjen profesionale, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës është angazhuar në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori. Përgjatë vitit 2022, në Shkollën e Magjistraturës janë organizuar dhe zhvilluar 61 tema në fusha të ndryshme të sistemit të drejtësisë penale, tema të përzgjedhura nga 704 prokurorë dhe 83 oficerë të policisë gjyqësore pjesëmarrës. Trajnimet kanë vijuar dhe janë zhvilluar edhe në kuadrin e disa projekteve dhe aktiviteteve rajonale, evropiane, Projektit EU4FOCAL, UNODC, Akademinë Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjit (ILEA), UNICEF dhe Forumit Ndërkombëtar TAIEX, me tema të ndryshme në fushën e drejtësisë penale me

[13] Nga të dhënat statistikore për vitin 2021 ka rezultuar se numri i çështjeve të filluara kryesisht ka qenë 125, ose pothuajse i njëjtë.

[14] Për vitin 2021 janë transferuar 69 procedime në Prokurorinë e Posaçme.

pjesëmarrjen e 84 prokurorëve dhe 27 oficerëve të policisë gjyqësore.

Në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit miratuar me nr. 627, datë 13.4.2021 mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prezencës së OSBE-së "Për bashkëpunimin dhe bashkërendimin në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive në mbështetje të efikasitetit të sistemit të prokurorisë shqiptare" me fokus "Veprimi kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri" në shkurt 2022 u publikua manuali "Trafikimi i qenieve njerëzore" për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të ligjit, i shpërndarë për njohje dhe përdorim në praktikë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Në kuadër të rekomandimit për marrjen e masave me qëllim rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), vlen të përmendet fakti se Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar punën në bashkërendim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për vlerësimin e kapaciteteve humane dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me standardet aktuale. Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet përdorimit të sistemit CAMS, mundëson vetëm ndarjen e rastësishme të çështjeve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Sistemi CAMS për shkak të gjendjes së përgjithshme teknike jashtë funksionimit nuk mundëson asnjë veprimtari tjetër të teknologjisë së informacionit në administrimin e çështjeve apo të dhënave statistikore në prokurori.

Sistemi *e-tracking* PRESTO, i krijuar në mbështetjen e Projektit EURALIUS V, është funksional dhe mundëson përfitimin e statistikave në kohë reale sipas një baze të të dhënave të qëndrueshme e të besueshme. Në këtë kuadër për të mundësuar mbikëqyrjen e vazhdueshme, Prokuroria e Përgjithshme ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 3, datë 6.9.2022 "Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10/2020 "Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, si dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", ku është normuar se prokurori i seksionit të posaçëm ose prokurori i dedikuar, i ndihmuar nga oficeri i policisë gjyqësore i caktuar pranë tij, hedhin në kohë reale të dhënat në regjistrin elektronik në sistemin *e-tracking* PRESTO. Ky sistem synon të krijojë një bazë të dhënash e treguesish statistikorë të besueshëm për veprat penale të pastrimit të parave.

Sa më sipër, pavarësisht arritjeve pozitive dhe adresimit të sfidave në vlerësim të prioriteteve të Bashkimit Evropian, politikave në fushën e së drejtës, *me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit, Këshilli i Ministrave rekomandon:*

1. Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, rekomandim i përsëritur ndër vite, me qëllim shtimin e rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht, numër i cili vijon të mbetet i ulët.

2. Marrjen e masave procedurale dhe administrative për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve; si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit.

3. Vijimin e marrjes së masave për kontrollin nga prokurori të punës së Oficerëve të Policisë Gjyqësore, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe shpejtësisë së hetimeve, duke evidentuar rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.

4. Vijimin e masave për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve si për prokurorët ashtu dhe për oficerët e policisë gjyqësore, në përputhje me profilizimin e tyre sipas seksioneve brenda prokurorive, duke mbajtur në konsideratë edhe politikën penale.

5. Vijimin e masave me qëllim arritjen e funksionimit optimal të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm për saktësinë e paraqitjes së këtyre të dhënave.

2. Lufta kundër korrupsionit

Rekomandimet në luftën kundër korrupsionit vazhdojnë të mbeten një nga shtyllat kryesore të kërkesave për forcimin e politikës ndëshkuese pa luhatje, pa intimidim dhe pa kompromis. Në këtë aspekt, qëllim mbetet konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave ligjzbatuese me synimin e ndërmarrjes së masave të efektshme

dhe proaktive për të siguruar ndëshkimin e duhur, të ashpër dhe të shpejtë, veçanërisht të individëve që janë përfaqësues të shtetit dhe që në emër të tij kryejnë veprime dhe mosveprime të dëmshme korruptive.

Referuar të dhënave statistikore të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë dhe konkretisht nga Sektori i Rrjetit Antikorrupsion rezulton se për periudhën janar-dhjetor 2022 janë hartuar 43[15] raporte të hetimit administrativ për çdo institucion, janë marrë 259[16] masa disiplinore, janë dhënë 88 [17] rekomandime si dhe janë bërë 20[18] kallëzime penale me 70[19] persona të kallëzuar. Referuar numrit të kallëzimeve penale të bëra për vitin 2022 rezulton se krahasuar me numrin e kallëzimeve penale të bëra për vitin 2021[20] janë 8 kallëzime penale më shumë.

Në kuadër të forcimit të cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit referuar kompetencës lëndore që parashikon neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, ky grup veprash janë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme në bashkëpunim si me institucionet e reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ashtu edhe me agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese.

Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional në nivel vendor dhe qendror si me Prokurorinë e Posaçme në zbatim të Aktit të Koordinimit Institucional datë 15.7.2020, ashtu dhe në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe të vitit 2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit,

[15] Janë hartuar 43 raporte nga ku 1 raport për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale 1; 1 raport për DVASHK Tirana Veri; 1 raport për DVASHK Tirana Jug; 4 raporte për DVASHK Kamzë-Vorë; 5 raporte DVASHK Durrës; 1 raport për DVASHK Lezhë; 1 raport për DVASHK Fier; 1 raport për DVASHK Vlorë; 2 raporte për DVASHK Sarandë; 1 raport për DVASHK Shkodër; 1 raport për DPT-në; 1 raport për Dr.Rajonale Tatimore Durrës, 1 raport për Dr. Rajonale Tatimore Fier; 1 raport për Dr.Rajonale Tatimore Elbasan; 3 raporte për DPGJC; 3 raporte për AKZM-në; 2 raporte për AKM-në; 1 raport për IKMT-në; 1 raport për ISHP-në; 2 raporte për AKU-në; 1 raport për DRAP Fier; 1 raport për AZHBR-në; 1 raport për Spitalin Universitar të Traumës; 1 raport për Bashkinë Vau Dejës; 3 raporte për DPD; 2 raporte për Postën Shqiptare Korçë.

[16] Janë dhënë 8 masa disiplinore për DVASHK Tirana Veri; 5 masa disiplinore për DVASHK Tirana Jug; 68 masa disiplinore për DVASHK Kamzë-Vorë; 36 masa disiplinore për DVASHK Durrës; 7 masa disiplinore për DVASHK Lezhë; 5 masa disiplinore për DVASHK Fier; 5 masa disiplinore për DVASHK Vlorë; 15 masa disiplinore për DVASHK Sarandë; 11 masa disiplinore për DVASHK Shkodër; 2 masa disiplinore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; 3 masa disiplinore për Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës; 6 masa disiplinore për Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, 4 masa disiplinore për Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan; 5 masa disiplinore për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile; 3 masa disiplinore për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; 2 masa disiplinore për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit; 3 masa disiplinore për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit; 1 masë disiplinore për Institutin e Shëndetit Publik; 1 masë disiplinore për AKU-në (Durrës dhe Korçë); 20 masa disiplinore për Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar Fier; 3 masa disiplinore për Spitalin Universitar të Traumës; 15 masa disiplinore për Bashkinë Vau Dejës; 19 masa disiplinore për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; 12 masa disiplinore për Postën Shqiptare (filiali Korçë).

[17] 1 rekomandim për DVASHK Tirana Rurale 1; 6 rekomandime për DVASHK Tirana Veri; 13 rekomandime për DVASHK Vorë; 4 rekomandime për DVASHK Durrës; 1 rekomandim për DVASHK Fier; 2 rekomandime për DVASHK Vlorë; 3 rekomandime për DVASHK Sarandë; 5 rekomandime për DVASHK Shkodër; 3 rekomandime për DPT; 1 rekomandim për Dr. Rajonale Tatimore Fier; 3 rekomandime për Dr. Rajonale Tatimore Elbasan; 2 rekomandime për DPGJC;7 rekomandime për AKZM; 4 rekomandime për AKM-në; 3 rekomandime për ISHP; 3 rekomandime për AKU; 8 rekomandime për DRAP Fier; 4 rekomandime për AZHBR-në; 2 rekomandime për Spitalin Universitar të Traumës; 12 rekomandime për DPD; 1 rekomandim për Postën Shqiptare Korçë.

[18] Janë paraqitur 4 kallëzime penale për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës; 4 kallëzime penale për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, 1 kallëzim penal për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë; 1 kallëzim penal të Drejtorisë Vendore për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Pogradec; 1 kallëzim penal për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë; 1 kallëzim penal për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier; 2 kallëzime penale për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, 1 kallëzim penal për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; 1 kallëzim penal për Agjencinë e Trajtimit të Pronave; 1 kallëzim penal për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier; 1 kallëzim penal për Zyrën Postare Dibër; 1 kallëzim penal për Zyrën Postare Shkodër; 1 kallëzim penal për Zyrën Postare Tropojë.

[19] Janë paraqitur për 19 persona të kallëzuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, 12 persona të kallëzuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, 5 persona të kallëzuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, 5 persona të kallëzuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec; 7 persona të kallëzuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë; 2 persona të kallëzuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier; 4 persona të kallëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile; 1 person i kallëzuar në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; 1 person i kallëzuar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave; 1 person i kallëzuar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit; 1 person i kallëzuar në Zyrën Postare Dibër; 1 person i kallëzuar në Zyrën Postare Shkodër dhe 1 person i kallëzuar në Zyrën Postare Tropojë.

[20] Për vitin 2021 rezulton se janë bërë 12 kallëzime penale.

Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me synim rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me veprat penale në fushën e krimeve financiare, shpërdorimit të fondeve publike.

Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2022 dhe të aktit të koordinimit ndërinstitucional mes dy prokurorive, në vitin 2022 sipas të dhënave statistikore, nga 61 referime/procedime penale të transferuara nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe të pranuara nga Prokuroria e Posaçme, janë regjistruar 30 procedime penale për vepra që lidhen me korrupsionin ose vepra penale që lidhen me detyrën, që zënë 49.2% të numrit të referimeve/procedimeve penale të transferuara për kompetencë dhe të pranuara nga Prokuroria e Posaçme.

Prokurorët për vitin 2022 kanë rritur rolin aktiv në hetimin paraprak, si nëpërmjet hetimeve të filluara kryesisht ashtu dhe në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 61 procedime penale për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën ose me rritje 3.3% të numrit të këtyre procedimeve krahasuar me vitin 2021. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit ashtu edhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 58 personave të dyshuar, ku krahasuar me vitin 2021 kemi një rritje prej 45% të numrit të personave të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar për këtë grup veprash penale. Vijimi i bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme dhe roli proaktiv i prokurorit ka sjellë në 7 raste zbulimin e veprave penale të tjera të korrupsionit, të cilat i përkisnin kompetencës lëndore të Prokurorisë së Posaçme.

Lidhur me rritjen e numrit të hetimeve sistematike pasurore, i është kërkuar prokurorëve marrja e masave për rritjen më tej të eficiencës në bashkëpunimin ndërinstitucional për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval-it në kuadrin e mbikëqyrjes dhe zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020.

Për vitin 2022 si në kuadrin e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe rasteve të referimeve pasurore është paraqitur një rritje e konfiskimeve të vendosura nga gjykata mbi kërkesat e prokurorëve, ku konkretisht ka sekuestrim pasurie/aseteve kriminale në 6 raste ose krahasuar me vitin 2021 kemi rritje me 3 herë të numrit të rasteve dhe sekuestrime pasurie/aseteve kriminale në 18 raste ose krahasuar me vitin 2021 kemi rritje me 3 herë të numrit të rasteve në zbatim të dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, mbi kërkesat e prokurorëve, gjykatat kanë vendosur 11 konfiskime pasurie/asete kriminale ose me rritje 10 herë të numrit të rasteve krahasuar me vitin 2021 dhe 7 sekuestrime pasurie/asete kriminale ose me rritje me 2.3 herë të numrit të rasteve të sekuestruara krahasuar me 2021.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve profesionale Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës është angazhuar në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe janë organizuar dhe zhvilluar trajnime me tema në fushën e korrupsionit dhe pastrimit të parave ku kanë marrë pjesë 40 prokurorë dhe 7 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar bashkëpunimin edhe në kuadër të projekteve KiE dhe KE, EU4FOCAL (FIIAPP-Spanjoll) me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Në kuadër të këtij bashkëpunimi është duke u hartuar dhe një manual për pastrimin e parave, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Lidhur me raportimet e institucioneve ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, "Raporti për të Drejtat e Njeriut" i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar në Mars 2023,[21], ndër të tjera përmend se: *Çështjet e rëndësishme të të drejtave të njeriut përfshinin: problemet me pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit; mungesa e mediave të pavarura; dhe korrupsioni i vazhdueshëm në qeveri, organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet vendore. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe sistemi i drejtësisë vazhduan të bëjnë progres të rëndësishëm gjatë vitit duke hetuar, ndjekur penalisht dhe dënuar zyrtarët e lartë dhe kriminelët që u përfshinë në korrupsion. Qeveria zbatoi masat e shërbimeve elektronike për të përmirësuar*

[21] ALBANIA 2022 HUMAN RIGHTS REPORT (state.gov)

transparencën dhe për të reduktuar mundësitë për korrupsion, dhe prokurorët bënë përparim në përballjen me kulturën e vjetër të mosndëshkimit.

Progres Raporti për Shqipërinë 2022[22] për luftën kundër korrupsionit konstaton se: *Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Ajo vazhdoi përpjekjet e saj për të ndërtuar historikun e saj të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe dha disa rezultate. Këto përpjekje duhet të vazhdojnë. Megjithatë, vullneti më i madh politik, përpjekjet e mëtejshme të strukturuara dhe burimet dhe aftësitë adekuate mbeten të nevojshme. Struktura e Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka kryer procedime penale dhe hetime financiare për disa çështje të nivelit të lartë. Edhe pse vetingu i anëtarëve të drejtësisë është një proces administrativ, ai vazhdon të sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit brenda gjyqësorit. Në përgjithësi, pavarësisht disa përparimeve, korrupsioni mbetet një fushë me shqetësim serioz. Rritja e numrit të dënimeve përfundimtare të zyrtarëve të nivelit të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për të trajtuar më tej kulturën e mosndëshkimit. Meqenëse rekomandimet e vitit 2021 u zbatuan vetëm pjesërisht, këto mbeten të vlefshme.*

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2022[23], Shqipëria ka pësuar një rritje në renditjen e shteteve për sa i përket korrupsionit në sektorin publik, duke u rankuar në vendin e 101 me 36 pikë nga 35 pikë që kishte në vitin 2021.

Lidhur me problemin e korrupsionit të sistemit gjyqësor, ai vazhdon të perceptohet se është i lartë. Sipas dokumentit "Indeksi i sundimit të ligjit 2022 i World Justice Project[24], i cili paraqet një pasqyrë të sundimit të ligjit në 140 vende duke dhënë rezultatet dhe renditjen sipas vlerësimit nga 0 në 1, Shqipëria renditet në vendin e 87 nga 140 vende. Në lidhje me vlerësimin sipas secilit faktor, për faktorin sistemi i drejtësisë penale, si një aspekt thelbësor për sundimin e ligjit, i cili përfshin të gjithë sistemin penal, Shqipëria është renditur në vendin e 81 në listë. Në lidhje me faktorin e dytë të vlerësimit, matja e mungesës së korrupsionit, Shqipëria renditet në vendin e 107-të.

2.1 Prokuroria e Posaçme

Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2022 i ka kushtuar një vëmendje të veçantë hetimit të veprave penale që lidhen me korrupsionin e zyrtarëve të lartë duke u fokusuar kryesisht në çështjet e keqpërdorimit të fondeve publike. Për këtë arsye numri i çështjeve dhe numri i personave nën hetim, për këtë kategori ka qenë më i lartë se ai i veprave penale që lidhen me krimin e organizuar. Duhet nënvizuar se i është kushtuar një rëndësi e veçantë regjistrimit të hetimeve të filluara kryesisht, përdorimit me efikasitet të metodave të hetimeve proaktive dhe për pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi e kryesojnë çështjet e hetuara për veprën penale të korrupsionit.

Konkretisht, për periudhën e vitit 2022 rezulton se[25] nga organi i Prokurorisë së Posaçme janë paraqitur të dhëna statistikore në lidhje me veprat penale që ka në kompetencë lëndore, ku janë hetuar gjithsej 712[26] procedime penale, nga të cilat 455 procedime penale janë mbartur nga viti 2021, ndërsa 257 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2022 si procedime penale të reja. Nga 257 procedime penale të reja të filluara në vitin 2022, 61 procedime penale janë dërguar për kompetencë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe 28 procedime penale janë regjistruar kryesisht nga Prokuroria e Posaçme me 34 persona nën hetim. Për 69 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke shkuar në 643 procedime penale, me 602 persona nën hetim. Krahasuar me të dhënat e pasqyruara në raportin e vitit 2021, rezulton një ulje e numrit të procedimeve të hetuara me 3 procedime më pak, por vihet re një rritje e numrit të personave nën

[22] Albania 2022 Report, Acompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2021 Communication on EU Enlargement Policy.

[23] Publikuar në faqen zyrtare të Transparency International: https://www.transparency.org/en/cpi/2022.

[24] World Justice project "Indeksi i sundimit të ligjit 2022, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendës dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen web: https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2022/Albania/.

[25] Raporti Vjetor 2022 mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

[26] Për vitin 2021 kanë qenë regjistruar 715 procedime penale, ku 363 procedime kanë qenë të regjistruara nga vetë Prokuroria e Posaçme dhe nga ku 18 kanë qenë regjistruar kryesisht.

hetim me 83[27] persona më shumë, ndërsa numri i procedimeve të regjistruara kryesisht ka një rritje me 10 procedime më shumë, rreth 3,9% e totalit të procedimeve të hetuara.

Gjatë vitit 2022 Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), ka regjistruar 422[28] procedime penale në fushën e korrupsionit, shifër kjo që shënon rritje nga viti i kaluar me 83 procedime më tepër, ose rreth 65.6% e veprave penale të regjistruara. Numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara e ka neni 258 i Kodit Penal "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" me 92 procedime penale të regjistruara dhe neni 248 i Kodit Penal "Shpërdorimi i detyrës" me 86 procedime penale të regjistruara. Në lidhje me çështjet e regjistruara rezulton se janë dërguar për gjykim 43 çështje, 30 çështje janë pushuar, 5 çështje janë pezulluar, 59 çështje janë transferuar dhe 285 çështje rezultojnë të mbetura në hetim. Krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë 10 çështje më shumë të dërguara për gjykim, 6 çështje më tepër të pushuara, 4 çështje më pak të pezulluara dhe 21 çështje më tepër të transferuara. Ndërkohë rezultojnë më tepër çështje të mbetura në hetim krahasuar me vjet, me 50 çështje më tepër[29].

Nga 43 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2022[30], të cilat zënë rreth 10.2% të çështjeve të hetuara në fushën e korrupsionit, rezulton se numri i të hetuarve/pandehurve ka qenë 208 persona. Nga këto çështje për 75 persona është caktuar masa e sigurimit "Arrest me burg" (një rritje 2.34 herë më tepër nga vitit 2021), për 27 persona është caktuar masa e sigurimit "Arrest në shtëpi" (11 persona më shumë) dhe për 14 persona është caktuar masa e sigurimit "Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore" (një rritje me 8 persona më shumë se vitin e kaluar). Referuar këtyre të dhënave konstatohet një ashpërsim i politikës penale për këtë kategori veprash[31]. Gjithashtu, numrin më të lartë të çështjeve të dërguara për gjykim e ka neni 245/1/2 i Kodit Penal "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", me 7 çështje të dërguara për gjykim dhe neni 257/a/2 i Kodit Penal "Refuzimi për deklarimin, mos deklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", me 6 çështje të dërguara për gjykim dhe neni 258 i Kodit Penal "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" me 6 çështje të dërguara për gjykim.

Për vitin 2022 rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 27 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 140 të pandehurish. Krahasuar me vitin 2021 rezulton një ulje e numrit të çështjeve të përfunduara me 25 çështje më pak dhe një rritje e numrit të të pandehurve me 4 të pandehur më tepër[32]. Gjatë vitit 2022 janë përcjellë të dhëna dhe për gjykimet në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku rezulton se për vitin 2022 ka përfunduar gjykimi për 22 çështje penale me një numër prej 80 të pandehurish, për veprat penale kundër korrupsionit dhe vepra të tjera penale (pa përfshirë veprat penale të krimit të organizuar).

Ndërkohë vijon të mbetet i ulët roli i prokurorisë për sa u përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të korrupsionit, pasi në total për të gjitha veprat penale rezulton se janë regjistruar vetëm 28 procedime penale kryesisht nga organi i Prokurorisë së Posaçme. Në vitin 2023, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rezulton të ketë të mbartura për hetim 447 procedime penale me 166 persona nën hetim, ose 2 procedime më pak dhe 21 persona nën hetim më pak se viti 2022[33]. Nga këto hetime të mbartura rezulton se numri prej 285 procedime penale me 26 persona nën hetim janë të regjistruar për veprat penale të korrupsionit, ose rreth 63,7% e çështjeve të mbartura për hetim. Krahasuar me vitin 2022

[27] Për vitin 2021 kanë qenë 519 persona nën hetim.

[28] Për vitin 2021 ishin regjistruar 339 procedime penale, ose 50.2% e veprave penale.

[29] Për vitin 2021 rezultojnë 33 çështje të dërguar për gjykim, 24 të pushuara, 9 të pezulluara, 38 të transferuara dhe 235 të mbetura në hetim.

[30] Për vitin 2021 ishin dërguar për gjykim 33 çështje ose 9.74% të çështjeve me nr. të pandehurish 96 persona.

[31] Për vitin 2021 rezultojnë: 32 persona "arrest në burg", 16 arrest në shtëpi dhe 6 persona detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore.

[32] Për vitin 2021 ka përfunduar gjykimi për 52 çështje me një numër prej 136 të pandehurish.

[33] Për vitin 2022 rezulton të ketë të mbartura në hetim 449 procedime me 187 persona nën hetim.

rezultojnë 50 çështje më tepër, por 38 persona nën hetim më pak[34]. Gjithashtu lidhur me përdorimin e metodave speciale të hetimit rezulton se përgjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 122 procedime penale[35], ose 7 më pak se vitin e kaluar ku pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë ato çështje të hetuara për veprat penale të korrupsionit[36], me 69 procedime penale (2 procedime më tepër se në 2021) dhe 1023 pajisje fundore (ose 173 pajisje më tepër se viti 2021[37]).

Lidhur me zbatimin e ligjit antimafia[38], nga Prokuroria e Posaçme për vitin 2022 janë paraqitur në gjykatë 5 kërkesa për sekuestrimin e pasurisë ose 9 kërkesa më pak se në vitin 2021 të dhëna nga gjykata dhe 5 vendime sekuestrimi pasurie. Ndërkohë janë paraqitur në gjykatë 10 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, për të cilat janë dhënë nga gjykata 2 vendime konfiskimi, ku krahasuar me vitin e kaluar[39] rezulton një ulje e numrit me 4 kërkesa më pak drejtuar gjykatës.

Në zbatim të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike"[40], janë paraqitur në gjykatë 3 kërkesa për konfiskim pasurie dhe janë dhënë nga gjykata 35 vendime nga të cilët për 32 vendime është pranuar kërkesa për konfiskim pasurie[41] dhe në 3 raste është vendosur kthimi i pasurisë.

Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale gjatë procesit penal me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme janë marrë 7 vendime për sekuestrim, nga të cilat 5 vendime të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 vendim i marrë nga prokurorët e posaçëm[42].

Për sa i përket rritjes së kapaciteteve profesionale Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përfshirë Byronë Kombëtare të Hetimit është asistuar nga projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe konkretisht hetuesit e Byrosë kanë marrë pjesë në rreth 36 trajnime brenda dhe jashtë vendit, 13 vizita studimore dhe 26 takime/konferenca/forume të organizuara nga ICITAP, OPDAT, FBI, ILEA Budapest, CEPOL, EUROPOLI, EU4FOCAL.

2.2 Të dhënat statistikore

Referuar analizës për vitin 2022 që Ministria e Drejtësisë ka kryer në bazë të të dhënave statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme[43], rezulton se:

- Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit të cilat janë aktualisht në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, ka ndryshuar numri i veprave penale në kompetencën lëndore të kësaj prokurorie. Gjatë vitit 2022, janë hetuar 2129 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit[44], me një numër total prej 404 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 387 persona. Rezulton se ka një rritje të numrit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2021, me 237 çështje më shumë, rritje të numrit të personave nën hetim me 59 persona më shumë nën hetim dhe me rritje 160 persona më shumë të marrë si të pandehur, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar[45]. Për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 230

[34] Për vitin 2022 janë 235 procedime penale për korrupsion me 64 persona nën hetim.

[35] Për vitin 2021 janë regjistruar 129 procedime penale për metodën e përgjimit.

[36] Konkretisht nenet 244, 245, 245/1, 258, 259, 319, dhe 319/ç, 328 të Kodit Penal.

[37] Për vitin 2021 janë 67 procedime penale, 850 pajisje fundore.

[38] Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar.

[39] Për vitin 2021 janë paraqitur në gjykatë 14 kërkesa për sekuestrim dhe 14 kërkesa për konfiskim të pasurive të sekuestruara.

[40] Miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 5.3.2020.

[41] Për vitin 2022 janë konfiskuar 84 pasuri të paluajtshme, 34 pasuri të luajtshme për 7 subjekte tregtare.

[42] Për vitin 2022 janë sekuestruar 34 pasuri të paluajtshme, 1 pasuri e luajtshme për 10 subjekte tregtare.

[43] Me shkresën nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/2 prot., datë 13.3.2023.

[44] Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korrupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/a, 164/b, 248, 256 dhe 257/a, 244/1; 245/1; 245/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

[45] Për vitin 2021 janë hetuar 1892 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit, me një numër total prej 345 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 227 persona.

procedime penale ose rreth 10.7% të çështjeve të hetuara, me 392 të pandehur. Krahasuar me vitin 2021[46], konstatohet një rritje e numrit të çështjeve me 110 çështje më shumë dhe 196 të pandehur më shumë. Për vitin 2022 ka përfunduar gjykimi për 115 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 180 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 152 persona krahasuar me vitin 2021[47], pra rezulton se ka një rritje me 47 çështje, një rritje e numrit me 77 persona të pandehur më shumë dhe 81 të dënuar më shumë.

- Ndërsa nga ana tjetër, nëse i referohemi hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, konkretisht në vitin 2022, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuara është 38437[48], nga të cilat vetëm 124[49] janë vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori, ose rreth 0,3% e numrit të përgjithshëm. Krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara kryesisht në 2021 nuk rezulton ndonjë ndryshim i ndjeshëm, vetëm 1 çështje më pak. Nga 124 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 17 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit[50], ose rreth 13.7% e numrit të çështjeve kryesisht, ku numrin më të madh e zënë çështjet e regjistruara për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me 15 çështje. Gjithashtu, rezultojnë edhe 2 çështje të regjistruara kryesisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 244/1 dhe 259/1 të Kodit Penal. Nëse i krahasojmë me vitin 2021 për të njëjtat vepra penale në fushën e korrupsionit, rezulton një ulje e lehtë e numrit të çështjeve të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit, me 3 çështje më pak[51] pavarësisht rekomandimeve.

- Rezulton një ulje e numrit të çështjeve për veprat penale në fushën e pastrimit të parave regjistruar pranë Prokurorisë së Përgjithshme (rreth 1.6% më pak) krahasuar me të dhënat e vitit 2021. Ndërsa, në total numri i çështjeve të regjistruara (kryesisht dhe me referim) për veprat penale të pastrimit të parave[52] është 244 çështje, me një numër total prej 20 personash nën hetim nga të cilët vetëm 20 prej tyre janë marrë si të pandehur. Krahasuar me të dhënat për vitin 2021[53], rezulton se ka një ulje të ndjeshme prej 57 çështjesh të regjistruara më pak, ulje e numrit të personave nën hetim me 28 më pak dhe me rritje të numrit të të pandehurve me 12 të pandehur më shumë.

Duke mbajtur në konsideratë problematikat sa më sipër të evidentuara, prioritetet e përbashkëta, *Këshilli i Ministrave për forcimin e luftës kundër korrupsionit rekomandon:*

1. Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, vijimin e rritjes së numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave.

2. Vijimin e bashkëpunimit midis prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme për sa i përket ndarjes së kompetencës lëndore për këto vepra, me qëllim garantimin e efektivitetit dhe shpejtësisë në hetimin e çështjeve.

3. Rritjen e numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, rekomandim i përsëritur ndër vite (numri i të cilave vijon të jetë i ulët), si dhe vijimin e rritjes së numrit të hetimeve proaktive-përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit, me qëllim vazhdimin e përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së hetimeve, veçanërisht për veprat penale në fushën e korrupsionit referuar kompetencës lëndore.

[46] Për vitin 2021 janë dërguar për gjykim 120 procedime penale me 196 të pandehur.

[47] Në vitin 2021 për 8 veprat penale të mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme kishin përfunduar gjykimin 68 çështje penale me 103 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 71 persona.

[48] Për vitin 2021 numri i veprave penale të referuar dhe kallëzuara ishte në total 41541.

[49] Në vitin 2021 kanë qenë 125 çështje të filluara kryesisht.

[50] Krahasimi është bërë për 8 veprat penale (nenet 164/a, 164/b, 248, 256 dhe 257/a, 244/1; 254/1; 254/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

[51] Në vitin 2021 kanë qenë 20 çështje të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit.

[52] Nenet 287, 287/a dhe 287/b të Kodit Penal.

[53] Në vitin 2021 për këto tre vepra penale janë regjistruar 301 çështje me 48 persona nën hetim dhe 8 të pandehur.

4. Rritjen e numrit të hetimeve financiare sistematike dhe hetimit financiar paralel për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura.

5. Shtimin e rasteve të gjurmimit të produkteve të veprave penale/aseteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve, përfshirë rastet e tjetërsimit të tyre nga persona të tretë.

6. Vijimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit; si dhe hetimeve pasurore veçanërisht me fokus në format e reja të nxitura nga zhvillimet teknologjike.

3. Lufta kundër krimit të organizuar

Rekomandimet në luftën kundër krimit të organizuar vijojnë të mbështeten në nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve brenda dhe jashtë vendit, me qëllim parandalimin e përçuarjes përtej kufijve dhe ndëshkimin brenda vendit me masat më të ashpra dhe më të efektshme për reduktimin e tij. Në këtë drejtim, mbetet prioritet forcimi i kapaciteteve profesionale të agjencive ligjzbatuese dhe zhvillimi i teknikave të reja, me fokus ato kibernetike dhe ndërveprimi me to në nivel rajonal.

Progres Raporti 2022[54] në lidhje me pastrimin e parave konstaton se: "Shqipëria ka një sektor të madh informal dhe ekonomia e saj bazohet kryesisht në para. Krimet që gjenerojnë shuma të mëdha parash përfshijnë trafikun e drogës, evazionin fiskal, kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Për sa i përket pastrimit të parave, Shqipëria është në listën e Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF) të juridiksioneve nën monitorim të shtuar që nga shkurti 2020 dhe me gjithë progresin e dukshëm, nuk ka përfunduar zbatimin e Planit të Veprimit të FATF deri në afatin e shkurtit 2022. Amendamentet në ligjin kundër pastrimit të parave që synojnë përafrimin me direktivën e katërt dhe të pestë të BE-së kundër pastrimit të parave u miratuan në Parlament në dhjetor 2021. Si regjistri i centralizuar i llogarive bankare ashtu edhe regjistri i pronësisë përfituese janë tashmë në fuqi. Regjistri i pronësisë përfituese tani është populluar kryesisht, por ende nuk janë vendosur sanksione ndaj personave juridikë të paregjistruar. Në janar 2022 u miratuan ndryshimet në ligjin për noterët dhe ligji i ri për mbikëqyrjen e agjentëve të pasurive të paluajtshme, si dhe aktet e nevojshme nënligjore. Në korrik 2021, Prokuroria e Përgjithshme prezantoi një regjistër elektronik të dedikuar "PRESTO" për të siguruar të gjitha rastet e pastrimit të parave që gjurmohen me synim rritjen e efektivitetit në sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve kriminale".

3.1 Referuar analizës për vitin 2022 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezulton se:

Lidhur me veprat penale në fushën e krimit të organizuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, është përcaktuar se Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka kompetencë hetimi për çdo vepër penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, (neni 75/a, germa "b" e Kodit të Procedurës Penale) ose nga subjekte të posaçme sipas parashikimeve të nenit 75/a, germat "c" dhe "ç" të Kodit të Procedurës Penale). Ndërkohë që vepra penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, sipas parashikimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale i përket prokurorive të juridiksionit të zakonshëm.

Në raportin vjetor 2022 mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rezulton se gjatë vitit 2022, kjo strukturë ka regjistruar 167 procedime penale në fushën e krimit të organizuar, me rritje prej 3 çështje më shumë krahasuar me vitin 2021. Numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara, sikurse vitin e kaluar, e kanë grupi i veprave penale të neneve (283/a "Trafikimi i narkotikëve", 333/a "Grupi i strukturuar kriminal", 334 "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal") me 53 procedime penale të regjistruara[55]. Rezulton një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për këto vepra me 3 procedime më shumë. Në lidhje

[54] "*Albania 2022 Report, Acompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2021 Communication on EU Enlargement Policy"* publikuar në datën 12.10.2022 në faqen: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf.

[55] Për vitin 2021 për këtë grup veprash kanë qenë të regjistruara 50 procedime penale.

me çështjet e regjistruara rezulton se janë dërguar për gjykim 10 çështje, 4 çështje janë pushuar, 11 çështje janë pezulluar, 11 çështje janë transferuar dhe 131 çështje rezultojnë të mbetura në hetim. Referuar shifrave të vitit të kaluar, rezulton një ulje me 4 çështje dërguar për gjykim, 11 çështje më pak të pezulluara, 3 çështje më shumë të transferuara dhe 13 çështje më tepër të mbetura në hetim[56].

Nga 10 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2022, të cilat zënë rreth 5.9% të çështjeve të hetuara në fushën e krimit të organizuar, rezulton se numri i të hetuarve/pandehurve ka qenë 100 persona ose 16 persona më shumë se vjet. Numrin më të lartë të çështjeve të dërguara për gjykim e kanë grupi i veprave penale të neneve (78/2 "Vrasja e kryer për interes apo hakmarrje"; 278 "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit"; 303 "Fshehja ose asgjësimi i kufomës" ; 333/a "Grupi i strukturuar kriminal", 334 "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal") me 2 çështje të dërguara për gjykim. Nga këto çështje për 92 persona është caktuar masa e sigurimit "Arrest me burg" (ose 28 persona më shumë se vjet), për 4 persona është caktuar masa e sigurimit "Arrest në shtëpi" (1 person më shumë se vjet) dhe për asnjë person nuk është caktuar masa e sigurimit "Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore" (një më pak se vjet)[57].

Për vitin 2021 rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 19 çështje penale për veprat penale në fushën e krimit të organizuar me një numër prej 35 të pandehurish ose krahasuar me vjet me një ulje prej 4 çështjesh më pak dhe 59 të pandehur më pak[58]. Për vitin 2022 janë përcjellë të dhëna edhe për gjykimet në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku rezulton se ka përfunduar gjykimi për 15 çështje penale me një numër prej 47 të pandehurish[59], për veprat penale në fushën e krimit të organizuar.

Lidhur me përdorimin e metodave speciale të hetimit rezulton se përgjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 122 procedime penale (ose 7 më pak se vitin e kaluar), ku për çështjet penale të hetuara për veprën penale të grupit të strukturuar kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike (283/a/2, 333/a, 334) me 53 procedime penale (ose 76 më pak se vjet) dhe 1154 pajisje fundore (ose 226 më shumë se vitin kaluar[60]).

Ndërkohë vijon të mbetet i ulët roli i prokurorisë për sa i përket numrit të hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të krimit të organizuar, pasi në total për të gjitha veprat penale rezulton se janë regjistruar vetëm 28 procedime penale kryesisht nga organi i Prokurorisë së Posaçme.

Në kuadër të ndërveprueshmërisë së sistemeve të informacionit është nënshkruar Marrëveshja Trepalëshe për dhënien e së drejtës së qasjes në sistemin elektronik "SIENA"-Aplikim i Sigurt i Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit", EUROPOL, midis Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje Prokuroria e Posaçme i shtohet listës së autoriteteve kompetente kombëtare që janë përgjegjës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit me qasje të drejtpërdrejtë në sistemin SIENA të Europol.

Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme ka një praktikë të regjistrimit të të dhënave sipas regjistrave përkatës në mënyrë manuale. Së bashku me projektin ICITAP po vijon puna për krijimin e një sistemi të brendshëm të menaxhimit të çështjeve i cili parashikon edhe një *track-record* për procedimet penale.

Për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, e veçanërisht me EUROJUST, Prokuroria e Posaçme dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë bërë të mundur që Shqipëria të ketë treguesit më të lartë në rajon në lidhje me numrin e skuadrave të

[56] Për vitin 2021 janë regjistruar 164 procedime penale, nga të cilat 14 procedime për krimin e organizuar rezulton se janë dërguar për gjykim, 2 pushuar, 22 pezulluar, 8 transferuar dhe 118 në hetim.

[57] Për vitin 2021 kanë qenë 84 persona të hetuar të pandehur, nga të cilët për 64 është caktuar arrest në burg, për 3 persona arrest në shtëpi, për 1 person detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore.

[58] Për vitin 2021 ka përfunduar gjykimi për 23 çështje me 94 të pandehur.

[59] Për vitin 2021 kanë qenë përfunduar 19 çështje penale me 71 të pandehur.

[60] Për vitin 2021 janë përdorur metodat për 129 procedime penale, ku për çështjet penale të trafikimit me 45 procedime dhe 928 pajisje fundore.

përbashkëta hetimore si dhe kryeson në rajon për takimet e organizuara në kuadër të veprimtarisë së skuadrave të përbashkëta hetimore.

3.2 Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme[61] për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezulton, se:

- Në kuadrin e rekomandimit për vijimin e rritjes së numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit datë 15.7.2020 me autoritetet shqiptare dhe ka koordinuar dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme nr. 10/2020 dhe nr. 2/2022, si dhe ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel vendor dhe qendror me synim rritjen e eficiencës së koordinimit, rritjen e numrit të akuzave të ngritura në gjykatë dhe dënimeve për veprën penale të pastrimit të parave si dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve të produkteve kriminale.

- Në kuadër të "Hetimeve efektive nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe rritja e hetimeve proaktive" gjatë vitit 2022, në zbatim të kërkesave dhe procedurave ligjore, janë kryer hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në kuadrin e 324 procedimeve për veprat penale kundër trafiqeve të paligjshme (narkotikëve, personave, armëve/municioneve), përfshi edhe veprat penale kundër narkotikëve, pastrimit të parave dhe krimeve të rënda në kompetencë lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin e kaluar rezulton një ulje me 7 procedime penale më pak.

- Ky proces i ka shërbyer si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu edhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 362 personave të dyshuar për veprat penale të trafikimit të paligjshëm, prodhimi, mbajtja dhe kultivimi i narkotikëve, mbajtja pa leje, prodhimi i armëve dhe armëve shpërthyese e municioneve, vrasjet e dyshuara të kryera nga autorë/vrasës me pagesë, vjedhjet e bankave dhe arkave të kursimit si vepra penale bazë të hetuara paralelisht me veprën penale të pastrimit të parave dhe hetimeve financiare në zbatim të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr. 10192/2009.

- Gjithashtu, në vitin 2022, prokurorët kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 275 procedime penale vetëm për kategoritë e veprave penale, si: trafikimi, prodhimi dhe kultivimi i narkotikëve; trafikimi dhe mbajtja e armëve e municioneve; pastrimi i parave; trafikimi e ndihma për kalim të paligjshëm të personave; vepra me qëllime terroriste dhe nxitja - thirrja për kryerje të veprave terroriste. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, po ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 346 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

- Në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit roli aktiv i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore përkatës ka mundësuar përftimin e të dhënave nga interceptimi të shoqëruara me vëzhgime përtej veprave penale të regjistruara nga prokurori për të cilat ishte lejuar përgjimi dhe zbulimi në 5 raste të krimeve të tjera në luftën kundër tyre sikurse janë "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Kultivimi i bimëve narkotike", "Shkelja e barazisë së pjesëmarrjes në tendera apo ankande publike", "Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara", vepra këto të parashikuara nga nenet 114, 197, 258, 283, 284, të Kodit Penal.

- Gjithashtu, me rëndësi vijon të mbetet zbatimi i kuadrit ligjor mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave kriminal[62] me qëllim ndërprerjen e të ardhurave të grupeve kriminale, e mundësive për të ndërvepruar në terren apo për t'i shpëtuar drejtësisë. Lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, përgjatë vitit 2022, në prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm, për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" është bërë konfiskim pasurie në 4 raste, nga 2 raste që kanë qenë në vitin 2021 dhe janë kryer sekuestrime pasurie mbi kërkesën e prokurorëve me vendimet gjyqësore, në kuadrin e 18 procedimeve penale nga 6 që kanë

[61] Me shkresën nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/2 prot., datë 13.3.2023.

[62] Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar.

qenë në vitin 2021, nga ku rezulton se në krahasim me vitin 2021 kemi rritje me 2 konfiskime më tepër dhe një rritje të konsiderueshme me 12 sekuestrime më tepër. Gjatë po kësaj periudhe në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar, në kuadrin e hetimit pasuror, prokurorët kanë kërkuar për 3 procedime sekuestrimin e pasurisë, dhe në 8 raste konfiskimin e pasurisë, kërkesa këto të pranuara nga gjykata, nga ku rezulton se në krahasim me vitin 2021 sekuestrimet rezultojnë në të njëjtat shifra, ndërsa konfiskimet janë rritur me 7 më tepër, nga 1 konfiskim që ka qenë për vitin 2021.

- Prokurori i Përgjithshëm në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetit kompetent ka vijuar zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust nëpërmjet veprimtarisë së Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust dhe referuar të dhënave rezulton se janë nënshkruar 10 marrëveshje të reja për ngritjen e Skuadrave të Përbashkëta Hetimore si dhe ka vijuar zbatimi i 10 marrëveshjeve të Skuadrave Hetimore të mbartura nga vitet e kaluara me autoritetet gjyqësore të huaja. Në nëntor 2022, në një takim midis zv.presidentit të Eurojust, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, u prezantua projekti më i ri i Eurojust për forcimin e bashkëpunimit në nivel rajonal, përmes krijimit të një strukture të vendeve të Ballkanit Perëndimor që do të mundësojë koordinimin e hetimeve midis prokurorive të këtyre vendeve.

- Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ndërmori një hap të rëndësishëm në drejtim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të shpejtë të informacionit me autoritetet gjyqësore të vendeve evropiane dhe euro-atlantike me nënshkrimin e dy marrëveshjeve, si: i) Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Zyrës së Prokurorit Publik Evropian me seli në Luksemburg dhe Prokurorisë së Përgjithshme, me synim lehtësimin e bashkëpunimit në çështjet penale dhe shkëmbimin e informacionit, nëpërmjet ngritjes së grupeve të përbashkëta hetimore, ngrirjes së aseteve me të ardhura nga veprimtaria kriminale; ii) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme (PP) dhe Shoqatës Ibero-Amerikane e Prokurorëve Publikë (AIAMP), me synim rritjen e gatishmërisë për bashkëpunimin në luftën kundër trafiqeve të paligjshme, pastrimit të parave dhe çdo krimi tjetër me interes të përbashkët si dhe për përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe shkencore në fushën penale sipas ligjit.

- Në kuadër të "Përditësimit të sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave, me qëllim për të rritur numrin e procedimeve penale dhe dënimeve për veprat penale të pastrimit të parave", në vitin 2022 është mundësuar implementimi dhe përdorimi i plotë i sistemit *e-tracking* PRESTO nga 44 prokurorë, në 21 prokurori pranë gjykatave të shkallës parë, që kanë trajtuar çështje të pastrimit të parave, si dhe ky sistem i vlerësuar funksional, mundëson përftimin e statistikave në kohë reale sipas një baze të të dhënave të qëndrueshme e të besueshme, për të evidentuar gjendjen e treguesve statistikorë për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale dhe nevojën për reforma të mëtejshme, për të rritur numrin e procedimeve penale të dërguara për gjykim dhe të dënimeve për veprat penale të pastrimit të parave si objektiv prioritar i prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Për të mundësuar mbikëqyrjen e vazhdueshme mbi hedhjen dhe administrimin e të dhënave në sistemin *e-tracking* PRESTO, Prokuroria e Përgjithshme ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 3/2022, datë 6.9.2022, "Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10/2020 "Për masat administrative dhe procedurale penale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", i cili ka normuar se prokurori i seksionit të posaçëm ose prokurori i dedikuar, është përgjegjës për hedhjen në kohe reale të të dhënave në regjistrin elektronik të sistemit *e-tracking* PRESTO sipas udhëzimeve në Manualin e përdorimit të tij.

- Janë paraqitur të dhënat statistikore për veprat penale të trafikimit, prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve; trafikimit të personave dhe trafikimit të armëve. Këto të dhëna janë krahasuar me vitin paraardhës, duke u shprehur dhe nëse ka pasur një rritje apo ulje të numrit të procedimeve dhe të pandehurve. Në lidhje me veprat penale kundër

terrorizmit, Prokuroria e Përgjithshme në përgjigjen e paraqitur është shprehur se ky grup veprash penale në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale i përket Prokurorisë së Posaçme.

- Nga analiza e të dhënave statistikore lidhur me veprat penale të trafikimit[63], për vitin 2022 rezulton se janë regjistruar 183 çështje penale me 21 persona në hetim, nga të cilët vetëm 9 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 28 çështje me 31 të pandehur, ose rreth 15.3% e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të regjistruara e zë vepra penale "Trafikimi i mjeteve motorike" parashikuar nga neni 141/a i K. Penal me 97 çështje.

- Rezulton një ulje e konsiderueshme e numrit[64] të çështjeve të regjistruara me 64 procedime më pak dhe ulje e numrit të personave nën hetim dhe të personave të marrë si të pandehur me 16 persona më pak. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2022, numri i tyre është ulur me 9 çështje më pak, po ashtu edhe numri i të pandehurve në gjykim është ulur me 21 persona më pak krahasuar me vitin 2021[65].

- Lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike[66], në vitin 2022 janë hetuar 3324 çështje penale ose 166 çështje penale më pak se viti 2021. Rezulton se janë hetuar 1405 persona dhe janë marrë të pandehur 1325 persona. Krahasuar me vitin 2021[67] rezulton ulje me 128 persona të hetuar më pak dhe rritje me 32 të pandehur më shumë. Janë dërguar për gjykim 753 çështje ose 22.6% e çështjeve, me 1165 të pandehur, nga ku rezulton një rritje krahasuar me vitin 2021 me 50 çështje me tepër të dërguara për gjykim dhe 149 të pandehur më shumë[68]. Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e zë vepra penale: "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" neni 283 i Kodit Penal me 1895 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 560 çështje.

- Lidhur me kategorinë e veprave penale të terrorizmit[69], rezulton se është regjistruar në total 1 çështje për vitin 2022 me asnjë person nën hetim dhe asnjë të pandehur. Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2022, nuk ka asnjë çështje të dërguar për gjykim. Në krahasim me vitin 2021[70], vihet re një ulje e numrit të çështjeve të regjistruara me 8 çështje më pak.

- Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura[71] për vitin 2022 janë regjistruar 6 çështje penale për veprën penale "Nxitja e urrejtjes ose grindjeve" parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal, me 2 persona nën hetim dhe 1 të pandehur, si dhe 1 çështje penale për veprën penale "Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj" parashikuar nga neni 265/a i Kodit Penal, me asnjë person nën hetim dhe asnjë të pandehur. Rezulton një ulje e lehtë e numrit të çështjeve me 1 çështje më pak krahasuar me vitin 2021[72], dhe vijon të mbetet në të njëjtat shifra me 3 çështje të dërguara për gjykim dhe me 3 të pandehur[73].

- Lidhur me "Ashpërsimin e politikës penale për veprat penale në fushën e narkotikëve lidhur me masat e sigurimit personal dhe dënimin e tyre", kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit vijojnë të jenë të ashpra, ku 99.98% është numri (947) i personave me masa shtrënguese, nga të cilët 83,3% janë kërkesa për masa sigurimi me arrest me burg, dhe mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2021 ku kërkesa për masa sigurimi me arrest ishte 83.2%. Ndërsa në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime, numri i kërkesave për caktimin e dënimit me burg rezulton të jetë 65% nga 64.5% që ka qenë në vitin 2021 dhe numri i kërkesave për caktimin e alternativave të dënimit me burg është 35% nga 35.5% që ka qenë në vitin 2021. Gjithashtu, krahasimi i dy periudhave të dënimeve me burgim

[63] Nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a dhe 282/a të K. Penal.

[64] Në vitin 2021 ishin regjistruar 247 çështje penale me 37 persona në hetim, nga të cilët 25 janë marrë si të pandehur.

[65] Në vitin 2021 ishin dërguar për gjykim 37 çështje me 52 të pandehur për këtë kategori veprash penale.

[66] Ku janë përfshirë nenet 283-286/a të K. Penal.

[67] Në vitin 2021 kanë qenë 3490 çështje të hetuara me 1533 persona nën hetim dhe 1293 të pandehur.

[68] Në vitin 2021 janë dërguar për gjykim 703 çështje me 1016 persona të pandehur.

[69] Nenet 230-232/b të Kodit Penal.

[70] Në vitin 2021 ishin regjistruar 9 çështje penale, me 3 persona nën hetim dhe 2 të pandehur.

[71] Nenet 265- 265/c të K. Penal.

[72] Në vitin 2021 janë regjistruar 8 çështje penale, me 4 person të marrë nën hetim dhe 1 të pandehur.

[73] Në vitin 2021 ishte 3 çështje e dërguar për gjykim me 3 të pandehur.

evidenton se në vitin 2022, dënimet maksimale janë rritur 120%, dënimet mesatare janë rritur 24.3% dhe dënimet minimale janë rritur 4.2% krahasuar me vitin 2021.

- Lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale për prokurorët nëpërmjet trajnimeve në këtë fushë Prokuroria e Përgjithshme e ka trajtuar me prioritet rekomandimin si nëpërmjet akteve nënligjore të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm ashtu dhe nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës dhe me misionet/projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale. Referuar të dhënave rezulton se janë zhvilluar 17 tema nga Shkolla e Magjistraturës me pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Sa më sipër, *Këshilli i Ministrave me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar rekomandon:*

1. Rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme; si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale.

2. Marrjen e masave për evidentimin dhe rritjen e numrit të procedimeve për veprat penale në fushën e terrorizmit, përfshirë dhe rastet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare.

3. Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale dhe atë në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim; si dhe numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve.

4. Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust, si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

5. Marrjen e masave për rritjen e rasteve të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore, por dhe në rastet e trafikimit dhe krimit të organizuar.

6. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike.

7. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit me organet ligjzbatuese ndërkombëtare, në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda.

8. Rritjen e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të posaçme në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me struktura të tjera ligjzbatuese.

9. Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe aseteve të sekuestruara për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale.

4. Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut

Rekomandimet për forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut, përbëjnë thelbin e qëllimit të të gjitha masave me karakter ligjor dhe institucional, të planifikuara në të gjitha dokumentet strategjikë në të cilat mbështeten në tërësi rekomandimet kundër kriminalitetit për vitin 2023. Sfida për çdo institucion ligjzbatues, veçanërisht për ato që janë në kontakt të vazhdueshëm me autorët, viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale, mbetet trajtimi i tyre me dinjitet dhe në ambiente me kushte të përshtatshme me nevojat dhe kërkesat e tyre specifike.

4.1 Referuar analizës për vitin 2022 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezulton se:

Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2022 për prokuroritë pranë Gjykatave me Juridiksion të Përgjithshëm, numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale[74] është për 764[75] çështje, me 780[76] të pandehur. Në lidhje me këto institute të reja procedurale, rezulton se për 254 [77] çështje për kundërvajtje penale është kërkuar miratimi i urdhrit penal me 265[78] të pandehur, ku krahasuar

[74] Referuar shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/2 prot., datë 13.3.2023.

[75] Për vitin 2021 ka qenë 1071 çështje.

[76] Për vitin 2021 ka qenë 1096 të pandehur.

[77] Për vitin 2021 ka qenë 264 çështje.

[78] Për vitin 2021 ka qenë 269 të pandehur.

me 2021 rezulton me ulje 35.6% të çështjeve, për 265[79] çështje me 268[80] të pandehur është kërkuar miratimi marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ku rezulton ulje me 29.07% të çështjeve të krahasuara me vitin 2021, për 245[81] çështje me 247[82] të pandehur është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë, një ulje me 27.5% të çështjeve krahasuar me vitin 2021.

Nga të dhënat statistikore të sipërpërmendura rezulton se të tria institutet procedurale penale: urdhri penal, marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe gjykimi i drejtpërdrejtë kanë pësuar ulje krahasuar me vitin 2021.

- Në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës[83] rezulton se për vitin 2022 janë regjistruar 1564 çështje penale me 366 persona nën hetim dhe janë marrë 889 të pandehur. Krahasuar me vitin 2021[84] rezultojnë 73 çështje më shumë të regjistruara; 35 persona më pak nën hetim, dhe 16 të pandehur më shumë. Në lidhje me këtë kategori veprash rezulton se për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 1128 çështje me 1217 të pandehur. Krahasuar me një vit më parë[85] ka një rritje prej 48 çështjesh më shumë të dërguara për gjykim, dhe 54 të pandehur më shumë.

- Në lidhje me veprën penale "Dhuna në familje" parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, për vitin 2022 janë regjistruar 1453[86] çështje penale, me rritje 3.3% të procedimeve krahasuar me 2021, dhe që në total përbëjnë rreth 3.7% e të gjitha çështjeve penale të regjistruara[87], me 351 persona nën hetim dhe 865[88] të pandehur, me 37 persona në hetim më pak dhe rritje 19 persona të pandehur më shumë. Rezulton se në vitin 2022 për veprën penale "Dhuna në familje" parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 1093[89] çështje për këtë vepër penale me total prej 1182[90] të pandehur, çka përbën një rritje prej 56 çështjesh ose 5.4% dhe 63 të pandehur më shumë ose 5.6% krahasuar me vitin 2021. Çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 82,7% dërguar në gjyq dhe 17,3% të pushuara.

- Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjykimit, për veprën penale "Dhuna në familje" parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, Prokuroria e Përgjithshme është shprehur se 61%[91]e kërkesave janë kërkesa për caktimin e dënimit me burg, me rritje 4,9% të kërkesave për caktimin e dënimit me burgim krahasuar me vitin 2021, dhe 39% [92] të kërkesave për dënime alternative. Ndërkohë nga analiza e të dhënave statistikore, ka rezultuar se: në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për veprën penale "Dhuna në familje" rezulton se është kërkuar në 8 raste dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës[93]. Gjithashtu, krahasuar me vitin 2021 rezulton se: i) në 2 raste është kërkuar dënimi me gjobë[94]; ii) për 3 raste është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit[95]; iii) për 237 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita[96]; iv) për 359 të pandehur është kërkuar dënimi mesatar[97]; v) në asnjë rast nuk është kërkuar ulja nën minimumin e parashikuar nga dispozita[98]; vi) për 389 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit[99]; vii) në asnjë rast nuk është kërkuar tërheqja e akteve[100]; viii) në asnjë rast nuk është kërkuar pushimi i akuzës[101]; ix) për 10 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes[102]; dhe x) në asnjë rast nuk është kërkuar pafajësi[103]. Për sa më sipër kemi ulje të numrit me 6 raste të dënimit në maksimum, rritje me 2 raste të dënimit me gjobë, rritje me 3 raste më shumë të dënimit sa periudha e paraburgimit, rritje me 75 raste më shumë të dënimit në minimum, rritje me 29 të

79 Për vitin 2021 ka qenë 520 çështje.
80 Për vitin 2021 ka qenë 537 të pandehur.
81 Për vitin 2021 ka qenë 287 çështje.
82 Për vitin 2021 ka qenë 290 të pandehur
83 Seksioni IX, nenet 124-130/a të Kodit Penal.
84 Në vitin 2021 ishin regjistruar 1491 çështje me 401 persona nën hetim dhe 873 të pandehur.
85 Në vitin 2021 ishin dërguar për gjykim 1080 çështje me 1163 të pandehur.
86 Për vitin 2021 ka qenë 1406 çështje penale.
87 Për vitin 2022 janë regjistruar në total 38437 çështje.
88 Për vitin 2021 kanë qenë 388 persona nën hetim dhe janë marrë në cilësinë e të pandehurit 846 persona.
89 Për vitin 2021 ka qenë 1037 çështje.
90 Për vitin 2021 ka qenë 1119 të pandehur.
91 Për vitin 2021 ka qenë 56,1 % e kërkesave për caktimin e dënimit me burg.
92 Për vitin 2021 ka qenë 43.9 % kërkesave për dënim alternativ.
93 Në vitin 2021 dënimi maksimal është kërkuar vetëm në 2 raste.
94 Në vitin 2021 dënimi me gjobë nuk është kërkuar në asnjë rast.
95 Në vitin 2021 nuk është kërkuar në asnjë rast.
96 Në vitin 2021 ky dënim është kërkuar për 162 të pandehur.
97 Në vitin 2021 ky dënim është kërkuar për 330 të pandehur.
98 Në vitin 2021 ky dënim nuk është kërkuar në asnjë rast.
99 Në vitin 2021 pezullimi i ekzekutimit është kërkuar në 388 raste.
100 Në vitin 2021 tërheqja e akteve është kërkuar në 1 rast.
101 Në vitin 2021 pushimi i akuzës është kërkuar në 1 rast.
102 Në vitin 2021 për 4 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes.
103 Në vitin 2021 pafajësia është kërkuar në 1 rast.

dënimit mesatar, rritje me 1 rast të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, rritje me 6 raste të pushimit të çështjes dhe ulje me 1 rast të tërheqjes së akteve, pushimit të akuzës dhe pafajësisë.

Lidhur me të miturit viktima të moshës deri në 18 vjeç rezulton se për vitin 2022 kemi në total 21 viktima të mitur të moshës deri në 18 vjeç, nga ku 9 janë meshkuj dhe 12 femra. Për vitin 2021 rezulton se kanë qenë në total 21 të mitur të moshës deri në 18 vjeç nga ku 7 kanë qenë meshkuj dhe 14 femra. Krahasuar me vitin 2021 kemi të njëjtin numër të viktimave të mitur, nga ku 2 viktima meshkuj më shumë dhe 2 viktima femra më pak.

- Po kështu, për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" neni 79/c i Kodit Penal, në vitin 2022 janë regjistruar 14 procedime penale, me 10 persona nën hetim/të pandehur ose me ulje 26,3% të procedimeve dhe ulje 33,3% të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2021. Janë dërguar për gjykim 11 procedime me 14 të pandehur, ose me rritje 83,3% të procedimeve dhe 133,3% e të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2021.

- Lidhur me ashpërsimin e politikës penale për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" neni 79/c i Kodit Penal, nga të dhënat statistikore rezulton se kërkesat e prokurorit janë 100% kërkesa për masa sigurimi me arrest, ashtu si dhe në vitin 2021, ndërsa kërkesat për caktimin e dënimit, gjithashtu rezultojnë të ashpra, e konkretisht si vijon: 2 kërkesa për burgim të përjetshëm, 5 kërkesa për burgim në maksimumin e dënimit dhe 2 kërkesa burgim në nivelin mesatar, që parashikon neni 79/c i Kodit Penal.

- Nga të dhënat statistikore[104] rezulton se në çështjet penale të regjistruara gjatë vitit 2022, janë regjistruar 833[105] procedime/çështje me 873[106] viktima të mitura ku prej të cilëve 563 janë meshkuj dhe 310 femra[107], nga ku rezulton një rritje e konsiderueshme e viktimave të mitur, e veçanërisht viktimave meshkuj. Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për të miturit në konflikt me ligjin *për vitin 2022, janë regjistruar 821[108] procedime, me një rritje prej 16.6% të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2021, me 572[109] të mitur në konflikt me ligjin të regjistruar si të pandehur, ku krahasuar me vitin 2021 rezulton një ulje prej 23.1% të numrit të të pandehurve.*

Për të miturit në konflikt me ligjin rezulton se për vitin 2022 janë vendosur 25 masa sigurimi personal arrest në burg, ose për rreth 4,3% të të miturve të pandehur ose persona nën hetim, ose me ulje 28% të numrit të të miturve në konflikt me ligjin me masë sigurimi arrest në burg krahasuar me vitin 2021. Gjithashtu, për çështjet ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin janë dërguar 206 çështje për gjykim me 225 të pandehur, duke shënuar një ulje me 4 çështje më pak të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2021[110] ose me ulje 2% të çështjeve të dërguara për gjykim dhe ulje 15.4% të pandehurve të dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2021. Është vendosur mosfillimi i procedimit për 479 raste[111] duke shënuar rritje me 15 raste më shumë ose rritje me 46% krahasuar me vitin 2021, si dhe për 318 raste[112] me 281 të pandehur është vendosur pushimi i çështjes, duke shënuar rritje me 182 raste pushimi më shumë ose rritje me 5% më shumë se në vitin 2021 dhe ulje të numrit të pandehurve për çështjet e pushuara me 1% më pak se viti 2021.

- Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat statistikore për vitin 2022 rezulton se në kuadrin e 479 procedimeve të mosfilluara, në 82 raste[113]është aplikuar shmangia, nga të cilat në 11 raste është vendosur kështillim për të miturin dhe familjen, në 1 rast është vendosur paralajmërim me gojë, dhe në 70 raste është vendosur paralajmërim me shkrim. Ndërkohë, për 318 çështjet e pushuara rezulton se në 266 raste është aplikuar shmangia, ndër të cilat në 8 raste është vendosur ndërmjetësimi, në 6 raste është vendosur këshillimi, në 3 raste është vendosur paralajmërim me gojë, në 254 raste është vendosur paralajmërim me shkrim dhe në 1 rast është vendosje nën kujdesje. Aplikimi i shmangies nga dënimi i të miturit në konflikt me ligjin është rritur 8.1% krahasuar me vitin 2021.

[104] Të paraqitura në shkresën nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme.

[105] Për vitin 2021 kanë qenë 313 procedime të regjistruara.

[106] Për vitin 2021 kanë qenë 358 viktima të mitura.

[107] Për vitin 2021 kanë qenë 175 kanë qenë meshkuj dhe 183 femra.

[108] Për vitin 2021 kanë qenë 702 procedime të regjistruara.

[109] Për vitin 2021 kanë qenë 743 të mitur të pandehur.

[110] Në vitin 2021 janë regjistruar 210 çështje të dërguar për gjykim.

[111] Në vitin 2021 është vendosur mosfillimi i procedimit për 464 raste.

[112] Në vitin 2021 është vendosur pushimi i çështjes për 136 raste.

[113] Në vitin 2021 në 324 raste është aplikuar shmangia.

- Në lidhje me veprën penale "Krimet seksuale" janë regjistruar 162[114] procedime penale, me rritje prej 2.5% të numrit të procedimeve penale dhe me 96[115] të pandehur ose me ulje 10.2% të numrit të pandehurve të regjistruar, krahasuar me vitin 2021. Gjithashtu, janë dërguar për gjykim 87[116] procedime me 95[117] të pandehur, ku rezulton me rritje prej 4.8% të numrit të procedimeve për gjykim dhe me 2.1% të numrit të të pandehurve krahasuar me vitin 2021.

- Lidhur me masat e sigurimit personal për veprën penale "Krimet seksuale", rezulton ashpërsim i masave, ku 95%[118] janë kërkesa për masën e sigurimit "arrest në burg" dhe vetëm 5% [119] janë kërkesa me detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, ku krahasuar me vitin 2021 ky raport është me ulje rreth 4%. Për kërkesat për caktimin e dënimit me burg, mbetemi pothuajse në të njëjtat nivele si në vitin 2021, pasi konkretisht janë 81.7% kërkesa për caktimin e dënimit me burg ndërsa në vitin 2021 ka qenë 81,9%, si dhe kërkesat për dënim alternativ janë 18,3%, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 18.4%.

- Gjithashtu, sa i përket politikës penale në veprat penale të trafikimit të fëmijëve, të dhënat tregojnë se, për vitin 2022 nuk ka kërkesa të prokurorit lidhur me masat e sigurimit personal apo kërkesa për caktim dënimi sepse nuk ka persona nën hetim apo të pandehur dhe as të dënuar. Ndërsa për veprën penale "Trafikimi i të rriturve", parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal ka vetëm një 1 kërkesë për caktim dënimi me burgim ndaj një të pandehuri.

- Në lidhje me veprat penale dhe/ose me autorë me rrezikshmëri të ulët shoqërore, persona vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore, prokurorët janë udhëzuar për ndjekjen e një politike penale eficiente për zbutjen e dënimit apo aplikimin e dënimeve alternative në rastet e këtyre veprave penale me këtë kategori autorësh të veprave penale, me synim rehabilitimin dhe parandalimin e posaçëm e të përgjithshëm të veprave penale të kryera nga kjo kategori subjektesh, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar rast pas rasti rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të përfshirë në këtë grup subjektesh, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese në kuptim dhe zbatim të nenit 49 të Kodit Penal. Referuar të dhënave statistikore për vitin 2022 lidhur me aplikimin e dënimeve alternative në raport me dënimet me burgim, rezulton se për të gjitha kategoritë e veprave penale që mund të jenë kryer nga persona të përfshirë në këtë grup subjektesh janë dhënë gjithsej 9447 dënime me burgim, prej të cilëve 6303 janë dënime alternative të dënimit me burgim, të cilët mund të jenë dhënë dhe ndaj "autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore", "personave vulnerabël" dhe "personave me probleme shëndetësore". Këto tregues evidentojnë se në vitin 2022, dënimet alternative zënë 66,7% të dënimeve me burgim, ndërsa në vitin 2021 zinin 60,7% të dënimeve me burgim ose me rritje 6% të këtij raporti në përqindje krahasuar me vitin 2021.

- Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit[120], nga të dhënat statistikore në vitin 2022 janë regjistruar 372[121] procedime penale me 52 persona nën hetim dhe 51 persona të pandehur[122]. Në krahasim me vitin 2021, rezulton një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara me 58 procedime më shumë ose me rritje 18.4% të numrit të procedimeve, me 27 persona nën hetim më pak dhe me një ulje prej 2 të pandehur më pak se në vitin 2021. Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë grup veprash rezulton se për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 75 procedime me 103 të pandehur, ku krahasuar me vitin 2021[123] rezulton një ulje me 5 procedime më pak dërguar për gjykim ose ulje me 6.25% të procedimeve dhe me rritje prej 14 të pandehur më shumë.

- Gjithashtu, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore lidhur me veprat penale në fushën e mjedisit, prokurorët kanë ndjekur ndër të

[114] Në vitin 2021 janë regjistruar 158 procedime penale.

[115] Në vitin 2021 kanë qenë 107 të pandehur të regjistruar.

[116] Në vitin 2021 janë dërguar për gjykim 83 procedime.

[117] Në vitin 2021 kanë qenë 93 të pandehur të dërguar për gjykim.

[118] Në vitin 2021 janë 98,6 % kërkesa për masën e sigurimit "arrest në burg".

[119] Në vitin 2021 janë 1,4 % kërkesa me detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.

[120] Nenet 201-207, nenet 207/a, 207/b, 207/c dhe 207/ç të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2021.

[121] Në vitin 2021 janë regjistruar 314 çështje penale.

[122] Në vitin 2021 janë 79 persona nën hetim dhe 53 të pandehur për procedimet penale të regjistruara.

[123] Në vitin 2021 janë dërguar për gjykim 80 çështje me 89 të pandehur.

tjera, edhe dy tema trajnimi në Shkollën e Magjistraturës. Në lidhje me veprat penale me bazë gjinore, është vlerësuar nevoja për rritjen e trajnimeve dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës janë zhvilluar disa trajnime ku kanë marrë pjesë 20 prokurorë dhe 9 oficerë të policisë gjyqësore.

- Po kështu Prokuroria e Përgjithshme është përfshirë në Projektin e Prezencës së OSBE-së për "Rritjen e Sigurisë dhe Qeverisjes Mjedisore në Shqipëri", për përgatitjen e analizës lidhur me situatën dhe kompetencat e gjithë institucioneve të përfshira në krimin mjedisor, ku kontributi institucional ka filluar me diskutime për aspektet institucionale, statistikore dhe treguesit e ndjekjes penale të veprave kundër mjedisit.

- Është vijuar bashkëpunimi me Qendrën për Nisma Ligjore dhe Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në kuadër të projektit "Angazhim proaktiv për mbrojtje dhe zbatimin e ligjit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje".

Këshilli i Ministrave me qëllim forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut rekomandon:

1. Vijimin e aplikimit të masave alternative të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (shmangies) tek të miturit, për të siguruar një drejtësi miqësore dhe duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të të miturit.

2. Shtimin e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe rritja e rasteve të gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve.

3. Nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore.

4. Vijimin e ashpërsimit të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

5. Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimit dhe gjykimit për veprat penale në fushën e mjedisit.

6. Rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe veçanërisht të oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve, krimin kibernetik dhe veprat penale mjedisore.

7. Marrjen e masave për të rritur efektivitetin e garancive procedurale për viktimat e mitur dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit në konflikt me ligjin.

8. Rritjen e përpjekjeve dhe ashpërsimin e masave për të forcuar luftën kundër krimit në familje dhe dhunës ndaj grave, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e këtyre fenomeneve të dëmshme për shoqërinë shqiptare.

9. Vijimin e rritjes së cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale duke rritur kërkesat e caktimit të dënimit me burg për autorët e veprës penale të dhunës në familje dhe kryesisht autorët recidivistë të dhunës në familje.

5. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional

Rekomandimet për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional vijnë në qasje me zhvillimet e reja institucionale dhe organizative, të fokusuara në ndërveprimin e shpejtë dhe efektiv të komunikimit dhe marrëdhënieve produktive ndërmjet institucioneve ligjzbatuese.

Në kuadër të marrjes së masave për forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme, të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme përmendet nënshkrimi i Aktit të Koordinimit Institucional "Për rritjen e eficiencës nëpërmjet bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj", i cili po vijon bashkëpunimin.

Gjatë vitit 2022, nga Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë trajtuar 54 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, ku krahasuar me vitin 2021[124] rezulton ulje prej 37 kërkesash më pak.

[124] Për vitin 2021 janë trajtuar 91 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike.

Nga totali janë ekzekutuar 39 letërporosi dhe për vitin 2020-2022, vijon ende procedura për ekzekutim për 21 kërkesa. Këto kërkesa janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2021 nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë përcjellë 62 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve të huaja, ose 11 më tepër se vjet[125]. Nga këto janë ekzekutuar 33 kërkesa dhe po vijon procedura për ekzekutimin e 48 kërkesave për vitin 2020-2022.

Për vitet 2021-2022 janë krijuar 10 Skuadra të Përbashkëta Hetimore[126] në funksion të hetimeve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Procedimet penale për të cilat janë krijuar këto skuadra kanë objekt hetimi në fushën e trafikimit të narkotikëve, prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, veprat penale kundër terrorizmit, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, korrupsionit, kontrabandës së barnave, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, vepra të kryera në formën e bashkëpunimit të "Grupit të strukturuar kriminal", parashikuar si vepër penale nga Kodi Penal në nenet 283, 283/a, 230, 230/a, 264, 143, 143/b, 28, 109, 333/a dhe 334.

Gjatë vitit 2022 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bërë shpalljen në kërkim ndërkombëtar për 42 persona si dhe ka transmetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë 10 kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri, kryesisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet (283/a, 297, 333/a, 334, 258-25, 298/3, 28/5, 319-25, 232/a, 189, 190, 79/dh, 178/1, 28/4, 109, 278/1, 152, 130/a/1, 139, 80, 245-25 të Kodit Penal).

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është asistuar në punën e saj nga disa programe, misione apo projekte të SHBA-së dhe BE-së të cilat synojnë përmirësimin e drejtësisë kriminale të Shqipërisë dhe sektorit të zbatimit të ligjit, e konkretisht bëhet fjalë për programet si Misioni OPDAT, Programi ICITAP, Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të marrëveshjes IPA 2019/Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor, Projekti EU4FOCAL, Projekti EU4LEA.

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje dhe konkretisht:

- Më datë 4.2.2022 është nënshkruar Protokolli i Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion të Rumanisë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Shqipërisë.

- Më datë 4.11.2022 është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit të Rumanisë.

Lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 2022 kanë përfunduar verifikimet e plota të pasurisë dhe pastërtisë së figurës për 74 kandidatë për hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit. Po gjatë këtij viti komisioni ka filluar dhe ka vazhduar procesin e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës edhe për 99 subjekte nga të cilat 84 punonjës të administratës së Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, 2 kancelarë të Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit, 13 kandidatë për hetues të Seksionit Financiar në Prokurorinë e Posaçme.

Në kuadër të veprave penale që lidhen me zgjedhjet, për periudhën 1.1.2021-31.12.2022 rezulton se numri i materialeve kallëzuese / referuese është 152 nga të cilat për 20 është vendosur mosfillim procedimi, për 19 është vendosur dërgim për verifikim në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për 50 materiale është vendosur dërgimi për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore ndërsa për 63 materiale është vendosur regjistrimi i procedimit penal. Nga 63 procedime penale të regjistruara është vendosur ndarja për 3 procedime penale duke

[125] Për vitin 2021 janë 51 kërkesa për ndihmë të ndërsjellët juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja nga Prokuroria e Posaçme.

[126] Për vitin 2021-2022 janë 6 skuadra të përbashkëta me Italinë, 1 skuadër me Italinë dhe Kosovën, 1 skuadër me palë Suedi-Ukrainë-Spanjë-Gjermani-Gjeorgji-Finlandë-Letoni, 1 skuadër me Francën dhe 1 skuadër me Britaninë e Madhe.

e çuar kështu numrin e procedimeve penale të regjistruara për krimet zgjedhore në 66 në total[127].

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale për vitin 2022 janë ekzekutuar 55 vendime gjykate të formës së prerë dhe janë dënuar 207 [128] të pandehur. Nga këto vendime 18 kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe 37 vendime kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Apelit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2022 në drejtim të bashkëpunimit ndërinstitucional, nga organi i prokurorisë rezulton:

- Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme[129] në lidhje me rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit është konsideruar domosdoshmëri një qasje e përbashkët dhe e unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese. Për këtë qëllim, Prokuroria e Përgjithshme i ka kushtuar vëmendje si bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, ashtu edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror.

- Në zbatim të kompetencave të tij ligjore, me synim për të normuar veprimtarinë administrative dhe procedurale Prokurori i Përgjithshëm gjatë vitit 2022 ka nxjerrë akte të reja normative ose ndryshim/plotësim aktesh normative ekzistuese; si dhe marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume mirëkuptimi, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, në vitin 2022, në zbatim të nenit 108/a, të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", Prokuroria e Përgjithshme ka bashkërenduar punën me Ministrinë e Drejtësisë për të mundësuar aksesin në bazën e të dhënave të sistemit elektronik të noterisë. Ndërkohë, në zbatim të ligjit nr. 112/2020 "Për regjistrimin e pronarëve përfitues", ligjit nr. 154/2020, "Për regjistrimin qendror të llogarive bankare", dhe vendimit nr. 415, datë 8.7.2021 të Këshillit të Ministrave i nxjerrë për zbatimin e këtij ligji, dhe jo vetëm, ka kërkuar dhe është në pritje të marrjes së aksesit në bazën e të dhënave në "regjistrin e pronarëve përfitues", dhe "regjistrin qendror të llogarive bankare", bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe bazën e të dhënave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe bazën e të dhënave në Sistemin Elektronik të çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

- Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, po bashkëpunon me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe me Shkollën e Magjistraturës, për të siguruar mbarëvajtjen e punës administrative në prokurori, rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe lehtësimin në shmangien e problematikave që janë e po vijojnë të krijohen për shkak të vakancave të prokurorëve në sistemin e prokurorisë si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar.

- Prokurori i Përgjithshëm në kuadrin e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Ministrinë e Drejtësisë dhe në raportimin periodik në Kuvendin e Shqipërisë, ndër të tjera, është angazhuar në aktivitete dhe diskutime për miratimin e hartës së re gjyqësore, ashtu dhe për përmirësime në infrastrukturë në sistemin e prokurorisë, ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori, rritje të kapaciteteve akomoduese me ambiente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe stafin e prokurorisë, me synim për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe për të mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në të gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

- Prokuroria e Përgjithshme i ka propozuar në prill 2022 Kuvendit të Shqipërisë të ndërmarrë nismën për ndryshime e shtesa në paketën ligjore "Përmirësimi i funksionalitetit, eficiencës dhe efektivitetit në sistemin e prokurorisë" përgatitur nga grupi punës ndërinstitucional me asistencën e ekspertëve të projektit EURALIUS V, misionit OPDAT dhe projektit PAMECA V, në kuadrin e urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 52, datë 12.5.2021. Ndryshimet dhe shtesat e propozuara

[127] 5 procedime janë dërguar për gjykim me 7 të pandehur; 12 procedime janë dërguar me kërkesë për pushim me 4 persona nën hetim; 25 procedime janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore; 4 procedime janë pezulluar; 4 procedime janë bashkuar; 16 procedime penale janë në hetim.

[128] 158 persona me burgim, 40 persona me kusht, kohë prove, 3 persona me orë pune, 4 persona me gjobë.

[129] Me shkresën nr. 1108/36 prot., datë 13.3.2023, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 523/2 prot., datë 13.3.2023.

vijnë si rezultat i nevojës për të adresuar një sërë problematikash të evidentuara gjatë zbatimit në praktikë të këtij kuadri ligjor, dhe ka si qëllim vazhdimin e implementimit të reformës në prokurori, pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë penale, si dhe normalizimin e situatës së krijuar nga boshllëku ligjor, për të shmangur problematikat shqetësuese të evidentuara në performancën e veprimtarisë organizative dhe administrative të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe për të rritur eficiencën dhe përmirësuar performancën në veprimtarinë e tyre.

- Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme, ka kontribuar periodikisht dhe ka përgatitur informacionet/materialet lidhur me progresin institucional të prokurorisë, në kuadër të zbatimit të Strategjive dhe Planeve të Veprimit ndërinstitucionale për aktivitete brenda vendit dhe me institucionet ndërkombëtare dhe rajonale si dhe ka vijuar të japë kontributin e saj në përgatitjen e opinioneve/mendimeve lidhur me projektligje të ndryshme.

- Prokuroria e Përgjithshme me hapjen e negociatave dhe nisjes së procesit teknik për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, me synim normimin e organizimit dhe funksionimit të një zyre integrimi në përbërje të strukturës së Prokurorisë së Përgjithshme në funksion të përmbushjes së detyrave dhe angazhimeve institucionale në ecurinë e procesit të integrimit evropian të vendit, me urdhrin nr. 61, datë 6.9.2022, "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme", ka miratuar ndryshimin e emërtimit në "Sektori i Koordinimit, Studimeve dhe Integrimit" të strukturës përkatëse, si dhe janë normuar detyrat funksionale të kësaj strukture të ndryshuar për ta përshtatur në funksion të përmbushjes së detyrave dhe angazhimeve në kuadrin e integrimit evropian të vendit dhe përfaqësimin e prokurorisë në nivel teknik në takimet e grupit negociues ndërinstitucional Shqipëri-Bashkimi Evropian. Prokuroria e Përgjithshme është përfaqësuar si pjesë e grupeve ndërinstitucionale të ndryshme dhe është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit me Bashkimin Evropian dhe takimet dypalëshe *screening* për kapitujt 23 dhe 24 të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

- Prokuroria e Përgjithshme, për të lehtësuar rritjen e ngarkesës së prokurorëve dhe për forcimin e kapaciteteve të seksioneve të policisë gjyqësore në prokurori, me qëllim për të mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në sistemin e prokurorisë, për shkak të vakancave nga procesi i rivlerësimit kalimtar, në projektbuxhetin për vitin 2022 i ka kërkuar Kuvendit të Shqipërisë rritjen e numrit organik të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori. *Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 115/2021, datë 25.11.2021, "Për buxhetin për vitin 2022", hyr në fuqi me 1 janar 2022, ka miratuar rritjen e numrit organik me 30 oficerë të policisë gjyqësore,* domethënë nga numri organik që ishte 216, aktualisht numri organik është 246 oficerë të policisë gjyqësore në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Në kuadrin e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të policisë gjyqësore në seksionet e prokurorisë, mbi kërkesat e Prokurorit të Përgjithshëm, në zbatim të ligjit nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", *Komisioni i Policisë Gjyqësore përgjatë vitit 2022 ka emëruar 21 oficerë të policisë gjyqësore në seksionet e policisë gjyqësore në prokuroritë përkatëse, për të lehtësuar dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve në përballimin e volumit të punës në rritje.* Ndërkohë, po vijon procedura e konkurrimit të kandidatëve të tjerë për rekrutimin dhe emërimin e tyre nga Komisioni i Policisë Gjyqësore. Përgjatë vitit 2022 është miratuar "Rregullorja për trajnimin fillestar për hetimin e oficerëve të policisë gjyqësore" dhe në zbatim të saj është kryer trajnimi fillestar për 21 oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë, të emëruar rishtas nga Komisioni i Policisë Gjyqësore. Gjithashtu, për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurori, Prokurori i Përgjithshëm në bashkërendim me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe me Shkollën e Magjistraturës kanë mundësuar përfshirjen e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë në programin e trajnimit vazhdues të kësaj shkolle për vitin 2022.

- Gjatë vitit 2022, për veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet[130] rezulton se janë regjistruar 313 procedime penale me 48 të pandehur për këto

[130] Referuar neneve 180-182/a të Kodit Penal.

vepra penale[131], me rritje prej 0.9% të numrit të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2021. Janë dërguar për gjykim 85 [132] çështje penale me ulje prej 9.5% të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2021, si dhe me 117[133] të pandehur të dërguar për gjykim, ku krahasuar me vitin 2021 ka një ulje prej 18.1% të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim. Ndërsa për veprën penale "Moskryerja e detyrave nga organet tatimore" të parashikuar nga neni 181/a i Kodit Penal nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal, njësoj si në vitin 2021, ndërsa për veprën penale "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore" sipas nenit 175 të Kodit Penal, ku përfshihen nëpunësit publik të dyshuar të administratës doganore, janë regjistruar 3 procedime penale. Ndërkohë nga analiza e statistikave të prokurorisë për vitin 2022 konstatohet se numri më i madh i referimeve ka ardhur nga policia e shtetit me 31210 çështje të referuara, ndërkohë që referimet e policive të tjera janë si vijon: 10 çështje të referuara nga policia e ndërtimit; 25 çështje të referuara nga policia financiare; 4 çështje të referuara nga policia pyjore; 3 çështje të referuara nga policia elektrike; dhe 305 çështje të referuara nga policitë e tjera. Krahasuar me vitin 2021[134], konstatohet se kemi një ulje të referimeve nga Policia e Shtetit me 2006 raste më pak, ulje të referimeve nga policia elektrike me 47 raste më pak dhe nga policitë e tjera me 33 raste më pak. Nga ana tjetër, për policinë financiare rezulton se kemi rritje me 10 raste më shumë të referuara, për policinë pyjore kemi 1 rast më pak të referuar dhe për policinë e ndërtimit 28 raste më pak të referuara, krahasuar me vitin 2021.

- Referuar të dhënave statistikore për grup-veprat penale në lidhje me krimet në fushën e doganave, në vitin 2022, evidentohet se janë regjistruar 259 procedime penale me 232 të pandehur ose me rritje 54,1% të numrit të procedimeve dhe rritje 74.3% të pandehurve krahasuar me vitin 2021. Gjithashtu, për këtë grup-veprash penale janë dërguar për gjykim 134 procedime penale me 190 të pandehur ose me rritje 32,6% të numrit të procedimeve dhe rritje 54.4% të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë grup-veprash krahasuar me vitin 2021.

- Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, gjatë vitit 2022 nga sistemi IMPRO janë paraqitur këto të dhëna:

Për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve" - ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit - 55 praktika; - Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë- 38 praktika; - letërporosi nga jashtë- 39 praktika; - letërporosi për jashtë - 40 praktika.

Për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale" janë trajtuar kërkesat: - letërporosi nga jashtë – 31 praktika; - letërporosi për jashtë - 97 praktika.

Për veprën penale "Trafikimi i qenieve njerëzore" janë trajtuar kërkesat: - ekstradimet nga jashtë drejt Shqipërisë - 2 praktika; - ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit - 1 praktikë; - letërporosi nga jashtë - 35 praktika; - letërporosi për jashtë - 4 praktika.

- Po kështu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2022 në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja janë kryer: - Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit - 119 praktika dhe janë përfunduar gjithsej 49 praktika; - Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë - 162 praktika dhe janë përfunduar 62 praktika; - Urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, - 252 praktika nga këto 122 të përfunduara; - letërporosi nga jashtë - 489 praktika nga këto 284 të përfunduara; - letërporosi për jashtë – 526 praktika nga këto 173 të përfunduara; - shpallja e shtetasve shqiptarë ose të huaj në kërkim ndërkombëtar - 245 praktika nga këto 24 të përfunduara; - heqje e shtetasve shqiptarë nga kërkimi ndërkombëtar - 134 praktika; - transferime të dënuarish nga jashtë - 10 praktika nga këto 2 të përfunduara; - transferime të dënuarish për jashtë - 0 praktika; - transferime procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë - 17 praktika; - transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë - 11 praktika; - njohjet e vendimeve penale të ardhura

[131] Për vitin 2021 janë regjistruar 316 procedime penale me 78 të pandehur për veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet.

[132] Për vitin 2021 janë dërguar për gjykim 94 çështje penale.

[133] Për vitin 2021 janë 143 të pandehur të dërguar për gjykim.

[134] Të dhënat për vitin 2021 kanë qenë: 33216 referime nga policia e shtetit; 15 referime nga policia financiare; 38 referime nga policia e ndërtimit; 5 referime nga policia pyjore; dhe 338 referime nga policitë e tjera, ndërsa nga policia elektrike janë referuar 50 raste.

nga jashtë - 19 praktika; - njohjet e vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit - 7 praktika.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit për organizimin e trajnimeve të përbashkëta është përmendur sërish bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për të organizuar aktivitete të përbashkëta trajnuese të zhvilluara me tema që lidhen me hetimet financiare, evazionin fiskal dhe krimin kibernetik, si dhe numri i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore pjesëmarrës në to.

Nga vlerësimi i rekomandimeve të propozuara nga ministritë e linjës që kanë në përgjegjësi agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, evidentohet progres i arritur dhe forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë.

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, nga këto institucione janë propozuar si vijon:

Ministria e Brendshme[135] në përputhje me prioritetet e përcaktuara në programin e Qeverisë, detyrimet që lindin në kuadër të MSA-së me Bashkimin Evropian, rekomandimet e FATF/MONEYVAL dhe Planin e Veprimit të ICRG/FATF për vitin 2023 "Për nxjerrjen e Shqipërisë nga lista gri", si edhe në Memorandumin e Bashkëpunimit Ndërinstitucional nr. 5270, datë 16.7.2020, *"Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale në funksion të përmbushjes së Rekomandimeve KSA-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF",* ka paraqitur disa sugjerime me qëllim: i) rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit; ii) parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimet ekonomike e financiare; iii) forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Prokurorinë.

Konkretisht, Ministria e Brendshme ka sugjeruar:

i. Zhvillimin e hetimeve pasurore paralelisht me hetimin penal referuar ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", veçanërisht në hetimet e grupeve të strukturuara kriminale, dhe subjektet e shpallura në kërkim ndërkombëtar, duke synuar që për këto subjekte të kërkohet sekuestrimi i pasurisë që në fazën fillestare të hetimit.

ii. Rritja e numrit të hetimeve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtar, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe të grupeve kriminale me aktivitet ndërkombëtar.

iii. Të zbatohen kërkesat e memorandumit të bashkëpunimit për realizimin e takimeve dhe analizave periodike ndërinstitucionale Prokurori-Polici, në nivel qendror dhe lokal me qëllim evidentimin, adresimin, zgjidhjen e problematikave.

iv. Të mbështesë në mënyrë prioritare implementimin e shkëmbimit të të dhënave midis dy aplikacioneve të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë.

v. Të vlerësohet rishikimi i udhëzimit të përbashkët nr. 2487, datë 15.5.2017, "Për trajtimin e bimëve, lëndëve narkotike apo psikotrope dhe prekursorve kimikë të sekuestruara", lidhur me administrimin e tërheqjes dhe dorëzimit të këtyre provave.

Krahas këtyre sugjerimeve për rekomandimet drejtuar prokurorit të përgjithshëm, Ministria e Brendshme ka paraqitur disa problematika dhe sugjerime të përgjithshme që lidhen me mbarëvajtjen e hetimeve, konkretisht: i) krijimi i një *track-recordi* në lidhje me veprat penale të krimit të organizuar dhe hetimeve financiare; ii) ndryshimi i kuadrit ligjor për përditësimin e listave të lëndëve narkotike në ligjin 7975/1995; si dhe iii) problematikat për shkak të ngarkesës së lartë të rasteve të paraqitura në Institutin e Policisë Shkencore në lidhje me ekspertimin e profilitgjenetik të ADN-së.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë[136] konkretisht *Drejtoria e Përgjithshme e Doganave* shprehet se, ka pasur një bashkëpunim të mirë me organin e prokurorisë veçanërisht në rastet e regjistrimit të procedimeve penale në bazë të materialeve të referuara. Një sugjerim i paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, është që për shkak të mundësisë për aksesin e informacionit në terren, pavarësisht se cili është institucioni referues, materiali t'u delegohet Oficerëve të Policisë

[135] Kërkuar informacion me shkresën nr. 277 prot., datë 16.1.2023, ardhur përgjigje në mënyrë elektronike me shkresën nr. 562/3 prot., datë 6.2.2023.

[136] Kërkuar informacion me shkresën nr. 277, datë 16.1.2023, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 2126/1prot., datë 20.2.2023, protokolluar pranë nesh me nr. 277/7 prot., datë 10.3.2023.

Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit[137] rekomandon:

i. forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, i cili të konsistojë në shkëmbimin e informacioneve dhe dhënien e ekspertizës nga ana e saj;

ii. rritjen e hetimeve proaktive jo vetëm të veprave penale në fushën e lojërave të fatit, por edhe në vepra penale të lidhura me to si pastrimi i produkteve të veprës penale, mitëmarrja, shpërdorimi i detyrës, evazioni fiskal, si dhe

iii. rritjen e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim për këtë kategori veprash penale me qëllim reduktimin e këtij fenomeni.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave[138] evidenton si prioritare përqendrimin e hetimit të procedimeve penale me pritshmëri për sekuestro e konfiskim pasurish kriminale, duke përfshirë veçanërisht rastet e kryerjes së veprës penale nga palë të treta dhe vepra penale origjinuese jashtë Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, kërkon vëmendje të veçantë për hetimin me përparësi të rasteve të veprave penale që sipas Vlerësimit Kombëtar të Riskut për Pastrimin e Parave evidentohen si veprat kryesore gjeneruese të ardhurash kriminale si në fushën e lëndëve narkotike, veprat penale të korrupsionit dhe ato në fushën doganore e tatimore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë[139] *dhe konkretisht Drejtoria e Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve* shprehet se, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 1079, datë 15.7.2020 janë marrë angazhime për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimit të veprave penale në fushën e pastrimit të parave, krimeve financiare, e hetimeve pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Në kuadër të këtij bashkëpunimi Drejtoria e Hetimit Tatimor sugjeron vëmendje e shtuar dhe prioritet më i lartë në sektorët e identifikimit me risk, forcim të bashkëpunimit, në lidhje me fenomenin e skemave mashtruese me TVSH-në, krijimin e subjekteve tregtare dhe caktimin e administratorëve fiktivë si dhe zbatimin më efektiv të sekuestros preventive dhe konservative, me qëllim evidentimin e përfituesve realë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit[140] shprehet në lidhje me veprimtarinë e institucioneve të saj për vitin 2022 dhe bashkëpunimin me prokurorinë, e konkretisht:

i. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) ka mbajtur 248 procesverbale konstatimi për dëmtime në zonat e mbrojtura nga të cilat 21 prej tyre i janë referuar drejtpërdrejt Prokurorive të Qarkut Berat, Elbasan, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Durrës, Gjirokastër dhe 227 raste Policisë së Shtetit dhe IKMT-së;

ii. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) ka referuar 24 raste në strukturat e Policisë së Shtetit për lirimin e plazheve publike dhe masat për mjetet lundruese dhe në 7 raste ka vënë në dispozicion të prokurorisë dokumentacionin e kërkuar;

iii. Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) ka pasur një numër të lartë denoncimesh lidhur me dëmtimet e fondit pyjor, prerje dhe transport të paligjshëm të lëndës drusore, ku 33 raste janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Lidhur me këto raste Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) ka paraqitur problematikën në lidhje me bashkëpunimin me prokurorinë dhe zhvillimin e hetimit, ekspertizën e kryer dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve penale.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nisur nga sa më sipër rekomandon:

i. rritjen e bashkëpunimit midis strukturave të fushës së turizmit dhe mjedisit në nivel qendror dhe rajonal me prokurorinë e rretheve për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe referimin e saktë të kundërvajtjes/veprës penale në fushën e mjedisit, mbledhjen e provave të sakta si dhe bashkëpunimin me strukturat për gjetjen e autorëve,

ii. forcimin e masave ndëshkuese nga ana e prokurorisë për kundërvajtjet penale që lidhen me fushën e mjedisit, pyjeve dhe zonave të mbrojtura me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe

[137] Kërkuar informacion me shkresën nr. 277 prot., datë 16.1.2023, ardhur përgjigjja nëpërmjet e-mailit datë 20.3.2023.

[138] Kërkuar informacion me shkresën nr. 277 prot., datë 16.1.2023, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 181/1 prot., datë 10.2.2023, protokolluar me nr. 277/7 prot., datë 10.3.2023.

[139] Kërkuar informacion me shkresën nr. 277 prot., datë 16.1.2023, kthyer përgjigje me shkresën e tyre nr. 1937/1 prot., datë 21.2.2023, protokolluar me nr. 277/4 prot., datë 21.2.2023.

[140] Kërkuar informacion me shkresën nr. 277, datë 16.1.2023, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 392/2 prot., datë 9.2.2023, protokolluar pranë nesh me nr. 277/2 prot., datë 10.2.2023.

parandalimin e dëmtimit të cilësisë së mjedisit apo të përbërësve të tij të veçantë;

iii. zhvillimi i komunikimeve periodike për të diskutuar lidhur me ecurinë e hetimit dhe problematikat që hasen; si dhe

iv. organizimin e trajnimeve të prokurorëve për hetimin e krimeve mjedisore sipas praktikave më të mira evropiane, duke pasur parasysh se Prokuroria e Përgjithshme është në cilësinë dhe të anëtarit të Rrjetit Evropian të Prokurorëve Mjedisorë (ENPE).

Ministria e Mbrojtjes[141] ka parashtruar një problematikë që lidhet me faktin e ushtrimit të atributeve ligjore të Oficerëve të Policisë Gjyqësore nga ana e Komandës së Forcës Detare/Roja Bregdetare sipas përcaktimit ligjor. Me qëllim përmirësimin e ushtrimit të detyrës nga ana e tyre, Ministria e Mbrojtjes ka sugjeruar rritjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme dhe trajnimin e vazhdueshëm të Oficerëve të Policisë Gjyqësore me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të ushtrimit të detyrës së tyre brenda kuadrit ligjor.

Sa më sipër, *Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional rekomandon:*

1. Forcimin e luftës kundër informalitetit, duke rritur numrin e çështjeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim, për grup veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, duke forcuar bashkëpunimin me institucionet përkatëse në luftën ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal dhe ndaj nëpunësve publikë të administratës tatimore dhe doganore.

2. Rritjen e numrit të hetimeve paralele financiare në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, si vepra penale që gjenerojnë të ardhura, gjurmimin e produkteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve.

3. Shtimin e vëmendjes për veprat penale në fushën e zgjedhjeve, duke pasur parasysh se viti 2023 është një vit zgjedhor, me qëllim garantimin e hetimit të shpejtë dhe efektiv të çështjeve.

4. Rritjen e vëmendjes në lidhje me veprat penale të krimit kibernetik, thelbësore si pjesë e masave për sigurinë kibernetike të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave.

5. Vijimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese kombëtare dhe ndër-kombëtare, me qëllim rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale, dhe shkëmbimin e të dhënave në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm.

6. Rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e krimeve financiare, pastrimit të parave, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, si dhe për veprat penale të fushës së krimeve të rënda që mund të lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit.

7. Vijimin e forcimit të kapaciteteve të seksioneve të posaçme pranë prokurorive me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në kompetencë të këtyre seksioneve.

8. Rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre.

9. Shtimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave veçanërisht në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik.

VENDIM
Nr. 227, datë 13.4.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 110, DATË 6.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË RREGULLAVE TË PËRZGJEDHJES SË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI, QË PËRFITOJNË FINANCIME NGA BUXHETI I SHTETIT DHE MËNYRA E FINANCIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

[141] Kërkuar informacion me shkresën nr. 277 prot., datë 16.1.2023, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 814/1 prot., datë 9.2.2023, protokolluar pranë nesh me nr. 277/3 prot., datë 10.2.2023.

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 110, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën "b", të pikës 2, fjala "...aplikuese..." zëvendësohet me fjalët "...që paraqesin kërkesën...".

2. Në shkronjën "ç", të pikës 4, fjala "...aplikime..." zëvendësohet me fjalët "...për paraqitjen e kërkesës për përfitimin e financimit ...".

3. Në pikën 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën "dh", togfjalëshi "...dorëzimit të aplikimeve...;" zëvendësohet me fjalët "...paraqitjes së kërkesës për përfitimin e financimit...;";

b) në shkronjën "e", fjala "...aplikimit..." zëvendësohet me fjalët "...kërkesës për përfitimin e financimit...".

4. Nënndarja "iii", e shkronjës "a", të pikës 6, shfuqizohet.

5. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Kërkesa për përfitimin e financimit, si dhe të gjitha dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, që i bashkëlidhen kërkesës, paraqiten pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ia përcjell kërkesën komisionit vlerësues menjëherë.".

6. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. Komisioni vlerësues, brenda 7 (shtatë) ditëve nga administrimi i kërkesës për përfitimin e financimit, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kur kërkesa përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatën jofitimprurëse mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit të kritereve;

b) kur kërkesa nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatën jofitimprurëse për plotësimin e të metave brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Mosplotësimi i të metave brenda afatit përbën shkak për mospranimin e kërkesës.".

7. Në pikën 8 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën "a", fjalët "...aplikimeve për financim të organizatave..." zëvendësohen me "...kërkesave për përfitimin e financimit të paraqitura nga organizatat...";

b) në shkronjën "b", fjalët "...për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit, të vendimeve për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara që përfitojnë financim, si edhe të masës së financimit..." zëvendësohen me "...ndaj vendimeve të komisionit vlerësues...".

8. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

"8/1. "Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimeve shqyrtojnë, përkatësisht, kërkesat për përfitimin e financimit dhe ankesat ndaj vendimeve të komisionit vlerësues, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.".

9. Shkronja "c", e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) 1 (një) përfaqësues nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për monitorimin e institucioneve në varësi të saj ose nga Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.".

10. Në pikën 10, fjala "...aplikimeve..." zëvendësohet me fjalët "...kërkesave për përfitimin e financimit...".

11. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"11. Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimit ngrihen me urdhër të ministrit të Drejtësisë jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e njoftimit të thirrjes sipas pikës 5, të këtij vendimi. Emrat e anëtarëve të komisioneve nuk bëhen publikë deri para shpalljes së rezultateve të shqyrtimit të ankesave. Anëtarët e komisioneve sipas pikave 9 dhe 10, të këtij vendimi, zgjidhen nga radhët e nëpunësve civilë.".

12. Në pikën 14 bëhen këto ndryshime:

a) Fjala "...aplikimet..." zëvendësohet me fjalët "... kërkesat për përfitimin e financimit...";

b) Togfjalëshi "...10 (dhjetë) ditëve..." zëvendësohet me "...sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë...".

13. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

"14/1. Komisioni vlerësues vlerëson përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, bazuar në metodologjinë e miratuar me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.".

14. Në pikën 16, fjalët "...i rezultateve për shkelje të procedurave..." shfuqizohen.

15. Në pikën 24, fjala "...revokimin..." zëvendësohet me fjalët "...dhe propozuar shfuqizimin...".

II. Kërkesat për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që janë depozituar pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shqyrtohen sipas dispozitave në fuqi të vendimit në kohën e depozitimit të kërkesës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 11, datë 13.4.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

I. Në nenin 2 "Përkufizime të përgjithshme", shtohen pikat 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14, me përmbajtje si më poshtë:

9. Marrëveshje kuadër donacioni/granti është marrëveshja e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, në të cilën është përcaktuar qartësisht kushti që këto donacione/grante nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.

10. Marrëveshje vjetore donacioni/granti është marrëveshja që bazohet në marrëveshjen kuadër sipas pikës "9" më lart dhe që detajon për vitin në fjalë donacionin/grantin.

11. Projekte konkrete janë projektet e parashikuara në marrëveshjet vjetore të donacionit/grantit dhe që mbulojnë një fushë të caktuar.

12. Zbatuesi i projektit është personi juridik (institucioni/organizata/entiteti), në cilësinë e njësisë zbatuese të projektit, të cilën donatori e ka caktuar si përgjegjës për zbatimin e projektit, të financuar me fonde të marra në bazë të marrëveshjes së donacionit/grantit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në personin fizik që është caktuar si përgjegjës direkt për menaxhimin e këtij projekti.

13. Përfituesi/it i/e projektit nënkupton/jnë personin juridik (institucioni/organizata/entiteti) që është/janë përfituesi/it përfundimtar i donacionit / grantit / punimeve / furnizimeve / shërbimeve, objekt i projektit, të financuar me fonde të marra në bazë të marrëveshjes së donacionit/grantit.

14. Kontraktori është subjekti, i cili kontraktohet, sipas rastit, nga zbatuesi i projektit, ose përfituesi/it i/e projektit, ose edhe vetë donatori i projektit, me qëllim realizimin e projektit.

II. Pas nenit 63 "Rimbursimi për marrëveshjet financiare", shtohet neni 63/1 "Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit" me përmbajtjen si më poshtë:

"Neni 63/1
Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit

1. Në zbatim të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, për qëllime të TVSH-së, trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.

2. Për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së zero për qind, zbatuesi ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), duhet të regjistrohet

për qëllime të TVSH-së dhe të ndjekë procedurën e mëposhtme:

2.1 Regjistrimi në organin tatimor për efekt të TVSH-së i zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorit të projektit

Në mënyrë që skema e parashikuar në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 60, të ligjit të funksionojë, duhet që zbatuesit/përfituesit (kur nuk ka zbatues)/kontraktorët, të jenë të regjistruar për TVSH-në. Regjistrimi për qëllime të TVSH-së mundëson lëshimin e faturave tatimore me TVSH zero për qind për furnizime brenda vendit nga kontraktorët, si dhe pranimin e këtyre faturave nga zbatuesit/përfituesit e projektit. Regjistrimi për TVSH-në mund të bëhet edhe nëpërmjet përfaqësuesit tatimor, sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

2.2 Regjistrimi i zbatuesit/përfituesit të projektit në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)

a) Zbatuesi i projektit ose përfituesi i projektit (kur nuk ka zbatues), regjistrojnë projektin në SASPAC, duke paraqitur:

i. kërkesë me shkrim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet nga marrëveshja e donacionit/grantit të miratuar, e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, në të cilën është përcaktuar qartësisht kushti që donacionet/grantet e parashikuara në marrëveshje, nuk do të përdoren për të paguar tatime;

ii. kopje të aktit me të cilin është miratuar projekti;

iii. çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga SASPAK.

b) SASPAC vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga zbatuesi/përfituesi i projektit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Projektit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, SASPAC njofton menjëherë zbatuesin/përfituesin e projektit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor).

c) Certifikata përmban elementet, si: emërtimi i projektit, data e fillimit dhe data e përfundimit të projektit, vlera fillestare e financimit të projektit, të dhënat e zbatuesit dhe përfituesit të projektit, si dhe Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të lëshuar nga SASPAC për këtë qëllim.

d) SASPAC, një kopje të certifikatës së regjistrimit të projektit, së bashku me kopje të dokumentacionit të parashikuar në shkronjën "a" më sipër, i'a dërgon menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).

e) Në rast të ndryshimit të kushteve të marrëveshjes dhe/ose projektit, zbatuesi/përfituesi i projektit duhet të njoftojë SASPAC, brenda një afati 5 (pesë) ditor. Në këtë rast, SASPAC reflekton ndryshimet në certifikatën e lëshuar dhe ia dërgon menjëherë DPT-së dhe DPD-së.

2.3 Regjistrimi i kontratës/ave në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) përkatëse:

a) DPT, certifikatën e lëshuar nga SASPAC, së bashku me dokumentacionin e dërguar sipas shkronjës "d", të pikës 2.2, më sipër, ia përcjell ditën e nesërme të punës, DRT-së ku është i regjistruar për TVSH-në i kontraktuari i zbatuesit të projektit ose zbatuesi/përfituesi i projektit.

b) Kontraktori/ët dorëzon/jnë pranë DRT-së ku është/janë i/të regjistruar një kopje të noterizuar të kontratës/ave të dakordësuar/a dhe nënshkruar/a me zbatuesin ose me përfituesin e projektit, për rastet kur ky i fundit nuk e delegon projektin tek ndonjë zbatues projekti.

DRT-ja përkatëse regjistron në një regjistër të veçantë kontraktorin/ët dhe/ose zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe brenda 5 (pesë) ditëve pune, lëshon certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, pjesë integrale e këtij udhëzimi. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në përfundimin e projektit, sipas kritereve të parashikuara në marrëveshje.

c) Kodi Unik i Identifikimit të Projektit, i përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga SASPAC, do të evidentohet në çdo faturë të lëshuar me TVSH zero për qind nga kontraktori për zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe në çdo faturë që furnizuesit e mallrave/shërbimeve (qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja) lëshojnë për kontraktorin e miratuar.

d) Në faturat që lëshon, kontraktori duhet të pasqyrojë dispozitën e ligjit, konkretisht, shkronja "c", pika 1, neni 60, sipas së cilës ky furnizim do të trajtohet si furnizim i përngjashëm me eksportet,

me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind, si dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja. Ndërsa, furnizuesit e mallrave/shërbimeve për kontraktorin, qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja, do të pasqyrojnë në faturë numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja.

e) Faturimi i furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

3. Aplikimi i TVSH-së gjatë zbatimit të projektit nga kontraktori

Kontraktori, subjekt i regjistruar për TVSH-në, në zbatim të kontratës së nënshkruar me zbatuesin e projektit, realizon furnizime mallrash/ shërbimesh, të cilat sipas shkronjës "c", pika 1, neni 60, të ligjit, trajtohen si furnizime të përngjashme me eksportet, pra me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind.

4. Deklarimi i transaksioneve për qëllime të TVSH-së nga kontraktori/ët dhe rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve

Kontraktori/ët, furnizimin e mallrave/ shërbimeve të realizuara në zbatim të shkronjës "c", pika 1, neni 60, të ligjit e deklarojnë në librin e shitjeve dhe më pas në formularin e deklarimit të TVSH-së në rubrikën "*Shitje të përngjashme me eksportet*", ndërsa blerjet e realizuara për qëllim të kësaj skeme, në rubrikën "*Blerje të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante*".

Për blerjet e kryera në funksion të realizimit të projektit, qofshin këto blerje me normë standarde apo të reduktuar të TVSH-së, kontraktori gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së, sipas përcaktimeve në nenet 68-84, të kreut IX, të ligjit. Në rast se kontraktori rezulton me tepricë kreditore, i lind e drejta e rimbursimit, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përjashtimi nga TVSH-ja në import

Në zbatim të pikës 45, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, importimi i mallrave të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.

Për qëllime të zbatimit të përjashtimit në import, zbatuesi/përfituesi (kur nuk ka zbatues)/ kontraktuesi i projektit, të cilët mund të kryejnë importe mallrash në kuadër të kësaj skeme, do të pajisen me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Për marrjen e këtij autorizimi, zbatuesi/përfituesi/kontraktuesi i projektit duhet të paraqesë me shkrim pranë DPD-së:

a) kërkesën për përjashtim nga TVSH-ja në importin e mallrave të destinuara për projektin;

b) kopje të Certifikatës së Regjistrimit të Projektit, përfshirë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit;

c) kopje të certifikatës së lëshuar nga DRT-ja;

d) kopje të noterizuar të kontratës/ave ndërmjet zbatuesit/përfituesit me kontraktorin/ët;

e) dokumentin që vërteton përgjegjësinë tatimore të regjistrimit për qëllime të TVSH-së.

DPD-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të kërkesës, shqyrton aplikimin për përjashtim dhe lëshon autorizimin nëse dokumentacioni është i saktë. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, DPD njofton menjëherë subjektin aplikues për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor. Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtimin nga TVSH-ja në import. Ky autorizim regjistrohet në sistemin informatik të DPD-së.

6. Monitorimi dhe kontrolli i furnizimeve për llogari të projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/ granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj

Administrata tatimore monitoron, analizon dhe verifikon furnizimet dhe importet e kryera në kuadër të skemës së parashikuar në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nga:

a) Kontraktorët, të cilët aplikojnë TVSH zero për qind për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve për zbatuesit/përfituesit e projekteve.

b) Zbatuesit/përfituesit e projekteve, të cilët furnizohen me mallra dhe shërbime me TVSH zero për qind nga kontraktorët e tyre.

Administrata tatimore ka detyrimin e kontrollit, verifikimit, kryqëzimit të të dhënave të deklaruara

nga kontraktorët/zbatuesit/përfituesit e projekteve në librat e tyre të shitjeve dhe blerjeve, si dhe në deklaratën e TVSH-së, me qëllim garantimin e trajtimit me TVSH zero për qind vetëm për furnizimet e parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 60, të ligjit.

Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve, kontrollit të tyre dhe rimbursimit të kontraktorëve për rastet kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione dhe subjekte.

III. MODELI I DEKLARATËS SË TVSH-SË DHE LIBRIT TË SHITJEVE DHE LIBRIT TË BLERJEVE

1. Modeli i Deklaratës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, i përcaktuar në nenin 67 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e Deklaratës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Modeli i Librit të Shitjeve dhe Librit të Blerjeve, i përcaktuar në nenin 68 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e Librit të Shitjeve dhe Librit të Blerjeve, sipas këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

Libri i blerjeve
Shoqëria Emri i Shoqërise
NiptiNipti i Shoqërise
VitiViti për të cilin plotësohet libri (yyyy)
MuajiMuaji për të cilin plotësohet libri - muaji nga 1 deri 12
Pa veprimtari Plotëso PO nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Faktura			Shitësi				Blerje																				Të tjera veprime					
r Faturës	umri Serial	D ata (ddmmyyyy)	emri tregtar / personi	nethi	tPT /Kodi Fermerit	Totali (përfshirë TVSH)	T a përjashtuara,me Tvsh ju të zbritshmejna tvsh	Iarje investime brenda vendit pa TVSH	mporte të përjashtuara të investimit pa TVSH	i nport mallra të përjashtuara	Importe mallra me shkallë 20%		Importe mallra me shkallë 10%		Importe mallra me shkallë 6%		Importe të investimit me shkallë 20%		Blerje të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante		Nga Furnitorë Vendas me shkallë 20%		Nga Furnitorë Vendas me shkallë 10%		Nga Furnitorë Vendas me shkallë 6%		Të investimit nga Furnitorë Vendas me shkallë 20%		Nga Fermerët vendas		Autorngarkesë TVSH në blerje me të drejtë kredtime		Rregullime të TVSH-së së zbritshme		Veprime të borxhit të keq	
											lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh	lera e Tatueshme	vsh
		c			h	am[ja]+[ng+gj+[nj+[sh+[zh+[k+[h+[m+[n+[p+[q+[r+[rr+[s+[sh+[t+[th+[u+[v+[x+[y+[z+[zh+(totali)	a		g	i	q																											
Shuma totale						0	0		0	0	0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0	
Kuita sipas Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së							k		k	k	k		k		k		k		k		k		k		k		k		k		k		k		k	
							uita (26)	uita (27)	uita (28)	uita (29)	uita (30)	uita (31)	uita (32)	uita (33)	uita (34)	uita (35)	uita (36)	uita (37)	uita (38)	uita (39)	uita (40)	uita (41)	uita (42)	uita (43)	uita (44)	uita (45)	uita (46)	uita (47)	uita (48)	uita (49)	uita (50)	uita (51)	uita (52)	uita (53)	uita (54)	uita (55)

Emri Mbiemri

Shpjegim:
Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/ mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen / rreshtat nga 1 në 12.
Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve.

Libri i shitjeve
Shoqëria Emri i Shoqërisë
NiptiNipti i Shoqërisë
VitiViti për të cilin plotësohet libri (yyyy)
MuajiMuaji për të cilin plotësohet libri - muaji nga 01 deri 12
Pa veprimtari Plotëso PO nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Fatura			Blerësi			Totali Shitjeve	Shitjet e përjashtuara	Shitjet pa TVSH	Shitje të përngjashme me eksportet	Eksporte mallrash	Furnizime me 0%	Shitje me shkallë 20%		Shitje me shkallë 10%		Shitje me shkallë 6%		Shitje regjimi aqjentëve të udhëtimit/ marzhi fitimit /shitje në ankand		Autongarkesë TVSH në shitje		Borxh i keq	
Nr Faturës	Numri Serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar /personi	Rrethi	NIPT							Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh
a	b	c	ç	d	dh	e=(ë+f+g+gj+h+i+j+k+l+ll+m+n+nj+o+p+q+r)	ë	f	g	gj	h	i	j= (i) x 20%	k	l = (k)x 10%	ll	m = (ll)x 6%	n	nj = (n) x 20%)	o	p = (o) x 20/10/6 %)	q	r = (q) x 20/10/6 %)
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
						0							0		0		0		0				
Shuma totale						0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kutia sipas Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së							kutia (9)	kutia (10)	kutia (11)	kutia (12)	kutia (13)	kutia (14)	kutia (15)	kutia (16)	kutia (17)	kutia (18)	kutia (19)	kutia (20)	kutia (21)	kutia (22)	kutia (23)	kutia (24)	kutia (25)

Emri Mbiemri

Shpjegim:
Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/ mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen / rreshtat nga 1 në 12.
Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve.

DEKLARATA E TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT):	**(3)**
Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:	**(4)**
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	**(5)**
Adresa:	**(6)**
Qyteti/Komuna/Rrethi:	**(7)**
Numri Telefonit:	

Informacioni i mësipërm (rubrikat 4, 5,6,7) duhet të jetë i saktë dhe i azhornuar.

☐ **[8] Shënoni 'X' nqs gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.**

TVSH e llogaritur për muajin	Vlera e tatueshme	TVSH e llogaritur
(9) Shitje të përjashtuara	(9) 0	
(10) Shitje pa TVSH	(10) 0	
(11) Shitje të përngjashme me eksportet	(11) 0	
(12) Eksporte mallrash	(12)	
(13) Furnizime me shkallë 0%	(13) 0	
(14) Shitje të tatueshme (me shkallë 20%)	(14) 0	(15) 0
(16) Shitje të tatueshme (me shkallë 10%)	(16) 0	(17) 0
(18) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)	(18) 0	(19) 0
(20) Shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhetimit/ të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand (20%)	(20) 0	(21) 0
(22) Autongarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge) (22 x20%)	(22) 0	(23) 0
(24) Borxhi i keq	(24) 0	(25) 0
(26) Totali TVSH-së së llogaritur {(15)+(17)+(19)+(21)+(23)+(25)}		(26) 0

TVSH e zbritshme për muajin	Vlera e tatueshme	TVSH e zbritshme
(27) Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH	(27) 0	
(28) Blerje investimi brenda vendit pa TVSH	(28) 0	
(29) Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH	(29) 0	
(30) Import mallra të përjashtuara nga TVSH	(30) 0	
(31) Import mallra me shkallë tatimore 20%	(31) 0	(32) 0
(33) Import mallra me shkallë tatimore 10%	(33) 0	(34) 0
(35) Import mallra me shkallë tatimore 6%	(35) 0	(36) 0
(37) Importe te investimit me TVSH 20%	(37) 0	(38) 0
(39) Blerje të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante 20%	(39) 0	(40) 0
(41) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 20%	(41) 0	(42) 0
(43) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 10%	(43) 0	(44) 0
(45) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 6%	(45) 0	(46) 0

(47) Blerje të Investimit Brenda vendit me TVSH 20%	(47) 0	(48) 0
(49) Blerje nga fermerët vendas	(49) 0	(50) 0
(51) Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)	(51) 0	(52) 0
(53) Rregullime të TVSH-së së zbritshme	(53) 0	(54) 0
(55) Borxhi i keq	(55)	(56)
(57)Totali TVSH-së së zbritshme {(32)+(34)+(36)+(38)+(40)+(42)+(44)+(46)+(48)+(50)+(52)+(54)+(56)}		(57) 0
(58) Teprica e TVSH-së së zbritshme për muajin {(26)-(57)} nqs {(26)<(57)}		(58) 0
(59) TVSH I DETYRUESHËM PËR T'U PAGUAR {(26)-(57)} nqs {(26)>(57)}		(59) 0

Data dhe Firma e Personit të Tatueshëm - Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

Deklaratë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (DTVSH)

1. Numri serial perdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhornuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata.

2. Periudha Tatimore është muaji i paraqitur nga dita e parë deri në ditën e fundit.Të gjitha transaksionet (Shitjet, Blerjet) dhe llogaritjet mujore të TVSH-së të kryera gjatë kësaj periudhe duhet te perfshihen ne kete deklaratë.

Të dhëna të Personit të Tatueshëm

3. Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT/NUIS) është numri i vetëm që ju përfaqëson dhe identifikon në të gjitha marrëdhëniet me Administratën Tatimore Qendrore. Nipt/ Nuis duhet të vendoset detyrimisht në çdo faturë që lëshoni ose merrni.

4. Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm është emri tregtar me të cilin ju jeni regjistruar në QKR ose Drejtorinë Rajonale Tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe që tregohet në certifikatën tuaj të regjistrimit si NIPT/NUIS.

5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një Person Fizik dhe nuk ka emër tregtar.

6. Adresa tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuaj ekonomike. Kjo adresë është e treguar edhe në çertifikatën tuaj të NIPT/NUIS.

7. Numri i Telefonit (nqs keni) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuajekonomike.

Shënim. Nëqoftëse ndonjë nga të dhënat e rubrikave 4,5,6,7 ka ndryshuar, jeni të detyruar të deklaroni në kohë, çdo ndryshim pranë QKR-së ose Drejtorisë Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.

8. Nëqoftëse ju nuk keni kryer asnjë transaksion gjatë muajit, shënoni një ‘/’ në kutinë 8. Sipas mënyrës së deklarimit, plotësoni datën dhe firmosni dukе deklaruar në këtë mënyrë që informacioni i dhënë në deklaratë është i plotë dhe i saktë.

TVSH e llogaritur për muajin

9. Nga kolona **“ë”** -Shitje të **përjashtuara”** e librit tuaj të shitjeve nxirmi totalin e të gjithë shitjeve të pashtuara të muajit dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet e përjashtuara sipas Kapitullit 8 seksioni 1 të ligjit, për të cilat nuk llogaritet TVSH.

10. Nga kolona **“f”**- **“Shitje** pa TVSH’ e librit tuaj të shitjeve nxirmi totalin e të gjithë shitjeve pa TVSH të muajit dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitje të patatueshme në Shqipëri për të cilat nuk llogaritet TVSH.

11. Nga kolona **“g”**- **“Shitje të përngjashme me eksportet”** të librit tuaj të shitjeve nxirmi totalin e të gjithë shitjeve.

12. Nga kolona **“gj”**- **“Eksporte mallrash”** të librit tuaj të shitjeve nxirmi totalin e të gjithë eksporteve të mallrave me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 12 të Deklaratës tuaj. Furnizimet Eksporte sipas nenit 57 të ligjit tatohen me shkallë 0%

13. Nga kolona **“h”**- **“Furnizime** me shkallë **0%”** e librit tuaj të shitjeve nxirmi totalin e të gjithë furnizimeve me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 13 të Deklaratës tuaj, furnizime sipas Kapitullit 8 Seksioni 3 përveç eksportit të mallrave që deklarohet ne kutine 12.

14. Nga kolona **“i”**- **“Vlera** e Tatueshme për shitje me shkallë **20%”** nxirmi totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit të cilat sipas ligjit që i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 20%. dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)

15. Nga kolona **“j”** e Librit të shitjeve **“TVSH** për shitje me shkallë **20%”**, nxirmi totalin e tvsh-së për muajin për shitjet me shkallë 20% dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 15 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 14.(vlera +/-)

16. Nga kolona ‘k e Librit të shitjeve ‘9 ïši– e Tatueshme për shitje me shkallë ŁELI’ nxirmi totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit, të cilat sipas ligjit, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 10% dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 16 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)

17. Nga kolona ‘l e Librit të shitjeve ‘79 é+ për shitje me shkallë 10%, nxirmi totalin e TVSH- së për muajin për shitjet me shkallë 10% dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 16 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 16. (vlera +/-).

18. Nga kolona rll e Librit të shitjeve r9 ïši– e Tatueshme për shitje me shkallë ELI’ nxirmi totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit, të cilat sipas ligjit, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 6% dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 18 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)

19. Nga kolona :m‘ e Librit të shitjeve r7VSH për shitje me shkallë 6%, nxirmi totalin e TVSH- së për muajin për shitjet me shkallë 6% dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 19 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 18. (vlera +/-).

20. Nga kolona **“n”** e Librit të shitjeve **“Vlera** e Tatueshme për Shitje sipas regjimit te agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitimit /shitje në **ankand”** nxirmi totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 20 të Deklaratës tuaj. Këto shitje të tatueshme i nënshtrohen shkallës 20% të TVSH-së.

21. Nga kolona **“nj”** e Librit të shitjeve **“TVSH** për Shitje regjimi agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitimit /shitje në **ankand”**, nxirmi totalin e TVSH-së të shitjeve për muajin dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 21 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 21 duhet të jetë e barabartë me 20 % të vlerës së paraqitur në kutinë 20.

22. Nga kolona **“o”** e Librit të shitjeve **“Vlera** e Tatueshme për Autongarkesë TVSH në **shitje”** nxirmi totalin per transaksionet për të cilat llogariten autongarkesë TVSH në shitje të bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 22 të Deklaratës tuaj. Këto transaksionе deklarohen sipas shkallës tatimore standarte dhe/ose të reduktuar të TVSH-së në shitje sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

23. Nga kolona **“p”** e Librit të shitjeve **“TVSH** e autongarkuar në shitje ”, nxirmi totalin e TVSH-së për transaksionet për të cilat llogaritet autongarkesë TVSH në shitje per muajin dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 23 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 23 duhet të jetë e barabarte me vlerën e kutisë 22 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

24. Nga kolona **“q”** e Librit të shitjeve **“Vlera** e Tatueshme për veprime te Borxhit e **keq”** nxirmi totalin per muajin të transaksioneve sipas nenit 84 të Ligjit, dhe vendoseni në kutinë 24 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatueshme e TVSH-së është sipas legjislacionit tatimor në fuqi (vlera +/-)

25. Nga kolona **“r”** e Librit të shitjeve **“TVSH** për veprime të Borxhit e **keq”**, nxirmi totalin e TVSH-së për arkëtimet e Borxhit të keq për muajin dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 25 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 25 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 24 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/osetë reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

26. Llogarisni totalin e TVSH së mbledhshmepër muajin, dukе mbledhur TVSH e llogaritur për Shitje të tatueshme me 20% (kutia15); Shitje të tatueshme me 10% (kutia 17); Shitje të tatueshme me 6% (kutia 19); TVSH e llogaritur për shitje të tatueshme sipas regjimeve te agjentit udhetimi/marzhit fitimit/ shitje në ankand, me 20 % (kutia 21); TVSH e llogaritur për transaksionet e blerjes se shërbimeve nga persona jo rezident e autongarkuar në shitje me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 23), TVSH e mbledhshme nga veprime te Borxhit të keq me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 25). Shumën plotësojeni në kutinë 26. (vlera +/)

TVSH e zbritshme gjatë Muajit

27. Nga kolona **“ë”** e Librit tuaj të Blerjeve **”Blerje** të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh”, nxirmi totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 27 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, përveç blerjeve të filla të kryera për investime te cilat regjistrohen veçmas në kutinë 28. Për blerjet me TVSH jo të zbritshme nuk do të bëhet zbritje e TVSH.

28. Nga kolona **“f”**e Librit tuaj të Blerjeve-**”Blerje** investime brenda vendit pa **TVSH”.** Këtu regjistrohen vetëm blerjet e kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit të kryera brenda vendit dhe pa Tvsh si p.sh. blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, për investime. Nxirmi totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 28 të Deklaratës tuaj.

29. Nga kolona **“g”**e Librit tuaj të Blerjeve-**”Importe** të përjashtuara të investimit pa **TVSH”**, nxirmi totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 29 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëmimportet e kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit.

30. Nga kolona **“gj”**e Librit tuaj të Blerjeve-**”Import** mallra të **përjashtuara”**, nxirmi totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 30 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistro- hen të gjitha importet e mallrave të përjashtuara nga TVSH, përveç importeve të perjashtuara për investime të cilat regjistrohen veçmas në kutinë 29

31. Nga kolona **“h”**-**“Vlera** e Tatueshme e Importe mallra me shkallë **20%”** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirmi totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përfluar, në kutinë 31 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 37.

32. Nga kolona **“i”**- **“TVSH** në Import për mallra me shkallë **20%“** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 32 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 32 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 31.

33. Nga kolona **“j”**-**“Vlera** e Tatueshme e Importe mallra me shkallë **10%”** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirmi totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 10% dhe plotësoni shumën e përfluar, në kutinë 33 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 10%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 37.

34. Nga kolona **“k”**- **“TVSH** në Import për mallra me shkallë **10%“** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 34 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 34 duhet të jetë e barabartë me 10% te vlerës së kutisë 33.

35. Nga kolona **“l”**-**“Vlera** e Tatueshme e Importe mallra me shkallë **6%”** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirmi totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 6% dhe plotësoni shumën e përfluar, në kutinë 35 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 6%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 37.

36. Nga kolona **“ll”**- **“TVSH** në Import për mallra me shkallë **6%“** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 36 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 36 duhet të jetë e barabartë me 6% te vlerës së kutisë 35.

37. Nga kolona **“m”**-**“Vlera** e Tatueshme e Importe investimi me shkallë **20%”** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirmi totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përfluar, ne kutinë 37 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20% te kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, te cilat deklarohen në kutinë 37 .

38. Nga kolona **“n”**- **“TVSH** në Import për investimi me shkallë **20%“** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e TVSH-së në import për mallrat të investimit dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 38 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 38 duhet të jetë e barabartë me 20% te vlerës së kutisë 37.

39. Nga kolona **“nj”-Blerje të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante,** te librit tuaj te blerjeve, per muajin, nxirmi totalin e vlerës së tatueshme te blerjeve me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përfluar, në kutinë 39 të Deklaratës tuaj.

40. Nga kolona **“o“-“TVSH** në Blerje të **destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante** me shkallë **20%“** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e TVSH-së në blerje te destinuara per realizimin e projekteve dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 40 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 40 duhet të jetë e barabartë me 20% te vlerës së kutisë 39.

41. Nga kolona **“p“**-Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë **20%”** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 41 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutine 47.(vlera +/-)

42. Nga kolona **“q”**- **“TVSH** për blerje nga furnitorë vendas me shkallë **20%”** e Librit tuaj të Blerjeve, mblidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 42 të Deklaratës tuaj.Vlera në kutinë 42 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 41.(vlera +/-)

43. Nga kolona **“r“**-Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë **10%”** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 43 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutine 47.(vlera +/-)

44. Nga kolona **“rr”**- **“TVSH** për blerje nga furnitorë vendas me shkallë **10%”** e Librit tuaj të Blerjeve, mblidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 44 të Deklaratës tuaj.Vlera në kutinë 44 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së kutisë 43.(vlera +/-)

45. Nga kolona **“s“**-Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë **6%”** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 45 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutine 47.(vlera +/-)

46. Nga kolona **“sh”**- **“TVSH** për blerje nga furnitorë vendas me shkallë **6%”** e Librit tuaj të Blerjeve, mblidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 46 të Deklaratës tuaj.Vlera në kutinë 46 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së kutisë 45.(vlera +/-)

47. Nga kolona **“t“**- Vlera e tatueshme per blerje te investimit nga furnitore vendas me shkallë **20%”** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirmi totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 47 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm blerjet brenda vendit te kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit.(vlera +/-)

48. Nga kolona **“th”**- **“TVSH** për blerje të investimit nga furnitorë vendas me shkallë **20%”** e Librit tuaj të Blerjeve, mblidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 48 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 48 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 47.(vlera +/-)

49. Nga kolona **“u”**-**“Vlera** e tatueshme e blerjeve nga fermerët **vendas”** e Librit tuaj të Blerjeve nxirmi totalin e këtyre blerjeve nga fermerët e identifikuar me NIPT por jo te regjistruar per TVSH-ne dhe plotesoni shumën e përfluar në kutinë 49 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatuar nga blerësi për këto blerje është 6% për periudhat deri në Dhjetor 2021 (përfshirë), dhe 0% duke filluar nga Janar 2022.

50. Nga kolona **“v”**-**“TVSH** i zbritshëm, kompensimi i **fermerëve”** e Librit tuaj të Blerjeve, mblidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 47 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 50 duhet të jetë e barabartë me 6% per periudhat deri në Dhjetor 2021 (përfshirë), dhe 0% duke filluar nga Janar 2022., të vlerës së kutisë 49.

51. Nga kolona **“x”** e Librit te blerjeve **“Vlera** e Tatueshme për Autongarkesë TVSH në **blerje”** nxirmi totalin për transaksionet e blerjes së shërbimeve nga persona jo rezident ne Shqipëri për të cilat llogariten autongarkese TVSH në shitje, te bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 51 të Deklaratës tuaj. Shkalla e TVSH-së e zbatuar është sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

52. Nga kolona **“xh”** e Librit të blerjeve **“TVSH** e autongarkuar në blerje ”, nxirmi totalin e tvsh- së për muajin të transaksioneve për të cilat llogaritet autongarkesë TVSH në blerje dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 52 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 52 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 51 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi .

53. Nga kolona **“y”** e Librit të blerjeve **“Vlera** e Tatueshme për Rregullim të TVSH së **zbritshme”** nxirmi totalin për rregullimet e TVSH-së të kryera gjatë muajit, sipas neneve 78-83 dhe 73 pika 3 të Ligjit, dhe plotësoni shumën e përfluar në kutinë 53 të Deklaratës tuaj. Shkalla e TVSH- se e zbatuar eshte sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

54. Nga kolona **“z”** e Librit të blerjeve **“TVSH e Rregulluar”**, nxirmi totalin e tvsh-së për rregullime të TVSH për muajin dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 51 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 54 duhet të jetë e barabarte me vlerën e kutisë 53 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.(vlera +/-)

55. Nga kolona **“zh”** e Librit te blerjeve **“Vlera** e Tatueshme të Borxhit e **keq”** nxirmi totalin e vlerave të transaksioneve të borxhit të keq dhe regjistrojeni në kutinë 55 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen tatueshme të borxhit të keq me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar të TVSH-së sipas legjislacionit tatimor në fuqi.(vlera +/-)

56. Nga kolona **“zha”** e Librit te blerjeve **“TVSH** për veprime të Borxhit e **keq”**, nxirmi totalin e tvsh-së për faturimet e Borxhit të keq për muajin dhe shumën e përfluar vendoseni në kutinë 53 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 56 duhet të jetë e barabarte me vlerën e kutisë 55 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/osetë reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.(vlera +/-)

57. Llogarisni totalin e TVSH së zbritshëm për muajin, dukе mbledhur TVSH e zbritshme për Importet mallra me shkallë 20% (kutia 32); TVSH e zbritshme për Importet mallra me shkalle 10% (kutia 34); TVSH e zbritshme për Importet mallra me shkalle 6% (kutia 36); TVSH e zbritshme për Importet te investimeve me shkalle 20% (kutia 38);TVSH e zbritshme për Blerjet nga furnizuesit të **destinuara për realizimin e projekteve të financuara me donacione/grante** me shkallë 20% (kutia 40), TVSH e zbritshme për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkalle 10% (kutia 42), TVSH e zbritshëm për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkalle 6% (kutia 44), TVSH e zbritshëm për Blerjet per investime nga furnizuesit vendas me shkalle 20% (kutia 46);TVSH (kompensimi) i paguar për blerjet nga fermerët (kutia 48);TVSH e llogaritur për transaksionet e blerjes se shërbimeve nga persona jo rezident e autongarkuar në blerje me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 50), TVSH e rregulluar me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar sipas kutisë (52) TVSH e zbritshme nga veprime të Borxhit të keq me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 54). Shumën plotësojeni në kutinë 56. (vlera+/-)

Rezultati i TVSH për muajin

58. Në kutinë 58 të Deklaratës llogaritet Tepricë e TVSH-së zbritshme për muajin, zbritur vlerën e kutisë 57 nga vlera e kutisë 26, nqs totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 57) është më i madh se TVSH i llogaritur për shitjet e muajit te paraqitura ne kutinë 26. Pra keni si rezultat Tepricë të TVSH së zbritshme per muajin dhe nuk duhet të bëni pagesë TVSH në këtë muaj.

59. Në kutinë 59 të Deklaratës llogaritet TVSH e detyrueshëm për tu paguar duke zbritur vlerën e kutisë 57 nga vlera e kutise 26, nqs shuma e TVSH-së së llogaritur për muajin me shkallë tatimore standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi, në kutinë 26 të deklaratës është më i madh se totali i TVSH të zbritshme për muajin (kutia 57), pra keni rezultuar me TVSH të detyrueshme për tu paguar

Shënime : Mbi plotësimin e Deklaratës së TVSH- së

Kjo deklaratë është konceptuar në bazë të Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe është e përshtatshme për të kryer deklarimin e TVSH-së sipas mënyrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Deklarata duhet të plotësohet dhe deklarohet në mënyrë elektronike brenda datës 14 të muajit pasardhës të muajit të treguar në deklaratë. Pagesa e TVSH-së bëhet me Urdhër pagese në bankë ose në mënyrë elektronike (nëse është e mundur pagesa elektronike) brenda datës 14 të muajit pasardhës të muajit të treguar në Deklaratë si periudhë tatimore. Urdhërpagesa do t'ju gjenerohet automatikisht nqs aktivi pasë të keni plotësuar dhe dërguar këtë deklaratë. Nqse ju keni pagesë për të bërë dhe e bëni këtë pagesë të plotë brenda afatit nuk ju aplikohen kamatevonese ose gjoba për mospagesë në afat të vlerës së pagesës. Nqs bëhet një pagesë e pjesshme ose një pagesë e vonuar, detyrimit tuaj sipas kutisë 59 të kësaj deklarate i shtohen gjobat dhe interesi përkatëse nga data që detyrimi duhej paguar deri në datën kur kryhet pagesa.Vendosni datën e plotësimit të Deklaratës, dhe dërgojeni deklaratën në mënyrë elektronike, ku një kopje e kësaj deklarate do t'ju rishtet në llogarinë tuaj si tatimpagues. Për më shumë informacion lexoni aktet ligjore dhe nenligjore per TVSH-ne, (Ligjin dhe Udhëzimin e TVSH-se etj) ose merrni kontakt me Drejtorine Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

CERTIFIKATË REGJISTRIMI TË PROJEKTIT/KONTRATËS PËR EFEKT TË TRAJTIMIT SI FURNIZIM I PËRNGJASHËM ME EKSPORTET

Formular 7A

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE _____

Numri i Certifikatës në regjistrin e DRT-së: _____

1. Emri i zbatuesit/përfituesit të projektit:		2. NIPT:	
3. Data e fillimit të projektit/kontratës:		4. Data e mbarimit të projektit/kontratës:	
5. Titulli i projektit/kontratës:		6. Donatori i grantit:	

7. Lista e bashkëaplikuesve në certifikatë (kur është e aplikueshme)

Statusi në kontratë	Emri	NIPT	Kontrata	Kontrollori/konfirmuesi i shpenzimeve
Kontraktor 1	xxxxx	yyyyyy		
Kontraktor 2				
.....				

8. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar që parashikon mospërdorimin e fondeve për të paguar tatime (referenca e nenit dhe ligjit ratifikues)	

DREJTORI **Nënshkrimi**: _____	**Data**: _____

Kjo certifikatë lëshohet në zbatim të nenit 60, pika 1, gërma c), e ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar dhe nenit 63/1 të udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar.

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 45, datë 12.4.2023

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR APLIKIM PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE NËPËRMJET PROGRAMIT TË VEÇANTË TË SHTETËSISË NË FUSHËN E ARTIT, KULTURËS, ARSIMIT, SHKENCËS DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", vendimit nr. 1008, datë 25.11.2020 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë" dhe të shkronjës "c" të pikës 1, të vendimit të nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore", ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për veprime dhe shërbime që kryhen nga Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë janë si më poshtë:

a) tarifë për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës;

b) tarifë për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës e sportit.

2. Tarifat e shërbimit (pagesat) për shërbimet e pikës 1 të këtij udhëzimi përcaktohen në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve administrative.

4. Tarifa paguhet në emër të Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë dhe derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

5. Ngarkohen Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

SHTOJCË NR. 1

Tarifat për veprime dhe shërbime që kryhen nga Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë janë përkatësisht:

a) tarifa për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës: 7 500 lekë;

b) tarifa për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës e sportit: 7 500 lekë.

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 46, datë 13.4.2023

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA, AFATIT, SI DHE ORGANIT KOMPETENT PËR ASGJËSIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 215, pika 6, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Brendshëm,

UDHËZOJNË:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi është:

a) përcaktimi i organit kompetent për asgjësimin e sendeve të sekuestruara;

b) përcaktimi i llojit të sendeve të sekuestruara të cilat do t'i nënshtrohen procedurës së asgjësimit;

c) përcaktimi afatit për mbajtjen dhe asgjësimin e sendeve të sekuestruara.

II. ORGANI KOMPETENT PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA

1. Në rastet kur gjykata urdhëron asgjësimin e sendeve të sekuestruara, prokurori, jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni mbi urdhrin përkatës, ngre Komisionin e Asgjësimit të Sendeve (organi kompetent), për vijimin e procedurave të asgjësimit.

2. Komisioni përbëhet nga:

a) oficeri i policisë gjyqësore,

b) një përfaqësues nga Policia e Shtetit,

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, dhe

ç) një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Kur është e mundur, anëtar i Komisionit është edhe një ekspert kriminalist i cili dokumenton procesin e asgjësimit me mjete audiovizive.

4. Anëtarët e përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, caktohen nga radhët e punonjësve të kualifikuar në fushën përkatëse për të cilën kërkohet asgjësimi.

5. Kur kërkohen njohuri të posaçme, për shkak të nevojave dhe kompleksitetit të çështjes, komisioni mund të asistohet edhe nga ekspertë të jashtëm.

III. PËRCAKTIMI I AFATIT PËR MBAJTJEN DHE ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA

1. Komisioni i Asgjësimit të Sendeve kryen procedurat e asgjësimit të sendeve të sekuestruara, menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga njoftimi i urdhrit.

2. Në rast të pamundësisë së ekzekutimit të urdhrit të organit procedues, apo të respektimit të këtij afatit, Komisioni i dërgon organit procedues një relacion ku argumenton arsyet e mosekzekutimit të urdhrit, apo të mosrespektimit të afatit. Për vijimin e procedurave të mëtejshme, komisioni vepron sipas urdhërimeve përkatëse të organit procedues.

IV. PËRCAKTIMI I PROCEDURËS PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË SEKUESTRUARA

1. Sende të sekuestruara në kuptim të këtij udhëzimi do të jenë ato sende të cilat mund të ndryshojnë ose sendet e ndaluara për t'u prodhuar, zotëruar, mbajtur apo tregtuar, në rast se ruajtja e tyre është e vështirë, veçanërisht e kushtueshme ose përbën rrezik për sigurinë, shëndetin apo higjienën publike.

2. Mënyra e asgjësimit të sendeve të sekuestruara, përcaktohet rast pas rasti nga komisioni, në varësi të llojit të sendeve për të cilat është vendosur asgjësimi, me kusht që procesi teknik i asgjësimit:

a) të kryhet në mënyrë që të garantohet siguria e jetës dhe shëndetit të pjesëmarrësve gjatë procesit, si dhe të popullatës;

b) të mos ketë pasoja të dëmshme mbi mjedisin.

3. Asgjësimi i sendeve të sekuestruara bëhet me djegie në inceneratorin e ndërtuar për këtë qëllim, por në varësi të llojit dhe sasisë, si dhe në mungesë të inceneratorit përcaktohet një vend i përshtatshëm për kryerjen e asgjësimit, i cili plotëson kriteret sipas legjislacionit në fushën e mjedisit.

4. Në çdo rast asgjësimi, përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë udhëzon Komisionin mbi mënyrën e asgjësimit me qëllim shmangien e dëmtimeve në shëndetin e personave që marrin pjesë në procesin e asgjësimit.

5. Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, udhëzon komisionin mbi mënyrën dhe vendin e asgjësimit, me qëllim shmangien e dëmtimit në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

6. Procedura e dokumentimit të veprimeve të kryera për asgjësimin e sendeve të sekuestruara, të bëhet sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për problemet, që do të lindin gjatë zbatimit të këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen organet e parashikuara në pikën 2, të kreut II të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR
Nr. 80, datë 9.2.2023

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË VEÇANTË PËR APLIKIMIN E AUTONOMISË SPITALORE DHE PËRCAKTIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 17, pika 4, dhe nenit 19, pika 1, të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë"; dhe të vendimit nr. 72, datë 8.2.2023, "Për miratimin e rregullores së autonomisë spitalore",

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit të veçantë për aplikimin e spitaleve publike që duan të përfitojnë autonominë spitalore menaxheriale dhe financiare, sipas shtojcës A1 dhe A2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Miratimin e sistemit të pikëzimit për vlerësimi e aplikimeve të spitaleve publike që duan të përfitojnë autonominë spitalore menaxheriale dhe financiare, sipas shtojcës B1 dhe B2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe spitalet autonomë të cilët kërkojnë t'u jepet statusi i spitalit autonom për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA A1
FORMULAR PËR APLIKIMIN E AUTONOMISË SPITALORE MENAXHERIALE

Nr.	**INFORMACION MBI APLIKUESIN**		
1	**Emri i spitalit**		
2	**Data e aplikimi**		
3	**Vendndodhja e spitalit**		
4	**Përfaqësues i spitalit (ekipi menaxhues)**		
Përgjigjuni me "po" ose "jo" çdo pyetjeje duke specifikuar, sipas rastit, numrin dhe datën e akteve përkatëse		**PO**	**JO**
5	**AKREDITIMI I SPITALIT**		
5.1	*Certifikata e akreditimit bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
6	**STRATEGJIA 3-VJEÇARE PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT SPITALOR E MIRATUAR**		
6.1	*Vendimi i Bordit Drejtues për miratimin e Strategjisë bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
6.2	*Strategjia 3-vjeçare për zhvillimin e shërbimit spitalor bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
7	**RAPORT I AKTIVITETIT SPITALOR DHE INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS PËR ÇDO SHËRBIM/KLINIKË/NJËSI MJEKËSORE PËR 3 VITET E FUNDIT**		
7.1	*Rregullorja e brendshme e spitalit bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
7.2	*Procedurat standarde operacionale për shërbimet spitalore bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
8	**TREGUES SPITALORË**		
8.1	*Treguesit e shërbimit spitalor bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
8.1.1	*Shkalla e zënies së shtretërve në masën 60%*		
9	**PROTOKOLLET DHE UDHËRRËFYESIT MJEKËSORË**		
9.1	*Lista e protokolleve dhe udhërrëfyesve të miratuar bashkëlidhur këtij formulari*		
10	**RAPORT MBI SHFRYTËZIMIN E KAPACITETIT SPITALOR**		
11	**PROPOZIM PËR PËRMIRËSIMIN**		
11.1	*Plan për përmirësimin e aktivitetit spitalor*		
11.2	*Plan për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, strukturën organizative dhe organizimin e praktikës së dyfishtë për 2 vitet pasuese*		

SHTOJCA A2
FORMULAR PËR APLIKIMIN E AUTONOMISË SPITALORE FINANCIARE

Nr.	INFORMACION MBI APLIKUESIN		
1	**Emri i spitalit**		
2	**Data e aplikimi**		
3	**Vendndodhja e spitalit**		
4	**Përfaqësues i spitalit (ekipi menaxhues)**		
Përgjigjuni me "po" ose "jo" çdo pyetjeje duke specifikuar, sipas rastit, numrin dhe datën e akteve përkatëse		**PO**	**JO**
5	**APLIKIMI I AUTONOMISË MENAXHERIALE PËR 2 VJET**		
5.1	*Karta e Autonomisë Menaxheriale bashkëlidhur këtij formulari*		
5.2	*Raport krahasues i indikatorëve të performancës para dhe pas aplikimit të autonomisë menaxheriale bashkëlidhur këtij formulari*		
6	**STRATEGJIA 5-VJEÇARE E ZHVILLIMIT TË SPITALIT, MENAXHIMIT FINANCIAR DHE INVESTIMEVE**		
6.1	*Vendimi i Bordit Drejtues për miratimin e Strategjisë bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
6.2	*Strategjia 5-vjeçare për zhvillimin e spitalit, menaxhimit financiar dhe investimeve bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
7	**INDIKATORËT E PERFORMANCËS PËR MBULIMIN E SHËRBIMIT MJEKËSOR PËR 3 VITET E ARDHSHME**		
8	**RREGULLORJA EKONOMIKO–FINANCIARE**		
9	**PAKETAT BAZË SHËNDETËSORE TË KOSTIFIKUARA**		
10	**PLAN VEPRIMI PËR OPTIMIZIMIN E KAPACITETEVE PËR TË GJENERUAR TË ARDHURAT DYTËSORE**		
11	**MBULIMI I MBI 70% TË NEVOJAVE PËR KUJDES SHËNDETËSOR NË TERRITORIN QË AI MBULON**		
12	**RAPORT I SITUATËS SË QËNDRUESHME FINANCIARE PËR 3 VITET E FUNDIT**		

SHTOJCA B1
VLERËSIM I PIKËZUAR PËR APLIKIMIN E AUTONOMISË MENAXHERIALE

Vlerësimi nga Komisioni për vlerësimin e përmbushjes së kritereve për përfitimin e autonomisë bëhet bazuar në sistemin e pikëzimit.

Pikët maksimale janë 100 pikë.

Vlerësimi i pikëve bëhet si vijon:

Nr.	VLERËSIM I PIKËZUAR PËR APLIKIMIN E AUTONOMISË MENAXHERIALE		
		Pikët maksimale	**Pikët e vlerësuara nga Komisioni**
1	**AKREDITIMI I SPITALIT**	**5**	
5.1	*Certifikata e akreditimit bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
2	**STRATEGJIA 3-VJEÇARE PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT SPITALOR E MIRATUAR**	**15**	
6.1	*Vendimi i Bordit Drejtues për miratimin e Strategjisë bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
6.2	*Strategjia 3-vjeçare për zhvillimin e shërbimit spitalor bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
3	**RAPORT I AKTIVITETIT SPITALOR DHE INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS PËR ÇDO SHËRBIM/KLINIKË/NJËSI MJEKËSORE PËR 3 VITET E FUNDIT**	**20**	

7.1	*Rregullorja e brendshme e spitalit bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
7.2	*Procedurat standarde operacionale për shërbimet spitalore bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
4	**TREGUES SPITALORË**	**30**	
8.1	*Treguesit e shërbimit spitalor bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
5	**PROTOKOLLET DHE UDHËRRËFYESIT MJEKËSORË**	**10**	
9.1	*Lista e protokolleve dhe udhërrëfyesve të miratuar bashkëlidhur këtij formulari*		
6	**RAPORT MBI SHFRYTËZIMIN E KAPACITETIT SPITALOR**	**10**	
7	**PROPOZIM PËR PËRMIRËSIMIN**	**10**	
11.1	*Plan për përmirësimin e aktivitetit spitalor*		
11.2	*Plan për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, strukturën organizative dhe organizimin e praktikës së dyfishtë për 2 vitet pasuese*		

SHTOJCA B2

VLERËSIM I PIKËZUAR PËR APLIKIMIN E AUTONOMISË FINANCIARE

Vlerësimi nga Komisioni për vlerësimin e përmbushjes së kritereve për përfitimin e autonomisë bëhet bazuar në sistemin e pikëzimit

Pikët maksimale janë 100 pikë.

Vlerësimi i pikëve bëhet si vijon:

Nr.	**VLERËSIM I PIKËZUAR PËR APLIKIMIN E AUTONOMISË FINANCIARE**		
		Pikët maksimale	**Pikët e vlerësuara nga Komisioni**
1	**APLIKIMI I AUTONOMISË MENAXHERIALE PËR 2 VJET**	10	
1.1	*Karta e Autonomisë Menaxheriale bashkëlidhur këtij formulari*		
1.2	*Raport krahasues i indikatorëve të performancës para dhe pas aplikimit të autonomisë menaxheriale*		
2	**STRATEGJIA 5-VJEÇARE E ZHVILLIMIT TË SPITALIT, MENAXHIMIT FINANCIAR DHE INVESTIMEVE**	15	
2.1	*Vendimi i Bordit Drejtues për miratimin e Strategjisë bashkëlidhur formularit të aplikimit*		
2.2	*Strategjia 5-vjeçare për zhvillimin e spitalit, menaxhimit financiar dhe investimeve*		
3	**INDIKATORËT E PERFORMANCËS PËR MBULIMIN E SHËRBIMIT MJEKËSOR PËR 3 VITET E ARDHSHME**	25	
4	**RREGULLORJA EKONOMIKO– FINANCIARE**	25	
5	**PAKETAT BAZË SHËNDETËSORE TË KOSTIFIKUARA**	10	
6	**PLAN VEPRIMI PËR OPTIMIZIMIN E KAPACITETEVE PËR TË GJENERUAR TË ARDHURAT DYTËSORE**	5	
7	**MBULIMI I MBI 70% TË NEVOJAVE PËR KUJDES SHËNDETËSOR NË TERRITORIN QË AI MBULON**	5	
8	**RAPORT I SITUATËS SË QËNDRUESHME FINANCIARE PËR 3 VITET E FUNDIT**	5	

SHTOJCA C1
KARTA E AUTONOMISË MENAXHERIALE

KARTA E AUTONOMISË MENAXHERIALE

Mbështetur në Ligjin nr. 55/2022 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 72, datë 8.2.2023 "Për miratimin e rregullores së autonomisë spitalore" , bazuar në Vendimin e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e përmbushjes së kritereve për përfitimin e autonomisë spitalore,

SPITALIT

Adresa: _____

I jepet karta e autonomisë spitalore menaxheriale për fushëveprimevet e mëposhtme:

1. organizimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;
2. administrimin e shërbimeve spitalore dhe jospitalore;
3. organizimin e praktikës së dyfishtë, bazuar në kriteret e përftimit të saj.

Për periudhën ___/___/2022 deri më ___/___/2024

MINISTRI
Ogerta MANASTIRLIU

SHTOJCA C2
KARTA E AUTONOMISË FINANCIARE

KARTA E AUTONOMISË FINANCIARE

Mbështetur në Ligjin nr. 55/2022 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 72, datë 8.2.2023 "Për miratimin e rregullores së autonomisë spitalore", bazuar në Vendimin e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e përmbushjes së kritereve për përfitimin e autonomisë spitalore,

SPITALIT

Adresa: _____

I jepet karta e autonomisë spitalore financiare për fushëveprimevet e mëposhtme:

1. përdorimin e burimeve financiare, bazuar në buxhetet e spitalit dhe të ardhurave dytësore për shërbimet e ofruara;
2. përcaktimin dhe përdorimin e mekanizmit të shpërblimeve në bazë të performancës për personelin mjekësor, sipas indikatorëve të normave të aktivitetit mjekësor;
3. përcaktimin e tarifave të shërbimeve për procedurat e kryera jashtë sistemit të referimit.

Për periudhën ___/___/2022 deri më ___/___/2024

MINISTRI
Ogerta MANASTIRLIU

URDHËR
Nr. 201, datë 6.4.2023

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E BULLGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe informacioni i përditësuar, i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
b) zogjtë 24-orësh;
c) shpendë dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezët e shpendëve;
dh) mishi i shpendëve;
e) nënproduktet e shpendëve.
Nga shteti i Bullgarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Veliko Tarnovo	Veliko Tarnovo	

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 204 , datë 6.4.2023

PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA MAQEDONIA E VERIUT

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Maqedonisë së Veriut:

Ndarja administrative e nivelit të parë	*Ndarja administrative e nivelit të dytë**	*Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Češinovo-Obleševo	Ularci	
Delcevo	Kostin Dol	
Karbinci	Karbinci	
Kočani	Obleshevo	
Kočani	Trkanje	
Kočani	Mojanci	
Kočani	Dolni Podlog	
Kratovo	Muskovo	
Kriva Palanka	Kriva Palanka	
Kumanovo	Kumanovo	
Kumanovo	Dolno Konjare	
Kumanovo	Ljubodrag	
Kumanovo	Tabanovce	
Kumanovo	Recica	
Makedonska Kamenica	Moshtica	
Makedonska Kamenica	Preseka	
Makedonska Kamenica	Glavovica	
Novo Selo	Novo Selo	
Probištip	Drenok	
Probištip	Shtalkovica	
Probištip	Stalkovica	
Rankovce	Otosnica	
Staro Nagoričane	Staro Nagoričane	
Staro Nagoričane	Arbanasko	
Staro Nagoričane	Tromegja	
Štip	Štip	
Vinitsa	Vinitsa	
Vinitsa	Vinicka Krshla	

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri më 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë, që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë, që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë, që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar

në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 592, datë 13.12.2022 *"Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Maqedonia e Veriut",* shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 213, datë 7.4.2023

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENET E OHRIT, PRESPËS, FIERZËS, ULZËS DHE SHKOPETIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 "Për peshkimin", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin të të gjitha llojeve të peshqve në liqenet e Ohrit (me përjashtim të koranit), Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit dhe, konkretisht:

- *për gjuhcën (cironka) - Alburnus Albidus Alborella,* prej 20 prillit deri më 20 korrik 2023, në liqenin e Ohrit dhe prej 20 prillit deri më 31 korrik 2023, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit;

- *për krapin - Cyprynus Carpio,* prej 20 prillit deri më 20 korrik 2023, në liqenin e Ohrit dhe prej 25 prillit deri më 25 maj 2023, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

2. Për periudhën 20.7.2023 deri më 20.8.2023, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu për liqenin e Ohrit dhe për periudhën 25.4.2023 deri më 25.6.2023, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën breqliqenore prej 150 ml nga bregu për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitet peshkimi në këto liqene.

5. OMP-të të marrin të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në këto liqene.

6. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Organizatat e

Menaxhimit të Peshkimit të liqeneve të Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit, Drejtoritë Rajonale të AKU-së, duke bashkëpunuar me strukturat e vetëqeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare të qarqeve përkatëse dhe me policitë bashkiake përkatëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 225, datë 12.4.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z.Enio Civici nga data 14.4.2023 deri më datë 16.4.2023.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Në ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Enio Civici.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

VENDIM
Nr. 11, datë 10.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 26.1.2023 dhe 21.2.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (E) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ëngjëll Myteveli

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Fillareti Salihaj, Fatri Shishmani, Lejla Shishmani, Violeta Topçi, Hafet Gjino

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimeve nr. 253

regjistri, datë 11.11.2020; nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 15, 18, 33, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f", 133, 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara Fillareti Salihaj, Fatri Shishmani, Lejla Shishmani, Violeta Topçi dhe Hafet Gjino, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Rahmi Shishmani (Pojani) ka qenë pronar, përpara datës 29.11.1944, i një trualli dhe një shtëpie të ndërtuar mbi të, të ndodhura në qytetin e Korçës. Në vitin 1947 kjo pronë është marrë nga shteti me vendimin nr. 16, datë 31.5.1947, të Seksionit Financiar të Nënprefekturës së Qendrës, Korçë, në zbatim të dekretligjit nr. 234, datë 18.5.1946, "Për nxjerrjen e të ardhurave shtetërore", për shkak të mospagimit nga ky shtetas të tatimit të jashtëzakonshëm mbi fitimin gjatë luftës të vendosur sipas ligjit nr. 37, datë 13.1.1945, "Për tatimin e jashtëzakonshëm".

2. Në vitin 1962 këtë pronë shteti ia ka kaluar në pronësi vëllezërve Myteveli, si kompensim për një pronë/shtëpi dhe truall që iu është shpronësuar në atë periudhë për efekt të planit rregullues të qytetit të Korçës. Nga viti 1963 ata kanë banuar në këtë shtëpi.

3. Në vitin 1995, mbështetur në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", të ndryshuar *(ligji nr. 7698/1993),* me vendimin nr. 706, datë 22.3.1995 *(vendimi nr. 706/1995),* Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë *(KKKP, Korçë)*, ndër të tjera, ka vendosur të njohë Rahmi Shishmanin si ish-pronar të shtëpisë me sipërfaqe 583 m^2, të ndodhur në Korçë, me kufij të përcaktuar, duke ua kthyer këtë pronë trashëgimtarëve të tij (Selie Shishmani, Fillareti Shishmani, Zhaneta Shishmani, Fatri Shishmani, Violeta Shishmani, Lejla Shishmani, Hajet Shishmani dhe Romeo Shishmani). Në këtë rast, KKKP-ja, Korçë ka vendosur po ashtu që ndërmarrja, institucioni dhe çdo person fizik dhe juridik që ka në administrim pronën të bëjë kalimin e saj në duar të pronarit, i cili një kopje të vendimit e paraqet për regjistrim në hipotekë. Mbi bazën e këtij vendimi, prona është regjistruar në regjistrat hipotekorë në pronësi të trashëgimtarëve të Rahmi Shishmanit.

4. Pas këtij vendimi të KKKP-së, Korçë, në nenin 1, të ligjit nr. 7698/1993 është bërë një shtesë me ligjin nr. 7916, datë 12.4.1995, që ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 11, datë 31.5.1995. Me shtesën e bërë kjo dispozitë parashikonte: *"Ky ligj u njeh ish-pronarëve a trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara ose të konfiskuara sipas akteve ligjore (duke përfshirë edhe ligjin nr. 37, datë 13.1.1945, "Për tatimin e jashtëzakonshëm"), nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944, ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, si dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin a kompensimin e tyre."*.

5. Shtesa e bërë si më lart, në nenin 1 të ligjit nr. 7698/1993, pikërisht fjalia *"duke përfshirë edhe ligjin nr. 37, datë 13.1.1945, "Për tatimin e jashtëzakonshëm",* është bërë objekt i kontrollit kushtetues, në përfundim të të cilit, me vendimin nr. 16, datë 17.4.2000 *(vendimi nr. 16/2000)*, Gjykata Kushtetuese *(Gjykata)* e ka shfuqizuar atë si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

6. Në vitin 2001 kërkuesi dhe të tjerë (trashëgimtarë të vëllezërve Myteveli) kanë kundërshtuar në gjykatë vendimin nr. 706/1995 të KKKP-së, Korçë, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe detyrimin e trashëgimtarëve Shishmani t'i njihnin pronarë të shtëpisë me sipërfaqe 583 m^2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1439, datë 9.7.2003, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se ish-pronarit Rahmi

Shishmanit prona i ishte marrë nga shteti në mënyrë të padrejtë me ligjin nr. 37, datë 13.1.1945, "Për tatimin e jashtëzakonshëm", prandaj me të drejtë KKKP-ja, Korçë i kishte njohur pronësinë dhe kthyer pronën trashëgimtarëve të tij, ndërkohë që vendimi nr. 16/2000 i Gjykatës nuk kishte efekt prapaveprues në këtë rast.

7. Mbi ankimin e trashëgimtarëve Myteveli, me vendimin nr. 332, datë 11.12.2003, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke e gjetur të drejtë arsyetimin e saj.

8. Ndërkohë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për rekursin e trashëgimtarëve Myteveli, me vendimin nr. 1098, datë 7.7.2005, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, duke pranuar padinë dhe anuluar vendimin nr. 706/1995 të KKKP-së, Korçë, si dhe detyruar të padituri (trashëgimtarët Shishmani) të njihnin paditësit (trashëgimtarët Myteveli) pronarë të shtëpisë së banimit objekt konflikti. Kolegji Civil, duke mbajtur në konsideratë edhe vendimin nr. 16/2000 të Gjykatës, ka arsyetuar se ish-pronarit Rahmi Shishmani prona nuk i ishte marrë nga shteti në mënyrë të padrejtë, ndaj njohja pronar dhe kthimi i pronës nga KKKP-ja, Korçë binte në kundërshtim me ligjin nr. 7698/1993.

9. Më datë 19.1.2006 trashëgimtarët Shishmani (Salie Shishmani, Lefta Shishmani, Eduard Shmili dhe Rudina Shmili) i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me pretendimet se procesi gjyqësor i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ishte i parregullt, pasi gjykimi i çështjes ishte bërë në mungesë të palës dhe pa e njoftuar atë, ndërkohë që ajo nuk ka pasur dijeni për rekursin e palës kundërshtare, si dhe Gjykata e Lartë kishte kapërcyer kompetencat e saj duke bërë vlerësim rrethanash e faktesh. Me vendimin nr. 18, datë 23.6.2006, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se kërkuesve nuk u është mohuar padrejtësisht pjesëmarrja në gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe njëkohësisht e drejta e mbrojtjes, në rrethanat kur ata nuk arritën të provojnë pretendimet e tyre për mungesën e komunikimit të rekursit. Po kështu, është gjetur i pabazuar edhe pretendimi i kërkuesve për kapërcimin e kompetencave nga Gjykata e Lartë.

10. Më datë 21.11.2006, trashëgimtarët Shishmani kanë paraqitur padi në gjykatë me objekt pavërtetësinë e dokumentit "Lajmërimmarrje akti gjyqësor" të datës 21.4.2004 të Gjykatës së Apelit Korçë, pikërisht të aktit të komunikimit të rekursit për të padituri Shishmani. Me vendimin nr. 219, datë 29.1.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka pranuar padinë, duke njohur të pavërtetë dokumentin "Lajmërimmarrje akti gjyqësor", datë 21.4.2004, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe shpallur atë të pavlefshëm, me arsyetimin se nga ekspertimi grafik ka rezultuar që nënshkrimi në rubrikën "Marrësi" është i falsifikuar. Mbi ankimin e të paditurve Myteveli, me vendimin nr. 147, datë 16.4.2007, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur të drejtë arsyetimin e saj. Kundër këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

11. Më datë 6.6.2007 Salie Shishmani ka paraqitur përsëri ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat pretendime të ngritura më parë, por duke sjellë në këtë rast si rrethanë të re shpalljen të pavlefshëm të aktit të komunikimit të rekursit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 133, datë 1.10.2007, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke arsyetuar, ndër të tjera, se shkaku i ri i paraqitur nga kërkuesja si pretendim për riparaqitjen e kërkesës, konkretisht vendimi nr. 219, datë 29.1.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 147, datë 16.4.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë, është kundërshtuar me rekurs në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, në kushtet kur për rrethanat e reja të pretenduara ka një proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë, Gjykata nuk është kompetente të shqyrtojë kërkesën.

12. Ndërkohë, për rekursin e të paditurve Myteveli, me vendimin nr. 526, datë 22.11.2011, Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 147, datë 16.4.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr. 219, datë 29.1.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përmes të cilit është deklaruar i pavërtetë dhe shpallur i pavlefshëm dokumenti "Lajmërimmarrje akti gjyqësor" i datës 21.4.2004.

13. Në vijim, trashëgimtarët Shishmani (Fillareti Salihaj, Fatri Shishmani, Lejla Shishmani, Violeta

Topçi dhe Hafet Gjino) i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit të formës së formës së prerë, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit nr. 332 datë 11.12.2003 të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Korçë. Po kështu, ata kanë kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kërkesa për rishikim është bazuar në nenin 494, shkronjat "a", "ç" dhe "e", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC),* ndërsa kërkuesit kanë pretenduar se: - janë zbuluar rrethana dhe prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga ata gjatë shqyrtimit të çështjes (shkronja "a"); - vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara (shkronja "ç"); - vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak (shkronja "e"). Krahas argumenteve për secilin shkak rishikimi, kërkuesit Shishmani kanë paraqitur edhe provat ku mbështesnin pretendimet e tyre.

14. Ndërsa kërkesa për rishikim ka qenë në pritje për t'u shqyrtuar, KPC-ja ka pësuar disa ndryshime në vitet 2013 dhe 2017 në lidhje me mjetin e rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

15. Kërkesa për rishikim është marrë në shqyrtim në vitin 2020. Fillimisht, me vendimin e datës 28.10.2020, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Më tej, me vendimin nr. 253 regjistri, datë 11.11.2020, mbështetur në nenin 500 të KPC-së, ky kolegj ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit *(vendimi i pezullimit)*, ndërsa me vendimin e datës 3.11.2021, pas ndryshimeve të KPC-së në vitin 2021, ka vendosur revokimin e vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve *(vendimi i revokimit)*. Kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin e revokimit, si dhe për të drejtën e tij për të paraqitur pretendime me shkrim, të cilat i ka dërguar më datë 17.11.2021. Sipas një parashtrese me shkrim të kërkuesit, që mban datën 17.11.2021, drejtuar Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me kërkesën për rishikim të paraqitur nga trashëgimtarët Shishmani, nga ana e tij janë parashtruar disa pretendime. Konkretisht, kërkuesi ka ngritur pretendime në drejtim të paanshmërisë së gjyqtarëve në përbërje të trupit gjykues, por duke theksuar se nuk kërkonte përjashtimin e tyre, pasi ata ishin të detyruar të hiqnin dorë nga gjykimi i çështjes. Në këtë parashtresë, kërkuesi ka pretenduar po ashtu se kërkesa për rishikim ishte e pabazuar në ligj dhe duhej të rrëzohej, pasi nga trashëgimtarët Shishmani nuk ishte paraqitur asnjë provë e re që nuk dihej prej tyre gjatë gjykimit të çështjes, duke parashtruar argumente për disa nga dokumentet e paraqitura si provë për kërkesën për rishikim dhe për disa procese gjyqësore të tjera të papërmendura në kërkesën për rishikim. Sipas kërkuesit në këtë parashtresë, vendimi nr. 1098, datë 7.7.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ishte marrë në përputhje me ligjin e kohës, duke mos përbërë shkak rishikimi ndryshimi i mëvonshëm i legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave.

16. Me vendimin nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 1098, datë 7.7.2005 të Gjykatës së Lartë dhe nr. 332, datë 11.12.2003 të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se në çështjen civile objekt kërkese për rishikim, paditësit Myteveli kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, por ai nuk u është komunikuar të paditurve Shishmani, ndërsa dëftesa e komunikimit të rekursit ka rezultuar e falsifikuar me vendim gjyqësor të të tria shkallëve të gjykimit. Sipas Kolegjit Civil, rekursi është një akt procedural i domosdoshëm që u komunikohet palëve të tjera pjesëmarrëse në gjykim, ndaj, referuar edhe jurisprudencës kushtetuese në lidhje me të drejtën e aksesit dhe asaj të mbrojtjes, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, *"mosnjoftimi i rekursit për palën e paditur në atë gjykim e bën procesin e gjykimit në Gjykatën e Lartë një proces të parregullt, pasi i ka hequr mundësinë palës së paditur për t'u mbrojtur. Zhvillimi i gjykimit në bazë të këtij dokumenti të falsifikuar përbën shkak për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë" (shih paragrafin 15 të vendimit të Gjykatës së Lartë).* Në vijim, Kolegji Civil ka arritur në konkluzionin se *"shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë pa u njoftuar rekursi i palëve kërkuese siç ka rezultuar nga vendimet e mësipërme gjyqësore, përbën shkelje*

procedurale dhe kjo shkelje është e tillë që pasojellë detyrimisht prishjen e vendimit të gjykatës, pasi procesi i zhvilluar nga ajo gjykatë është një proces i parregullt ligjor, i cili vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ" (shih paragrafin 16 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Në arsyetimin e vendimit të Kolegjit Civil nuk ka trajtim për elementet e pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës për rishikim dhe ligjin e zbatueshëm në këtë rast, sikundër as për shkaqet e tjera të rishikimit të ngritura në atë kërkesë (ato sipas shkronjave "a" dhe "e" të nenit 494 të KPC-së).

17. Më datë 24.6.2022 kërkuesi Engjëll Myteveli i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dy vendimeve të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, të vendimit të datës 11.11.2020 për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të Gjykatës së Lartë, si dhe të vendimit të datës 28.2.2022 për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005, me të cilin çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit Korçë.

18. Më datë 23.9.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, më datë 12.10.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

19. Në seancën e datës 26.1.2023, Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për shqyrtimin e çështjes për më datë 21.2.2023, me qëllim saktësimin e subjekteve të interesuara në këtë gjykim, konkretisht të personave që kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me kërkesën për rishikimin e vendimit: Fillareti Salihaj, Fatri Shishmani, Violeta Topçi dhe Hafet Gjini.

20. Në parashtrimet e datës 15.11.2022, subjektet e interesuara i kanë kërkuar Gjykatës edhe shqyrtimin e çështjes në seancë plenare publike, kërkesë të cilën e kanë përsëritur edhe më datë 2.3.2023. Në seancën e datës 21.2.2023, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkese, me argumentin se në Mbledhjen e Gjyqtarëve të datës 12.10.2022 është vlerësuar i mjaftueshëm për nevojat e gjykimit kushtetues zhvillimi i seancës plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

21. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

21.1 E drejta për proces të rregullt ligjor, në aspekt të:

21.1.1 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi duke pranuar kërkesën për rishikim pa shkaqe ligjore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë pas 15 vjetësh. Kërkesa për rishikim është paraqitur tej afateve ligjore të parashikuara nga nenet 445, 495 dhe 496 të KPC-së, konkretisht rreth 4 vjet e 8 muaj pas dhënies së vendimit nr. 147, datë 16.4.2007, të Gjykatës së Apelit Korçë. Nga sistemi elektronik i Gjykatës së Lartë rezulton se ajo është paraqitur më datë 9.1.2012, ndërsa vula e vendosur në kopjen e saj të ndodhur në dosjen e Gjykatës së Lartë është e falsifikuar. Në kushtet kur kërkesa për rishikim ishte e pabazuar në ligj, pasi vendimi nr. 1098, datë 7.7.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk bazohej në dokumente të falsifikuara, si dhe nuk kishte vendim tjetër të formës së prerë që binte në kundërshtim me të, Gjykata e Lartë duhej të kishte vendosur mospranimin e kërkesës. Vendimmarrja e saj bie ndesh me vendimin unifikues nr. 8, datë 24.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

21.1.2 *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë S.S., E.P. dhe I.P. kanë qenë në konflikt interesi me kërkuesin, i cili i ka denoncuar ata për korrupsion në parlamentin shqiptar dhe Ambasadën Amerikane në Republikën e Shqipërisë. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, S.S., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues në vendimin për pezullimin, ka qenë edhe pjesë e trupit gjykues të Gjykatës që ka dhënë vendimet nr. 18, datë 23.6.2006 dhe nr. 133, datë 1.10.2007 për çështjen. Po kështu, gjyqtarët E.P. dhe I.P. kanë qenë njëkohësisht pjesë e trupit gjykues që ka dhënë vendimin për pezullimin e ekzekutimit dhe të atij që ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Korçë. Për rrjedhojë, këta gjyqtarë duhej të kishin hequr dorë nga shqyrtimi në themel i kërkesës për rishikim, çka është kërkuar edhe në parashtrimet e tij të datës 17.11.2021, ndërkohë që ka hequr dorë vetëm gjyqtari S.S.

21.1.3 *Parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi në raste të tjera Kolegji Civil i

Gjykatës së Lartë nuk i ka pranuar kërkesat për rishikim të paraqitura tej afateve ligjore të përcaktuara.

21.1.4 *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kompetencë të prishë vendimin e saj për shkak të moskomunikimit të rekursit. Këtë të drejtë e ka vetëm Gjykata. Po kështu, ajo nuk ka zbatuar ligjin në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës për rishikim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 109 të ligjit nr. 38/2017, datë 30.5.2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" *(ligji nr. 38/2017)* dhe nenin 498, pika 2, të KPC-së. Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me nenin 298, paragrafi 2, të KPC-së, duke e dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Korçë, pasi edhe nëse ekzistonin kushtet për pranimin e kërkesës për rishikim, duhej t'ia dërgonte çështjen për rigjykim një trupi tjetër gjykues pranë saj.

21.1.5 *Parimit të ligjshmërisë*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka trajtuar moskomunikimin e rekursit si cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, ndërkohë që ka njoftuar për zhvillimin e gjykimit persona që kanë ndërruar jetë dhe nuk ka bërë kalimin procedural për trashëgimtarët e tyre, në zbatim të nenit 199/1 të KPC-së.

21.1.6 *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka trajtuar problemet ligjore të ngritura nga kërkuesi si në rekurs, ashtu edhe në parashtrimet e tij të datës 17.11.2021.

21.1.7 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka trajtuar si prova të reja provat e shqyrtuara në gjykimin e mëparshëm. Dokumentet mbi të cilat është mbështetur vendimi nr. 1098, datë 7.7.2005 i Gjykatës së Lartë nuk janë konsideruar të falsifikuara.

21.1.8 *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi duke e kthyer çështjen për rigjykim, shqyrtimi i themelit të saj zgjatet pambarim.

21.2 E drejta e pronës, pasi vendimet e Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të saj dhe prishjen e këtij vendimi dhe atij të gjykatës së apelit, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim cenojnë rëndë interesat e tij ekonomikë. Vendimi i KKKP-së, Korçë, që i ka kthyer pronën trashëgimtarëve të familjes Shishmani, është i datës 22.3.1995, ndërkohë që ndryshimet e bëra me ligjin nr. 7916, datë 12.4.1995 në ligjin nr. 7698/1993 nuk kishin hyrë ende në fuqi. Pretendimet e trashëgimtarëve të familjes Shishmani për ndryshimin e nenit 2 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" *(ligji nr. 9235/2004)* me ligjin nr. 10095, datë 12.3.2009, janë të pabazuara. Ky ndryshim nuk i jepte të drejtë familjes Shishmani për të paraqitur kërkesë për rishikim. Po kështu, kërkesa për rishikim nuk është paraqitur për një nga shkaqet e parashikuara me ligj dhe pretendimi i tyre se aktnjoftunia e Gjykatës së Paqit Korçë përbën provë të re, është i pabazuar, pasi kjo provë dihej që në vitin 2010.

22. ***Subjektet e interesuara, Fillareti Salihaj, Fatri Shishmani, Lejla Shishmani, Violeta Topçi dhe Hafet Gjino*,** kanë parashtruar se:

22.1 Vendimi i Gjykatës së Lartë i kundërshtuar nuk është përfundimtar dhe, si i tillë, nuk mund të jetë objekt i gjykimit kushtetues.

22.2 Pretendimi për *cenimin e parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Rekursi i paraqitur nga paditësit nuk u është komunikuar dhe firma e hedhur në lajmërimin e marrjes dijeni ka rezultuar e falsifikuar me vendim gjyqësor të të tria shkallëve. Në kushtet kur ndaj vendimit nr. 147, datë 16.4.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë për çështjen e falsifikimit të firmës në dëftesën e komunikimit të rekursit ishte paraqitur rekurs, përfundimtar për këtë qëllim konsiderohet vendimi nr. 00-2011-2272 (526), datë 22.11.2011 i Gjykatës së Lartë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës në vendimin nr. 133, datë 10.10.2007 dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*. Kërkesa për rishikim është depozituar në Gjykatën e Lartë më datë 19.12.2011 me nr. F-108, çka rezulton nga vula dhe shënimi i sekretarisë gjyqësore, pra brenda afatit ligjor. Krahas falsitetit të njoftimit, ajo përmbante edhe prova të tjera, të cilat përbënin, gjithashtu, shkak për rishikim. Pretendimet e kërkuesit se janë vënë në dijeni të aktnjoftunisë së zotnimit të vitit 1934 kohë përpara paraqitjes së kërkesës në Gjykatën e Lartë është i pavërtetë, pasi për këtë provë të re janë vënë në dijeni gjatë gjykimit të çështjes për falsifikimin e firmës së lajmërimmarrjes së rekursit.

22.3 Pretendimet e kërkuesit për *cenimin e parimit të paanshmërisë* janë të pabazuara. Pretendimi se ndaj gjyqtarit S.S. është bërë kallëzim për korrupsion,

nuk përbën shkak për cenimin e parimit të paanshmërisë, ashtu siç nuk përbën shkak fakti se dy gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen kanë vendosur për kërkesën për pezullim. Vendimet e pezullimit kanë natyrë të ndërmjetme dhe nuk paragjykojnë themelin e çështjes.

22.4 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë para ligjit* është i pabazuar, pasi vendimet e paraqitura në këtë drejtim nuk kanë lidhje me rastin konkret.

22.5 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar* është i pabazuar, pasi kërkuesi është njoftuar për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, duke iu dhënë mundësia të paraqesë pretendimet e tij me shkrim në përputhje me procedurën e caktuar me ligj për gjykimin në atë gjykatë dhe nuk ka paraqitur asnjë pretendim.

22.6 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi, siç rezulton edhe nga kërkesa, vendimi është shpallur i arsyetuar.

22.7 Pretendimi për cenimin e *parimit të ligjshmërisë* është i pabazuar, pasi nga ana e tyre janë paraqitur në gjykim dëshmitë e trashëgimive të të gjitha palëve që kanë ndërruar jetë gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, si për palën paditëse, ashtu edhe për palët e paditura.

22.8. Me vendimin nr. 1098, datë 7.7.2005, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të *drejtën e tyre të pronësisë*, pasi:

22.8.1 Prona me sipërfaqe 583 m^2 që i është njohur ish-pronarit Rahmi Shishmani përfshinte godinat nr. 2 dhe nr. 4. Më datë 24.4.1967 godinën nr. 2, me sipërfaqe 111 m^2 dhe oborr po kaq, shteti ia ka kaluar në pronësi shtetases Kimete Haki Biba, e cila po atë vit ia ka shitur shtetasit Shaqir Beqir Çaushllarit. Procedurat gjyqësore të zhvilluara në lidhje me këtë pronë nga njëri prej trashëgimtarëve të këtij të fundit tregojnë se sipërfaqja prej 222 m^2, e cila përfshihej brenda truallit prej 583 m^2, është trajtuar si pronë më vete dhe nuk ka qenë asnjëherë në posedim ose pronësi të kërkuesit dhe paditësve të tjerë.

22.8.2 Me vendimin nr. 737/1, datë 2.6.1995 të KKKP-së, Korçë, paditësve Myteveli u është njohur dhe kthyer prona që u ishte shpronësuar në vitin 1960 e në shkëmbim të së cilës kanë përfituar godinën nr. 4, si dhe janë kompensuar në vlerë të plotë për pronën e shpronësuar. Në këto kushte, ata nuk mund të përfitojnë njëkohësisht si pronën që u është shpronësuar, ashtu edhe pronën që u është dhënë në këmbim të shpronësimit. Sipas vërtetimit të pronësisë nr. 808/25, datë 5.7.1963, shteti ka kaluar në pronësi të vëllezërve Myteveli vetëm godinën nr. 4.

22.8.3 Me vendimin e formës së prerë nr. 2436, datë 22.9.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, trashëgimtarëve të Rahmi Shishmanit u është njohur pronësia edhe për sipërfaqen prej 494 m^2, të patrajtuar sipas pikës 3 të vendimit nr. 706/1995 të KKKP-së, Korçë, krahas sipërfaqes prej 583 m^2 ku shtrihet pjesërisht ndërtesa objekt gjykimi.

22.8.4 Më datë 18.9.2002, në cilësinë e pronarëve, trashëgimtarët Shishmani kanë kaluar pronësinë e ndërtesës dhe të truallit me sipërfaqe 884 m^2 në favor të shtetasve Servet Feka dhe Agim Shahu, të cilët, në cilësinë e pronarëve, kanë ngritur mbi të një godinë tjetër, në zbatim të lejes së ndërtimit të datës 12.2.2003 të Këshillit të Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Korçë. Në kohën e gjykimit të çështjes godina nuk ka ekzistuar, pasi ajo ishte prishur në vitin 2003 dhe paditësit Myteveli nuk kanë qenë më pronarë të kësaj prone, ndërkohë që pronarët e rinj nuk janë thirrur në gjykim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

23. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret

për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

24. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

25. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit *(shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 56, datë 25.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi *(shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Për sa i takon pretendimit për cenimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën e saj, në referim të ndryshimeve ligjore të bëra në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, Gjykata ka vlerësuar se, si rregull, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Sipas Gjykatës, vetëm në raste të veçanta, kur vihet në dyshim efektiviteti i këtij mjeti, kërkuesi mund t'i drejtohet drejtpërsëdrejti kësaj Gjykate me ankim kushtetues individual për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave *(shih vendimet nr. 39, datë 9.12.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në rastin konkret, Gjykata vëren se nga dosja gjyqësore e administruar për qëllim të gjykimit kushtetues të çështjes, rezulton se kërkesa për rishikim është depozituar në Gjykatën e Lartë më datë 19.12.2011 me nr. F-108 prot. dhe është regjistruar në atë gjykatë më datë 9.1.2012 me nr. 11243-00028-00-2012 *(shih dosjet gjyqësore nr. 253 vendimi, datë 11.11.2020 të Gjykatës së Lartë, faqja 116; nr. 11243-00028-00-2012 regjistri themeltar, datë 20.12.2012 të Gjykatës së Lartë, faqja 1)*, ndërsa vendimi është marrë më datë 28.2.2022. Nga materialet e çështjes nuk rezulton që kërkuesi t'i jetë drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose, pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja ligjore të KPC-së më datë 5.11.2017, të ketë shfrytëzuar mjetet ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të këtij kodi për gjykimin e çështjes së tij nga Gjykata e Lartë brenda një afati të arsyeshëm ose për përshpejtimin e procedurave, si dhe nuk ka parashtruar asnjë argument në këtë drejtim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për këtë pretendim ai nuk ka shteruar mjetet në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

28. Në lidhje me pretendimet e tjera, Gjykata konstaton se përmes ankimit kushtetues individual kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të kësaj gjykate, si dhe të vendimit të këtij kolegji, i cili ka pranuar kërkesën për rishikim, duke vendosur prishjen e vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të Gjykatës së Lartë dhe atij nr. 332, datë 11.12.2003 të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në këtë të fundit. Për sa u takon pretendimeve të kërkuesit për vendimin e pezullimit nr. 253 regjistri, datë 11.11.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se ato duhen trajtuar së bashku me vendimin nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022 të Gjykatës së Lartë për pranimin e kërkesës për rishikim, për aq sa janë të lidhura me njëra-tjetrën.

29. Po kështu, për sa u përket pretendimeve për vendimin nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim, duke kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Korçë, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se vlerësimi i respektimit të standardeve kushtetuese gjatë procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, i nënshtrohet juridiksionit kushtetues *(shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 61,*

datë 27.9.2016; nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

30. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis,* pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 28.2.2022, kurse ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar më datë 24.6.2022, brenda afatit 4-mujor, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

31. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të ligjshmërisë, së drejtës për t'u dëgjuar, standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe së drejtës së pronës, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës.

32. Në drejtim të këtij legjitimimi, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të ligjshmërisë dhe së drejtës për t'u dëgjuar, në thelb, kanë të bëjnë me parimin e sigurisë juridike. Nga ana tjetër, për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, e cila përbën të drejtë kushtetuese me natyrë substanciale, Gjykata thekson se, si rregull, ajo i shqyrton pretendimet e individit për cenimin e të drejtave themelore pas shterimit të shkallëve të zakonshme të gjykimit, duke qenë se bazuar në parimin e subsidiaritetit gjykatat e zakonshme, në përputhje me kompetencat e tyre, kanë mundësi t'i riparojnë shkeljet eventuale duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mund t'i shqyrtojë pretendimet për cenimin e të drejtave themelore substanciale në mënyrë autonome, pra pa i lidhur domosdoshmërisht me procesin e rregullt ligjor, kur shkaku përcaktues i cenimit, të paktën në dukje, nuk është rezultat i drejtpërdrejtë dhe i lidhur ngushtë me procesin e gjykatave të zakonshme *(shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

33. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për shkak të pjesëmarrjes së disa prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në trupin gjykues që ka vendosur për vendimin e pezullimit të ekzekutimit dhe për themelin e kërkesës për rishikim, përmes të cilit është vendosur prishja e vendimit të saj dhe atij të gjykatës së apelit dhe çështja e themelit është kthyer për rigjykim pranë kësaj të fundit, Gjykata vëren se këto vendime janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Për rrjedhojë, pretendimi i ngritur nga kërkuesi për këtë argument është haptazi i pabazuar. Po kështu, argumenti i kërkuesit për denoncimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, si shkak paanshmërie, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim respektimin në rastin konkret të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për sa kohë ky veprim tregon për një veprim të njëanshëm të vetë kërkuesit dhe nuk mund të klasifikohet në ndonjë prej rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksioneve nga gjyqtarët e çështjes. Për pasojë, edhe për këtë argument, pretendimi i ngritur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar.

34. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* për një pjesë të pretendimeve të tij. Për rrjedhojë, Gjykata në vijim do të duhet të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike, si dhe për cenimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike

35. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka trajtuar si prova të reja ato të shqyrtuara në gjykimin e mëparshëm. Dokumentet mbi të cilat është mbështetur vendimi nr. 1098, datë 7.7.2005 i Gjykatës së Lartë nuk janë konsideruar të falsifikuara. Po kështu, duke pranuar kërkesën për rishikim, pa shkaqe ligjore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë pas 15 vjetësh. Kërkesa për rishikim është paraqitur tej afateve ligjore të parashikuara nga nenet 445, 495 dhe 496 të KPC-së, konkretisht rreth 4 vjet e 8 muaj pas dhënies së vendimit nr. 147, datë 16.4.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë. Nga sistemi elektronik i Gjykatës së Lartë rezulton se ajo është paraqitur më datë

9.1.2012, ndërsa vula e vendosur në kopjen e saj të ndodhur në dosjen e Gjykatës së Lartë është e falsifikuar. Në kushtet kur kërkesa për rishikim ishte e pabazuar në ligj, pasi vendimi nr. 1098, datë 7.7.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk bazohej në dokumente të falsifikuara dhe nuk kishte vendim tjetër të formës së prerë që binte në kundërshtim me të, Gjykata e Lartë duhej të kishte vendosur mospranimin e kërkesës. Vendimmarrja e saj bie ndesh me vendimin unifikues nr. 8, datë 24.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

36. Subjektet e interesuara, Fillareti Salihaj, Fatri Shishmani, Lejla Shishmani, Violeta Topçi dhe Hafet Gjino, kanë prapësuar se pretendimet e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit gjyqësor dhe të parimit të sigurisë juridike janë haptazi të pabazuara. Rekursi i paraqitur nga paditësit nuk u është komunikuar dhe firma e hedhur në lajmërimin e marrjes ka rezultuar e falsifikuar me vendim gjyqësor të të tria shkallëve. Në kushtet kur ndaj vendimit nr. 147, datë 16.4.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë për çështjen e falsifikimit të firmës në dëftesën e komunikimit të rekursit ishte paraqitur rekurs, përfundimtar për këtë qëllim konsiderohet vendimi nr. 00-2011-2272 (526), datë 22.11.2011 i Gjykatës së Lartë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës në vendimin nr. 133, datë 10.10.2007 dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së. Kërkesa për rishikim është depozituar në Gjykatën e Lartë më datë 19.12.2011 me nr. F-108, çka rezulton nga vula dhe shënimi i sekretarisë gjyqësore, pra brenda afatit ligjor. Krahas falsitetit të njoftimit, ajo përmbante edhe prova të tjera, të cilat përbënin, gjithashtu, shkak për rishikim. Pretendimet e kërkuesit se janë vënë në dijeni të aktnjoftunisë së zotnimit të vitit 1934 kohë përpara paraqitjes së kërkesës në Gjykatën e Lartë, është i pavërtetë, pasi për këtë provë të re janë vënë në dijeni gjatë gjykimit të çështjes për falsifikimin e firmës së lajmërimmarrjes së rekursit.

37. Në lidhje me standardin e arsyetimit, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale ose civile, si një garanci për procesin ligjor. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme ajo ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 8, datë 28.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

38. Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik *(shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 20, datë 13.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

39. Po kështu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka për qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin *(shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 50, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

40. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të

drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe, për rrjedhojë, parimi i sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 11, datë 16.4.2018*; *nr. 10, datë 13.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

41. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, në analizë të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, subjektet e interesuara kanë parashtruar si shkaqe rishikimi: *i)* zbulimi i rrethanave dhe provave të reja me rëndësi për çështjen, të cilat nuk diheshin prej tyre në kohën e shqyrtimit të themelit, konkretisht se kërkuesit në gjykimin e zakonshëm e kanë përfituar nga shteti pronën objekt gjykimi, në kompensim të pronës që atyre u është shpronësuar, ndërkohë që prona e shpronësuar u është kthyer me vendimin nr. 737/1 datë 2.6.1995 të KKKP-së, Korçë, çka përbënte shkak të ri, në kuptim të nenit 494, shkronja "a", të KPC-së; *ii)* vendimi nr. 1098, datë 7.7.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është bazuar në dokumente të falsifikuara, pasi dëftesa e komunikimit të rekursit të paditurve Shishmani ka rezultuar e falsifikuar me vendimin nr. 219, datë 29.1.2007 të Gjykatës së Rrethit Korçë, lënë në fuqi me vendimet nr. 147, datë 16.4.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr. 526, datë 22.11.2011 të Gjykatës së Lartë, çka përbënte shkak rishikimi, në kuptim të nenit 494, shkronja "ç", të KPC-së; *iii)* vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë, të dhënë për një pjesë të objektit të këtij gjykimi dhe për të njëjtin shkak, sipas të cilit, sipërfaqja e truallit prej 222 m^2, e ndodhur në truallin me sipërfaqe prej 583 m^2, nuk i ka kaluar asnjëherë nga shteti paditësve dhe kjo sipërfaqe nuk ka qenë në pronësi të tyre, por të personave të tjerë, çka përbënte shkak rishikimi në kuptim të nenit 494, shkronja "e", të KPC-së *(shih vendimin nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 4-5).*

42. Për sa i përket vetëm njërit nga shkaqet, falsitetit të dëftesës së komunikimit të rekursit të datës 21.4.2004 të të paditurve Shishmani, si shkak për rishikimin e vendimit nr. 1098, datë 7.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ky kolegj ka arsyetuar: *"13. [...] Falsiteti i Dëftesës së komunikimit është vërtetuar me vendimin gjyqësor nr. 219, datë 29.1.2007 të Gjykatës së Rrethit Korçë, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 147, datë 16.4.2007 dhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 526, datë 22.11.2011. Rekursi është një akt procedural i domosdoshëm që u komunikohet palëve të tjera pjesëmarrës në gjykim, sipas neneve 472,476,477,478 të KPC. Akti është i pavlefshëm edhe në vështrim të nenit 122 të KPC, pasi nuk është zbatuar kjo kërkesë ligjore që ka lidhje me mënyrën e njoftimit dhe personit të cilit duhej t'i njoftohej. 15. [...] mosnjoftimi i rekursit për palën e paditur në atë gjykim e bën procesin e gjykimit në Gjykatën e Lartë një proces të parregullt, pasi i ka hequr mundësinë palës së paditur për t'u mbrojtur. Zhvillimi i gjykimit në bazë të këtij dokumenti të falsifikuar përbën shkak për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Menjëherë palët kërkuese i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim të vendimit më datë 19.12.2011. 16. [...] shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë pa u njoftuar rekursi i palëve kërkuese siç ka rezultuar nga vendimet e mësipërme gjyqësore, përbën shkelje procedurale dhe kjo shkelje është e tillë që pas sjellë detyrimisht prishjen e vendimit të gjykatës, pasi procesi i zhvilluar nga ajo gjykatë është një proces i parregullt ligjor, i cili vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ" (shih vendimin nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 8 dhe 9).*

43. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se, bazuar në nenin 485, shkronja "c", të KPC-së, Gjykata e Lartë ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim, prishjen e vendimit të saj nr. 1098, datë 7.7.2005 dhe të vendimit nr. 332, datë 11.12.2003 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj të fundit për shqyrtimin në themel, ndonëse shkaku i pranuar i rishikimit lidhej me falsitetin dhe pavlefshmërinë e aktit të njoftimit të rekursit për trashëgimtarët Shishmani, pra me rregullsinë e procesit gjyqësor të zhvilluar në vitin 2005 në Gjykatën e Lartë. Në vendimin e pranimit të kërkesës për rishikim nuk arsyetohet për ekzistencën e ndonjë rasti rishikimi që afekton procesin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Korçë. Pavarësisht kësaj, vendimi i saj është prishur, duke u urdhëruar ajo gjykatë të rigjykojë çështjen në themel, megjithëse shkaku i pranuar i rishikimit nuk lidhej me nevojën e saktësimit të fakteve të reja.

44. Në vlerësimin e Gjykatës, analiza e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në drejtim të rastit të pranuar të rishikimit në raport me dispozitivin, me të cilin disponohet prishja e vendimit të Gjykatës së

Apelit Korçë dhe rigjykimi i çështjes, krijon alogjizëm në vendimin objekt kundërshtimi. Pjesa arsyetuese dhe dispozitivi i këtij vendimi nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, çka bën që ky vendim të mos ketë një harmoni të brendshme.

45. Për të arritur në këtë konkluzion, Gjykata vëren se në vendimin e tij Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i është referuar nenit 485/c të KPC-së, që përcakton mënyrën e vendimmarrjes pas shqyrtimit të rekursit, situatë ligjore kjo e ndryshme nga ajo e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishikim, duke mos iu referuar kështu dispozitave konkrete (nenit 498 të KPC-së) që rregullojnë në mënyrë të posaçme këtë procedurë të veçantë. Edhe në arsyetimin e vendimit, në funksion të analizës së ndryshimeve ligjore të KPC-së me ligjin nr. 44/2021, në raport me përbërjen e trupit gjykues, procedurën e gjykimit dhe vendimmarrjen, ky kolegj i referohet shqyrtimit të rekursit dhe vendimmarrjes sipas nenit 485 të KPC-së, përmbajtjes së tij aktualisht në fuqi *(shih vendimin nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqja 7, pika 10)*.

46. Arsyetimi i mësipërm krijon paqartësi në drejtim të disponimit për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë dhe kthimin asaj të çështjes për rigjykim në themel, kur rasti i pranuar i rishikimit lidhet me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe vendimin e saj nr. 1098, datë 7.7.2005, duke mos ndikuar kështu procesin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Korçë. Për më tepër, ky rast rishikimi nuk përmban as nevojën për saktësimin e fakteve të reja nga kjo gjykatë në kuadër të rigjykimit të urdhëruar. Fakti që kërkuesit e rishikimit, krahas rastit të pranuar, kanë ngritur pretendime për ekzistencën edhe të rasteve të tjera për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, raste të cilat lidhen me fakte dhe rrethana të çështjes, nuk do të thotë që kërkesa për rishikim është pranuar edhe në lidhje me to, për sa kohë Kolegji Civil, pavarësisht se i ka pasqyruar në vendim si pretendime të kërkuesve të rishikimit, nuk i ka shqyrtuar dhe as është shprehur për to.

47. Gjykata rithekson se rishikimi përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse *(shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 74, datë 16.12.2016; nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Krahas përcaktimit në mënyrë eksplicite të rasteve të rishikimit, ligji përcakton po ashtu edhe kushtet e pranueshmërisë së kërkesës për rishikim. Duke mbajtur në konsideratë parimin e sigurisë juridike dhe natyrën përjashtimore të rishikimit, Gjykata thekson se pranimi i rastit të rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, duhet të gjejë patjetër trajtim të shprehur në vendimin e gjykatës. Për më tepër, një gjë e tillë është e domosdoshme edhe në funksion të përcaktimit të kufijve të shqyrtimit të çështjes nga gjykata e rigjykimit.

48. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në rastin konkret është i pamjaftueshëm dhe i paqartë dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike është i bazuar.

49. Në kushtet kur kjo çështje do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizën e pretendimeve të tjera të kërkuesit në drejtim të sigurisë juridike për shkak të paraqitjes së kërkesës për rishikim tej afateve ligjore, pasi ajo gjykatë duhet të shprehet edhe për këtë pretendim. Ndërsa, për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronës, Gjykata çmon se, për sa kohë konstatoi cenimin nga Gjykata e Lartë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike, ky cenim ka ndikuar edhe në këtë të drejtë.

50. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f"

dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-658 (69), datë 28.2.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 10.3.2023.
Shpallur, më 11.4.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

VENDIM
Nr. 12, datë 15.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datën 15.3.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (I) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Idriz Konjari

SUBJEKT I INTERESUAR: MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-883, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: nenet 4, 41, 42, 43, 44, 124, 131, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 141, 142 dhe 167 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjekti i interesuar, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (*MEPJ*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Idriz Konjari, me urdhrin nr. 908, datë 1.11.2006, të ministrit të Punëve të Jashtme (*sot ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme*), ka fituar gradën diplomatike "*sekretar i parë*". Në vijim, me urdhrin nr. 40, datë 11.2.2011 të ministrit të MEPJ-së, është emëruar i ngarkuar me punë pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kuala Lumpur, Malajzi. Në bazë të këtij urdhri, marrëdhëniet me detyrën dhe ato financiare ishin sipas gradës diplomatike "*ministër këshilltar*" dhe fillonin në datën e paraqitjes në përfaqësi.
2. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 510, datë 30.7.2014, ka vendosur mbylljen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Malajzisë, Kuala Lumpur, për pasojë kërkuesi, me urdhrin nr. 379, datë 22.10.2014, është liruar nga detyra.
3. Ai ka ngritur padi në gjykatë me objekt kthimin në vendin e punës në përputhje me gradën diplomatike "sekretar i parë", dhënien e pagës nga momenti i shkëputjes deri në kthimin në vendin e

punës, si dhe dëmshpërblimin me pagën e 18 muajve, në aplikim të neneve 143, 144, 145 dhe 155, pika 3, të Kodit të Punës.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 691, datë 16.2.2015, e ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, duke detyruar Ministrinë e Punëve të Jashtme (*sot Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*) t'i paguajë 15 paga mujore dëmshpërblim për shkak të mosrespektimit të procedurës dhe afatit në zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës, si dhe duke caktuar afatin 2-vjeçar për ekzekutimin e detyrimit nga marrja formë të prerë të vendimit. Masa e dëmshpërblimit është referuar te paga mujore e kërkuesit, por pa përcaktuar masën konkrete të saj dhe nëse ajo ishte bruto ose neto. Gjykata Administrative e Apelit, pas shqyrtimit të ankimit të MEPJ-së, me vendimin nr. 3575(86-2017-3736), datë 24.7.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar rekurs.

5. Në vijim, sipas urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata, kërkuesi i është drejtuar përmbaruesit gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv - vendimit gjyqësor. Në kuadër të vënies në ekzekutim të vendimit, në datën 9.10.2017 përmbaruesi gjyqësor ka lajmëruar me shkrim palën debitore, MEPJ-në, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit në favor të kërkuesit kreditor brenda afatit 5-ditor, duke i njoftuar edhe masën e detyrimit në vlerën 33,975 dollarë amerikanë (USD) ose 3,884,362 lekë (shumë e konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë), e cila do të ndahej në 6 këste të barabarta brenda dy vjetësh. Vlera ka rezultuar nga llogaritja e dëmshpërblimit në masën e 15 pagave mujore, bazuar në vërtetimin e datës 25.11.2014, të paraqitur nga debitori, sipas të cilit kërkuesi në periudhën 22.3.2011–22.10.2014 ishte paguar me pagë mujore në vlerën 2,265 USD, që përkon me pozicionin e punës "i ngarkuar me punë në ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Malajzi".

6. Nëpërmjet urdhërxhirimit nr. 247, datë 12.4.2018, pala debitore, MEPJ-ja, ka kaluar në llogari të përmbaruesit gjyqësor shumën 1,602,720 lekë dhe nuk rezulton që ajo të ketë kryer veprime të mëtejshme në kuadër të ekzekutimit të titullit ekzekutiv në masën e plotë të detyrimit të përcaktuar në lajmërimin për ekzekutimin vullnetar, pasi e ka vlerësuar të përmbushur detyrimin. Pavarësisht qëndrimit të MEPJ-së, ekzekutimi nuk është pushuar nga përmbaruesi gjyqësor, i cili, me shkresat e datës 16.4.2018 dhe 9.5.2019, ka bërë me dije palën debitore se kishte bërë likuidim të pjesshëm të shumës. Gjithashtu, përmbaruesi gjyqësor ka njoftuar MEPJ-në se detyrimi i mbetur për t'u përmbushur ishte në vlerën 2,654,541 lekë.

7. Në datën 14.7.2020 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në gjykatë me pretendimin se detyrimi sipas titullit ekzekutiv nuk ishte përmbushur plotësisht nga debitori, për sa i përket vlerës 2,654,541 lekë, për shkak se vendimi gjyqësor nuk ishte i qartë lidhur me masën e dëmshpërblimit me referencë te paga mujore. Sipas tij, vendimi gjyqësor nuk identifikonte pagën mujore sipas pozicionit të punës dhe nëse paga ishte bruto ose neto. Konkretisht, kërkuesi, bazuar në nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC),* ka kërkuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë sqarimin dhe interpretimin e vendimit të saj nr. 691, datë 16.2.2015, të lënë në fuqi me vendimin nr. 3575(86-2017-3736), datë 24.7.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit. Kërkesa është pranuar me vendimin e datës 1.10.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka sqaruar se: (i) pozicioni i punës, paga e të cilit do të shërbejë për llogaritjen e vlerës totale të dëmshpërblimit të dhënë nga gjykata në favor të kërkuesit është "*i ngarkuar me punë në ambasadën tonë në Malajzi, ku është paguar me pagë mujore 2,265 (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) dollarë*"; (ii) paga mbi të cilën llogaritet dëmshpërblimi është paga "*bruto*".

8. Subjekti i interesuar, MEPJ-ja, ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 108(86-2021-766), datë 20.12.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 314 i KPC-së, pasi kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj edhe nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv është ekzekutuar ose jo plotësisht apo nëse përmbaruesi ka vendosur ose jo pushimin e ekzekutimit. Pavarësisht kësaj, gjykata e apelit është shprehur edhe për themelin e kërkesës, duke arsyetuar se referenca e pagës për llogaritjen e dëmshpërblimit ishte ajo e caktuar nga ministri përgjegjës dhe Këshilli i Ministrave, sipas gradës

diplomatike dhe jo paga e pozicionit të fundit të punës të mbajtur nga kërkuesi.

9. Kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke pretenduar, se: (i) vendimi bie ndesh me nenin 314 të KPC-së, me Kodin e Punës, me ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe atë për shërbimin e jashtëm, si dhe me praktikën e Gjykatës së Lartë për llogaritjen e dëmshpërblimit në rastin e zgjidhjes së paligjshme të marrëdhënies së punës; (ii) qëndrimi i gjykatës së apelit se kërkesat për sqarim dhe interpretim vendimi duhet të bëhen përpara se të nisë procedura e ekzekutimit, bie në kundërshtim të hapur me nenin 314 të KPC-së; (iii) ekzekutimi përfundon vetëm me vendimin përkatës të përmbaruesit gjyqësor dhe në rastin konkret MEPJ-ja nuk e ka shlyer pjesën e mbetur të detyrimit prej 2,654,541 lekësh; (iv) qëndrimi i gjykatës së apelit ka zvogëluar debinë e MEPJ-së, duke zëvendësuar mjetin e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore që ligji u ka dhënë palëve në një procedurë ekzekutimi; (v) gjykata e apelit, ndonëse ka arsyetuar për kohën e ngritjes së kërkesës, në vijim e ka interpretuar ligjin me njëanshmëri, duke vendosur në kundërshti me të; (vi) gjykata e apelit, në kundërshtim me ligjin, është shprehur se paga për dëmshpërblim është vetëm paga bazë për gradë dhe ka reduktuar elementet përbërëse të pagës së kërkuesit; (vii) gjykata e apelit ka anashkaluar përllogaritjen e dëmshpërblimit nga përmbaruesi gjyqësor, bazuar në pagën e fundit të kërkuesit, që është vënë në dispozicion nga vetë MEPJ-ja, e cila nuk ka ngritur asnjë kundërshtim sipas neneve 610 e vijues të KPC-së; (viii) gjykata e apelit, pavarësisht se shprehet që nuk mund të bëhet kërkesa për sqarim dhe interpretim vendimi, në vijim ka bërë sqarimin e tij; (ix) vendimi është në kundërshtim me praktikën gjyqësore, pasi nuk ka referenca ligjore dhe në kundërshtim me ligjet për shërbimin e jashtëm dhe Kodin e Punës, për përcaktimin e pagës referuese për llogaritjen e dëmshpërblimit për rastin e largimit të padrejtë nga puna.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-883, datë 13.5.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

11. Në datën 6.9.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në atë gjykatë. Kolegji i Gjykatës në datën 18.11.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.1 *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për pretendimet e tij në rekurs mbi shkeljet e rënda të ligjit nga gjykata e apelit. Mënyra e interpretimit të nenit 314 të KPC-së e ka vënë kërkuesin në pamundësi të përdorë mjetin procedural të garantuar nga ligji për mbrojtjen e të drejtave të tij.

12.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* të garantuar nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë janë parashtruar kërkimet dhe argumentet e kërkuesit për zbatimin e gabuar të ligjit, por nuk janë dhënë arsyet përse ato nuk përfshihen në rastet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Vendimi i kundërshtuar është formal dhe nuk përligj qëndrimin e mbajtur. Gjykata e Lartë kishte detyrimin për arsyetim, në kushtet kur vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor, është bazuar në norma që nuk ekzistojnë dhe ka ndryshuar vendimin gjyqësor të formës së prerë që kishte zgjidhur themelin e çështjes së kërkuesit.

12.3 *Së drejtës së ankimit,* të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë duhet ta zgjidhte çështjen me arsyetim në kushtet kur gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta. Për këtë shkak, kërkuesit i është shkelur edhe e drejta e aksesit substancial në gjykatë nëpërmjet ankimit.

13. ***Subjekti i interesuar,*** MEPJ-ja, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe, për rrjedhojë, ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 8, datë 3.3.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues me objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit që kishte vendosur rrëzimin e kërkesës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, me qëllim saktësimin e masës së dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Për nga natyra dhe qëllimi, ky lloj vendimi i bashkohet si pjesë përbërëse vendimit përfundimtar që ka disponuar për të drejtën e dëmshpërblimit financiar nga zgjidhja e marrëdhënies së punës. Për rrjedhojë, në kushtet kur procesi gjyqësor ka përfunduar dhe kërkuesi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, Gjykata çmon se ai e ka përmbushur këtë kriter, pasi nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, të pretenduara si të cenuara.

18. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.5.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 6.9.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

19. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* kërkuesi parashtron se me vendimin e mospranimit të rekursit, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se gjykata e apelit e kishte rrëzuar kërkesën për saktësimin e vendimit gjyqësor, për shkak të interpretimit të gabuar dhe diametralisht të kundërt të ligjit në raport me interpretimin e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje as pretendimit për kontradiktoritetin e vendimit të gjykatës së apelit. Si rrjedhojë e këtyre shkeljeve, sipas kërkuesit, masa e dëmshpërblimit e fituar prej tij me vendim gjyqësor të formës së prerë është ndryshuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk e ka riparuar këtë cenim. Mbi bazën e këtyre fakteve, kërkuesi pretendon se atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektin e aksesit, standardit të arsyetimit dhe ankimit substancial, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 142, pika 1 dhe 43 të Kushtetutës, të cilat hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës.

20. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se standardet e procesit të rregullt ligjor janë ngushtësisht të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi edhe i vetëm njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të

ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 86, datë 26.12.2017; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më lart, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se pretendimet lidhen me mënyrën e argumentimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të kërkuesit, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

22. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje se përse pretendimet e tij nuk përfshiheshin në kategorinë e rasteve të përcaktuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Ajo gjykatë nuk ka riparuar arsyetimin kontradiktor të vendimit të gjykatës së apelit, i cili është bazuar në norma që nuk ekzistojnë dhe ka ndryshuar vendimin gjyqësor të formës së prerë që kishte zgjidhur themelin e çështjes. Si rrjedhojë, është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi është mbajtur qëndrim formal. Kjo mënyrë e ushtrimit të rolit të Gjykatës së Lartë, në kushtet kur dy gjykatat më të ulëta kishin dhënë vendime diametralisht të kundërta, i ka cenuar kërkuesit edhe të drejtën e ankimit në aspekt të aksesit substancial në gjykatë. Sipas tij, Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për akses edhe për shkak se nuk është shprehur për pretendimet në rekurs mbi shkeljet e rënda të ligjit material dhe procedural të gjykatës së apelit, duke i kufizuar aplikimin e nenit 314 të KPC-së dhe duke e vendosur në pamundësi për të ezauruar mjetin mbrojtës procedural të garantuar nga ligji.

23. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

24. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë, i qartë dhe jo kontradiktor në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen nga Gjykata e Lartë në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 9, datë 26.3.2018; nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit ka natyrë kushtetuese, pasi, në thelb, lidhet me të drejtën e dëmshpërblimit si rrjedhojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, e drejtë e cila është fituar prej tij me vendim gjyqësor përfundimtar. Këtij pretendimi, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme, duke interpretuar dhe zbatuar në mënyrë diametralisht të kundërt nenin 314 të KPC-së, sipas të cilit gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar.

27. Kështu, konkretisht, gjykata e shkallës së parë e ka pranuar kërkesën për sqarim dhe interpretim, duke cilësuar edhe vlerën e pagës mbi të cilën do të duhej të bëhej ekzekutimi i vendimit të formës së prerë, që do të thotë se ajo gjykatë ka vlerësuar se një kërkesë e tillë, sipas nenit 314 të KPC-së, mund të ngrihet në gjykatë edhe kur ekzekutimi është në vijim e sipër. Ndërsa, gjykata e apelit e ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se neni 314 i KPC-së, në thelb, përcakton se kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv (vendimi gjyqësor) është ekzekutuar ose jo plotësisht. Sipas saj, në fazën e ekzekutimit, legjislacioni procedural parashikon mjete të tjera që mund të përdoren nga palët e interesuara. Në vijim, gjykata e apelit, ndonëse ka konstatuar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga ligji, ka vijuar me analizimin e pretendimit të kërkuesit për pagën referuese të dëmshpërblimit, duke e përcaktuar atë sipas gradës diplomatike dhe jo sipas pozicionit të fundit të punës së kërkuesit.

28. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, në vendimin e mospranimit të rekursit, ka parashtruar rrethanat dhe faktet e çështjes, si dhe ka listuar pretendimet e kërkuesit në rekurs, pjesa më e madhe e të cilave lidhet me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të nenit 314 të KPC-së. Arsyetimi i këtij vendimi është i kufizuar, duke u mjaftuar me qëndrimin se përfundimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

29. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, ndonëse gjendej përpara interpretimit diametralisht të kundërt të ligjit prej dy gjykatave më të ulëta, nuk u ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Për më tepër, arsyetimi i gjykatës së apelit se kërkesa të tilla nuk mund të ngrihen nëse ekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka filluar, bie ndesh në pamje të parë me vetë formulimin ligjor të nenit 314 të KPC-së, i cili parashikon shprehimisht si kufi kohor "*gjersa vendimi nuk është ekzekutuar*". Nga mënyra se si Gjykata Administrative e Apelit ka interpretuar këtë dispozitë ligjore, duket sikur mjafton që ekzekutimi të ketë filluar, pavarësisht masës së përmbushjes së detyrimit, qoftë edhe të pjesshme, që vendimi të konsiderohet i ekzekutuar. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit në raport me rrethanat dhe faktet e rastit konkret, në dukje është e paarsyeshme, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi i ishte drejtuar rrugës gjyqësore për mbrojtjen e një të drejte, të fituar gjyqësisht dhe ku vendimi gjyqësor që ia njihte atë lexohej në mënyra të ndryshme prej tij e përmbaruesit gjyqësor, nga njëra anë, dhe MEPJ-së, në cilësinë e debitorit, nga ana tjetër. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuesit për kontradiktën në arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit në drejtim të shkaqeve të rrëzimit të kërkesës, pasi ndonëse është konkluduar se kërkesa për sqarim është paraqitur jashtë afatit ligjor, ndaj nuk mund të shqyrtohej në themel, në vijim është mbajtur qëndrim mbi themelin e kërkesës për përcaktimin e pagës referuese të dëmshpërblimit.

30. Nën dritën e analizës së mësipërme, Gjykata ripohon rolin e Gjykatës së Lartë, e cila si gjykatë e ligjit i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të ushtruar rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta *(shih vendimet nr. 42, datë 7.7.2014; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit, të lidhur me aksesin dhe ankimin substancial, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues i kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-883, datë 13.5.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 15.3.2023.
Shpallur, më 12.4.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini
Anëtarë kundër: Elsa Toska, Genti Ibrahimi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Idriz Konjari dhe objekt "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-883, datë 13.5.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën*", nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur lidhur me pretendimin e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndaj çmojmë të shprehemi në mendim pakice për sa vijon.

2. Në mënyrë të përmbledhur, vlerësojmë se mënyra e arsyetimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë në kundërshtim me standardet kushtetuese të të drejtave themelore të njeriut për këto arsye kryesore:

2.1 Së pari, gjykatat e sipërpërmendura lidhur me diskutimin mbi kufijtë e zbatimit të mjetit procedural të parashikuar nga neni 314 të KPC-së (kërkesë për sqarim dhe interpretim të vendimit gjyqësor), u kanë dhënë përgjigje në mënyrë të qartë dhe shteruese pretendimeve të kërkuesit.

2.2 Së dyti, zbatimi i nenit 314 të KPC-së është natyralisht juridiksion i gjykatave të zakonshme, dhe mënyra se si ato e kanë interpretuar këtë dispozitë nuk arrin të provojë arbitraritet me pasoja antikushtetuese për të drejtat themelore të kërkuesit.

2.3 Së treti, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë cenimin e së drejtës substanciale të pronës, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që caktonte në dispozitiv detyrimin e pagesës së 15 pagave mujore dëmshpërblim për kërkuesin nga MEPJ-ja.

3. Konkretisht, shumica ka argumentuar: "Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit ka natyrë kushtetuese, pasi në thelb lidhet me të drejtën e dëmshpërblimit si rrjedhojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, e drejtë e cila është fituar prej tij me vendim gjyqësor përfundimtar. Këtij pretendimi, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme, duke interpretuar dhe zbatuar në mënyrë diametralisht të kundërt nenin 314 të KPC-së, sipas të cilit gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar." (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Po ashtu shumica analizon se "[...] Gjykata e Lartë, ndonëse gjendej përpara interpretimit diametralisht të kundërt të ligjit prej dy gjykatave më të ulëta, nuk u ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Për më tepër, arsyetimi i gjykatës së apelit se kërkesa të tilla nuk mund të ngrihen nëse ekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka filluar, bie ndesh në pamje të parë me vetë formulimin ligjor të nenit 314 të KPC-së, i cili parashikon shprehimisht si kufi kohor "*gjersa vendimi nuk është ekzekutuar*". Nga mënyra se si Gjykata Administrative e Apelit ka interpretuar këtë dispozitë ligjore, duket sikur mjafton që ekzekutimi të ketë filluar, pavarësisht masës së përmbushjes së detyrimit, qoftë edhe të pjesshme, që vendimi të konsiderohet i ekzekutuar. Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit në raport me rrethanat dhe faktet e rastit konkret, në dukje është e paarsyeshme, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi i ishte drejtuar rrugës gjyqësore për mbrojtjen e një të drejte, të fituar gjyqësisht dhe ku vendimi gjyqësor që ia njihte atë lexohej në mënyra të ndryshme prej tij e përmbaruesit gjyqësor, nga njëra anë, dhe MEPJ-së, në cilësinë e debitorit, nga ana tjetër. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje as pretendimit të kërkuesit për kontradiktën në arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit në drejtim të shkaqeve të rrëzimit të kërkesës, pasi ndonëse është konkluduar se kërkesa për sqarim është paraqitur jashtë afatit ligjor, në vijim është mbajtur qëndrim mbi themelin e kërkesës për përcaktimin e pagës referuese të dëmshpërblimit" (shih *paragrafin 29 të vendimit*).

4. Gjykata, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka

konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës. Sipas kësaj jurisprudence, arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2 datë 11.2.2021; nr. 7, datë 7.2.2017; nr. 6, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, por ajo mund ta ushtrojë këtë kompetencë vetëm duke analizuar faktet e natyrës kushtetuese *(shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

6. Në rastin konkret rezulton se me vendimin nr. 691, datë 16.2.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është pranuar pjesërisht padia e kërkuesit, duke u detyruar pala e paditur, Ministria e Punëve të Jashtme, t'i paguajë 15 paga mujore dëmshpërblim për shkak të mosrespektimit të procedurës dhe afatit në zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe kërkuesi ka vënë në lëvizje procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, vendimit gjyqësor. Më datë 9.10.2017 përmbaruesi gjyqësor ka lajmëruar me shkrim MEPJ-në për ekzekutimin vullnetar të detyrimit në favor të kërkuesit kreditor brenda afatit 5-ditor, duke i njoftuar shumën e detyrimit në vlerën 3,884,362 lekë, pas llogaritjes së 15 pagave mujore me vlerë 2,265 USD, të konvertuar në lekë. Sipas kërkuesit, MEPJ-ja, nëpërmjet urdhërxhirimit nr. 247, datë 12.4.2018, ka kaluar shumën prej 1.602.720 lekësh, duke lënë të paekzekutuar pjesën tjetër të detyrimit në vlerën 2,654,541 lekë (*shih paragrafët 4-6 të vendimit*).

7. Duke pretenduar se vendimi gjyqësor nuk ishte i qartë lidhur me shumën e dëmshpërblimit, pasi nuk identifikohej paga mujore sipas pozicionit të punës dhe as nëse paga ishte bruto ose neto, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e tij. Me vendimin e datës 1.10.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar kërkesën dhe ka sqaruar se: (i) pozicioni i punës, paga e të cilit do të shërbejë për llogaritjen e vlerës totale të dëmshpërblimit të dhënë nga gjykata në favor të kërkuesit është "*i ngarkuar me punë në ambasadën tonë në Malajzi, ku është paguar me pagë mujore 2,265 (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) dollarë*"; (ii) paga mbi të cilën llogaritet dëmshpërblimi është paga "*bruto*". Mbi bazën e ankimit të palës së paditur, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 108 (86-2021-766), datë 20.12.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 314 i KPC-së, duke u shprehur gjithashtu se referenca e pagës për llogaritjen e dëmshpërblimit ishte ajo e caktuar nga ministri përgjegjës dhe Këshilli i Ministrave sipas gradës diplomatike dhe jo paga e pozicionit të fundit të punës të mbajtur nga kërkuesi. Mbi bazën e rekursit të ushtruar nga

kërkuesi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-883, datë 13.5.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 (*shih paragrafët 7-10 të vendimit*).

8. Sikundër theksuam edhe më lart, në vlerësimin tonë kërkuesi nuk ka provuar cenimin e së drejtës kushtetuese të pronës, që synon të mbrojë nëpërmjet këtij ankimi kushtetues dhe as shumica nuk ka arritur të përcaktojë një të drejtë të tillë. Siç rezulton nga faktet, kërkuesi, me vendim të formës së prerë, ka fituar dëmshpërblimin për zgjidhjen e kontratës së tij të punës në mënyrë të paligjshme. Sipas këtij vendimi gjyqësor, masa e dëmshpërblimit është përcaktuar në masën e 15 pagave dhe jo në vlerë monetare. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se thjesht pritshmëritë e ligjshme dhe fitimet ose pasuritë e ardhshme sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së nuk mund të mbrohen nëse nuk gjejnë mbështetje, për shembull, me vendim gjyqësor të ekzekutueshëm. Kështu, pasuri në kuptimin e pronës do të kuptohet vetëm ajo që është përcaktuar me një vendim gjyqësor përfundimtar (*shih vendimin Pressos Compania Naviera S.a. e të tjerë kundër Belgjikës, (1995), prg.29-31*). Po ashtu, sipas kësaj gjykate, nga ana tjetër, kërkuesi nuk mund të pretendojë se ka një pritshmëri të ligjshme në rastin kur është vënë në diskutim interpretimi dhe zbatimi i saktë i së drejtës kombëtare dhe pretendimet e tij janë rrëzuar nga gjykatat kombëtare (*Anheuser-Busch Inc. v. Portugal [GC], § 65; Centro Europa 7 S.R.L. and di Stefano v. Italy [GC], § 173; Béláné Nagy v. Hungary [GC], § 75; Karachalios v. Greece (dec.), § 46; Radomilja and Others v. Croatia [GC], § 149*).

9. Në analizë të sa më lart, e drejta e pronësisë së kërkuesit është ajo që ka buruar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, i vënë në ekzekutim me anë të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, pra 15 pagat mujore, ndërkohë që e drejta e pretenduar nga kërkuesi, për një detyrim në vlerën 2,654,541 lekë, nuk përbën një të drejtë pronësore të matshme në kuptimin kushtetues, por një pritshmëri, të pretenduar si diferencë mes vlerës së detyrimit të paguar nga debitori dhe asaj që, sipas kërkuesit, është vlera e 15 pagave që i takojnë.

10. Shumica, duke e lidhur kërkesën e paraqitur në kuptim të nenit 314 të KPC-së me përcaktimin detyrues të vendimeve gjyqësore që kanë gjykuar në themel çështjen, ka vënë në dyshim vlerën përfundimtare të atij gjykimi dhe natyrën e tij *res judicata* në lidhje me të drejtën e pronës së kërkuesit. Në vlerësimin tonë, në kushtet kur nuk është vënë në diskutim nga palët në proces masa e detyrimit të përcaktuar nga gjykata, ajo prej 15 pagash, ose fuqia detyruese e atij vendimi, pretendimet në lidhje me mënyrën se si është përllogaritur vlera që i korrespondon këtyre pagave apo çdo pretendim i lindur gjatë procedurës përmbarimore, duhet të zgjidheshin me anë të mjeteve të ankimit që parashikon legjislacioni procedural.

11. Për sa i përket kërkesës sipas nenit 314 të KPC-së, gjykata e shkallës së parë e ka pranuar kërkesën për sqarim dhe interpretim, duke cilësuar edhe vlerën e pagës mbi të cilën do të duhet të bëhet ekzekutimi i vendimit të formës së prerë, ndërsa gjykata e apelit e ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se neni 314 i KPC-së, në thelb, përcakton se kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv (vendimi gjyqësor) është ekzekutuar ose jo plotësisht. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se përfundimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

12. Duke iu referuar vendimeve në fjalë konstatohet se gjykata e apelit ka argumentuar qëllimin e nenit 314 të KPC-së dhe kushtet që duhet të plotësohen për përdorimin e këtij mjeti procedural, duke vlerësuar se: "*[...] ky mjet ka për qëllim të sqarohen dhe interpretohen vetëm ato pjesë të arsyetimit të vendimit mbi faktin dhe ligjin të cilat nga ana e kërkuesit pretendohet se nuk janë ezauruese, në kuptimin që janë dukshëm të errëta, të paqarta apo kontradiktore aspektet të caktuara të vlerësimit dhe arsyetimit të gjykatës për zgjidhjen e çështjes në lidhje me ndonjërin nga kërkimet e padisë objekt gjykimi dhe veçanërisht në krahasim me atë që ka vendosur gjykata në dispozitivi e saj për zgjidhjen e çështjes*" (*shih paragrafin 31 të vendimit të gjykatës së apelit*).

13. Gjykata e apelit e ka vazhduar arsyetimin, duke u shprehur se ky mjet nuk ka për qëllim të ndryshojë disponimin e gjykatës në lidhje me zgjidhjen e çështjes, i cili tashmë përbën *res judicata*, çka nënkupton se çdo pretendim në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes ose refuzimin e palëve për zbatimin e vendimit, duhet të zgjidhet me mjetet ligjore përkatëse. Referuar nenit 314 të

KPC-së, ndreqja e gabimit është përcaktuar në mënyrë të qartë se bëhet për sa kohë që vendimi nuk është ekzekutuar, pasi nënkupton se gjatë kësaj procedure ka pasur paqartësi në lidhje me mënyrën/formën apo ekzekutimin. Pra, kërkesa të kësaj natyre mund të paraqiten përpara se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që përbën tashmë titull ekzekutiv, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse ky titull është ekzekutuar ose jo plotësisht apo nëse përmbaruesi ka vendosur ose jo pushimin e ekzekutimit (*shih paragrafin 33 të vendimit të gjykatës së apelit*). Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, Gjykata e Lartë, gjithashtu, ka qartësuar se "*në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore vlerësohet se përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural*" (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

14. Për sa më lart, gjykata e apelit, në ushtrimin e funksionit të saj për të kontrolluar vendimmarrjen e gjykatës më të ulët dhe për të interpretuar normën e zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, ka paraqitur argumente të mjaftueshme, të qarta dhe shteruese në lidhje me përfundimin e arritur prej saj. Ajo ka vlerësuar në vendim çështjet e faktit dhe të ligjit që kanë rezultuar në rastin konkret, duke përcaktuar momentin dhe kufijtë e zbatueshmërisë së mjetit të parashikuar nga neni 314 i KPC-së. Në të kundërt me qëndrimin e shumicës, sipas së cilës interpretimi i kësaj dispozite nga Gjykata Administrative e Apelit në dukje është i paarsyeshëm, ne vlerësojmë se interpretimi i kësaj gjykate, sipas të cilit kërkesa për interpretim mund të ngrihet para se të fillojë faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj nuk ka vlerë përcaktuese nëse titulli ekzekutiv (vendimi gjyqësor) është ekzekutuar ose jo, i mbështetur edhe nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë, nuk është i natyrës kushtetuese, por i natyrës ligjore, dhe si i tillë përbën element që ndan juridiksionin kushtetues nga juridiksioni i gjyqësorit të zakonshëm, ndaj nuk duhej të analizohej nga shumica.

15. Përveç sa më lart, edhe pse nuk vëmë në dyshim jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me rastet kur për shkak të qëndrimeve diametralisht të kundërta të gjykatave të faktit dhe mungesës së ndërhyrjes së Gjykatës së Lartë janë vënë në dyshim të drejtat themelore të individit, vlerësojmë se kjo qasje ka qenë e kufizuar dhe e kujdesshme pa dashur dhe pa synuar të zhveshë nga roli i saj Gjykatën e Lartë. Megjithatë, në rastin konkret Gjykata e Lartë, për sa kohë e ka gjetur të bazuar vendimin e gjykatës së apelit, duke e shprehur në mënyrë të qartë këtë qëndrim, kjo nënkupton se ajo ka vlerësuar të drejtë qëndrimin dhe mënyrën e zbatimit të ligjit prej gjykatës më të ulët.

16. Po ashtu, edhe argumenti tjetër i shumicës se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për kontradiktën në arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit në drejtim të shkaqeve të rrëzimit të kërkesës, pasi ndonëse është konkluduar se kërkesa për sqarim është paraqitur jashtë afatit ligjor, në vijim është mbajtur qëndrim mbi themelin e kërkesës për përcaktimin e pagës referuese të dëmshpërblimit, nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimit objekt kundërshtimi. Kjo pasi linja e arsyetimit dhe interpretimit të gjykatës së apelit harmonizohet me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke i dhënë kërkuesit përgjigje ezauruese në lidhje me mjetin e përdorur prej tij.

17. Për më tepër, duke iu referuar këtij arsyetimi, rezulton se gjykata e apelit ka vlerësuar se "*[...] në shërbimin diplomatik ligji i zbatueshëm i kohës përcakton qartë në nenin 39, shkronja "dh", se nëpunësi i shërbimit të jashtëm përfiton trajtim financiar të posaçëm në përputhje me statusin e tij. Kjo dispozitë, e zbërthyer në qëllimin dhe përmbajtjen e tij në aktet nënligjore, synon të përcaktojë se paga e nëpunësit të shërbimit diplomatik përcaktohet nga grada diplomatike që ai gëzon... Paga, sipas gradës diplomatike, caktohet nga Këshilli i Ministrave dhe individualisht nga ministri përgjegjës për punët e jashtme. Ndërsa në rastin, dhe vetëm për kohën kur diplomati ushtron detyrën në misione diplomatike e konsullore jashtë vendit, krahas pagës sipas gradës diplomatike përfiton edhe shtesë page bazuar në indekset e nivelit të jetesës së vendit pritës dhe kategorizimit të këtyre vendeve. Ky lloj trajtimi financiar gjen zbatim për aq kohë sa diplomati ushtron detyrën në këto misione diplomatike, duke përfituar kështu vetëm trajtimin financiar dhe pagën sipas gradës diplomatike kurdoherë që përfundon apo ndërpritet emërimi në misionet diplomatike e konsullore jashtë vendit.*" *(shih paragrafin 34 të vendimit të gjykatës së apelit).* Ky arsyetim i saj nuk shfaq kontradikta me pjesën tjetër të vendimit, përkundrazi është argument shtesë dhe rrjedhë logjike e vendimit, i parë në tërësinë e tij.

18. Në përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj Gjykate dhe fakteve të natyrës kushtetuese,

vlerësojmë se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtare: Genti Ibrahimi, Elsa Toska

KËRKESË
Nr. 128/7, datë 13.4.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Rehabilitimi i rrugës së ish-Repartit Ushtarak për në aeroportin e Rinasit"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Shoqëria Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "arë", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 477 120 (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT"'

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Nr. i pasurisë	Sip. totale m^2	Lloji i pasurisë	TOKË ARË			VLERA TOTALE LEK	Adresa	Shënime
								Sip. e shpr.	Çmimi (lek/m^2)	Vlera, lek			
1.	Skënder	Sinan	Kulli	1669	42/69	3150	Arë	1065	448	477120	**477,120.00**	Tiranë (Fushë-Prezë)	Konfirmuar ASHK Tiranë. Në favor BKT.. K. Hip. 1925/1016, datë 6.12.2018.
								1065	**448**	**477120**	**477,120.00**		

KËRKESË

Shtetasi Arbër Hasani kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpalljen të vdekur të shtetases Eda Hasani, e datëlindjes 9.9.1959, me banim në Bashkinë Elbasan.

KËRKUES
Arbër Hasani

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 66
Datë: 2023/04/19 15:41:40
1a06dd52-f86c-455d-940c-7bb255f50aee

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 912 lekë